Resurset natyrore janë tërësia e pasurisë, që ofrohet nga natyra dhe që krijohet në kushte specifike të terrenit. Sasia dhe larmishmëria e tyre lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me pozitën gjeografike dhe me kushtet natyrore që ka një hapësirë e caktuar gjeografike. Për të evidentuar llojshmërinë, cilësinë dhe sasinë e burimeve natyrore në dy bashkitë (Durrës dhe Shijak), ka rëndësi përcaktimi i kushteve natyrore të të gjithë hapësirës territoriale. Në *çështjen e parë*, përshkruhen veçoritë e ndërtimit gjeologjik sipas periudhave gjeokronologjike, duke filluar që nga periudha më e hershme, ajo tortoniane, e deri në periudhën më të vonë, atë kuaternare. Në *çështjen e dytë* përcaktohen format e relievit të krijuara mbi strukturat gjeologjike dhe njëkohësisht njësitë fiziko-gjeografike më kryesore të tij. Pjesë e kësaj çështjeje janë edhe tipet gjenetike që përbëjnë relievin e territoreve të bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut. Në *çështjen e tretë* përshkruhen kushtet e formimit të klimës së këtyre territoreve, si dhe karakteristikat më kryesore të rrezatimit diellor, temperaturës dhe reshjeve. Në *çështjen e katërt* jepen veçoritë e hidrografisë së bashku me elementët përbërës të tyre. Në *çështjen e pestë* dhe të *gjashtë* përcaktohen tiparet kryesore të tokave dhe biodiversitetit, që kanë përcaktuar peizazhin natyror në tërësi.

I.1.Ndërtimi gjeologjik

Territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut përfshihen në Përkuljen Pranadriatike. Karakteristike janë depozitimet terrigjene, të periudhës neogjenike dhe depozitimet aluvionale, detare dhe lagunore-kënetore të periudhës kuaternare. Shkëmbinjtë terrigjenë përfaqësohen nga molasat neogjenike, të moshës tortoniane (N_1^2t), mesiniane (N_1^3m) dhe suitës Helmesi të pliocenit (N_2H). I rëndësishëm është trajtimi i tyre sipas periudhave gjeologjike.

Shkëmbinjtë terrigjene më të hershme i përkasin periudhës së *Tortonianit* (N_1^3t). Të kësaj periudhe janë tri pakot litologjike si: pakoja argjilore-ranore ($N_1^3t(a)$), pakoja ranore-argjilore ($N_1^3t(b)$) dhe pakoja argjilore ($N_1^3t(c)$)¹¹. Pakoja argjilore-ranore ka trashësi 800-850m dhe ndërtohen nga shkëmbinjtë argjilorë, alevrolite e ranorë. Pakoja ranore-argjiloreka trashësi maksimale 175 m, ku mbizotëruese është prerja ranoro-argjilore shtresë trashë. Pakoja argjilorepërfaqësohet nga argjila masive, me trashësi rreth 700m. Këto depozitime kanë përhapje të gjerë në thellësi dhe sipërfaqe. Litofacja ranoro-argjilore karakterizohet nga ranorë e argjila të ndërthurura me gëlqerorë lithotamnikë. Ranorët kanë si karakteristikë fizike ngjyrën gri të çelët deri në të zverdhur ndërsa në thyerjet e reja kanë ngjyrë bezhë të errët. Ranorët paraqiten kompaktë, kokërmëdhën deri në kokërmesëm. Trashësitë e shtresave luhaten nga 0.5-1.5 m deri në 5-6 m. Argjilat paraqiten me ngjyrë gri në të kaltër, me ndërtim kuackor. Kanë trashësi nga 2-3 m deri në 15-20 m. Në brendësi të tyre mund të shihen mikrofauna 1-2 m të trasha me ngjyra të ndryshme. Madje në disa horizonte të mikrofaunës dallohen kristale të vegjël gipsi.

Periudha gjeologjike pasuese, mbas tortonianit, është periudha e *Messiniani* (N_1^3m). Depozitimet e Messinianit shtrihen në Kepin e Rodonit, në veri-perëndim të

¹¹ Serjani, A. *Mbi ndërtimin gjeologjik të zonës Durrës - Kepit të Rodonit*.

bashkisë së Durrësit. Nga ana litologjike ekzistojnë dy litofacie: litofacia ranoro-argjilore, në pjesën më lindore të hapësirës territoriale të marrë në studim dhe litofacia argjiloro-ranore në pjesën më perëndimore të kësaj hapësire. Në pjesët më të sipërme, ku është e përhapur facia argjiloro-ranore takohet edhe litofacia gipsmbajtëse. Gipset kanë përhapje në trajtë linzash brenda hapësirës së kësaj litofacie dhe trashësi deri në disa metra. Bashkëshoqëruese të litofacies argjiloro-ranore dhe gipsmbajtëse është zona faunistike me *Globorotalia conomiozea* dhe zona me *Globigerina multiloba*. Pjesa e sipërme e saj nuk ka tregues zonal dhe përfshihet në një zonë të papërcaktuar. Ndërsa në territoret ku gjen përhapje litofacia ranoro-argjilore takohen zonat faunistike të *Ammonia latiseptata*, *A. tepida* që datojnë moshën e Messinianit. Trashësia e depozitimeve të Messinianit arrin deri në 600 m në prerjen e Currilave¹².

Periudha më e vonshme neogjenike është periudha e *Pliocenit*(N₂). Depozitimet pliocenike janë të përhapura gjerësisht në territorin e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut, duke zënë pothuajse të gjithë hapësirën. I pranishme është formacioni litostratigrafik, që njihet me emërtimin suita “Helmesi”. Depozitimet e formacionit “Helmesi” fillojnë me shfaqjen në prerje të shtresave ranore dhe konglomerateve të pangopur, që përcaktojnë dyshemenë e tij dhe njëherazi praninë e transgresionit pliocenik¹³. Në zonën e Currilave trashësia ranore-konglomeratike arrin deri në 250 m. Ranorët e kësaj suite kanë trashësi nga 4-8 cm deri në 20-30cm. Ngjyra e tyre është hiri të verdhë. Ranorët janë të shkrifët nga çimentimi i dobët. Ata paraqiten kokërrvegjël dhe të mesëm, polimineralë, të tipit kuarcoro-feldshpatik. Argjilat predominojnë në prerje, janë gri hiri deri në të kaltërta, të buta deri në kompaktë, herë-herë shumë mikorë. Konglomeratet përbëhen nga zaje të përbërjes dhe formave të ndryshme. Takohen zaje të rrumbullakuara e gjysëm të rrumbullakuara me madhësi mesatare 4-10 cm. Janë kryesisht zaje kuarcitesh, serpentinite, gabro-dunitesh si dhe gëlqerorë e ranorë të moshave të vjetra deri në të reja, duke filluar nga ato të Jurasikut.

Studimet biostratigrafike të kryera në prerjet e depozitimeve të formacionit “Helmasi” kanë vërtetuar praninë e një faune të bollshme, në bazë të së cilës veçohet zona e lulëzimit me *Sphaeroidinellopsis*, biozona me *Globorotalia margaritae* dhe biozona me *Globorotalia puncticulata*¹⁴.

Mbi depozitimet neogjenike gjenden depozitimet e *Holocenit* (*Qh*), të cilat kanë përhapje të gjerë. Takohen pothuaj të gjitha tipet gjenetike si: kontinentale, ndërmjetëse dhe detare. Më të përhapura janë depozitimet aluviale, të cilat kanë mbushur pothuajse tërësisht territorin fushor të bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut. Përhapje të konsiderueshme kanë edhe tipet e tjera gjenetike, si kënetore e liqenore, lagunore e detare.

Depozitimet aluviale (me origjinë kontinentale) kanë përhapje të gjerë në territoret e ulta (fushore) të bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut. Këto depozitime janë formuar nga prurjet e fuqishme të lumenjve Ishëm dhe Erzen dhe i përkasin Holocenit të vonshëm. Pranë grykëderdhjeve të lumenjve të përmendur mësipërm këto depozitime janë të vendosura mbi depozitimet detare të Holocenit, kurse në drejtim të burimeve (pra në drejtim të lindjes), këto depozitime vendosen mbi zhavorret e periudhës së Pleistocenit. Depozitimet aluviale përfaqësohen nga rëra të imta, alevrite, argjila, zhavorre dhe zhurre.

Depozitime të tjera me origjinë kontinentale, të periudhës kuaternare janë dhe *depozitimet aluvialo-kenetore* (*Qkt*). Ato takohen kryesisht në fushën e Durrësit, që

¹²Serjani, A. *Mbi ndërtimin gjeologjik të zonës Durrës - Kepit të Rodonit*.

¹³Po aty.

¹⁴Po aty.

është përshkruar dhe përshkohet nga lumi Erzen. Depozitimetë tilla do t'i gjejmë edhe pranë Kepit të Rodonit. Këto depozitime i takojnë kryesisht Holocenit të vonshëm, kur me sa duket këto rajone përmblyeshin vazhdimisht nga lumenjtë, duke u kthyer kështu në kënetë. Depozitimet përfaqësohen nga ndërthurje alevritesh, rërash të imta, llum argjilor me material më të trashë, zhure e zhavorre.

Në zonën litorale të detit Adriatik janë të përhapura *depozitimet lagunore*, që janë depozitime ndërmjet atyre kontinentale dhe detare. Ato takohen pranë deltave të lumenjve Ishëm dhe Erzen. Karakteristika kryesore e këtyre depozitimeve është mungesa në to e lëndëve organike dhe prania e faunës detare (të ujërave të kripura). Ato përfaqësohen nga ndërthurje shtresash argjilore, alevritore e rërash dhe kanë trashësi deri në 10-15m.

Depozitimet me origjinë *detare(Qd)* dalin në sipërfaqe pranë vijës bregdetare deri në disa qindra metra në drejtim të brendësisë të territorit të bashkisë Durrës, dhe më në thellësi të territorit ato shtrihen poshtë depozitimeve lagunore, aluviale e kënetore. Depozitimet detare kanë trashësi nga 100 m në afërsi të bregdetit Adriatik deri në disa metra në brendësi të territorit. Në brezin bregdetar përfaqësuese janë rërat e shkripta dhe në thellësi të detit Adriatik është përfaqësues llumi deltinor. Vlen të theksohet që në fillimet e Holocenit të vonshëm (rreth 5 000 vjet me parë) deti Adriatik kufijte i ka patur më të shtrire. Depozitimet detare gjenden në cekëtinën detare të zonës qyteti i Durrësit-Kepi i Pallës si dhe në sterë; në zonën Rrushkull-Hamallaj dhe në veriperëndim të Kepit të Rodonit. Pranë Kepit të Pallës këto depozitime kanë trashësi 10 m në det pranë bregut dhe deri në 20-50 m në thellësi të detit Adriatik¹⁵.

Në tërësi depozitimet neogjenike dhe holocenike shprehen me një sasi të caktuar resurcesh gjeologjike, nëntokësore dhe mbitokësore. Deri në ditët e sotme, resurse natyrore me vlera të mëdha ekonomike mund të konsiderojmë qymyrgurin e Manzës, gipset, argjilat e Currilave dhe materialet inerte në sektorët e poshtëm të lumenjve Ishëm dhe Erzen.

I.2. Relievi

Relievi i territorit të bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut konsiderohet fushor-kodrinor. Fushat zënë 67% të sipërfaqes, ndërsa kodrat 33% të tyre. Territori fushor zënë pjesën qendrore, ndërsa territoret kodrinore gjenden në periferi të bashkive, sidomos në pjesën veriore, lindore dhe atë perëndimore. Lartësia maksimale mbi nivelin e detit është 269 m (afër fshatit Kuratni, bashkia Durrës). Nuk mungojnë as kriptodepresionet (2 m) në veri të fushës së Durrësit (bashkia Durrës). Lartësia mesatare është 135 m. Në tabelën e mëposhtme paraqitet lartësia hipsometrike e territoreve të Durrësit dhe të Shijakut.

Tabela 1. Lartësia hipsometrike në bashkinë e Durrësit dhe të Shijakut

Nr	Lartësitë	Sipërfaqja (në ha)	Përqindja (në %)
1.	Deri në 50 m	29 032	67%
2.	50-100 m	8 616	20%
3.	100- 150 m	3 919	9%

¹⁵ Serjani, A. *Mbi ndërtimin gjeologjik të zonës Durrës - Kepit të Rodonit.*

4.	150- 200 m	1 239	3%
5.	Mbi 200 m	373	1%

Burimi: Të dhëna të përfituara nga Arc GIS 10.1

Energjia e relievit është e vogël dhe shumë e vogël dhe kjo lidhet me përbërjen terrigjene dhe amplitudën e vogël të lëvizjeve tektonike ngritëse. Vlerat e coptimit horizontal janë të vogla, por të ndryshme për hapësira të ndryshme. Në territoret fushore vlerat e coptimit horizontal janë nën $1 \text{ km} / \text{km}^2$, ndërsa në territoret kodrinore marrin vlera nga $3-5 \text{ km} / \text{km}^2$. Relievi fushoro-kodrinor i këtyre bashkive është krijuar në kushtet e tektonogjenezën alpine dhe nën ndikimin e faktorëve të jashtëm. Si modelues kryesor të këtij relievit evidentojmë veprimtarinë detare dhe lumore. Mbi këtë bazë evidentojmë tipin gjenetike të relievit strukturor, lumor, bregdetar dhe erozivo-denudues.

I.2.1. Tipet gjenetike të relievit

I.2.1.1. Relievi strukturor

Territori i bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut karakterizohet nga një zhvillim morfologjik i vullshëm. Ky zhvillim lidhet me formimin e tij në kushtet e tektonogjenezës alpine dhe alpine të re, gjatë së cilës vazhdojnë të deformohen strukturat e Albanideve. Sipas gjeomorfologut Gj. Gruda, “kjo kushtëzohet drejtpërdrejt nga shtrirja e strukturave të Albanideve në brezin rrudhosës Alpino-Mesdhetar, i cili karakterisohet nga një deformim i vullshëm prej tektonikës së re (Miocen i mesëm-Pliocen) dhe asaj të sotme (Pliocen- Holocen)”¹⁶.

Territoret e të dyja bashkive janë të vendosura në struktura rrudhosëse (antiklinale dhe sinkliale). Karakteristikë e përgjithshme është përputhja e relievit me strukturën, ku përgjatë boshteve të strukturave sinkliale janë formuar fushat (e Durrësit dhe e Ishmit) dhe përgjatë boshteve të strukturave antiklinale janë formuar kodrat dhe vargje kodrinore (Durrës-Bishti i Pallës dhe Kepi i Rodonit-Prezë). Strukturat rrudhosëse (antiklinale dhe sinkliale) janë ripërtëritë nga tektonika bllokore, duke u shoqëruar me shkëputje tektonike gjatësore dhe shkëputje tektonike tërthore¹⁷. Shkëputjet tektonike gjatësore, të cilat kanë shtrirje veriperëndim-juglindje, shoqërojnë krahët perëndimor të strukturave, mbi të cilat konfigurohet relievi i bashkisës së Durrësit dhe të Shijakut, duke iu dhënë strukturave trajtë monoklinale. Shkëputjet tërthore, me trajtën e shtytjeve të majta apo të djathta, shprehen në reliev me ndryshimet në shtrirje të kurrizeve kodrinore të lartpërmendura¹⁸.

Në përgjithësi, format e relievit ruajnë drejtimin e strukturave ku janë formuar. Ato kanë drejtimin tipik të strukturave të albanideve, veriperëndim-juglindje.

¹⁶ Gruda, Gj. (2008). *Gjeomorfologjia e Shqipërisë*. Cikël leksionesh.

¹⁷ Po aty.

¹⁸ Balla, A. (2015). *Evolucioni morfotektonik dhe morfologjik i zonës bregdetare Shëngjin-Vlorë*. Disertacion, Tiranë.

I.2.1.2. Relievi lumor

Lumenjtë Erzen dhe Ishëm kanë ushtruar një rol modelues në relievin e territoreve të bashkisë së Durrësit dhe Shijakut. Pavarësisht se të dy lumenjtë konsiderohen të shkurtër, aftësia e tyre gërryerëse, transportuese dhe depozituese, e materialeve të ngurta ka qënë e madhe. Duke qënë se lumi Erzen transporton çdo vit rreth 3.2 milion ton materiale të ngurta, ai ka ndikuar në formimin e fushës së Durrësit. Lumi Ishëm, i cili transporton çdo vit rreth 2.2 milion ton materiale të ngurta ka ndihmuar në formimin e fushës së Ishmit. Gjatë periudhës së plotave lumenjtë ushtrojnë veprimtarinë e tyre më të madhe modeluese.

I.2.1.3. Relievi bregdetar

Sipas ndarjes më të re administrativo-territoriale, vetëm bashkia e Durrësit ka dalje të gjerë në detin Adriatik, në pjesën veriore, perëndimore dhe jugperëndimore të saj. Vija bregdetare, që fillon nga grykëderdhja e lumit Ishëm në veri deri tek përroi i Agaït në jug, ka një gjatësi rreth 61.8 km. Bregdeti është i tipit të ulët (akumulativ), por edhe i tipit të lartë (abraziv)¹⁹. Veçantia qëndron tek kombinimi i këtyre dy formave të relievit, por me mbizotërim të të parës. Relievi bregdetar i ulët përfaqësohet nga gjiret detare si: Rodonit, Lalëzit dhe i Durrësit, kurse relievi bregdetar i lartë evidentohet nëpërmjet klifeve apo falezave (në Kepin e Rodonit dhe në Malin e Durrësit).

Forma e gjireve detare në bregdetin e Durrësit kushtëzohet nga ndërtimi gjeologjik, zhvillimi i tektonikës së re dhe asaj të sotme, sasia e materialeve të ngurta të transportuara në det nga lumenjtë Ishëm dhe Erzen, drejtimi i rrymave detare të Adriatikut, veprimtaria e valëve të detit dhe sigurisht ndikimi i njeriut. Sipas Pano, N. "bregdeti i Durrësit shtrihet në bregdetin shelfor të Adriatikut, si pjesë e cekëtinës detare të këtij të fundit. Ky bregdet pëson lëvizje tektonike ngritëse. Në përgjithësi cekëtina detare është e sheshtë (me një pjerrësi të vogël) deri në thellësinë 50 m, si rezultat i depozitimeve ranore të sjella nga lumenjtë e lartpërmendur, si dhe nga baret nënujore"²⁰. Vlerat e transportit të ngurtë, duke përfshirë dhe materialet copëzore fundore të lumenjve janë 3.2 milion ton në vit (për Erzenin) dhe 2.2 milion ton në vit (për Ishmin)²¹.

Pjesa më e madhe e këtyre materialeve përfundojnë në grykëderdhje, të cilat ndikojnë në mbushjen e cekëtinës detare me aluvione. Materialet e ngurta shpërndahen dhe grumbullohen nga veprimtaria e valëve detare dhe e rrymave detare. Drejtimi kryesor i valëve të detit Adriatik është jugperëndim dhe perëndim. Lartësia maksimale e valëve shkon deri në 2.0-3.0 m dhe kjo kushtëzohet nga tiparet morfologjike e morfometrike të cekëtinës detare, si dhe shpejtësisë së erës. Nivelet ekstreme ndikohen nga erërat intensive me drejtim det-tokë ose anasjelltas. Nivelet më të larta të valëve vrojtohen gjatë veprimit të erërave me drejtim jugor që kanë shpejtësi dhe kohëzgjatje më të madhe²². Lartësitë më të mëdha vërehen gjatë gjysmës së ftohtë të vitit dhe kjo lidhet me kushtet klimatike të kësaj periudhe, ndërsa gjatë pranverës dhe verës luhatjet e nivelit të detit janë të njëjta. Amplituda vjetore e nivelit të detit shkon deri në 1.4 m, ashtu siç paraqitet në tabelën e mëposhtme.

¹⁹ Frashëri, A., (2012). *Gjeomonumentet që tregojnë historinë e tokës shqiptare*. Tiranë, faqe 172-182.

²⁰ Pano, N. (2008). *Pasuritë ujore të Shqipërisë*, Tiranë, faqe 40-44.

²¹ Gruda, Gj. (2008). *Gjeomorfologjia e Shqipërisë*. Cikël leksionesh.

²² Balla, A. (2015). *Evolucioni morfotektonik dhe morfologjik i zonës bregdetare Shëngjin-Vlorë*. Disertacion, Tiranë, faqe 43.

Tabela 2. Shpërndarja brendavjetore e niveleve të bregdetit në Durrës (mbi 0 absolute)

Vendmatja	Stinët				Nivelet		Amplituda
	Dimër	Pranverë	Verë	Vjeshtë	Maksimale	Minimale	
Durrës	15 cm	10 cm	10 cm	16 cm	92 cm	-48 cm	140 cm

Burimi: Pasuritë ujore të Shqipërisë, faqe 403

Pavarësisht veprimit të mekanizmave të përgjithshëm, secili nga gjiret është krijuar në kushte specifike dhe ka tipare morfologjike të veçanta.

Gjiri i Lalzës është 32 km i gjatë dhe gjendet midis Bishtit të Pallës dhe kodrave Rodon-Ishëm. Karakteristike është forma e rregullt e tij, në trajtë hënore, me lugëzim nga perëndimi. Gjiri i Lalzës është formuar nga lëvizjet tektonike ngritëse (të strukturës në të cilën është krijuar), nga materialet e ngurta që ka sjellë lumi i Erzenit dhe veprimtaria e valëve detare të Adriatikut. Në këtë gjiri detar gjendet plazhi i Shën Pjetrit, i Hamallës, i Rushkullit dhe i Sektorit Rinia.



Foto 1: Gjiri i Lalzës

Gjiri i Rodonit ndodhet në pjesën më veriore të bashkisë së Durrësit. Ai është krijuar nga veprimtaria e valëve të detit Adriatik dhe materialet e ngurta të sjella nga lumi i Ishmit. Ndryshimi i grykëderdhjes së lumit Ishëm, gjatë periudhës së sistemit komunist, ka bërë që kjo vijë bregdetare të pësojë ndryshime. Në bregdet, ky gjiri përfundon me një plazh të pyllëzuar²³.

Gjiri i Durrësit është 35 km i gjatë, por bashkisë së Durrësit i përkasin vetëm 10 km, nga përroi i Agait deri në plazhin e Currilave. Përgjatë gjirit të Durrësit rëra është kuarcore, ku kokrrizat variojnë nga të imta (0.1- 0.4 mm diametër) deri në mesatare (0.4 -1.25 mm diametër). Gjerësia e plazheve shkon nga 150-180 m. Rëra është e pastër dhe në disa sektorë janë krijuar duna rëre të vogla. Përgjatë bregdetit gjendet një pyll me pisha të buta, i cili është pakësuar si rezultat i rritjes së sipërfaqeve truall. Në këtë gjiri detar gjenden plazhi i Currilave, i Durrësit dhe i Shkëmbit të Kavajës.

Sikurse u trajtua edhe më sipër, gjiret detarendahen midis tyre nga kepe dhe relieve kodrinore. Ato janë:

²³Programi CARDS, (2005). *Ishmi dhe rizgjimi i vlerave të tij. (Të njohim Ishmin)*. Durrës, faqe 28

Kepi i Rodonit është më i madhi në vendin tonë. Ndodhet në pjesën veriore të bregdetit të Durrësit, midis gjirit të Rodonit në veri dhe gjirit të Lalzit në jug. Ai shtrihet në formë trekëndëshi dhe futet rreth 4-5 km në thellësi të detit. Përbëhet nga formacione molasike të moshës gjeologjike të tortonianit. Veprimtaria gërryerëse e detit Adriatik ka ndikuar në krijimin e kontureve të tij harkore dhe në formimin e falezave me lartësi rreth 25m mbi nivelin e detit²⁴. Klifi ose faleza është një shpat përgjithësisht i pjerrët deri në trajtë gremine, i cili ngrihet menjëherë drejtpërdrejt nga niveli i detit ose platforma e abrazionit. Thellësia e ujit pranë disa falezave është e vogël, duke krijuar kushte për thyerjen e valëve, prandaj këto faleza i nënshtrohen veprimtarisë abrazive gjatë rrëzës ose pjesës së poshtme të tyre, kurse në pjesën e sipërme ato modelohen nga tjetërsimi ose dukuritë shpatore bashkëshoqëruese (shembjet, rrëzimet apo rrëshqitjet). Kepi dhe falezat e Rodonit janë pjesë e rrejtës së Zonave të Mbrojtura, në vendin tonë. Këto territore konsiderohen si gjeomonument, si pjesë e kategorisë së III, Monumente Natyre.

Rrjedhjet gjeomorfologjike e tërheqjes së falezës është formimi i platformës së abrazionit para saj, përmasat e së cilës janë në varësi të ritmit të tërheqjes së falezës gjatë brigjeve shkëmbore të larta. Prania e veprimtarisë mekanike të valëve gjatë brezit të rrëpirës, pra tërheqja e vazhdueshme e saj, për rrjedhje dhe rritja e platformës së abrazionit realizohen kur ndodhin ngritje periodike të nivelit të detit²⁵.




Foto 2: Kepi i Rodonit dhe Falezat në krahun jugperëndimor të tij

Mali i Durrësit shtrihet nga plazhi i Currilave e deri tek Bishti i Pallës (Palit). Përfaqëson një strukturë antiklinale me lartësi 178m mbi nivelin e detit, ku vihen re dukuritë e abrazionit detar. Duke qenë se Mali i Durrësit ndërtohet nga shkëmbinjtë terrigjenë (lehtësisht të gërryeshëm) dhe energjia e valëve detare është e madhe, procesi i gërryerjes dhe i denudimit është i vazhdueshëm. Proceset e shpatit dhe veprimtaria e valëve detare kanë mundësuar, në pjesën perëndimore të tij, krijimin e plazhit të Kallmit.

²⁴Programi CARDS, (2005). *Ishmi dhe rizgjimi i vlerave të tij. (Të njohim Ishmin)*. Durrës

²⁵ Gruda, Gj (2003). *Gjeomorfologjia*. Tiranë.

1.2.1.4. Relievi erozivo-denudues

Pavarësisht se territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut gjenden në një relief fushoro-kodrinor, ku kontrastet e tij, energjia dhe copëtimi i relievit është i vogël, janë prezente format denuduese të relievit. Këto dukuri shpatore vihen re në shpatet perëndimore të vargut kodrinor Durrës-Bishti i Pallës, në shpatet lindore të kodrave Rodon-Prezë dhe në zona të vogla të kodrave të Arapajt. Zhvillimi i proceseve të shpatit në territoret e këtyre bashkive lidhet me përbërjen terrigjene, pjerrësinë e rënies së shtresave shkëmbore, karakterin kapricioz të klimës mesdhetare fushore, e cila ndikon në intensitetin e rrjedhjeve sipërfaqësore, me veprimtarinë e valëve detare dhe mungesën e bimësisë.

Zonat kodrinore në shpatin lindor Rodon-Prezë dhe Arapaj përbëhen prej shkëmbinjve terrigjenë, të cilët konsiderohen si lehtësisht të gërryeshëm prej pikave të shiut (dispergimit) dhe përroskave, përrenjëve dhe rrëqeve që ato krijojnë. Aktivizimi i këtyre të fundit kryhet nëpërmjet reshjeve intensive dhe të ç'rregullta, ndryshimit të temperaturës së ajrit gjatë vitit, të cilat çojnë në prishjen e këndit të qetësisë natyrore të shpatit. Mungesa e bimësisë natyrore bën që pika e shiut të godasë me një forcë më të madhe tokën, duke çuar në dispergimin e një sasive më të madhe të materialit, i cili përfshihet në rrjedhjen sipërfaqësore ujore.


Procesi denudues është aktiv në kodrat e Currilave, në shpatin jugperëndimor të Malit të Durrësit. Përbërja argjilore e këtyre territoreve, këndi i rënies së shtresave shkëmbore pothuajse 45° , dhe mungesa e bimësisë barishtore apo bimëve të larta ka bërë që gjatë gjysmës së lagësht të vitit të zhvillohet procesi i rrëshqitjeve të tokës. Kjo rrëshqitje e dheut (tokës), krijohet në ato raste kur argjila mbingopet me ujë dhe krijon një gjendje plastike, të paqëndrueshme. Njëkohësisht, proceset shpatore të rrëzimeve evidentohen pothuajse përgjatë të gjithë relievit bregdetar të lartë të Durrësit. Veprimtaria gërryerëse e valëve detare në pjesën fundore të shpatit shoqërohet me rrëzime dhe rrëshqitje të vazhdueshme, duke krijuar format më karakteristike të relievit abraziv, falezat.

Forcat e brendshme të tokës dhe veprimi i faktorëve të jashtëm (ndërtimi gjeologjik, klima, hidrografia, lloji i tokave dhe lloji i bimësisë) kanë mundësuar krijimin e disa formave të relievit.

I.3.Njësitë fiziko-gjeografike të territoreve të bashkisë së Durrësit dhe Shijakut

Studimet administrativo-territoriale kushtëzojnë studimin e copëtuar të njësive fiziko-gjeografike. Në hapësirën territoriale të bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut bën pjesëfusha e Durrësit, një pjesë e fushës së Ishmit (fusha në të majtë të lumit Ishëm), vargu kodrinor Durrës-Kepi i Palit dhe pjesa veriore e vargut kodrinor Rodon-Erzen. Në hartën e mëposhtme paraqitet shtrirja hapësinore e njësive fiziko-gjeografike të këtyre territoreve.

Harta nr.5 Njësitë fiziko-gjeografike të territoreve të bashkisë së Durrësit dhe Shijakut.



Punuar: Arc GIS 10.1, viti 2016

I.3.1. Fusha e Durrësit

Fusha e Durrësit shtrihet në qendër të territoreve të bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut. Ajo zë rreth 64% të hapësirës territoriale. Kufizohet në lindje nga vargu kodrinor Kepi i Rodonit-Vorë-Erzen, kurse në jugperëndim nga vargu kodrinor i Durrësit-Kepi i Palit. Në veriperëndim ka dalje të gjerë në detin Adriatik (aty ku është krijuar dhe gjiri i Lalëzit). Në juglindje vazhdon në bashkinë e Kavajës. Fusha e Durrësit është krijuar në dy struktura sinklinale. Sipas studimeve të Qendrës së Studimeve Gjeografike (1991), strukturat sinklinale marrin emërtimin sinklinali i Pezë-Shijakut dhe i Durrësit, ndërsa sipas gjeomorfologut Gruda, struktura sinklinale emërtohet “Sinklinali i Erzenit të poshtëm” prandaj në literaturën shkencore mund të gjenden të dyja emërtimet. Këto dy struktura sinklinale ndahen nga njëra-tjetra nga struktura antiklinale e Shkozës, e cila shfaqet në relief nëpërmjet kodrave Shënavlashaj-Arapaj, me lartësi 20-30 m mbi nivelin e detit. Ky antiklinal në krahun jugperëndimor shoqërohet me shkëputje tektonike gjatësore, me kënd të rënies së shtresave shkëmbore 50-60°. Fusha është formuar nga veprimi i lëvizjeve neotektonike ngritëse, i veprimtarisë gërryerëse dhe akumuluese të lumit Erzen dhe veprimtarisë së valëve të detit Adriatik. Dëshmuar i lëvizjeve tektonike ngritëse është thellimi i shtratit të Erzenit deri në 4-5 m në trashësinë aluvionale²⁶. Fusha e Durrësit përbëhet nga dy nënjjesi si: *fusha e Shijakut* dhe *fusha e Spitallës*.

Fusha e Shijakut shtrihet në të dyja krahët e lumit Erzen, nga qendra e Shijakut në jug deri në gjirin e Lalëzit në veri. Në veri dhe në lindje kufizohet me shpatet perëndimore të vargut kodrinor Rodon-Vorë-Erzen, ndërsa në jugperëndim kufizohet me vargun e ulët kodrinor Shënavlash-Arapaj. Gjerësia maksimale e fushës është rreth 10 km, kurse gjatësia e saj rreth 24 km. Në drejtim të veriut fusha zgjerohet duke dalë në gjirin e Lalëzit, aty ku janë krijuar plazhi i Rrushkullit, Hamallajt dhe Shën Pjetrit. Fusha e Shijakut është e vendosur në strukturën sinklinale të Pezë-Shijakut²⁷. Nga ana morfologjike kjo fushë paraqitet e rrafshët dhe me pjerrësi të vogël në drejtim të veriut. Lartësia maksimale e fushës rreth 36m mbi nivelin e detit, kurse në afërsi të gjirit të Lalëzit vetëm 0.5m.

Fusha e Spitallës shtrihet midis vargut kodrinor Durrës-Porto Romano-Bishti i Pallës, në perëndim dhe kodrave Shënavlash-Rrashbull-Arapaj në lindje. Shtrirja gjatësore është rreth 15 km, kurse gjerësia vetëm 4 km. Fusha ka pjerrësi të vogël nga periferia në drejtim të qendrës. Fusha e Spitallës është krijuar nga bonifikimi i kënetës së Durrësit mbas vitit 1965-së. Kjo fushë vendoset mbi sinklinalin e Spitallës (Durrësit).

I.3.2. Fusha e Ishmit

Në relief, fusha e Ishmit gjendet në të dyja krahët e lumit me të njëjtin emër. Ka përmasa më të vogla se fusha e Durrësit. Kufizohet në jugperëndim me vargun kodrinor Rodon-Erzen. Në brendësi të bashkisë së Durrësit gjendet një sipërfaqe rreth 22 km² e kësaj fushe. Fusha ka shtrirje gjatësore rreth 10 km dhe gjerësi rreth 2.2 km. Lartësia e fushës është vogël, e cila ulët nga juglindja në drejtim të veri-perëndimit (tek gjiri i Rodonit). Fusha e Ishmit është e vendosur në pjesën qendrore të sinklinalit Lezhë-Tiranë²⁸. Pjesa jugperëndimore e sinklinalit të Tiranës është zhytur tektonikisht nën strukturën monoklinale të Prezës, ku kjo e fundit mbihet drejt veri-lindjes mbi këtë sinklinal. Në këtë pjesë, kjo strukturë merr tiparet e një grabeni (pasi

²⁶ Gruda, Gj. (2015): Leksione të shkruara

²⁷ Qendra e Studimeve Gjeografike (1990). *Gjeografia fizike e Shqipërisë*. volumni 2, Tiranë.

²⁸ Programi CARDS, (2005). *Ishmi dhe rizgimi i vlerave të tij. (Të njohim Ishmin)*. Durrës.

mbizotërojnë lëvizjet tektonike ulëse), e cila shprehet në relievnë trajtën pothuajse të rrafshët të saj²⁹.

I.3.3. Vargu kodrinor Durrës -Bishti i Pallës

Ky vargu kodrinor është rreth 12 km i gjatë, në formë trapezi të stërgjatur³⁰. Shtrihet në jugperëndim të fushës së Durrësit. Krahu perëndimor i tij ka rënie të pjerrët në detin Adriatik. Nga pikëpamja tektonike njihet si vazhdim strukturor i antiklinalit Ardenicë-Divjakë-Kryevidh-Durrës-Bishti i Pallës³¹. Në relievnë janë të dallueshme dy njësi morfologjike, konkretisht vargu kodrinor Durrës-Porto Romano dhe sektori kodrinor Bishti i Pallës. Diferencimi i tyre lidhet me veprimtarinë tektonike dhe dinamikën jo të njëjtë të valëve detare. Ndërprerja e vargut kodrinor Durrës-Bishti i Pallës bëhet në sektorin e Porto Romanos, pikërisht nga një shkëputje tërthore, gjë që ka çuar në formimin e gjirit të vogël me të njëjtin emër. Kjo shkëputje shpreh njëkohësisht ndryshimin e menjëhershëm të lartësisë në relievnë. Lartësia maksimale e këtyre kodrave është 178 m mbi nivelin e detit. Kjo lartësi zbret në drejtim të veriut, në 83 m (Porto-Romano) dhe 49m në (Kepin e Palit).

Kodrat e Durrësit (Mali i Durrësit), që përbën pjesën jugore të këtij vargu kodrinor, gjenden në jugperëndim të fushës së Spitallës. Mali i Durrësit ka një gjatësi rreth 8.2 km dhe gjerësi deri në 2 km³². Lartësia maksimale gjendet pothuajse në qendër të këtyre kodrave. Kodrat Durrës-Porto Romano janë krijuar në strukturën antiklinale me të njëjtin emër, pra kemi përputhje të relievit me strukturën. Në relievnë shprehet vetëm krahu lindor i kësaj strukture, ndërsa krahu perëndimor gjendet i zhytur në detin Adriatik, si rrjedhojë e shkëputjes gjatësore që shoqëron krahun perëndimor të kësaj strukture. Këndi i rënies së shtresave shkëmbore është pothuajse vertikale 60-70⁰, duke dhënë kësaj strukture tiparet e një kreshte monoklinale gjatë së cilës janë formuar kodrat e Kallmit. Në këtë kreshtë vihen re disa qafa erozive. Shpati lindor i këtyre kodrave përfundon shkallë-shkallë në drejtim të fushës së Durrësit duke përfaqësuar gjithashtu një rrëpirë shkëputëse si ajo e shpatit perëndimor. Kjo morfologji e shkallëzuar lidhet me përbërjen litologjike dhe me stabilizimin e rrëshqitjeve të hershme.

Sektori kodrinor Bishti i Pallës, ka një gjatësi rreth 2 km dhe gjerësi mesatare 150-180 m. Lartësia më e madhe është 55.3 m në qendër, por që ulet në drejtim të veriut në 49 m dhe të jugut përkatësisht në 30 m lartësi. Kurrizi ruan pak tiparet e një kreshte. Shpati lindor ka pjerrësi të vogël, kurse nëshpatin perëndimor pjerrësia është shumë e madhe. Në këtë krah krijohen faleza të kapura nga abrazioni detar, në të cilat vihen re rrëshqitje (dukuri shpatore).

I.3.4. Vargu kodrinor Rodon-Erzen

Kodrat Rodon-Erzen shtrihen midis fushës së Durrësit në perëndim dhe asaj të Ishmit në lindje dhe kanë drejtim veriperëndim-juglindje. Kodrat kanë një gjatësi rreth 40 km. Brenda territorit të marrë në studim përfshihet një pjesë e këtij vargu kodrinor, nga Rodoni deri në Prezë. Gjerësia maksimale e tyre mund të arrihet deri në 8.5 km.

²⁹ Balla, A. (2015). *Evolucioni morfotektonik dhe morfologjik i zonës bregdetare Shëngjin-Vlorë*. Disertacion, Tiranë.

³⁰ Sala, S. (2010). *Rrëshqitjet në kodrat Durrës-Bishti i Pallës: kostot mjedisore, ekonomike dhe sociale*. Kumesë në Konferencën Ndërkombëtare të Gjeografisë: "Roli i gjeografisë në menaxhimin e rreziqeve natyrore dhe humane", Tiranë, faqe 129-137.

³¹ Balla, A., Gruda, Gj. (2015). *Tiparet morfotektonike e morfologjike të zonës bregdetare Kepi i Rodonit-Durrës*. Studime Gjeografike nr.18, Tiranë, faqe 37-45.

³² Pasha, M., (2006): "Gjeografia ushtarake" Botim elektronik, Tiranë, faqe 81.

Lartësia më e madhe (që gjendet në brendësi të territoreve të Durrësit) është 269 m mbi nivelin e detit (në afërsi të fshatit Kuraten), kurse lartësia më e ulët në Kepin e Rodonit. Forma e relievit është në përputhje me strukturën ku është formuar. Ato janë formuar gjatë monoklinalit të Prezës. Trajta monoklinale e kësaj strukture është formuar nga tektonika e re dhe ajo e sotme, duke u shoqëruar me shkëputje normale në krahun verilindor dhe veriperëndimor. Shkëputja normale e krahut verilindor i ka dhënë kësaj strukture tipare të një kreshte monoklinale me rënie jugperëndimore të shtresave deri në 30°³³. Relievi i kësaj kreshte monoklinale është tepër i copëtuar dhe dallohet për dendësi të lartë të copëtimit. Në reliev shfaqen kodra të ndara me lugje të vogla, të zhvilluara nga dukuritë shpatore.

Nga ana morfologjike ky varg kodrinor është tepër i coptuar, veçanërisht nga ana horizontale. Për këtë arsye, në peizazh dallohen kodra të ndara nga lugje të vogla. Energjia e relievit varion nga 50-300 m/ km².

I.3.5. Vargu kodrinor Shënavlash- Shkëmbi i Kavajës

Në territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut gjendet edhe vargu kodrinor i ulët Shënavlash-Shkëmbi i Kavajës. Ky varg kodrinor është pjesë e kodrave Kavajë-Shënavlash. Në territoret e Durrësit lartësia maksimale arrihet në Shkëmbin e Kavajës (monument natyre) me 105 m mbi nivelin e detit. Në drejtim të veriut lartësia ulet deri në 20-30 m mbi nivelin e detit. Vargu kodrinor është krijuar në strukturën antiklinale të Shkozës dhe kalon në mes të fushës së Durrësit.

Të gjitha format e relievit të lartpërmendura, pavarësisht me dukuritë natyrore negative që shoqërohen, konsiderohen resurse natyrore, me vlera shkencore, edukuese dhe ekonomike. Me vlera të veçanta ruajtjeve janë: falezat e Rodonit, plazhi Shën Pjetrit dhe plazhi i Kallimit, të cilat janë përfshirë në kategorinë e tretë, të Zonave të Mbrojtura, (Monumente Natyre, nënkategoria, gjeomonumente).

I.4. Klima

Territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut, si pjesë territoriale e Shqipërisë, bëjnë pjesë në gjerësitë gjeografike mesatare. Dalja e gjerë në detin Adriatik, si pjesa më veriore e detit Mesdhe, i jep klimës tipare mesdhetare. Tipari dallues i klimës mesdhetare është ekzistenca e katër stinëve (pranvera, vera, vjeshta dhe dimri). Në formimin e klimës së vendit tonë në tërësi dhe klimës tipike në hapësirën territoriale të Durrësit e të Shijakut kanë ndikuar rrezatimi diellor, qarkullimi i masave ajrore të përgjithshme dhe faktorët lokal. Ndikim dominues në formimin e klimës e ka energjia diellore e drejtpërdrejtë, deti Adriatik dhe relievi fushor-kodrinor. Një ndikim më të vogël ushtrojnë masat qarkulluese të ajrit, lloji i tokave, mbulesa bimore dhe veprimtaria e njeriut në këto territore.

Sipas zonalitetit klimatik të përcaktuar për vendin tonë, territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut bëjnë pjesë në zonën e klimës mesdhetare fushore, nënzona qëndrore. Kjo konsiderohet si një zonë që merr sasi të mëdha të rrezatimit diellor. Sipas të dhënave nga Instituti Meteorologjik Shqiptar, kjo hapësirë territoriale merr rreth 192.3 kkal/ cm² gjatë një viti kalendarik, në kushtet e motit pa vranësira. Rëndësi ka jo vetëm sasia e madhe e energjisë diellore por edhe shpërndarja gjithëvjete pothuajse e njëjtë e saj. Në total hapësira territoriale e marrë në studim merr mesatarisht rreth 2606 orë diellore gjatë një viti³⁴. Numri i ditëve me diell është

³³ Balla, A. (2015). *Evolucioni morfotektonik dhe morfologjik i zonës bregdetare Shëngjin-Vlorë*. Disertacion, Tiranë

³⁴ Instituti Meteorologjik Shqiptar (1975). *Klima e Shqipërisë*. Tiranë

340 ditë. Vlerat më të mëdha të këtij rrezatimi i kanë muajt korrik dhe gusht me 324 orë në të 31 ditët e tyre, kurse vlerat më të vogla muajt dhjetor dhe janar 105-116 orë në 22-25 ditë³⁵.

Rezatimi diellor i ndikuar dhe nga faktorët lokal ka përcaktuar këto tipare të temperaturave të ajrit. Temperatura mesatare vjetore është 16⁰C. Muaji më i ngrohtë është korriku me temperaturë mesatare 23.8⁰C. Dimri është i butë me ndikim të fortë detar. Temperatura mesatare e janarit lëkundet nga 7,5-8.2⁰C. Minimumet absolute zbresin deri në -6⁰C dhe -7⁰C. Temperatura maksimale absolute e regjistruar ka arritur në 39.0⁰C regjistruar në 14 gusht 1957, ndërsa minimumi absolut -6.2⁰C regjistruar në 26 janar 1954 në qytetin e Durrësit³⁶. Temperaturat më të mëdha se 20⁰C zgjasin 150-160 ditë në vit dhe vendosen pothuajse në mënyrë të qëndrueshme nga muaji maj deri në 10-ditëshin e parë të tetorit.

Periudha me ngrica është e shkurtër. Numri i ditëve të akullta është i kufizuar. Zakonisht vrojtohen 15-30 ditë në vit, gjatë të cilave temperatura minimale zbrit nën 0⁰C ose është 0⁰C. Ditët e akullta duken nga fundi i nëntorit deri nga fundi i 10-të ditësisht të parë të marsit. Por përgjithësisht ato janë të përqëndruara gjatë janarit dhe shkurtit³⁷. Periudha e vegetacionit (temperaturat mesatare mbi 10⁰C) fillon mesatarisht në fillim të marsit dhe vazhdon deri në fillim të dhjetorit. Afërsia e zonës me detin bën që në pranverë ngrohja të jetë e ngadaltë. Tipari dallues i kësaj nënzone klimatike është dimri i butë dhe i lagësht dhe vera e nxehtë dhe e thatë.

Territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut bëjnë pjesë në zonat më me pak reshje në vendin tonë, kjo si rezultat i relievit fushor dhe pjesërisht kodrinor (përgjithësisht i ulët), i cili nuk mundëson shkarkimin e masave ajrore të ngopura me lagështirë. Mesataria shumëvjeçare vjetore ndryshon nga 1000-1273 mm³⁸. Numri i ditëve me reshje lëviz mesatarisht nga 90-110 ditë në vit. Numri mesatar i ditëve me reshje është 116,0 ditë në vit³⁹. Reshjet kanë rregjim të ç'rregullt. Muaji më i lagësht është dhjetori me një diferencë të vogël me nëntorin. Kështu dhjetori e ka mesataren rreth 120 mm reshje. Korriku dhe gushti janë muajt më të thatë, respektivisht me një mesatare prej 23 mm dhe 31 mm⁴⁰. Stina e verës është stina më e thatë e vitit.

Rënia e dëborës është një dukuri e rrallë. Breshëri është i pranishëm dhe bie mesatarisht në 0,6 ditë në vit. Ai është karakteristik në çdo stinë, por më i theksuar në dimër. Afërsia me detin Adriatik (efekte zbutëse të klimës) dhe lartësia e vogël mbi nivelin e detit janë dy arsye që reshjet në këtë zonë bien kryesisht në formën e shiut.

Elementi i tretë klimatik është era. Ajo në përgjithësi ka dy drejtime. Gjatë stinës së vjeshtës dhe të dimrit mbizotërojnë erërat e kuadratit të veriut. Në gjysmën e ngrohtë të vitit mbizotërojnë erërat e kuadratit perëndimor dhe verior, gjë që përputhet me qarkullimin e brizave të kësaj periudhe. Ditën kemi brizin detar që fryn nga deti për në tokë dhe natën kemi brizin tokësor, që fryn nga toka në drejtim të detit. Kjo dukuri ndodh si rezultat i ndryshimit të trysnisë midis tokës e detit dhe ka rëndësi për freskimin e ajrit në pjesën e dytë të ditës.

Klima e territorit të Durrësit dhe të Shijakut e përcaktuar në bazë të elementëve të saj vlerësohet si një resurs natyror i pashtershëm që duhet përdorur në zhvillimin e të gjithë sektorëve të ekonomisë. Ajo konsiderohet si burim i përshtatshëm drite, ngrohtësie dhe lagështire. Si e tillë, klima ndikon në zhvillimin

³⁵ Qiriazi, P.(2001). *Gjeografia fizike e Shqipërisë*. Tiranë.

³⁶ Po aty.

³⁷ Po aty.

³⁸ Po aty.

³⁹ Po aty.

⁴⁰ Po aty.

dhe krijimin e resurseve të tjera natyrore, por që janë të shtershme dhe duhen përdorur në përputhje me zhvillimin e qëndrueshëm.

I.5. Hidrografia

Territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut bëjnë pjesë në pellgun ujëmbledhës të lumenjve Erzen, Ishëm dhe në pellgun ujëmbledhës të detit Adriatik. Kurrizi kodrinor Rodon-Erzen shërben si kufi ndarës i pellgjeve ujëmbledhëse të lumenjve të mësipërm. Pjesë të caktuara të fushës së Durrësit, të cilat kanë pjerrësi të vogël nga niveli i detit, i derdhen ujërat direkt në detin Adriatik. Rrjeti hidrografik sipërfaqësor përfaqësohet nga deti Adriatik, lumenjtë (Erzen dhe Ishëm), përrenjtë, prroskat, liqenet bregdetare dhe objektet ujore artificiale si: ujëmbledhësit dhe kanalet kullues të ndërtuar mbas vitit 1950.

I.5.1.Ujërat detare (Deti Adriatik)

Deti Adriatik është pjesë e detit Mesdhe. Konsiderohet si një gji verior i këtij të fundit. Vetëm territoret e bashkisë së Durrësit (jo bashkia Shijak) ka dalje të gjerë në detin Adriatik, në një vijë bregdetare prej 61.8 km gjatësi. Në përgjithësi bregdeti i Durrësit është i ulët dhe kjo lidhet kryesisht edhe me cekëtinën detare, ku izobata 100 m shkon deri në 50 km larg bregut⁴¹. Ujërat detare të Durrësit kanë valëzim mesatar, që në ditë të zakonshme fillon në mesditë ose në orët e para të mbasdites. Drejtimi dhe lartësia e valëve është në varësi të drejtimit dhe shpejtësisë së erës. Temperatura e ujit ka vlera të larta sidomos në muajt korrik dhe gusht (23,5°C-25,1°C). Kripësia mesatare mujore luhetet nga 30 - 33 për mijë⁴². Kripësia është më e ulët në stinën e dimrit, pasi dhe prurjet e lumenjve Ishëm dhe Erzen janë më të mëdha.

Sipas Konventës “Ligji i deteve”, kontrolli shtetëror shqiptar dhe vendor i bashkisë Durrës shkon deri në 200 milje nautike larg bregut⁴³. Brenda kësaj hapësire ujore diferencohen tri zona: Ujërat territoriale (12 milje nautike nga bregu), zona kontigje (24 milje nautike) dhe zona ekskluzive ekonomike⁴⁴.

I.5.2. Ujërat e lumenjve (Erzen dhe Ishëm)

Rrjeti hidrografik lumor, i dy bashkive, dallohet për dendësi të madhe, deri në 3 km/ km². Të dy lumenjtë konsiderohen të shkurtër, me pellgje ujëmbledhës të vegjël dhe shkallë ujëshmerie të ulët. Gjatësia e përgjithshme e lumit Erzen është 105 km dhe e lumit Ishëm 79.2 km⁴⁵. Pellgu ujëmbledhës i të dy lumenjve është 1433km². Erzeni buron në afërsi të qafës së Gurakuqit, rreth 1300 m mbi nivelin e detit, ndërsa Ishmi buron nga vargjet malore të Skënderbeut⁴⁶. Shkalla e ujëshmerisë në të dy lumenjtë ka karakter stinor dhe lidhet me regjimin klimatik. Gjatë periudhës së ftohtë të vitit dallohen prurjet maksimale (plotat) dhe gjatë periudhës së verës evidentohen prurjet minimale ose pakat. Dallime vihen re edhe midis stinëve të vitit. Në stinën e pranverës ka më tepër prurje se në vjeshtë, pavarësisht se në vjeshtë ka më shumë reshje shiu apo bore në pellgun ujëmbledhës. Prurjet më të mëdha janë në pranverë dhe kjo lidhet me shkrirjen e dëborës dhe me tokën e lagur e të ngopur me ujë nga stina e dimrit.

⁴¹Pano, N. (2008). *Pasuritë ujore të Shqipërisë*, Tiranë

⁴²Ziu, T. (2015). *Gjeografia Fizike e Shqipërisë*. Tiranë, faqe 138.

⁴³ Dollma, M. (2013). *Gjeografi ekonomike*. Tiranë

⁴⁴ Po aty

⁴⁵ Pano, N. (2008). *Pasuritë ujore të Shqipërisë*, Tiranë

⁴⁶ Po aty

Koeficienti i rrjedhjes së lumenjve është i lartë, përkatësisht Ishmi (0.68%) dhe Erzeni (0.51%), çka do të thotë se më tepër segjysma e sasisë së reshjeve që bie në pellgun ujëmbledhës të lumenjve hyn në rrjedhje. Sasia e ujit të grumbulluar në 1 km² ose moduli i rrjedhjes është i ndryshëm për të dy lumenjtë. Në çdo 1 km² të pellgut ujëmbledhës të Ishmit mbledhen rreth 31 l/sek, kurse në pellgun ujëmbledhës të Erzenit rreth 25 l/sek⁴⁷. Sasia e ujit që kalon në shtratin e lumit përfaqëson prurjen e lumit dhe në lumin Erzen është 20m³/sek, ndërsa në Ishëm 18 m³/sek⁴⁸. Të dy lumenjtë kanë rregjim torrencial të lartë (rregjim me luhate të mëdha midis prurjeve ekstreme dhe mesatare).

Pavarësisht se lumenjtë Ishëm dhe Erzen janë ujëpak, ata konsiderohen si lumenj që transportojnë sasi më të mëdha të materialeve të ngurta, në vendin tonë⁴⁹. Dallohet për rrjedhje shumë të vogël (minimale) dhe rrjedhje të madhe të ngurtë me prurje 102 kg/sek, turbullira 5610 gr/m³ dhe modul të rrjedhjes së ngurtë 5310 ton/km²/vit⁵⁰.

I.5.3. Liqenet bregdetare

Në territorin e bashkisë Durrës, pikërisht pothuajse në qendër të gjirit të Lalëzit, gjenden dy liqene bregdetare; ai i Godullës dhe i Bishtarakës. Të dy liqenet gjenden në të majtë të grykëderdhjes së lumit Erzen. Kanë sipërfaqe dhe thellësi të vogël. Janë krijuar gjatë evolucionit të bregdetit në sektorin e Gjirit të Lalëzit. Kanë rëndësi ekologjike, si zona buferike, por edhe në folelizimin e zogjve, sidomos ata shtegtarë.

I.5.4. Ujërat nëntokësore

Territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut kanë shtrirje të konsiderueshme të ujërave nëntokësore. Ujërat nëntokësore gjenden shumë pranë sipërfaqes së tokës. Cilësia e ujërave nëntokësore nuk është e mirë për të furnizuar banorët me ujë të pijshëm. Ujërat nëntokësore kanë përmbajtje të lartë të kripave dhe kjo lidhet edhe me përzierjen e ujërave nëntokësore me ujërat detare, si rezultat i afërsisë së tyre.

I.5.5. Ujëmbledhësit artificialë dhe kanalet kullues

Në territoret e bashkisë së Durrësit dhe asaj të Shijakut ka një numër të madh ujëmbledhësish (rezervuarë artificialë). Sipas Zyrës së Bordit të Kullimit në ish-rrethin e Durrësit, numërohen 35 ujëmbledhësa që zënë një sipërfaqe totale prej 6 368 ha dhe kanë një kapacitet ujëmbajtës të projektuar 55 768 000 m³. Në territoret e bashkisë Durrës gjenden 21 ujëmbledhësa, kurse në bashkinë Shijak gjenden 14 ujëmbledhësa. Aktualisht në funksion për ujitje janë 5 ujëmbledhësa në bashkinë e Shijakut (i Rubjekës, Bilalasit, Likesh, Karpenit dhe Karecit) dhe 8 ujëmbledhësa në bashkinë e Durrësit (i Topanas, i Ishmit, Maskuri e Vogël, Shkallnur, Spitallë 1, Radë 1, 2 dhe Shkallë). Të gjithë ujëmbledhësat janë ndërtuar gjatë periudhës komuniste dhe kanë pasur funksion ujitës dhe për peshkim.

Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të përdorura të qytetit të Durrësit shtrihen në një gjatësi prej mbi 130 km, me kolektorë kryesorë prej më shumë se 12 km, tubacione sekondare rreth 46 km dhe ato terciare mbi 72 km. Kolektorët kryesorë nëpërmjet motorpompave shtytëse të lagjeve 1, 13 dhe 16, i mbledh ujërat e përdorura

⁴⁷ Ziu, T. (2015). *Gjeografia Fizike e Shqipërisë*. Tiranë, faqe 138.

⁴⁸ Pano, N. (2008). *Pasuritë ujore të Shqipërisë*, Tiranë

⁴⁹ Gruda, Gj (2003). *Gjeomorfologjia*. Tiranë.

⁵⁰ Pano, N. (2008). *Pasuritë ujore të Shqipërisë*, Tiranë

të zonës së banuar dhe i shkarkojnë në kanal kryesor kullues të ish- Kënetës, i cili është me gjatësi 7 850 m⁵¹. Ky kanal mbledh edhe ujërat e kanaleve kulluese nr. 1(i vjetri) me gjatësi 4 950 dhe nr. 2 me gjatësi 4 700 m dhe duke kaluar i hapur në zonën e ish- Kënetës i derdh ujërat e zeza në Hidrovorin e Porto Romanos⁵². Këto ujëra të papërpunuara derdhen në det nëpërmjet një kanali me gjatësi 25 m dhe 3m i gjerë e i thellë.

Një kolektor me diametër 1 500 mm i mbledh pjesërisht ujërat e përdorura të lagjes 1 dhe 3 të qytetit dhe i shkarkon direkt në det në anën jugore të Portit Detar të Durrësit. Prurjet në këtë kolektor arrijnë deri në 50 l/sek. Kanali i ujërave të larta të kodrës së Durrësit, me gjatësi 5 564 m i ndërtuar, për mbledhjen e ujërave të larta pas reshjeve të shiut, si pasojë e ndërtimeve me dhe pa leje përgjatë dhe mbi kanal, nuk funksionon më, duke sjellë përmbytje të lagjeve të ulta të qytetit.

I gjithë rrjeti hidrografik sipërfaqësor dhe nëntokësor i territoreve të bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut përfaqëson një resurs ujor më vlera të mëdha ekonomike, sociale dhe mjedisore. Në këto territore gjenden sipërfaqe ujore të ëmbla, të kripura, natyrore dhe të krijuara, me përdorim të gjithanshëm.

I.6. Tokat

Pozita gjeografike, ndërtimi gjeologjik, veçoritë e relievit, kushtet klimatike dhe rrjeti hidrografik i hapësirës territoriale të bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut, kanë përcaktuar disa lloje tokash, të cilat ndryshojnë për shkak të strukturës, teksturës, ngjyrës, porozitetit etj. Në këto territore janë prezente tokat zonale, azonale dhe intrazonale.

I.6.1. Tokat Zonale

Zonaliteti i tokave lidhet me lartësinë mbi nivelin e detit. Duke qenë se territoret e Durrësit dhe të Shijakut shkojnë deri në lartësinë 269 m mbi nivelin e detit, këto toka bëjnë pjesë në brezin e tokave të hirta kafe. Si material parental në formimin e këtyre tokave kanë shërbyer depozitimet kuaternare, të tipit lumor, detar, liqenor dhe kënetor. Duke që se këto depozitime janë të periudhës më të vonë gjeologjike, asaj kuaternare, edhe këto toka janë të reja. Karakteri mesdhetar i klimës, i shprehur në karakterin stinor të temperaturave, reshjeve dhe erës, ka ndikuar në periudhën e tokëformimit dhe në gjendjen aktuale të tyre. Tokat e hirta kafe të Durrësit dhe të Shijakut janë formuar në temperaturën 16⁰C, në sasinë vjetore të reshjeve prej 1000 mm dhe në praninë e vazhdueshme të erërave perëndimore dhe veriore. Këto toka formohen nën shkurret dhe drurët mesdhetar, të shoqëruara nga bimësi kalimtare drunore-barishtore dhe praninë e ujërave nëntokësore pranë sipërfaqes⁵³.

Karakteristikat morfologjike, fiziko-kimike dhe kushtet e formimit, bëjnë të mundur ndarjen e tokave të hirta kafe në disa nëntipa: toka të hirta kafe të zakonshme ose tipike; toka të hirta kafe të shpërlara; toka të hirta kafe të kuqerremta; toka livadhore të hirta kafe (LHK) dhe toka të hirta kafe livadhore (HKL)⁵⁴. Në territorin e bashkive në studim gjendet vetëm nëntipi i tokave të hirta kafe të zakonshme dhe tokat livadhore të hirta kafe.

⁵¹ Ujësjiellës Kanalizimet Durrës (UKD) (2011). *Raporti Vjetor, 2010*. JuelDesign, Durrës.

⁵² Bordi i Kullimit Durrës-Krujë, Të dhëna statistikore 2013

⁵³ Gjoka, F., Brahusi, F. (2007). *Tokat, Natyra, cilësia, shpërndarja dhe përdorimi i tyre*. Tiranë.

⁵⁴ Po aty.

I.6.2. Tokat azonale

Në grupin e tokave azonale bëjnë pjesë tokat aluvionale-A (fluvisol, kambisol, regosol, arenosol, gleisol)⁵⁵. Këto toka janë gjenetiksht të reja. Ato janë zhvilluar në depozitimet lumore të Erzenit e Ishmit dhe në depozitimet e detit Adriatik. Këto toka kërkojnë një klimë mesdhetare fushore, qendrore; bimësi barishtore dhe drunore (shelgu, plepi, verriri, marina etj) dhe ndikimin e ujërave nëntokësore afër sipërfaqes. Tokat aluvionale shfaqin cilësitë e materialit të transportuar nga secili prej lumenjve të lartpërmendur⁵⁶. Në bazë të kushteve të formimit dhe shkallës së zhvillimit të tyre këto toka i ndajmë në: toka aluvionale të lumenjve (me nëndarjet: livadhore aluvionale dhe zallishtore) dhe toka aluvionale të bregut të detit (me nëndarjet: ranore të pazhvilluara dhe ranore të dunave të vjetra pak të zhvilluara)⁵⁷. Të gjitha nëntipet janë prezente në territorin e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut.

I.6.3. Tokat Intrazonale

Tokat e kripura zënë një vend të rëndësishëm në tokat intrazonale. Të kripura quhen ato toka që kanë përçueshmëri elektrike (konduktivitet elektrik), në ekstraktin ujor të ngopur (tretësirë e nxjerrë nga centrifugimi i pastër tokësore) më të madhe se 2 mmhos/cm ose mbi 1300 mg/l kripëra. Formimi i tokave të kripura është e lidhur me tri faktorë kryesorë që janë relievi (pozicioni topografik e gjeografik i zonës), shtrirja e sipërfaqes së ujitshmerisë dhe cilësia e ujit të ujitjes, dhe formacioni amnor. Cilësitë fizike, kimike dhe biologjike të llojeve të tokave të lartpërmendura, i bëjnë ato resurse me kohë të gjatë ripërtëritje. Vlerat dhe cilësitë e tyre do të trajtohen në kapitullin e dytë.

Të gjitha llojet e tokave të lartpërmendura janë përdorur nga njeriu për qëllime të ndryshme, duke që se cilësitë e tyre fizike, kimike dhe biologjike mundësojnë zhvillimin e një veprimtarie të caktuar ekonomike. Në kapitullin e dytë do të trajtohen cilësitë e secilës prej tokave dhe ccka i bën këto toka një resurs të natyrës.

I.7. Biodiversiteti

Pozita gjeografik, ndërtimi gjeologjik, kushtet klimatike, pasuria ujore dhe lloji i tokave të territoreve të Durrësit dhe të Shijakut kanë krijuar habitate të përshtatshme për botën e gjallë bimore e shtazore. Tërësia e llojeve të qënieve të gjalla që jetojnë në këto territore përbën biodiversitetin e Durrësit dhe të Shijakut.

Në biodiversitetin e kësaj hapësire territoriale përfshihen të gjitha kafshët dhe bimët që zoologët dhe botanistët kanë zbuluar dhe përshkruar nga ana shkencore⁵⁸. Në këto territore gjenden bimë e kafshë endemike dhe relikte të evolucionit, por edhe bimë e kafshë të reja, që kërkojnë nevojën e studimeve të mëtejshme. Flora dhe fauna janë shoqërime të njëra-tjetrës, megjithëse të veçanta. Pozicioni gjeografik dhe veçoritë e kushteve natyrore i pozicionojnë territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut në biorajonin e tipit Mesdhetar⁵⁹. Ky pozicionim është përcaktuar sipas klasifikimit paleartik të habitateve. Më poshtë janë evidentuar të gjitha bimët dhe kafshët e njohura të sipërfaqeve tokësore dhe hapësirave ujore, të territorit bashkiak të Durrësit dhe të Shijakut.

⁵⁵ Gjoka, F. (2015). *Pedogjeografia*. Tiranë.

⁵⁶ Po aty.

⁵⁷ Po aty.

⁵⁸ Ziu, T. (2006). *Biogjeografia*. Tiranë, faqe 12.

⁵⁹ Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave. *Thesaret e Biodiversitetit*. botim elektronik.

1.7.1. Bimësia

Bota bimore e këtyre territoreve bëj pjesë në katin fito-klimatik të shkurreve mesdhetare (ose e makje-shibjakut) dhe të dushkajave. Fizionomia e bimësisë shkurre karakterizohet kryesisht nga shkurre gjithmonë të blerta dhe pjesërisht nga shkurre që i lëshojnë gjethet gjatë stinës së dimrit. Këto të fundit në më të shumtën e rasteve janë të pajisura me gjemba dhe përfshihen në shibjakun. Nga shkurret me gjethë gjithmonë të blerta, që bëjnë pjesë në ndërtimin e makjes, më karakteristike janë: mareja (*Arbutus unedo L.*) mërsina (*Myrtus communis L.*), xina (*Pistacia lentiscus L.*) dhe shqopa (*Erica arborea L.*). Kati shkurre me gjelbërim të përhershëm përbëhet nga *Rosa sempervirens* (trandafili i eger), *Rubus ulmifolius* (ferra), etj⁶⁰. Krahas bimësisë shkurre në këto territore gjendet dushk, ah dhe bimë pyjore të kultivuara, të cilat shoqërohen me bimësi barishtore, si nënkati i tyre. Në katin barishtar dallojmë *Centaurium tenuifolium*, *Melisa officinalis*, etj⁶¹, të cilat kanë vlera mjekësore dhe aromatike.

Përgjatë lumenjve Erzen dhe Ishëm dhe në liqenet bregdetare gjenden bimësi higrofile, të cilat dominohen nga *Platanus orientalis* (rrapi), *Salix purpurea* (shelgu i kuq), *Salix alba* (shelgu i bardhë), *Alnus glutinosa* (vidhi) etj⁶². Krahas bimësisë të ujërave të ëmbla, në hapësirën territoriale ujore të bashkisë Durrës gjenden edhe bimësi ujore detare. Në bimësinë ujore detare bëjnë pjesë bimët e katin medialitoral (bregdetar) dhe infralitoral (detar). Përfaqësuese të dy kateve bimore ujore detare janë *Fucus virsoides* dhe livadhet nënujore me *Posedonia*.

Në territorin e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut gjenden, në gjendje natyrore, shumë bimë, të cilat bëjnë pjesë në Librin e Kuq (Bimët e Kërcënuara). Sipas përcaktimit të IUCN-s, çdo specie, numri i individëve të së cilës është reduktuar në një nivel të tillë që ajo mund të zhduket, edhe pse jo tërësisht, konsiderohet specie e kërcënuar⁶³. Shkalla e kërcënueshmërisë është e ndryshme, që nga bimë të zhdukura deri tek kategoria e bimëve të papërcaktuara.

Sipas Librit të Kuq, në hapësirën territoriale të këtyre bashkive gjenden bimë që mund të zhduken (Ex) si: Rrënja (*Quercus robur*), Rodhëza (*Agrimonia eupatoria*), Lule mastike (*Distamnus albus*), Luletogëz (*Digitalis lanata*), Gjunjëza (*Ephedra distachya*), Mëtergonë, bar i trashë (*Hyosciamus niger*), Lulebasani, Balç, Lulegjaku, Lulemaji (*Hypericum perforatum*), Dëllinja e zezë (*Juniperus communis*), Dëllinja e kuqe (*Juniperus oxycedrus*), Dafina (*Laurus nobilis*), Pllatkë trimajëshe (*Matthiola tricuspidata*), Zambaku i detit (*Pancratium maritimum*), Dorëvatë (*Sarcopoterium spinosum*). Në kategorinë e bimëve të prekshme (V) bëjnë pjesë: Biliqin (*Butomus umbellatus*), Klad marisk (*Cladium mariscus*) dhe Aster shqiptar (*Aster albanicus*)⁶⁴. Bimësia natyrore shoqërohet me botën e gjalla të kafshëve.

⁶⁰ Dragoti, N. *Vegjetacioni i pellgut ujëmbledhës i lumenjve Ishëm dhe Erzen*.

⁶¹ Po aty.

⁶² Po aty.

⁶³ Akademia e Shkencave (1995). *Libri i Kuq, Bimët e kërcënuara dhe të rralla të Shqipërisë*. (Instituti i Kërkimeve Biologjike), Tiranë.

⁶⁴ Po aty.

I.7.2.Kafshët

I.7.2.1.Kafshët e tokës

Bota shtazore e Durrësit dhe Shijakut është e shumëllojshme, në varësi edhe të tërësisë së habitateve tokësore e ujore që gjenden në këto territore. Në grupin e faunës tokësore bëjnë pjesë gjitarët e tokës (mishngrënës dhe barngrënës), shpezët, zvarranikët, amfibët, insektet etj. Të gjitha kafshët tokësore të hapësirës territoriale të bashkive Durrës dhe Shijak, janë pothuajse të ngjashëm me ato të të gjithë Shqipërisë dhe mbarë Mesdheut. Pavarësisht dëmtimeve nga dora e njeriut, fauna e këtyre territoreve është e ende e pasur. Përfaqësues i gjitarëve të tokës është lepuri i egër (*Lepus europaeus*, Pall, *L. Capensis*, L) dhe ketri (*Scirus Vulgarus*, L.)⁶⁵.

Bashkia e Durrësit dhe e Shijakut janë të pasura me lloje të shumta shpezësh të tokës dhe ujit, sedentarë dhe shtegtarë. Një pjesë e madhe e shpezëve banojnë në këto territore në mënyrë të përhershme e si të tillë, ata janë sedentarë. Por ka edhe një numër të madh shpendësh, të quajtur shtegtarë, që vijnë nga viset e Europës Veriore për të kaluar dimrin në këto territore. Disa të tjerë e kalojnë tek ne muajin e verës, ndërsa në dimër zbresin në viset më të ngrohta të Afrikës Veriore dhe Qëndrore. Kemi dy grupe shpendësh, ato që shtegëtojnë në distanca të vogla dhe në distanca të mëdha (shtegëtime ndërkontinentale). Shpendët që vijnë për të dimëruar në territoret e këtyre bashkive janë tushat, lareshat etj; nga rendi i harabelave (*Passeriformes*); rosat e patat nga rendi i patorëve (*Anseriformes*); disa shpendë nga rendi i pëllumbave të egër (*Colmbiformes*); nga rendi shapkave dhe i gjelzave të ujit (*Charadruiformes*) etj. Nga shpezët e grupit të dytë mund të përmendim disa lloje nga rendi i harabelorve, sic janë bilbilat (*Lucinia megarhyncha*), bilbilthat (*gjinia Sylvia*), bishtatundësit (*gjinia Motacilla*), dallëndyshet, bengat etj., ndërsa nga rendet e tjera shkurtat, turtujt etj⁶⁶.

Pjesa më e madhe e shpezëve sedentarë i ndërtojnë foletë e tyre atje ku dimërojnë, por ka edhe shumë prej tyre që bëjnë migracione sezonale, kryesisht vertikale brenda vendit. Interesantë janë edhe migracionet ditore të shumë shpendëve, të cilët lidhen kryesisht me sigurimin e ushqimit. Krahas shpezëve të tokës, kemi edhe shpezët e ujit, që gjenden në ujërat bregdetare. Ato janë të familjes së rosave, patave (*Anatidae*), të shapkave (*Scrolopacidae*) etj. Në grupin e shpezëve të ujit bëjnë pjesë: Thëllëza e fushës (*Perdix perdix*, L), Shkurta (*Coturnix coturnix* L) etj.

Bota e zvarranikëve është mjaft e pasur me lloje dhe ekzemplarë. Midis zvarranikëve të tokës përhapje më të madhe kanë breshkat, gjarpërinjtë dhe hardhucat. Breshkat e tokës përfaqësohen nga breshkat e zakonshme (*Testudo hermanni Gmel.*). Gjarpërinjtë janë më të shumtë e më të shumëllojtë. Përhapje të gjërë kanë ata johelmues si: Shigjetat (*Coluber gemonensis*, *C. Najadum* e *C. Jugularis*) dhe disa bolla, si bolla e shtëpisë (*Elaphe longissima*) dhe bolla me katër vija (*Elaphe quatuorlineata*). Nga gjarpërinjtë helmues më i rrezikshmi është nepërka e zakonshme (*Vipera ammodytes*). Hardhucat- më e përhapur është hardhuca e mureve (*Lacesta muralis*) dhe zhapiku i gjelbër (*Lacesta viridis*, L), që banon në vende të mbuluara me shkurre e ferra.

I.7.2.2. Kafshët ujore

Kompleksi faunor i ujërave të ëmbla është mjafti pasur. Ai përfaqësohet nga peshq, moluskë (butakë), gastropodë, bivarvorë, këmbënyjtorë, gamrra, insekte ujore

⁶⁵Qiriazi, P.(2001). *Gjeografia fizike e Shqipërisë*. Tiranë.

⁶⁶Po aty.

etj. Shpesh në Ujërat e ëmbla përfshihen edhe kafshë të tjera si shpenë, amfibë e ndonjë gjitar, siç është lundërza (vidra). Fauna e ujërave të ëmbla përfshin faunën e lumenjve, të rezervuarëve, të kanaleve ujore në territorin e rrethit të Durrësit.

Ujërat detare në bregdetin e Durrësit janë mjaft të pasura me lloje të ndryshme peshqish, zvarranikësh, molusqesh etj. Në faunën e ujërave bregdetare dallohen si format vendase (autoktone), siç janë levreku, qefulli, koca, spalci, dentali (sinagridha) ashtu edhe ato migratore, si stavridi, toni, shpata etj.

Nga vertebrorët rëndësinë dhe përhapjen më të madhe në sasi dhe shumëllojshmëri e kanë peshqit, të cilët përfaqësohen nga lloje të shumta e me rëndësi industriale siç është sardelja (*Srdina pilchardus sardina*). Peshq të tjerë janë qefulli (*Mugli cephalus* e lloje të tjera), i cili gjendet në Ujërat bregdetare të Durrësit, por sidomos në grykëderdhjet e lumit Erzen dhe Ishëm, nëpërmjet të cilave futet edhe në rrjedhjet e poshtme të tyre.

Në ujërat bregdetare të Durrësit rriten edhe peshq më të mëdhenj si toni (*Thunnus thunnus*) me rëndësi industriale, pelamidi (*Sarda sarda*), që ngjan shumë me tonit etj. Nga jovertebrorët, në ujërat e bregdetit të Durrësit takohen me shumicë moluskë (butakë), sfungjerë, celenteratë, lëkurëgjemborë (*ekinoderma*) si iriq, yje, zambakë deti etj. Nga gastopodët rriten patelat (*Patella*), muresket (*Murex*) etj. Nga krustacët rriten karkalecët e deti (*Panaeus*). Në ujërat detare rriten dhe mjaft zvarranikë, si breshka, gjarpërinj uji etj⁶⁷.

Të gjitha bimët dhe kafshët e përmendura më sipër, të cilat kanë vlera përdorimi konsiderohen resurse të biodiversitetit. Veccoritë dhe karakteristikat e tyre do të përshkruhen në kapitullin e dytë.

Pozita gjeografike e bashkisë Durrës dhe bashkisë Shijak në gjerësitë gjeografike mesatare, pothuajse në qendër të vendit tonë dheme dalje të gjerë në bregdetin e Adriatikut, ka mundësuar kushte natyrore të përshtatshme në krijimin e shumëllojshmërisë së resurseve natyrore. Depozitimet e periudhës gjeologjike tortonian-kuaternare kanë mundësuar praninë e resursit mineral jometalor të qymyrgurit, naftës dhe gazit natyror, si dhe materiale ndërtimi të ndryshme. Format e veçanta të relievit të krijuara nga veprimtaria e valëve detare dhe erës, janë pjesë e zonave të mbrojtura në vendin tonë dhe mund të konsiderohen si resurse gjeomorfologjike.

Klima mesdhetare fushore, e nënzonës qëndrore mundëson pasuri të pashtershme drite, ngrohtësie dhe lagështire. Rrjeti hidrografik i pasur me ujra të kripura dhe të ëmbla, përbën një burim të madh ujqor, me vlera të shumëllojshme përdorimi. Kushtet natyrore të Durrësit dhe të Shijakut kanë mundësuar praninë e 7-të lloje tokash në një sipërfaqe prej 432 km². Bota bimore dhe shtazore ka përhapje të gjerë në tokë dhe në ujë, në lartësi të kodrave, në fushën e Durrësit dhe në zonën bregdetare të Adriatikut dhe përbën një nga burimet e natyrës më të përdorur. Në kapitullin II do të trajtohet secila prej resurseve të natyrës së bashkive të lartpërmendura.

⁶⁷Qendra e Studimeve Gjeografike (1990). *Gjeografia fizike e Shqipërisë*. volumni 1, Tiranë.

KAPITULLI II

II.PASURITË NATYRORE TË TERRITORIT TË BASHKISË DURRËS DHE SHIJAK

Pozicioni gjeografik i bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut, në gjerësitë mesatare, si dhe kushtet natyrore të përshtatshme kanë ofruar pasuri të shumta natyrore, mbi dhe nëntokësore, të përdorura dhe jo, të mbrojtura dhe të panjohura nga banorët vendas, institucionet dhe OJF-të. Në këtë kapitull janë trajtuar të gjitha burimet natyrore, shtrirja gjeografike dhe sasia e tyre. Në kapitullin II, si *çështje e parë* do të trajtohet pasuria nëntokësore e ngurtë, e lëngët dhe e gastë, si dhe kushtet në të cilat ajo është krijuar. Në *çështjene dytë* evidentohen karakteristikat e materialeve të ndërtimit (rëra, argjila dhe zhavorret) dhe format gjeomorfologjike të relievit, të cilat për shkak të veçantisë së tyre të formimit, janë pjesë e trashëgimisë natyrore të vendit tonë. Pasuria klimatike trajtohen në *çështjen e tretë*. Në këtë pjesë pasqyrohen burimet e dritës, ngrohtësisë dhe lagështirës së bashku me të veçantat e tyre. Si *çështje e katërt* e këtij kapitulli është pasuria ujore me vetitë e tyre fizike dhe kimike. Në *çështjen e pestë* trajtohet toka si pasuri, përhapja gjeografike dhe veçoritë fizike, kimike dhe biologjike të saj. Si *çështje e fundit* analizohet pasuria bimore dhe shtazore, karakteristikat fizike të tyre dhe përhapja në territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut.

II.1.Pasuritë natyrore nëntokësore

Në territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut gjenden pasuri nëntokësore jometalore si: qymyrguri, nafta dhe gaz natyror. Këto burime natyrore pavarësisht se kanë përhapje të kufizuar dhe janë në sasi të pakta, përbëjnë një potencial natyror që mund të gjenerojë të ardhura për banorët vendas dhe vendin tonë në tërësi. Pasuritë nëntokësore jometalore konsiderohen si burime të paripërtërtshme dhe përdorimi i tyre duhet të jetë racional. Më poshtë po evidentojmë secilën prej tyre.


II.1.1.Qymyrguri, nafta dhe gazi natyror

Qymyrbajtja në nëntokën e Durrësit dhe të Shijakut lidhet me depozitimet molasike të Ultësirës Pranadriatike⁶⁸. Formacionet qymyrbajtëse janë formuar gjatë fazave të vonshme të zhvillimit të përkuljes Pranadriatike. Në territoret e bashkive të lartpërmendura gjendet pellgu qymyrbajtës i Erzenit dhe konkretisht formacioni qymyrbajtës i Manzës. Këto formacione janë krijuar gjatë periudhës së tortonianit dhe kanë përhapje në krahun lindor të ultësirës së Erzenit, nga Kepi i Rodonit në veri-perëndim deri në afërsi të Ndroqit në jug. *Qymyrguri i Manzës* gjendet në trajtë shtresash ndërmjet depozitimeve molasike të tortonianit. Gjenden mbi 10 shtresa qymyrore, të cilat kanë trashësi të hollë, deri në 0.7 m⁶⁹. Vendburimet e qymyrgurit kanë forma të çrregullta dhe me pjerrësi më të madhe se 45°. Ata janë krijuar nga dekompozimi në shkallë të ndryshme i mbeturinave bimore.

⁶⁸Dodona,E., Vranaj, A. (1973). *Bazat e Gjeologjisë*. Tiranë, faqe 252-254.

⁶⁹Po aty.

Harta 6. Shtrirja e formacionit qymyrbajtës të Manzës



Formimi i qymyrgurit të Manzës është bërë në dy etapa. Gjatë etapës së parë ka ndodhur dekompozimi dhe transformimi i mbeturinave bimore nën ndikimin e proceseve biokimike që zhvillohen në masën e bimësisë. Vendi më i përshtatshëm për shndërrimin e lëndës bimore në torfë është kënetat, por ky proces ndodh për një periudhë të gjatë kohore. Etapa e dytë e formimit të qymyreve lidhet me presionin e sedimenteve të sipërme (lumore, detare) dhe ngritjes së temperaturave të ajrit, të cilat së bashku bëjnë ndryshimin kimik të lëndës bimore. Vetëm gjatë kësaj periudhe kohore është bërë karbonizimi apo qymyrëzimi i lëndëve bimore⁷⁰. Qymyrguri i krijuar në pellgun e Manzës është kompakt, ka peshë specifike 1-1.8 kg dhe përmbajtja e karbonit në të është 80-85%⁷¹. Fuqia kalorifike e qymyrgurit është 1 960 kkal/ kg. Këto qymyre vlerësohen më cilësi mesatare.

Krahas qymyrgurit, në territoret administrative të bashkisë Durrës, janë evidentuar rezerva naftë dhe gazi natyror. Sipas studiuesve, rezervat e naftës dhe gazit natyror gjenden në platformën detare përballë Kepit të Rodonit. Ende nuk ka të dhëna se në çfarë thellësie gjenden këto rezerva. Zhvillimi i teknologjisë dhe financimet qeveritare do të mundësojnë në të ardhmen përdorimin e tyre.

II.2. Pasuritë natyrore sipërfaqësore

Krahas pasurisë nëntokësore në territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut gjenden edhe pasuri sipërfaqësore (materialet e ndërtimit) me vlera për zhvillimin e sektorit të dytë të ekonomisë (industri dhe ndërtimtari). Në pasuritë sipërfaqësore bëjnë pjesë ranishtet, zhavoret, përbërjet argjilore dhe format e veçanta të relievit (monumentet e natyrës).

II.2.1. Materialet e ndërtimit

Zhavorret gjenden në sektorët e poshtëm të lumenjve Erzen dhe Ishëm, në ato hapësira ku lumenjtë kryejnë veprimtari depozituese. Pavarësisht se këta lumenj konsiderohen të shkurtër, transportojnë një sasi të madhe të lëndëve të ngurta, për shkak edhe të mbizotërimit të shkëmbinjëve terrigjenë në sektorët e sipërm të tyre. Zhavorri konsiderohet një shkëmb i shkrifët që përbëhet prej copave pak a shumë të rumbullakosura të mineraleve dhe të shkëmbinjve të ndryshëm me përmasa 1-10 mm⁷².

Rërat gjendet si përgjatë vijës bregdetare por edhe në brendësi të territoreve të dy bashkive. Ato janë materiale të shkrifta, të krijuara nga shkatërimi i shkëmbinjve të ndryshme nën veprimtarinë e lumenjve Erzen dhe Ishëm, si dhe nga veprimtaria përpunuese e valëve të detit Adriatik. Përmasat e kokrizave të rërës janë nga 0.1-2 mm.

Argjilat janë shkëmbinj fundërrësorë, të paçimentuar, të lidhur, ku mbizotërojnë mineralet argjilore. Pjesëzat argjilore kanë përmasa të diametrit $d < 0.005$ mm. Kanë vetinë e plasticitetit dhe kur pluhuri i argjilës përzihet me ujë formon një trup veshtullor, të aftë të marrë formë dhe ta ruajë atë. E pjekur në zjarr ka fortësi të një guri. Në këto territore gjenden argjilat nëngjipsore të Kavajës dhe argjilat e Qerretit⁷³. Argjilat nëngjipsore të Kavajës gjenden në pjesën më të sipërme të suitës argjilore Mengajt, e cila gjendet gjithmonë poshtë siutës evaporitike të katit mesinian. Shtrihet përgjatë Kepit të Rodonit, fshatrave Rrashbull, Romanat, Shënavlash dhe

⁷⁰ Dodona, E., Vranaj, A. (1973). *Bazat e Gjeologjisë*. Tiranë, faqe 252-254.

⁷¹ Po aty

⁷² Shkupi, D. (1984). *Fjalori i Gjeologjisë*. Tiranë

⁷³ Po aty.

Metallaj. Në zonën e Shënavlashit gjendet një sipërfaqe prej 1 300 086 m² me rreth 3 000 000 m³ argjila⁷⁴. Argjila e Qerretit është një depozitim argjilo-ranore, që haset deri në thellësinë 200 m në kodrat e Currilave. Këto argjila janë të moshës pliocenike.

II.2.2. Format e relievit (monumentet e natyrës)

Gjeomonumentet janë forma të caktuara të relievit, të krijuara në kushte specifike dhe kanë rëndësi ruajtje dhe përdorimi. Në territorin e bashkisë së Durrësit (vetëm në këtë bashki gjenden gjeomonumente) gjendet Kepi dhe Faleza e Rodonit, Plazhi i Shën Pjetrit, Plazhi i Kallmit dhe Shkëmbi i Kavajës.

Kepi i Rodonit është kepi më i madhi në vendin tonë. Klasifikohet si gjeomonument me vlera nacionale. Ndodhet në veri-perëndim të bashkisë së Durrësit, midis gjirit të Rodonit në veri dhe gjirit të Lalzit në jug. Ai shtrihet në formë trekëndëshi dhe futet rreth 4-5 km në thellësi të detit Adriatik⁷⁵. Lartësia e kepit shkon deri në 30 m mbi nivelin e detit. Kepi i Rodonit përfaqëson skajin më veriperëndimor të vargut kodrinor Rodon-Prezë, i cili përbëhet tërësisht nga formacione molasike të moshës gjeologjike të tortonianit. Veprimtaria gërryerëse e detit Adriatik ka ndikuar në krijimin e kontureve të tij harkore. Vepër e veprimtarisë së valëve detare është faleza e gjallë me lartësi deri në 25 m. Në shpatet e kepit vihet re edhe fenomeni i rrëshqitjeve sipërfaqësore si rezultat i ndërthurjes së shtresave ranore me shtresat argjilore⁷⁶. Gërryerja është e vazhdueshme dhe ka sjellë ndryshim të vijës bregdetare nga viti në vit.

Plazhi i Shën Pjetrit ndodhet në gjirin e Lalëzit. Ai përfaqëson një gjeomonument me vlera ndërkombëtare për shkak të peizazhit gjeomorfologjik të rregullt e të bukur. Plazhi ka formë harkore, të lugët nga ana e bregdetit dhe ndodhet vetëm 0.5 m mbi nivelin e detit. Gjatësia e tij shkon deri në 100 m, kurse gjerësia deri në 20 m. Në këtë sektor depozitimet kuaternare detare dhe ato kontinentale kënetore mbulojnë depozitimet neogjenike të sinklinalit të Bisht-Kamzës. Plazhi është formuar nga veprimtaria akumuluese e valëve detare⁷⁷.

Plazhi i Kallmit është krijuar në bregdetin e lartë të Durrësit. Ai ndodhet në pjesën perëndimore të Malit të Durrësit. Plazhi është i tipit shkëmbor dhe është formuar nga veprimtaria akumuluese e valëve detare. Gjatësia e tij shkon deri në 100 m, kurse gjerësia është vetëm 15 m. Plazhi shkëmbor ndërthuret me rërën kuarcore me kokriza të mesme deri të mëdha⁷⁸.

Shkëmbi i Kavajës është një gur identifikues i zonës. Ai përbën një gur konglomeratik dhe ranor me moshë miocenike. Ndodhet në jug të bashkisë së Durrësit, në afërsi të fshatit Shkallnur. Shkëmbi i Kavajës është pjesë e vargut kodrinor Kavajë-Shënavlash⁷⁹. Lartësia e shkëmbit shkon deri në 105 m mbi nivelin e detit duke ofruar një peizazh interesant të qytetit dhe gjirit të Durrësit. Gjatësia e tij shkon 200 m dhe gjerësia është pothuajse 100 m. Ai paraqet dy veçori gjeologjike që i japin rëndësinë e monumentit të natyrës: shtresëzimet e kithta të shtresave ranore dhe gjurmët e gryerjes në formën e zgjoit të bletëve. Këto forma janë dëshmitë

⁷⁴ Ministria e Energjisë dhe Industrisë. *Plani Vjetor 2014*

⁷⁵ Serjani, A., Nezirat, A., Èimbleton, P.A.È., Onuzi, K., Hallaci, H., Bushati, S., (2003).

Gjeomonumentet dhe gjeoturizmi në Shqipëri. ProGEO-Albania, Tiranë.

⁷⁶ Qiriazi, P., Sala, S., (2006). *Monumentet e natyrës të Shqipërisë*. Botim Elektronik, faqe 27.

⁷⁷ Po aty.

⁷⁸ Po aty.

⁷⁹ Braholli, E. (2015). *The management of Geosites in Durrës*. The 4-th International Multidisciplinary Conference on Integrating Science in New Global Challenges, ICTEA, faqe 245-249, Dubrovnik, Croatia.

tëveprimtarisë së erës dhe shiut gjatë sedimentimit të rërës dhe gjatë gryerjes së shkëmbit⁸⁰.

II.3. Pasuritë e klimës

Në tërësinë e resurseve natyrore të një hapësire gjeografike, është e rëndësishme edhe njohja me karakteristikat dhe vlerat e burimeve të klimës, si resurse të pashtershme. Hapësira administrativo-territoriale e Durrësit dhe e Shijakut, e cila ka klimë mesdhetare, konsiderohet si territor me potenciale klimatike. Sipas P. Zorbës, burimet e klimës kategorizohen në tri grupime si: burime të dritës, burime të ngrohtësisë dhe burime të lagështirës⁸¹. Gërshetimi i mirë i tyre ofron kushte më të mira të klimës, ndërkohë që mungesa ose qenia me tepri e njërit ndikon negativisht në elementët e tjerë.

II.4.Drita

Drita konsiderohet si një nga resurset më të rëndësishme dhe të pashtershme që ka planeti ynë. Territorët e bashkisë Durrës dhe Shijak gjenden në gjerësitë mesatare (midis 41°36'35" dhe 41°16'30" gjerësi gjeografike veriore), për rrjedhojë rrezatimi ditor, mujor dhe vjetor ka vlera të larta. Në mënyrë të veçantë, territorët e këtyre bashkive marrin sasinë më të madhe të energjisë diellore krahasuar me të gjitha bashkitë e tjera të vendit, që gjenden në të njëjtat gjerësi gjeografike apo edhe në gjerësi më të vogla.

Sipas të dhënave të Institutit Meteorologjik Shqiptar, sasia e mundshme vjetore e rrezatimit të përgjithshëm, për kushtet e motit pa vranësira është 192.38 kkal/cm²⁸². Kjo energji, e përfutuar nga energjia e drejtpërdrejtë dhe e shpërndarë ka karakter të qëndrueshëm, pavarësisht se mund të ndryshojë në periudha të ndryshme të vitit. Ndryshueshmëria e rrezatimit diellor është më e madhe në periudhat ekstreme (verë-dimër, pranverë-vjeshtë). Vlerat më të larta të rrezatimit të përgjithshëm i ka muaji qershor, me 23.45 kkal/ cm², ndërsa vlerat më të ulta muaji dhjetor, me 7.18 kkal/ cm²⁸³.

Duke analizuar këto vlera kuptojmë se në muajin qershor territorët e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut marrin rreth 3 herë më shumë energji diellore të përgjithshme për kushte të motit pa vranësira. Kjo lidhet me zgjatjen më të madhe të ditës, me solsticin e verës dhe këndin më të vogël të rënies së rrezeve të diellit. Sasi energjie diellore të përafërta me muajin qershor, territorët e Durrësit dhe të Shijakut, marrin në muajt maj (22.82 kkal/ cm²), korrik (23.12 kkal/ cm²) dhe gusht (21.07kkal/ cm²)⁸⁴. Për vlera të vogla të rrezatimit diellor dallohet muaji nëntor (9.18 kkal/ cm²), janar (8.16 kkal/ cm²) dhe shkurt (10.96 kkal/ cm²), e cila shkaktohet nga pjerrësia më e madhe rrezeve të diellit dhe sasia e vogël e orëve me dritë. Në muajt e tjerë sasia e energjisë diellore që vjen është midis vlerave 13-20 kkal / cm² ashtu siç tregohet në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm.

⁸⁰ Frashëri, A., (2012). *Gjeomonumentet që tregojnë historinë e tokës shqiptare*. Tiranë, faqe 172-182.

⁸¹ Zorba, P. (2007). *Klimatologjia*. Tiranë.

⁸² Instituti Meteorologjik Shqiptar (1975). *Klima e Shqipërisë*. Tiranë

⁸³ Po aty.

⁸⁴ Po aty.

Tabela 3. Sasia e mundshme mujore e vjetore e rrezatimit të përgjithshëm (kcal /cm²) (për kushte moti pa vranësira)

Vendndodhja	Muajt												Vjetore
	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	
Durrës	8.16	10.96	16.59	19.74	22.82	23.45	23.12	21.07	17.18	12.93	9.18	7.18	192.38

Burimi: Instituti Metereologjik Shqiptar

Grafiku 1. Sasia e mundshme mujore e vjetore e rrezatimit të përgjithshëm (kcal /cm²) (për kushte moti pa vranësira)



Burimi: Instituti Metereologjik Shqiptar

Grafiku i mësipërm tregon sasinë e rrezatimit të përgjithshëm mujor vetëm për rastet e kushteve të motit pa vranësira. Krahas faktorëve të pozicionit gjeografik dhe kushteve topografike në hapësirën e Durrësit dhe të Shijakut, një rëndësi të madhe në shkallën e rrezatimit diellor ka kohëzgjatja e vranësirave.

Tabela dhe grafiku i mëposhtëm tregon sasinë mujore të rrezatimit të përgjithshëm në kushtet e motit me vranësira.

Tabela 4.. Sasia e mundshme mujore e vjetore e rrezatimit të përgjithshëm (kcal /cm²) (për kushte moti me vranësira)

Vendndodhja	Muajt												Vjetore
	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	
Durrës	4.83	6.42	10.05	12.61	15.20	17.66	20.35	18.54	13.50	8.96	5.25	4.11	137.48


Burimi: Instituti Metereologjik Shqiptar

Grafiku 2. Sasia e mundshme mujore e vjetore e rezatimit të përgjithshëm (kcal /cm²) (për kushte moti me vranësira)



Burimi: Instituti Metereologjik Shqiptar

Grafiku 3. Ndryshimi i sasisë së rezatimit të përgjithshëm (kcal /cm²) (për kushte moti me dhe pa vranësira)



Burimi: Instituti Metereologjik Shqiptar

Duke analizuar grafikun e mësipërm vëmë re se vranësirat ndikojnë në uljen e sasisë së energjisë diellore deri në 30 %. Vranësirat ushtrojnë ndikim më të madh gjatë muajve nëntor, dhjetor dhe janar, duke përgjysmuar sasinë e rrezatimit të përgjithshëm diellor mujor. Krejt e kundërta ndodh gjatë muajve qershor dhe korrik, ku vranësirat nuk përbëjnë një pengesë në depërtimin e rrezatimit diellor. Hapja e këtyre territoreve drejt perëndimit dhe prania e pengesave të vogla topografike, të tipit kodrinor në lindje, bën që në këtë hapësirë të ketë vranësira të përkohëshme, pra kalimtare.

Sasia e energjisë diellore mujore përcaktohet nga numri i orëve dhe ditëve me diell. Durrësi dhe Shijaku gjenden në një territor fushoro-kodrinor, ku fushat shtihen në pjesën perëndimore të këtij territori, me dalje të gjerë në detin Adriatik, ndërsa kodrat në pjesën lindore të tij. Sipas të dhënave të Institutit Metereologjik Shqiptar gjatë muajve qershor, korrik dhe gusht ekziston qiell i pastër, me mungesë të plotë të vranësirave. Në këto muaj ka rreth 14 orë me diell në ditë. Gjatë muajve prill-maj dhe shtator-tetor mund të vërehen re 1 ose 2 ditë pa diell dhe njëkohësisht një ulje e numrit të orëve me diell deri në 12.4- 13.7 orë. Muajt me numrin më të lartë të ditëve

pa diell konsiderohen nëntori, dhjetori, janari dhe shkurti me 5 deri në 7 ditë pa diell. Numri i orëve me diell në këto muaj varion nga 8.9 deri në 10.6 orë. Në tabelën e mëposhtme paraqitet numri i ditëve me diell, pa diell dhe maksimumi i orëve me diell për çdo muaj.

Tabela 5. Vlerat mesatare të zgjatjes së diellëzimit


Muajt	Nr .Ditëve		
	Me diell	Pa diell	Max. Absolut në orë
Janar	24	7	9.3
Shkurt	23	5	10.6
Mars	27	4	12.6
Prill	28	2	12.7
Maj	30	1	13.7
Qershor	30	0	14.1
Korrik	31	0	14.3
Gusht	31	0	13.7
Shtator	29	1	12.4
Tetor	29	2	11.4
Nëntor	25	5	10.0
Dhjetor	24	7	8.9

Burimi: Instituti Meteorologjik Shqiptar

Në tërësi territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut marrin rreth 2 606 orë me diell gjatë një viti⁸⁵. Vlerat më të larta të zgjatjes faktike mujore të diellëzimit vrojtohen në muajin korrik (356 orë) dhe jo në qershor (304 orë), kur zgjatja astronomike është më e madhe. Madje edhe muaji gusht ka më tepër orë me diell sesa qershori (331 orë). Kjo dukuri shpjegohet me faktin që këta dy muaj karakterizohen nga numri më i madh i ditëve me mot të qëndrueshëm anticiklonik.

Vlerat më të vogla vrojtohen në muajin nëntor (119 orë) dhe dhjetor (101), që përkon me zgjatjen më të vogël astronomike të ditës. Trendi i orëve me diell sipas muajve paraqitet në grafikun dhe tabelën e mëposhtëm.

Grafiku 4. Zgjatja faktike e diellëzimit (orë)



Burimi: Instituti Meteorologjik i Shqipërisë

⁸⁵ Instituti Meteorologjik Shqiptar (1975). *Klima e Shqipërisë*. Tiranë

Tabela 6. Zgjatja faktike e diellzimit (orë)

Vendndodhja	Muajt												Vjetore
	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	
Durrës	120	125	183	216	265	304	356	331	275	211	119	101	2606

Burimi: Instituti Meteorologjik i Shqipërisë

Nga të dhënat e mësipërme kuptohet se territoret e të dyja bashkive marrin sasi të mëdha drite gjatë gjithë vitit. Burimi i dritës konsiderohet një resurs natyror i pashtershëm dhe i shfrytëzueshëm në kushtet e sotme të zhvillimit teknologjik. Shndërimi i energjisë diellore në energji elektrike dhe konsum familjar është një prespektive e mirë në zhvillimin social, ekonomik dhe ekologjik të këtyre territoreve.

II.5. Erërat

Erërat janë një nga elementet kryesore të klimës së një vendi. Njohja më e mirë e klimës është e lidhur ngushtësisht me njohjen e erërave karakteristike, d.m.th. të qarkullimeve karakteristike të masave ajrore. Disa nga karakteristikat e erës janë: drejtimi, shpejtësia, ecuria vjetore dhe ditore e saj.

II.5.1. Drejtimi i erës

Drejtimi i erës në territoret e Durrësit dhe të Shijakut është i ndryshueshëm. Rastisjen më të madhe e kanë erërat e kuadratit të veriut dhe më pas vijnë ato të kuadratit të jugut. Një rastisje më të vogël kanë erërat perëndimore dhe lindore, të cilat krijohen jashtë kufirit të vendit tonë me përjashtim të erërave lokale, si puhitë detare dhe tokësore. Erërat veriore nga pikëpamja termike janë erëra të ftohta (quhen edhe lëvizje zbritëse) pasi fryjnë nga gjerësitë më të mëdha drejt gjerësive më të vogla gjeografike, pra nga poli në drejtim të këtyre territoreve.

Prej erërave të kuadratit të veriut mbizotëron veriu (27.8%) dhe veriperëndimi (8.5%)⁸⁶. Erërat jugore fryjnë gjithë të vitin kalendarik. Ato janë erëra të ngrohta dhe nga ky kuadrat mbizotëron juglindja (21.9 %) ⁸⁷. Këto erëra quhen ndryshe lëvizje ngjitëse, pas fryjnë nga gjerësitë më të vogla drejt gjerësive më të mëdha gjeografike. Erërat e kuadratit lindor janë shumë pak prezente në territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut, duke rastisur vetëm në 3.8% të vitit.

Erërat perëndimore janë më prezente në territorin e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut, si rezultat i ndyshimit termik midis sipërfaqes së tokës dhe sipërfaqes së ujit të detit Adriatik. Nëpërmjet tabelës së mëposhtme është ndërtuar grafiku, i cili paraqet trëndafilin vjetor të erës.

Tabela 7. Shpërndarja vjetore e drejtimit të erës %


Stacioni	Q	N	NE	E	SE	S	SW	W	NW
Durrës	6.2	27.8	4.3	3.8	21.9	7.6	6.6	13.3	8.5

Burimi: Instituti Meteorologjik Shqiptar

⁸⁶Instituti Meteorologjik Shqiptar (1975). *Klima e Shqipërisë*. Tiranë

⁸⁷Po aty.

Grafiku 5. Shpërndarja vjetore e drejtimit të erës %



Burimi: Instituti Metereologjik Shqiptar

Krahas të dhënave vjetore është e rëndësishme analiza e të dhënave stinore të drejtimit të erës. Duke studiuar të dhënat e marra nga stacioni metereologjik i Durrësit theksojmë se gjatë stinës së dimrit rastisje më të madhe kanë erërat me drejtim verior (37.5%) dhe juglindor (31.7), por me mbizotërim të erës veriore⁸⁸. Gjatë kësaj stine pothuajse mungojnë erërat e kuadrantit perëndimor dhe lindor. Gjatë stinës së pranverës vazhdon të jetë mbizotëruese era me drejtim verior (23.3%) dhe juglindor (18.5%), por fillon të mbizotërojë edhe era me drejtim perëndimor (15.9 %). Në stinën e verës era mbizotëruese është ajo me drejtim perëndimor (22.3%) dhe era me drejtim verior (19.9 %). E gjithë kjo shpjegohet me kontrastin e theksuar termik gjatë stinës së verës midis tokës dhe detit Adriatik, që shkakton lëvizjen e ajrit të ftohtë detar prej detit në drejtim të tokës me anë të rrymave perëndimore dhe veriperëndimore.

Një rastisje mesatare kanë edhe erërat me drejtim juglindor (14.8%) dhe drejtim veriperëndimor (14.6%). Gjatë stinës së vjeshtës fillojnë të mbizotërojnë përsëri erërat me drejtim verior (30.4%) dhe juglindor (22.8%), por edhe me rastisje mesatare të erës me drejtim perëndimor (11.1%). Shpërndarja stinore e drejtimit të erës paraqitet në tabelën dhe grafikët e mëposhtëm.


Tabela 8. Shpërndarja stinore e drejtimit të erës në territorin e rrethit të Durrësit (në %)

St.Durrës	Q	N	NE	E	ES	S	SW	W	NW
Dimër	2.6	37.5	4.8	5.0	31.7	7.4	4.0	4.0	3.1
Pranverë	6.1	23.3	4.4	3.6	18.5	9.9	9.8	15.9	8.6
Verë	9.6	19.9	3.7	2.2	14.8	5.6	7.0	22.3	14.6
Vjeshtë	6.0	30.4	4.4	4.3	22.8	7.5	5.6	11.1	7.8

Burimi: Instituti Metereologjik Shqiptar

⁸⁸Instituti Hidrometeorologjik (1988). *Atlasi klimatik i Shqipërisë*. Tiranë.

Grafiku 6. Shpërndarja stinore e drejtimit të erës në territorin e Durrësit e të Shijakut në %



Burimi: :Instituti Metereologjik Shqiptar

II.5.2. Shpejtësia e erës


Pozicioni i qendrave barike mbi Mesdhe, luan një rol të rëndësishëm jonetëm mbi drejtimin, por edhe mbi shpejtësinë e erës. Nëpërmjet të dhënave të tabelës dhe grafikut të mëposhtëm mund të analizojmë ndryshimin e shpejtësisë së erës sipas stinëve të vitit.

Tabela 9. Shpejtësia mesatare e erës sipas stinëve (m/sek)

Stinët	Dimër	Pranverë	Verë	Vjeshtë	Mes.Vjetore
Durrës	4.6	3.9	3.3	3.7	3.8

Burimi:Instituti Metereologjik Shqiptar

Grafiku 7. Shpejtësia mesatare e erës në m/sek



Burimi: Instituti Metereologjik Shqiptar

Si tendencë e përgjithshme, duhet të theksojmë se shpejtësia e erës gjatë verës dhe vjeshtës është më e vogël se ajo e stinës së pranverës dhe dimrit. Ulja e shpejtësisë së erës gjatë stinës së verës tregon karakterin e qendrueshëm të motit gjatë kësaj stine dhe se ndikimi i puhisë detare është i theksuar njëjloj për të gjitha stinët.

II.5.3. Ecuria ditore e shpejtësisë së erës


Vrojtimet mbi shpejtësinë e erës tregojnë se ecuria ditore e saj është pothuajse e ngjashme me atë të temperaturës së ajrit. Në orët e mbasdites forcimi i shkëmbimit vertikal, që krijohet si rezultat i lindjes së konveksionit shpien në forcimin e shpejtësisë së erës. Një gjë e tillë vërehet gjatë gjithë vitit, por në mënyrë të veçantë ajo është e theksuar gjatë stinës së verës dhe në prani të një moti të kthjellët. Gjatë natës, në varësi të gjendjes së qiellit, rrezatimi tokësor rrit qëndrueshmërinë e ajrit në shtresat e ulëta të atmosferës, duke ndikuar në këtë mënyrë në zvogëlimin e shpejtësisë së erës. Puhia detare frenon konveksionin e fuqishëm dhe vepron në mënyrë të ndieshme mbi lëvizjet vertikale të ajrit. Këto procese ndikojnë në mënyrë aktive mbi ecurinë ditore të shpejtësisë së erës. Tabela dhe grafiku i mëposhtme japin të dhëna rreth ecurisë ditore të shpejtësisë së erës.

Tabela 10. Shpejtësia mesatare ditore e erës (m/sek)

Ora	7	14	21
Durrës	3.2	5.2	1.2

Burimi: Instituti Metereologjik Shqiptar

Grafiku 8. Shpejtësia mesatare vjetore e erës m/sek



Burimi: Instituti Hidrometeorologjik

Siç shihet, shpejtësia e erës në orët e mesditës është më e madhe sesa në orët e mëngjesit dhe të mbrëmjes. Kjo veçori shpreh pikërisht paqëndrueshmërinë e shtresave të ajrit në orët e mesditës. Madje territoret e këtyre bashkive kanë vlera më të larta të shpejtësisë së erës për orën 14⁰⁰, krahasuar me të gjithë territoret e tjera të vendit tonë, kjo për shkak të ndikimit të puhisë detare dhe terrenit të rrafshët. Këto ndryshime brenda ditore vihen re në të gjithë stinët e vitit.


Në territoret e Durrësit dhe të Shijakut, erërat me shpejtësi më të madhe janë ato me drejtim jugor (6.3 m/s) dhe jugperëndimor (5.8 m/s)⁸⁹. Erërat e forta të jugut janë rezultat i situatave sinoptike të veçanta, kur në troposferën e mesme ekziston forma meridionale e qarkullimit dhe vendi ynë përfshihet në zhvendosjen jugore. Erërat e kuadrantit të veriut janë me shpejtësi më të vogël, ku erërat veriore kanë shpejtësi mesatare 2.8 m/s, erërat verilindore janë me shpejtësi mesatare 2.3 m/s dhe ato veriperëndimore 3.3 m/s⁹⁰. Këto të dhëna pasqyrohen në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm.

Tabela 11. Shpejtësia mesatare vjetore e erës sipas drejtimeve (m/sek)

Stacioni	N	NE	E	SE	S	SË	Ë	NË
Durrës	2.8	2.3	2.6	3.8	6.3	5.8	4.8	3.3

Burimi: Instituti Hidrometeorologjik Shqiptar

Grafiku 9. Shpejtësia mesatare vjetore e erës sipas drejtimeve në m/sek



Burimi: Instituti Hidrometeorologjik Shqiptar

⁸⁹Instituti Meteorologjik Shqiptar (1975). *Klima e Shqipërisë*. Tiranë

⁹⁰Po aty.

Trëndafilët e erës tregojnë më së miri se në shumicën e rasteve, rastisjet e drejtimit të erës nuk kanë lidhje me shpejtësinë mesatare më të madhe. Kjo tregon se era mbizotëruese nuk ka të bëjë gjithnjë me shpejtësinë e madhe, ose më mirë nuk duhet ngatëruar filladi i vazhdueshëm, i cili vjen nga kuadrati i veriut, me erërat e forta që vijnë nga kuadrati jugor. Në përdorimin energjistik të erës ka rëndësi vazhdimësia e saj, gjatë ditës, muajit dhe vitit. Era mbizotëruese është ajo me drejtim verior dhe juglindor. Në territorin e bashkive Durrës dhe Shijak mbizotëron shpejtësia nga 2-5 m/sek, me rreth 55.7 %⁹¹.

Tabela 12. Rastisja e shpejtësive të erës në %

Stacioni	0.1	2-5	6-10	10-15	➤ 15
Shpejtësia m/sek	22.5	55.7	17.6	2.2	2.0

Burimi: Instituti Hidrometeorologjik Shqiptar

Me shpejtësi të madhe të erës do të kuptojmë shpejtësinë më të madhe se 15 m/sek, e cila nuk është shumë e zakonshme në këto territore. Rastisja e erërave të mëdha lidhet me lëvizjen e sistemeve barike, që do të thotë se ato mund të ndodhin në çdo periudhë të vitit, dhe në raste të veçanta janë të shoqëruara me shtrëngata shiu dhe stuhie. Gjithsesi rastisjen më të madhe e ka në periudhën e ftohtë të dimrit.

II.5.4. Erërat periodike dhe lokale

Drejtimi mbizotërues i erës jep në përgjithësi karakteristikat lokale në qarkullimin e erërave. Në këto territore, sidomos gjatë muajve të verës, është karakteristike qarkullimi brizor (ajër-këmbimi det-tokë dhe tokë-det). Shkaku i krijimit të qarkullimit brizor është i njohur. Kontrasti i krijuar si rezultat i ngrohjes dhe ftohjes së pabarabartë të ujit dhe tokës shkakton lëvizjen e masave të ajrit nga deti në tokë dhe anasjelltas. Dallojmë dy lloj puhish:

Puhia detare. Është erë që gjatë ditës fryn nga deti në tokë. Zhvendosja e masës së ajrit nga deti Adriatik në tokë fillon në momentin kur kjo masë ajri mposht rezistencën e lëvizjeve anësore të ajrit të ngrohtë mbi sipërfaqen e tokës. Siç shihet, si rezultat i ngrohjes së shpejtë të tokës, ajri, i cili qëndron në shtresat e ulta, fillon të lëvizë në drejtim vertikal e horizontal. Vendin e ajrit të ngrohtë e zë ajri i freskët që vjen nga deti. Në këtë mënyrë, gjatë ditës krijohet lëvizja e ajrit nga deti në tokë ose siç quhet puhia detare. Në përputhje me gjendjen e motit gjatë ditës, puhia fillon rreth orës 9-10 paradite dhe vazhdon deri në orën 16-18⁰⁰. Në një mot të kthjellët dhe të qetë, intensiteti i saj është mjaft i madh. Drejtimi mbizotërues i erës gjatë puhisë është veriperëndimi. Puhia detare ndikon në temperatura jo shumë të larta në mesditë, lagështirë të ekuilibruar dhe freski të ajrit.

Puhia tokësore. Ndërprerja e qarkullimit det-tokë shoqërohet me një periudhë kohe qetësie, lëvizja e ajrit ndërpritet. Zgjatja e këtij intervali ndryshon në varësi të gjendjes së motit dhe periudhës së vitit. Lëvizja e ajrit nga toka në det, që realizohet gjatë natës është fenomeni i kundërt i puhisë detare dhe njihet me emrin puhia tokësore. Kjo lëvizje e masës së ajrit nga toka në det fillon në orët e vona të natës dhe vazhdon deri afër lindje së diellit. Puhia detare i ngjan më tepër një filladi të lehtë sesa një ere të vërtetë. Është shumë më pak e theksuar se puhia detare. Në bregdetin tonë

⁹¹Instituti Meteorologjik Shqiptar (1975). *Klima e Shqipërisë*. Tiranë

puhia tokësore pengohet edhe nga qarkullimi i përgjithshëm që konstatohet gjatë stinës së verës.

Juga është erë e kuadratit të jugut. Është karakteristike për zonën bregdetare në përgjithësi dhe territoret e Durrësit dhe të Shijakut në veçanti. Në varësi të situatës sinoptike dhe të periudhës së vitit, juga mund të jetë e lagësht sidomos gjatë vjeshtës dhe dimrit, ose e thatë nga fundi i pranverës dhe përgjatë verës. Në të dyja rastet kjo erë është e ngrohtë dhe bëhet shkak për dëmtime me karakter të ndryshëm. Gjatë gjysmës së ngrohtë të vitit efektet e saj tharëse vërehen sidomos në të lashtat, të cilat nga fundi i pranverës ndodhen në fazë kritike (qumësht-dyllë). Edhe kulturat frutore pësojnë dëmtime që shprehen në rrëzimin e luleve ose frutave të porsalidhura. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për kulturat prashitëse.

II.6.Ngrohtësia

Burimet klimatike të ngrohtësisë vlerësohen duke u bazuar në të dhënat e temperaturës dhe ecurinë e saj, për mjedisin ajror (atmosferën) dhe atë tokësor (në thellësisë 5, 10, 15, 20 cm deri në 3.2 m). Temperaturat e ajrit me rregjimin e saj mesatar, me ecurinë e saj ditore, stinore e vjetore ndikon në mënyrë aktive mbi jetën, aktivitetin njerëzor, bimor dhe shtazor.

Studimi i temperaturës së ajrit do të bëhet nëpërmjet analizës së vlerave mesatare, ecurisë vjetore dhe ditore, vlerave ekstreme si dhe frekuencës së vlerave mesatare dhe ekstreme.

II.6.1.Ecuria vjetore e temperaturave të ajrit


Ecuria vjetore e temperaturave të ajrit mund të përcaktohet nga seria e vlerave mesatare mujore. Sipas të dhënave të Instituti Meteorologjik Shqiptar, për periudhën 35-vjecare (1931-1965) temperaturat mesatare të ajrit kanë qenë, siç paraqiten në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm.

Tabela 13. Temperatura mesatare e ajrit në °C

Vendndorja	Muajt												Mes. vjetore	Amp. vjetore
	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII		
Durrës	7.9	8.8	11.0	14.4	18.1	21.9	24.0	23.9	21.4	17.6	13.7	10.0	16.1	

Burimi: Instituti Hidrometeorologjik Shqiptar

Grafiku 10. Temperatura mesatare e ajrit në °C



Burimi: Instituti Hidrometeorologjik Shqiptar

Sipas të dhënave të tabelës, për këtë periudhë kohore, temperatura mesatare vjetore e ajrit është 15.8°C , kurse amplituda 18.0°C . Ecuria vjetore e temperaturave paraqet një maksimum, realizuar në muajt korrik dhe gusht (përkatësisht 24.0°C dhe 23.9°C) dhe një minimum i realizuar në muajin janar (7.9°C). Shkaqet e një realizimit të tillë lidhen me shpërndarjen gjatë vitit të energjisë diellore, për të cilën është folur. Këtu le të theksojmë se kjo varësi shkaktohet pjesërisht nga efekti i sipërfaqeve shtresë dhe pjesërisht nga ai i qarkullimit atmosferik, i cili vonesën që lidhet me karakteristikat e ruajtjes së nxehtësisë nga deti, ia transmeton edhe kontinentit.

Mbi vendin tonë dhe në territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut ky efekt është më i theksuar, sepse vonesa e të ngrohtit veror bën që korriku dhe gushti të jenë muajt më të ngrohtë. Periudha prej 6 muajsh midis ekstremeve, në përgjithësi e bën ecjen vjetore simetrike. Ky fenomen na jep të drejtën për ta ndarë vitin në katër stinë me nga tre muaj secilin. Mesatares vjetore i afrohet më shumë mesatarja e muajit të mesëm, të secilës nga stinët tranzitore, d.m.th. mesatarja e prillit për pranverën (14.4°C) dhe mesatarja e tetorit për vjeshtën (17.6°C).


Mesataret mujore mund t'i përdorim edhe për të përcaktuar shpejtësinë e ndryshimit të temperaturave brenda muajve. Për këtë qëllim në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm janë paraqitur mesataret ndërmujore në këto territore. Me variacion ndërmujor kuptojmë ndryshimin ndërmjet temperaturës mesatare të një muaji të dhënë dhe të muajit të mëparshëm. Rëndësia e këtij indeksi është i madh për faktin se mënyra e ndryshimit të temperaturës në intervalin prej disa javësh ushtron një ndikim pak a shumë të theksuar në organizmat në përgjithësi dhe mbi njeriun në veçanti. Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm paraqitet variacioni ndërmujor i temperaturave të ajrit.

Tabela 14. Variacioni mesatar ndërmujor i temperaturave të ajrit

Vendndodhja	Muajt											
	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Durrës	0.9	2.2	3.4	3.7	3.8	2.1	-0.1	-2.5	-3.8	-3.9	-3.7	-2.1

Burimi: Instituti Hidrometeorologjik Shqiptar

Grafiku 11. Variacioni mesatar ndërmujor i temperaturave të ajrit (Mesatare 35-vjeçare 1931-1965)



Burimi: Instituti Hidrometeorologjik Shqiptar

Që në pamje të parë, në grafikun e mësipërm vihet re se maksimumi i variacionit vrojtohet në periudhën tetor-nëntor, me vlerë mesatare 3.9°C . Një


maksimum sekondar mund të vihet re në periudhën prill-maj, me një vlerë 3.8°C . Variacioni arrin vlera minimale në periudhën korrik-gusht me një mesatare 0.1°C , ndërsa një minimum sekondar në periudhën dhjetor-janar, me një mesatare 0.9°C . Temperatura mesatare mujore edhe në rastin e një serie shumë të gjatë do të ishte e pamjaftueshme për të karakterizuar temperaturën e ajrit në rastin se do të mungonin njohuritë mbi amplitudën e tyre. Këto amplituda janë dhënë në tabelën dhe grafikët e mëposhtëm.

Tabela 15. Temperatura mesatare mujore më e lartë, më e ulët dhe amplituda e tyre

Vendndodhja Durrës	Muajt											
	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Më e lartë	11.6	11.7	14.2	16.6	20.7	23.8	26.2	25.8	24.0	20.2	15.8	12.1
Më e ulët	4.1	5.4	7.8	11.9	16.7	19.4	22.7	21.0	19.6	15.2	11.9	6.4
Amplituda	7.5	6.3	6.4	4.7	4.0	4.4	3.5	4.8	4.4	5.0	3.9	5.7


Burimi: Instituti Hidrometeorologjik Shqiptar

Grafiku 12. Temperatura mesatare mujore më e lartë




Burimi: Instituti Hidrometeorologjik Shqiptar

Grafiku 13. Temperatura mesatare mujore më e ulët



Burimi: Instituti Hidrometeorologjik Shqiptar

Grafiku 14. Amplituda e temperaturave sipas muajve



Burimi: Instituti Hidrometeorologjik Shqiptar

Në dimër, amplituda e ajrit brenda të njëjtit muaj arrin deri në 7.5°C (në muajin janar), kurse në verë është pothuajse sa gjysma e asaj dimërore. Të dhëna të tilla duhen konsideruar si shprehje me karakteristika të pasigurisë termike. Megjithatë këtu nuk është fjala për fenomene të jashtëzakonshme të vrojtuar në ditë të caktuara, por për ngjarje të zakonshme, të qëndrueshme, të cilat ndodhin gjatë gjithë muajit dhe që luajnë një rol të madh në biodiversitet.

Fenomene të tilla, të jashtëzakonshme, shpesh shoqërohen me pasoja të rënda praktike (tharje e bimëve, çrregullime ngrohje dhe komunikacion, përhapje sëmundjesh, pengojmë zhvillimin e turizmit) etj. Amplituda më e vogël gjatë verës paraqitet më e rrezikshme sesa lëkundja gati dy herë më e madhe e dimrit, sepse bimët duke mos plotësuar nevojat që kanë ndaj ngrohtësisë mund të bien në mënyrë të ndjeshme ndaj prodhimit. Një verë shumë e nxehtë gjithashtu ka pasojat e saj, sepse në shumicën e rasteve shoqërohet me thatësi në një kohë kur të nxehtit e madh dhe rrezatimi intensiv ka shtuar transpiracionin e bimës. Kjo ka pasoja në prodhimtarinë bujqësore.

Praktikisht një ndër veçoritë e klimës së vendit tonë është pasiguria termike, domethënë, mundësia e një amplitudë ndërmjet kufijve shumë të gjerë, që vihet re edhe gjatë analizës së vlerave mujore. Amplitudat ekstreme, që jepen në grafikët e mësipërm, nuk janë amplituda të përvitshme por amplituda që realizohen rrallë, në një periudhë të gjatë kohore. Duke studiuar shpërndarjen e vlerave të temperaturës mesatare mujore ose të shmangieve të kësaj mesatareje prej normales, konstatojmë se sa më e madhe të jetë lëkundja, aq më i vogël është probabiliteti i rastisjes. Një analizë më e thellë e ecurisë vjetore të temperaturës së ajrit mund të bëhet nëpërmjet të dhënave që përfaqësojnë njësi kohore me të vogla se muaji.

II.6.2.Ecuria ditore e temperaturave të ajrit

Ecuria ditore e temperaturave të ajrit në të dyja bashkitë, shprehet nga një valë pothuajse sinusoidale që karakterizohet nga një maksimum në orët e para të pasdites dhe nga një minimum rreth kohës së lindjes së diellit. Veçoritë themelore të ecurisë ditore të temperaturës së ajrit jepen nga rrezatimi, vranësi dhe rrymat ajrore. Me ndihmën e tabelës së mëposhtme po analizojmë për stinët ekstreme dhe vitin, ecurinë ditore të temperaturës së ajrit. Analiza e dy stinëve tranzitore do të mënjanohet për arsye të ngjashmërisë së madhe të këtyre kurbave me atë vjetore. Në mungesë të një studimi të tillë për territoret e marra në studim, po mbështetemi në të dhënat nga stacioni (Tiranë-Aeroport), shumë afër në distancë nga zona në studim.

Tabela 16. Vlerat orët të temperaturave të ajrit

Muajt/ Orët	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Mes
1	4.6	5.7	7.6	10.9	14.4	18.0	19.9	19.3	16.8	13.2	10.1	6.5	12.2
2	4.3	5.4	7.3	10.8	14.1	17.7	19.2	18.9	16.4	13.1	9.8	6.4	12.0
3	4.2	5.2	7.0	10.6	13.9	17.5	18.9	18.7	16.3	12.6	9.8	6.3	11.8
4	4.1	4.9	6.9	10.3	13.1	17.2	18.8	18.4	16.1	12.5	9.6	6.1	11.5
5	3.9	4.8	6.6	10.0	12.5	17.3	18.6	18.1	15.8	12.3	9.5	6.0	11.3
6	3.6	4.7	6.8	9.9	13.1	17.6	19.0	18.2	15.1	12.2	8.4	5.9	11.2
7	3.7	4.6	6.9	10.8	15.6	19.5	21.3	19.9	15.5	12.2	8.4	5.9	12.0
8	3.8	4.6	7.8	12.7	17.6	21.4	23.9	23.2	18.9	13.4	9.8	6.1	13.6
9	4.6	6.1	9.4	13.5	19.1	22.8	25.7	25.4	19.5	16.6	11.3	6.8	15.1
10	6.1	8.0	10.7	14.6	20.1	24.2	27.0	27.0	22.3	18.7	13.1	8.3	16.7
11	7.7	9.4	11.9	16.6	21.2	25.0	27.7	28.9	24.5	20.2	14.2	9.7	18.1
12	8.7	10.4	12.8	17.5	21.9	25.4	28.8	29.2	25.4	20.7	15.1	10.8	19.6
13	9.5	11.0	13.6	17.9	23.1	26.2	29.4	29.4	26.0	21.4	15.8	11.6	20.0
14	10.0	11.3	14.3	18.6	23.5	26.4	29.8	29.7	26.3	21.8	15.9	11.9	19.7
15	9.9	11.5	14.2	17.8	23.2	25.9	29.3	29.4	25.9	21.4	15.7	11.7	19.1
16	9.6	11.3	13.8	17.4	22.2	25.5	28.8	29.0	25.3	20.9	14.7	11.1	18.2
17	8.8	10.5	12.2	17.1	21.2	24.9	28.0	27.4	24.4	20.3	14.0	10.0	17.1
18	7.5	9.0	11.2	16.4	20.1	24.2	27.2	26.8	23.0	18.1	12.9	9.1	16.1
19	6.7	8.6	10.5	15.7	19.0	23.4	23.8	25.1	21.3	16.8	12.1	8.2	14.9
20	5.9	7.6	10.1	13.7	17.9	22.4	24.0	23.7	19.1	15.3	11.5	7.4	14.0
21	5.4	7.3	9.2	12.7	16.6	20.4	24.4	22.0	19.0	15.0	11.0	7.2	14.0
22	5.2	7.0	8.9	12.4	16.0	19.8	21.7	21.2	18.2	14.5	10.7	7.0	13.6
23	5.0	6.8	8.4	12.0	15.3	19.2	20.9	20.5	18.0	14.1	10.3	6.9	13.1
24	4.7	5.9	7.9	11.5	14.9	18.6	20.6	20.0	17.1	13.7	10.4	6.8	12.7
Mes.	6.2	7.6	9.8	13.8	17.9	21.7	24.0	23.7	20.3	16.3	11.8	8.1	15.1

Burimi: Instituti Hidrometeorologjik Shqiptar(viti 1959-1969)

Duke u mbështetur në tabelën dhe grafikun e mësipërm analizojmë se në korrik minimumi i temperaturës përlogaritet në orën 05⁰⁰, kurse maksimumi në orën 14⁰⁰, që do të thotë se ngritja e temperaturës në një ditë korriku zgjat 9 orë, kurse ulja 5 orë. Shpejtësia e ngritjes së temperaturës është më e madhe se ajo e uljes së saj. Amplituda periodike ditore, domethënë ndryshimi midis vlerës më të madhe dhe më të vogël të ajrit është 11.2⁰C. Krahasimi midis kësaj amplitude me amplitudën aperiodike (ndryshimi midis mesatares mujore të maksimumeve dhe minimumeve ditore) tregon se kjo amplitudë është 2-2.5⁰C më e madhe se amplituda periodike. Vlera mesatare e muajit korrik gjatë ditës arrin në orën 8 të mëngjesit dhe 8 të mbrëmjes. Pjesa e kurbës që kufizohet nga këto dy orë është simetrike ndaj maksimumit të orës 14⁰⁰. Një gjë e tillë ndodh në pjesën zbritëse të kurbës, të cilës derisa të arrijë vlerën minimale i duhet të kryejë një ulje shumë të ngadaltë prej 9 orësh dhe pastaj një ngritje të shpejtë prej tri orësh.

Në janar minimumi bie në orën 7³⁰, kurse maksimumi në orën 14³⁰, ngjitja e temperaturës zgjat 7 orë. Amplituda periodike ditore është 6.3⁰C, ndërsa amplituda aperiodike është 3-4⁰C më e madhe. Gjatë ecurisë ditore temperatura mesatare mujore arrihet në orën 10⁰⁰ paraditë dhe në orën 19⁰⁰ në mbrëmje. Temperatura mesatare orare me vlerë më të madhe se mesatarja mujore zgjat 9 orë e 30 minuta. Nën mesataren mujore kemi një zgjatje prej 14 orësh e 30 minutash. Pjesa e sipërme e kurbës është pothuajse simetrike (ngritja 4 h e 20' dhe zbritja 5 h e 10'). Ndërkaq, pjesa e kurbës që ka vlera nën mesatare mujore tregon një asimetri të theksuar sepse këtu ka 2h e 40' ngritje dhe 11h e 50' zbritje. Nga sa u tha më sipër rezulton se, rrezatimi diellor është një nga faktorët kryesorë, i cili në kohën e lindjes së diellit

ndërpret ftohjen e ngadaltë dhe pas kësaj sjell me vete ngritjen intensive të temperaturës. Në pjesën më të madhe të vitit, rritja e nxehtësisë paradite kryhet nëpërmjet konvektimit. Këtë nxehtësi pjesërisht e frenon dhe e ngadalëson transmetimi i nxehtësisë në tokë, avullimi dhe sipërfaqja (si konsumi i energjisë), mjegulla e mëngjesit, shtimi paradite i vranësirave (si efekt hijëzimi) dhe pakësimi i rrezatimit tokësor. Nga këto faktorë frenues apo ngadalësues, ndodh ajo vonesë për shkak të së cilës, koha e maksimumit të temperaturës së ajrit nuk përputhet me maksimumin e energjisë marrëse.

Prandaj maksimumi i temperaturave të ajrit realizohet në orët e para të pasdites. Zbritja e temperaturës fillon jo menjëherë pas vendosjes së ekuilibrit të rrezatimit diellor dhe rrezatimit tokësor, por mbas mbizotërimit të rrezatimit tokësor. Vlera e rrezatimit tokësor pas maksimumit zbret por shumë ngadalë. Pas perëndimit të diellit, edhe për një kohë të shkurtër, kemi ardhjen e rrezatimit të shpërndarë prandaj rolin drejtues e merr rrezatimi tokësor, i cili shkakton ulje të ngadalshme të temperaturës. Ndërkaq, efektin e saj e frenon nxehtësia që rikthehet prej shtresave të sipërme të sipërfaqes tokësore. Kjo mund të krijohet me anë të kondensimit (vesës, brymës) ose me marrjen e ngrohtësisë nga shtresat më të larta të ajrit, si dhe nga rrezatimi i reflektuar prej reve. Ftohja relativisht e ngadaltë gjatë natës shpjegohet me numrin e madh të këtyre faktorëve frenues.

II.7.Lagështira

Territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut janë të pasura edhe me burime lagështire. Vlerësimi i burimeve të lagështirës bëhet kryesisht për lartësinë e reshjeve të shiut, të lagështirës relative e absolute të ajrit dhe lagështirës së tokës. Burimet e lagështirës vlerësohen për vlerat mujore, stinore, si dhe për periudhën e ftohtë e të ngrohtë të vitit⁹².

Sasia mesatare shumëvjeçare vjetore e reshjeve në territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut është 931.1 mm⁹³. Shpërndarja e reshjeve gjatë vitit ka karakter të ç'rregullt mesdhetar. Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm paraqitet shpërndarja mujore e reshjeve të shiut.

Tabela 17. Reshjet mesatare mujore dhe vjetore (në mm)


Vendndodhja	Muajt												Gjithsej
	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	
Durrës	110.6	91.4	95.2	76.2	50.8	38.7	23.9	34.8	62.5	101.1	132.9	113.0	931.1

Burimi: Raporti Final për projektin mbi monitorimin e lumit Erzen

⁹² Zorba, qafe 194

⁹³ Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave (2010). *Raporti final për projektin e Monitorimin e lumit Erzen*. Bashkëpunim me SGI dhe Qendra për Kërkim dhe Zhvillimi, Itali.

Grafiku 15. Reshjet mesatare mujore dhe vjetore (në mm)



Burimi: Raporti Final për projektin mbi monitorimin e lumit Erzen


Muajt me reshje më të mëdha janë nëntori (132.9 mm), dhjetori (113.0 mm) dhe janari (110.6 mm), ndërsa muajt me reshje më të pakta janë qershori (38.7 mm), korriku (23.9 mm) dhe gushti (34.8 mm). Sasia mesatare e reshjeve që bie gjatë një muaji është 77.6 mm⁹⁴. Shpërndarja stinore e reshjeve paraqitet si në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm.

Tabela 18. Reshjet mesatare stinore (në mm)

Vendodhja	Stinët			
	XII-II	III-V	VI-VIII	IX-XI
Durrës	315	222.2	97.4	296.5

Burimi: Raporti Final për projektin mbi monitorimin e lumit Erzen

Grafiku 16. Reshjet mesatare stinore (në mm)



Burimi: Raporti Final për projektin mbi monitorimin e lumit Erzen

⁹⁴ Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave (2010). *Raporti final për projektin e Monitorimin e lumit Erzen*. Bashkëpunim me SGI dhe Qendra për Kërkim dhe Zhvillimi, Itali.


Sipas grafikut të mësipërm, stina e dimrit rezulton me reshje më të mëdha (315mm), ndërsa gjatë stinës së verës bien më pak reshje (97.4 mm)⁹⁵. Gjatë stinës së pranverës, ose fillimit të periudhës së vegetacionit, reshjet janë rreth 222.2 mm, ndërsa gjatë stinës së vjeshtës reshjet janë më të mëdha (296.5 mm). Madje gjatë këtyre dy stinëve, shirat janë më intensive dhe kjo kushtëzohet nga zhvillimi i proceseve ciklonike që ndodhin në atmosferë. Reshjet në formë breshëri janë të rralla, kurse në formë bore vetëm në ditë të veçanta një herë në disa vite. Sasia e reshjeve që bie dhe sasia e avullimit të ujit nga toka përcakton sasinë e lagështirës së ajrit. Lagështira mesatare e ajrit në territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut është 75.3 %. Gjatë të gjithë muajve të vitit lagështira e ajrit ka vlera mbi 70 %. Vlerat e lagështirës mesatare për çdo muaj jepen në të dhënat e mëposhtme.

Tabela 19. Lagështira mesatare mujore dhe vjetore në %

Vendndodhja	Muajt												Mesatarja mujore
	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	
Sukth	76.0	75.0	76.0	76.0	75.0	72.0	70.0	73.0	77.0	77.0	78.0	78.0	75.3

Burimi: Raporti Final për projektin mbi monitorimin e lumit Erzen

Grafiku 17. Lagështira mesatare mujore dhe vjetore (në %)



Burimi: Raporti Final për projektin mbi monitorimin e lumit Erzen

Gjatë periudhës së ftohtë të vitit, lagështira e ajrit në territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut ka vlera të larta, për shkak të intensitetit të lartë të reshjeve të shiut, kurse gjatë periudhës së ngrohtë, lagështira e lartë e ajrit lidhet sasinë e madhe të avullimit të ujit nga objektet ujore që gjenden në brendësi dhe afërsi të territoreve të dy bashkive. Në detin Adriatik bëhet avullimi më i madh i ujit. Në tërësi, territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut, kanë burime të pazëvendësueshme të dritës, ngrohtësisë dhe lagështirës. Këtoburime konsiderohen si të pashtershme dhe me mundësi përdorimi dhe zhvillimi të qëndrueshëm.


II.8. Pasuritë ujore të territorit bashkiak

Në hapësirën territoriale të bashkisë së Durrësit dhe Shijakut gjenden një sërë objektesh ujore, me ujra të ëmbla dhe të kripura, mbi dhe nëntokësore. Pasuria më e madhe ujore është deti Adriatik, lumenjtë Erzen dhe Ishëm, dy lagunat bregdetare, 35 ujëmbledhësit artificialë, kanalet kullues dhe ujërat nëntokësore. Në hartën e

⁹⁵Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave (2010). Raporti final për projektin e Monitorimit të lumit Erzen. Bashkëpunim me SGI dhe Qendra për Kërkim dhe Zhvillimi, Itali.

mëposhtme shfaqet pozicioni gjeografik i secilës prej njërive ujore të territorit të marrë në studim.

Harta 7. Pasuritë ujore në bashkinë Durrës dhe Shijak




Burimi: Arc GIS 10.1, viti 2016

II.8.1.Pasuria ujore detare

Një nga potencialet më të mëdha ujore që ka hapësira e marrë në studim është deti Adriatik. Gjendet në perëndim të bashkisë së Durrësit, përgjatë 61.8 km vijë bregdetare, që nga grykëderdhja e lumit Ishëm në veri deri në derdhjen e përroit të Agait në jug. Kjo vijë bregdetare përfaqëson 14.5 % të vijës bregdetare të vendit tonë. Hapësira ujore që i përket bashkisë Durrës shkon deri në 12 milje detare, deri në atë distancë që konsiderohen si ujëra territorialë. Uji dhe biodiversiteti që përmban deti Adriatik në këtë pjesë bregdetare, konsiderohet si pasuri natyrore (resurs natyror). Janë pikërisht karakteristikat fiziko-kimike të tij, që e bëjnë ujin e detit Adriatik lehtësisht të përdorur. Nga monitorimet e kryera rezulton se Ujërat e detit Adriatik kanë temperaturë mesatare vjetore 17.8°C , kurse lëkundja vjetore e temperaturave është 15.7°C ⁹⁶. Në grafikët e mëposhtëm paraqiten temperaturat mesatare, maksimale dhe minimale mujore dhe gjithëvjetore të ujit të detit Adriatik.

Grafiku 18. Temperaturat mesatare të ujit në bregdetin e Durrësit (në $^{\circ}\text{C}$)




Burimi: Pasuritë ujore të Shqipërisë, Niko Pano, faqe 400

Nga të dhënat e grafikut të mësipërm rezulton se temperatura mesatare më e lartë arrihet gjatë muajit gusht (23.4°C), ndërsa temperatura mesatare më e ulët gjatë muajit shkurt (11.9°C). Muajt me temperaturë mesatare mujore më të lartë se 20°C janë qershori, korriku, gushti, shtatori dhe tetori. Ky kufi temperature përcakton edhe fillimin e sezonit turistik në bregdetin e Durrësit. Amplituda e temperaturave mesatare është 11.5°C ⁹⁷. Krahas temperaturave mesatare në grafikun e mëposhtëm evidentohen temperaturat më të larta për çdo muaj. Temperatura maksimale e ujit arrihet gjatë muajit gusht 26.1°C , ndërsa temperaturat më të larta se 25°C mund të arrihen edhe gjatë muajve korrik dhe shtator. Temperaturat e ujit mbi 20°C mund të fillojë që nga muaji maj dhe të vazhdojnë deri në tetor. Temperatura e ujit të detit lidhet drejtpërdrejtë me mbizotërimin e kushteve klimatike mesdhetare dhe drejtimit të rrymave detare. Gjatë stinës së dimrit (dhjetor, janar dhe shkurt), temperatura e ujit të detit Adriatik nuk i kalon 15°C , ashtu siç paraqitet në grafikun e mëposhtëm.

⁹⁶Pano, N. (2008). *Pasuritë ujore të Shqipërisë*. Tiranë, faqe 398

⁹⁷Po aty.

Grafiku 19. Temperaturat maksimale të ujit në bregdetin e Durrësit (në °C)



Burimi: Pasuritë ujore të Shqipërisë, Niko Pano, faqe 400


Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm paraqen temperaturat më të ulta të ujit të evidentuara për secilin muaj. Sipas këtyre të dhënave rezultojnë se temperatura minimale arrihet gjatë muajit janar (9.7°C), ndërsa gjatë të gjithë muajve të tjerë të vitit, temperatura e ujit nuk zbritet kufirin minimal prej 10°C⁹⁸. Temperaturat minimale më të larta evidentohen gjatë muajit korrik, gusht dhe shtator, ku temperaturat nuk zbresin nën 20°C. Muaji me temperaturë më të lartë minimale është gushti, gjatë të cilit temperaturat nuk ulen nën 21°C.

Tabela 20. Temperaturat e ujit në bregdetin e Durrësit, në °C

	Muajt												Mes.
	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	
Tem. mes. (t)	12.0	11.9	13.2	15.8	19.1	22.0	22.9	23.4	22.6	20.1	16.8	13.8	17.8
Tem. max. (t _{max})	13.6	13.5	15.6	19.6	22.4	23.8	25.0	26.1	25.4	21.6	18.2	15.0	20.0
Tem. min. (t _{min})	9.7	10.2	11.0	13.5	17.0	18.9	20.3	21.3	20.6	16.5	14.8	12.4	15.5

Burimi: Pasuritë ujore të Shqipërisë, Niko Pano, faqe 400

Grafiku 20. Temperaturat minimale të ujit në bregdetin e Durrësit (në °C)



Burimi: Pasuritë ujore të Shqipërisë, Niko Pano, faqe 400

⁹⁸Pano, N. (2008). *Pasuritë ujore të Shqipërisë*. Tiranë, faqe 400.


Krahas temperaturës, një element i rëndësishëm i resursit ujqor të detit Adriatik është kripësia. Sipas statistikave kripësia në Ujërat e detit Adriatik nuk është e njëjtë gjatë gjithë vitit dhe kjo lidhet me sasinë e ujërave të ëmbla që derdhen përgjatë vijës bregdetare të Durrësit. Duke qenë se gjatë periudhës së dimrit lumenjtë Erzen dhe Ishëm kanë prurjet maksimale në grykëderdhje, kripësia e ujit të detit do të ulet deri në 36,00 ‰⁹⁹. Kripësia më e lartë është gjatë periudhës së verës (33/000) dhe kjo shkaktohet nga sasia e vogël e ujërave të ëmbla të derdhura në këtë sektor të detit Adriatik dhe sasia e madhe e ujit që avullon nga sipërfaqja e detit.

Oksigjeni është një element tjetër me rëndësi për Ujërat e detit Adriatik. Edhe sasia e oksigjenit të tretur në ujë është i ndryshëm në periudha të ndryshme të vitit. Përmbajtja e oksigjenit në ujë është në varësi të nivelit të temperaturës dhe valëzimit. Kështu, përmbajtja e oksigjenit të tretur në ujë, në vlera absolute, është më e lartë në dimër për shkak të temperaturave të ulta të kësaj stine. Vlerat më të vogla të oksigjenit vërehen në periudhat kur ka nivel të lartë të valëzimit.

Niveli i ujit në bregdetin e Durrësit është i ndryshueshëm, duke pasur një karakter të shprehur periodik. Gjatë një ditë-nate, niveli i detit ka dy vlera të ulta dhe dy vlera të larta, duke ndryshuar drejtim çdo 6 orë. Në fakt, amplituda mesatare e lëkundjeve ditore të niveleve të ujit ndryshon nga 20-30 cm¹⁰⁰.

Në bregdetin e Durrësit nivelet më të ulta të ujit vrojtohen në muajt maj dhe korrik, ndërsa më të larta në muajt nëntor dhe dhjetor. Vlerat më të larta të nivelit të detit ndikohen nga erërat intensive me drejtim det-tokë, sidomos ato të kuadrantit jugor, që kanë shpejtësi dhe kohëzgjatjen më të madhe. Deti ka nivel më të ulët të ujërave të tij bregdetare, kur erërat fryjnë nga toka në drejtim të detit. Erërat ndikojnë edhe në procesin e valëzimit. Në përgjithësi erërat me ndikim më të madh në krijimin e valëve janë ato me shpejtësi 10-20 m/s, të cilat kanë rastisje më të madhe dhe janë të qëndrueshme. Në bregdetin e Durrësit, valët më të mëdha janë kryesisht ato të drejtim jugperëndim dhe perëndim dhe kjo lidhet me mbizotërimin e erërave në këtë drejtim. Në grafikët e mëposhtëm shprehen vlerat mesatare, maksimale dhe minimale të nivelit të detit Adriatik.

Grafiku 21. Vlerat mesatare të nivelit të detit Adriatik (në cm)




Burimi: Pasuritë ujore të Shqipërisë, Niko Pano, faqe 404

⁹⁹Qiriaz, P.(2001). *Gjeografia fizike e Shqipërisë*. Tiranë.


¹⁰⁰Pano, N. (2008). *Pasuritë ujore të Shqipërisë*. Tiranë, faqe 404.

Grafiku 22. Vlerat maksimale të nivelit të detit Adriatik (cm)



Burimi: Pasuritë ujore të Shqipërisë, Niko Pano, faqe 404

Grafiku 23. Vlerat minimale të nivelit të detit Adriatik (në cm)



Burimi: Pasuritë ujore të Shqipërisë, Niko Pano, faqe 404

Tabela 21. Vlerat mesatare, maksimale dhe minimale të nivelit të detit Adriatik (në cm)

	Muajt												Mes.
	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	
Niveli mes. (H)	122	121	118	118	118	119	117	119	120	125	128	121	121
Niveli mak. (H _{max})	153	158	145	143	146	142	144	144	145	152	154	162	149
Niveli min. (H _{min})	94	83	84	91	99	104	104	101	101	98	104	96	97

Burimi: Pasuritë ujore të Shqipërisë, Niko Pano, faqe 404

Deti Adriatik konsiderohet si një potencial ujqor dhe njëkohësisht një ekosistem që përmban një shumëllojshmëri të botës së gjallë, qoftë bimore dhe shtazorë, me vlera të mëdha ekonomike dhe ekologjike. Si i tillë, ujërat detare të Durrësit konsiderohen si një resurs me vlera të mëdha përdorimi në turizëm, peshkim, transport, tregti, sporte etj.

II.8.2.Pasuritë ujore të brendshme, lumenjtë Erzen dhe Ishëm


Dy lumenjtë kryesorë që përshkojnë territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut janë Erzeni dhe Ishmi. Ata përbëjnë një kompleks të përbashkët ujqor, për shkak të pozicionit gjeografik të afërt dhe tipareve hidrologjike. Lumi Erzen (*Adraxanus*) kalon pothuajse në qendër të territoreve bashkiake të lartpërmendura. Gjatësia e lumit është 109.3 km¹⁰¹, por brenda territoreve të Shijakut dhe Durrësit gjenden vetëm 38 km, pjesë e sektorit të poshtëm të tij. Lumi Erzen futet në territoret e bashkisë Shijak, pikërisht në fshatin Çizmeli dhe mbasi përshkon fushën e Durrësit, derdhet në gjirin e Lalëzit, në veriperëndim. Erzeni e ka burimin kryesor në afërsi të Qafës së Gurakuqit, në një lartësi prej 1300 metra mbi nivelin e detit. Gjatë rrugës së tij, lumi merr ujërat e burimeve që gjenden në fshatrat Shëngjergj, Shënmëri dhe Pëllumbas. Ushqimi nëntokësor përfaqëson 31% të rrjedhjes vjetore, ndërsa ai sipërfaqësor 69 % të saj¹⁰². Rregjimi i plotave në rrjetin hidrografik të këtij lumi ka kryesisht prejardhje shiu dhe shumë më pak të përzier (shiu dhe bore). Prurja mesatare e Erzenit në derdhje është $Q_0 = 9.3 \text{ m}^3/\text{s}$ ¹⁰³. Siç paraqitet edhe në grafikun e mëposhtëm prurjet më të mëdha ky lumë i ka në muajin shkurt (17.3 m³/sek), ndërsa prurjet më të vogla në muajin korrik (2.1 m³/sek)¹⁰⁴. Për prurje të ujit mbi mesataren vjetore evidentohet muaji janar (16.3 m³/sek), shkurti (17.3 m³/sek), marsi (15.6 m³/sek), prilli (14m³/sek), maji (9.6 m³/sek), nëntori (10.1m³/sek) dhe dhjetori(12.9 m³/sek)¹⁰⁵. Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm paraqiten prurjet mesatare të lumit Erzen gjatë një viti.

Tabela 22. Prurjet mesatare të lumit Erzen në m³/s

Lumi	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjetore
Erzen	16.3	17.3	15.6	14	9.6	4.8	2.1	2.2	2.7	5.17	10.1	12.9	9.3

Burimi: Instituti Hidrometeorologjik. Atlasi klimatik i Shqipërisë, Tiranë 1988

Grafiku 24. Prurjet mesatare të lumit Erzen (në m³/s)



Burimi: Instituti Hidrometeorologjik. Atlasi klimatik i Shqipërisë, Tiranë 1988

¹⁰¹ Pano, N. (2008). *Pasuritë ujore të Shqipërisë*. Tiranë.

¹⁰² Po aty.

¹⁰³ Po aty.

¹⁰⁴ Po aty.

¹⁰⁵ Instituti Hidrometeorologjik (1988). *Atlasi klimatik i Shqipërisë*. Tiranë.

Duke qenë se sipërfaqja e përgjithshme e pellgut ujëmbledhës të lumit Erzen është 759.8 km^2 , moduli i rrjedhjes është $q_0 = 23,8 \text{ l /s.km}^{2106}$. Koeficienti i rrjedhjes ujore vjetore për të gjithë pellgun e Erzenit është $a = 0,51^{107}$. Gjatë periudhës së lagët të vitit tetor-maj (X-V), në rrjetin hidrografik të Erzenit kalon 90 % e rrjedhjes vjetore, ndërsa gjatë periudhës së thatë korrik-shtator (VII- IX) rreth 5 % të saj. Prurja maksimale me përsëritje një herë në 100 vjet është $Q_{1\%}^M = 1610 \text{ m}^3 /\text{s}$, që i përgjigjet një plote me kohëzgjatje 3/ 4 ditë dhe me një volum uhor prej $88,6 \cdot 10^6 \text{ m}^3$ ujë. Ujërat e Erzenit kanë një mineralizim mesatar prej $m_i = 354 \text{ mg / lit}$ dhe një fortësi prej 10,7 gradë gjermane. Vlerat e oksideve të tretura në ujë paaqiten në tabelën e mëposhtme.

Tabela 23. Treguesit cilësorë të Ujit të lumit Erzen

Emërtimi	O ₂ itretur	NKO (KMNO ₄)	NBO	NH ₄ mg/l	NO ₂ mg/l	NO ₃ mg/l	SiO ₂ mg/l	P ₂ O ₅ mg/l	P total mg/l
L.Erzen	7.95	1.72	0.90	0.04	0.008	0.35	11.0	0.01	0.015

Burimi: Instituti Hidrometeorologjik Shqiptar. Atlasi klimatik i Shqipërisë, Tiranë 1988

Temperatura mesatare mujore e ujërave të këtij lumi lëkundet nga $6,4 \text{ }^\circ\text{C}$ në janar deri në $29 \text{ }^\circ\text{C}$ në gusht.

Lugina e Erzenit në territoret e Shijakut dhe Erzenit është fushore dhe me meandrite të shumta. Ky lumë kalon në hapësirat e disa qendrave rurale dhe urbane. Lumi Erzen kalon në territoret e bashkisë Shijak konkretisht në fshatrat Çismeli, Hardhishtë, Pjezë, Rreth, në qytetin e Shijakut dhe fshatin Salmone. Pikërisht në Salmone del nga kjo bashki dhe kalon në territoret e bashkisë Durrës.

Në bashkinë e Durrësit lumi Erzen kalon nëpër qytezën e Sukthit, në Vadardha, në Katundin e Ri dhe Rrushkull deri sa derdhet në detin Adriatik, në gjirin e Lalëzit. Brigjet e lumit arrijnë deri në 4.5 m, ndërsa gjerësia deri në 30 m. Lumi ka një rënie mesatare rreth 6 m/km dhe për rrjedhojë shpejtësia e ujit të lumit është e vogël 0.8-0.9 m/sek¹⁰⁸. Lumi i Erzenit dallohet për erozion dhe prurje të madhe të lëndëve të ngurta, sidomos në sezonin e vjeshtës me rreth 102 km/sek. Lumi transporton rreth 3.2 milion ton materiale të gërryera nga shtrati i tij. Përgjatë rrugës së tij depozitohen si materiale fundore rreth 390.000 ton materiale të ngurta. Kjo sasi e madhe materialesh të ngurta të transportuara e klasifikon lumin Erzen si një ndër lumenjtë më të turbullt në vendin tonë, me një mesatare shumëvjeçare (e matur në fshatin Sallmone) prej 5830 gr/ m³ dhe me modul mesatar të mbajtjes së lëndëve të ngurta prej 5520 ton/ km² në vit.

Krahas lumit Erzen, në territoret më verilindore të bashkisë së Durrësit kalon rrjedhja e poshtme e lumit Ishëm. *Ishmi ose Isamnusi* i dikurshëm konsiderohet si një nga lumenjtë më të vegjël në rrjetin hidrografik të vendit tonë, si për nga sipërfaqja e pellgut të tij ujëmbledhës, ashtu edhe nga shkalla e ujshmërisë. Lumi i Ishmit ka një gjatësi prej 79.2 km, por brenda territoreve të bashkisë së Durrësit gjenden vetëm 7.1 km e fundit¹⁰⁹. Lumi Ishëm futet në territoret bashkiake të Durrësit në afërsi të fshatit Gjericaj dhe vazhdon përgjatë kufirit bashkiak derisa derdhet në gjirin e Rodonit. Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës është 673 km^2 , por në këtë pellg ujëmbledhës bën pjesë vetëm shpati veri-lindor dhe lindor i kodrave Rodon-Prezë, si pjesë e njësisë

¹⁰⁶Pano, N. (2008). *Pasuritë ujore të Shqipërisë*. Tiranë.

¹⁰⁷Po aty.

¹⁰⁸Po aty.

¹⁰⁹Po aty.

administrative të Ishmit. Përgjatë luginës së Ishmit gjenden sipërfaqet tokësore të fshatrave si: Gjericaj, Kapedanaj, Kërtushaj dhe Likmetaj.

Lumi Ishëm formohet nga bashkimi i ujërave të lumit të Tiranës, lumit të Tërkuzes dhe lumit të Zezës, por dega kryesore është lumi i Tiranës, pasi është dega e tij më e gjatë. Të tri lumenjtë e sipërpërmendur ruajnë karakteristikat e përrrenjëve malorë. Duke qenë se rreth gjysma e sipërfaqes së pellgut ujëmbledhës përbëhet nga shkëmbinj të përshkueshëm, rreth 40% e rrjedhjes ujore vjetore vjen nga ushqimi nëntokësor dhe 60% nga rrjedhja sipërfaqësore. Prurja mesatare shumëvjeçare e Ishmit në derdhje është $Q_0 = 20,9 \text{ m}^3 / \text{s}$, që i përgjigjet një moduli prej $q_0 = 31 \text{ l/s/km}^2$ ¹¹⁰. Koeficienti i rrjedhjes ujore vjetore për gjithë pellgun e Ishmit është $a_0 = 0,68$. Prurja maksimale me përsëritje 1 herë në 100 vjet është $Q^M_{1\%} = 2039 \text{ m}^3 / \text{s}$ dhe mineralizimi i këtyre ujërave është i lartë $m_i = 461 \text{ mg} / \text{lit}$. Temperatura mesatare mujore e ujërave ndryshon nga $t = 7,2 \text{ }^\circ\text{C}$ në janar deri $t = 24,9 \text{ }^\circ\text{C}$ në korrik¹¹¹. Vlerat e oksideve të tretura në ujë paaqiten në tabelën e mëposhtme.

Tabela 24. Treguesit cilësorë të ujit të lumit Ishëm

Emërtimi	O ₂ itretur	NKO (KMNO ₄)	NBO	NH ₄ mg/l	NO ₂ mg/l	NO ₃ mg/l	SiO ₂ mg/l	P ₂ O ₅ mg/l	P total mg/l
L.Ishëm	9.62	4.96	6.44	1.65	0.220	1.40	25.0	0.14	0.22

Burimi: Instituti Hidrometeorologjik Shqiptar. Atlasi klimatik i Shqipërisë, Tiranë 1988

Sasia e lëndëve të ngurta që lumi i Ishmit transporton çdo vit në det është 2 milion ton ose 45.3 g/sek, e cila shkakton një turbullirë prej 6167 gr/m³ dhe modul të rrjedhjes së aluvioneve pezull prej 2167 ton/ km² në vit¹¹². Lumi i Ishmit është me brigje të veshura me shurre të ulta dhe brigje të butë. Shpejtësia e rrjedhës, është 0.3 m/sek. Pranë fushës së Ishmit përmasat e lumit janë: gjerësia midis brigjeve: 35 metra, gjersia e syprinës ujore: 12 m, thellësia e rënies së brigjeve 4.6 m, thellësia 1 m¹¹³. Ujërat e lumenjve Erzen dhe Ishëm konsiderohen si një resurs natyror me vlera të mëdha mjedisore, ekonomike dhe sociale. Materialet e ngurta që ata sjellin kanë ndikuar në formimin e fushës së Durrësit. Materialet e ngurta në formë rërash dhe zhavorësh kanë përdorim në industri. Ujërat e të dy lumenjve përdoren për ujitje në bujqësi.

II.8.3. Lagunat bregdetare

Lagunat bregdetare ose lagunat e Bishtarakës gjenden në gjirin e Lalëzit dhe kanë një sipërfaqe prej 155 ha¹¹⁴. Lagunat njihen si liqeni i Godullës, i cili është me sipërfaqe 65 ha dhe kënetat e Bishtarakës me sipërfaqe 90 ha¹¹⁵. Liqeni i Godullës (Hamallaj) është plotësisht e izoluar nga deti Adriatik, si rezultat i mbylljes së kanaleve komunikuese të godullës me detin. Izolimi ka sjellë një gjendje eutrofike dhe për pasojë ka ndikuar në ndryshime të strukturës dhe produktivitetit të komponentëve të ekosistemit. Sipas biologëve nivelet e larta të trofisë pasqyrohen nga niveli i lartë i produktivitetit e i biomasës si: *Potamogeton pectinatus*, *Phragmites*

¹¹⁰ Pano, N. (2008). *Pasuritë ujore të Shqipërisë*. Tiranë,

¹¹¹ Po aty.

¹¹² Po aty.

¹¹³ Pasha, M., (2006). *Gjeografia ushtarake*. Botim elektronik, Tiranë, faqe 81.


¹¹⁴ Instituti i Kërkimeve Biologjike (2007). *Monitorimi I florës së zonës së mbrojtur Rrushkull-Hamallaj*. Artikull, Tiranë.

¹¹⁵ Po aty.

australis dhe *Typha angustifolia*, por edhe nga varfërimi i përbërjeve llojore të shoqërimeve bimore¹¹⁶.

Këneta e Bishtarakës (Rrushkullit) është një mbetje e kënetave të mëparshme. Ajo është pjesë e zonës ligatinore të Rrushkullit, e cila është pjesë e zonave të mbrojtura, kategoria e IV, (Rezervat natyror i Menaxhuar). Laguna e Rrushkullit konsiderohet si lagunë e vogël, e cekët dhe me sasi të lartë të lëndëve organike të ardhura dhe vendase¹¹⁷. Brigjet e kësaj lagune janë të ulëta, moçalore, ndërsa fundet e tyre janë të pasura me lëndë të dekompozuar biologjike. Laguna e Rrushkullit është e mbuluar me vegjetacion hidrofilik, kryesisht kallamishte. Kjo lagunë ka rëndësi në dimërimin e zogjve dhe të grabitqarëve të ujit dhe si e tillë është përfshirë në zonën Esmerald (Rrjeti i zonave me Interes të Veçantë të Ruajtjes (ASCI)¹¹⁸.

Harta 8. Lagunat e Bishtarakës



¹¹⁶ Instituti i Kërkimeve Biologjike (2007). *Monitorimi I florës së zonës së mbrojtur Rrushkull-Hamallaj*. Artikull, Tiranë.

¹¹⁷ Po aty.

¹¹⁸ Ministria e Mjedisit (2015). *Dokumenti i Politikave Strategjike për mbrojtjen e Biodiversitetit*. Tiranë

II.8.4.Ujëmbledhësit artificialë

Bashkia e Durrësit dhe e Shijakut kanë një numër të madh ujëmbledhësish (rezervuarësh artificialë), rreth 35 të tillë. Sipas Zyrës së Bordit të Kullimit Durrës, në hapësirën territoriale të kësaj bashkie gjenden 20 ujëmbledhësa, ndërsa në territoret e bashkisë Shijak gjenden 15 të tillë. Të gjithë ujëmbledhësat janë ndërtuar gjatë periudhës 1950-1990. Në bashkinë e Durrësit gjenden ujëmbledhësat Spitallë 1 dhe 2 (në njësinë administrative Durrës); Bozanxhie, Maskuri e Vogël, Shkallnur, Metalla, Arapaj 1 dhe 2, Memaj, Xhafzotaj (njësia administrative Rrashbull); Katundi i Ri (në njësinë administrative Katundi i Ri); Borçë, Shkallë, Shkafane, Tarin, Rada 1 dhe 2 (në njësinë administrative Manzë); Topana, Ishëm dhe Shën Pjetër (në njësinë administrative Ishëm). Në bashkinë Shijak gjenden ujëmbledhësat Shijak (në njësinë administrative Shijak); Karpen, Rubjekë, Bilalas, Kareç (në njësinë administrative Maminas); Likesh, Çallik, Romanat, Cismeli, Gjepalaj, Shtrazë, Shetel, Lagjia Popullore (në njësinë administrative Gjepalaj); dhe Koxhaz e Pjezë (në njësinë administrative Xhafzotaj). Të gjithë ujëmbledhësat zënë një sipërfaqe totale prej 6 368 ha dhe kanë kapacitet ujëmbajtës të projektuar prej 55 768 000 m³ ujë¹¹⁹. Kapaciteti ujëmbajtës aktual është 20 630 m³ ujë, ndërsa sasia e ujit e grumbulluar është 22 960³ ujë. Në tabelën dhe hartën e mëposhtme paraqitet shpërndarja hapësinore e ujëmbledhësave në të dyja bashkitë.


Tabela 25. Ujëmbledhësat sipas ndarjes së re administrativo-territoriale

Bashkia	Njësia administrative	Nr.	Ujëmbledhësi
Durrës	Durrës	2	<i>Spitallë 1 dhe 2</i>
	Rrashbull	8	<i>Bozanxhie, Maskuri e Vogël, Shkallnur, Metalla, Arapaj 1 dhe 2, Memaj, Xhafzotaj</i>
	Katundi i Ri	1	<i>Katundi i Ri</i>
	Manzë	5	<i>Borçë, Shkallë, Shkafane, Tarin, Rada 1 dhe 2</i>
	Ishëm	3	<i>Topana, Ishëm dhe Shën Pjetër</i>
Shijak	Shijak	1	<i>Shijak</i>
	Maminas	4	<i>Karpen, Rubjekë, Bilalas, Kareç</i>
	Gjepalaj	8	<i>Likesh, Çallik, Romanat, Cismeli, Gjepalaj, Shtrazë, Shetel, Lagjia Popullore</i>
	Xhafzotaj	2	<i>Koxhaz e Pjezë</i>

Burimi: Bordi i Kullimit Durrës-Krujë

¹¹⁹Bordi i Kullimit Durrës-Krujë, Të dhëna statistikore 2013

Harta 9. Shpërndarja hapësinore e ujëmbledhësve në bashkinë Durrës dhe Shijak



Punuar: Arc GIS 10.1, viti 2016

Qëllimi kryesor i ndërtimit të ujëmbledhësave ishte për ujitje të tokave bujqësore, por edhe për peshkim. Mbas vitit 1990, me ndryshimin e sistemit politik dhe mungesës së funksionit institucional vetëm një pjesë e tyre janë në funksion në ditët e sotme.

Sipas të dhënave të Bordit të Kullimit rezultojnë së vetëm 13 nga 35 ujëmbledhësat janë në funksion të ujitjes. Në funksion janë ujëmbledhësi i Topanas, i Ishmit, i Shkallës, Rubjekës, Bilalasit, Likesh, Karpen, Maskuri e Vogël, Shkallnur, Spitallë 1, Radë 1 dhe 2 dhe Karec, ndërsa 22 ujëmbledhësat e tjerë janë jashtë funksionit ose të bllokuar. Ujëmbledhësat e lartpërmendur grumbullojnë rreth 6 800 m³ ujë, pavarësisht se janë projektuar për 13 690 m³ ujë. Mosfunksionimi apo bllokimi i tyre vjen si rezultat i mosfunksionimit të portave ujëlëshuese, rrëshqitjeve zonale të digës, çarje të tubacioneve apo edhe problemeve të tjera. Të gjithë ujëmbledhësat përbëjnë një pasuri të madhe ujore me vlera në bujqësi, blegtori dhe mjedisin natyror.

II.8.5. Sistemi i kanaleve kullues

Sisemi i kanaleve të ujërave të përdorura për qytetin e Durrësit është konceptuar që në vitin 1939, i tipit të ndarë dhe me sistem trajtimi të ujërave të zeza para derdhjes së tyre në det me anë të baseneve Imhoff por nuk u arrit. Në vitin 1967 sistemi u konceptua dhe u ndërtua i kombinuar dhe pa sistem trajtimi të ujërave të përdorura para derdhjes në det, i cili përfundoi së ndërtuari në vitin 1976. Deri në vitin 1990, rreth 80 % popullsisë së zonës urbane mbulohej me rrjet të kanalizimeve të ujërave të përdorura, ndërsa sot kjo shifër është ulur ndjeshëm si rezultat i rritjes së zonave informale.

Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të përdorura të qytetit të Durrësit shtrihen në një gjatësi prej mbi 130 km, me kolektorë kryesorë prej më shumë se 12 km, tubacione sekondare rreth 46 km dhe ato terciare mbi 72 km. Kolektorët kryesorë nëpërmjet motopompave shtytëse të lagjeve 1, 13 dhe 16, i mbledh ujërat e përdorura të zonës së banuar dhe i shkarkon në kanalin kryesor kullues të ish-Kënetës me gjatësi 7 850 m.

Edhe ujërat e përdorura të qendrave të banuara Rrashbull, Vrrinë, Arapaj, Plazh, Shkozë, ish Kënetë, Spitallë e Porto Romano, që shtrihen në jug, në veri, verilindje dhe veriperëndim të qytetit të Durrësit, nëpërmjet kanaleve të hapura derdhen në det, pa ju nënshtruar ndonjë përpunimi paraprak, në kolektorët që më parë kanë shërbyer edhe si kanale kullimi e drenazhimi të ish Kënetës së Durrësit si dhe ato me drejtim për në hidrovorin e Porto Romanos.

Zona e Plazhit si zonë që është pothuajse në nivel apo nën nivelin e detit, i shkarkon Ujërat e përdorura dhe të zeza nëpërmjet 6 stacioneve të pompimit dhe 7 elektropompave (të ndërtuara para 50 vjetësh), në kolektorin kryesor të drenazhimit të zonës dikur kënetore, me drejtim për në Porto Romano ku ndodhet Hidrovori i madh. Kanali i ujërave të larta të kodrave të Shkallnurit, i cili është i shtrirë deri në derdhjen e tij në det.

Në pjesën fundore të tij ky kanal në një gjatësi prej 30 m është i veshur me pllaka betoni. Prurjet më të zakonshme të këtij kanali janë rreth 35-50 l/sek në ditë.

II.8.6. Ujërat nëntokësore

Territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut bëjnë pjesë në sistemin ujëmbajtës të kuaternarit. Këto ujra gjenden shumë pranë sipërfaqes së tokës për shkak edhe të lartësisë së vogël mbi nivelin e detit. Furnizuesi kryesor i

ujëravenëntokësore është uji sipërfaqësor i lumit Erzen. Afërsia me detin Adriatik bën që këto ujra të derdhen në detin Adriatik. Përbërja kimike e ujërave nëntokësore është e ndryshme të këtë hapësirë territoriale.

Në pjesën perëndimore të fushës së Durrësit uji ka mineralizim të tipit klorur natriumi, kurse në lindje mineralizim të tipit bikarbonat-kalcium-magnez¹²⁰. Ujërat nëntokësore janë përdorur në vazhdimësi për ujitje dhe përdorim familjar sidomos në hapësirat territoriale ku mori zhvillim informaliteti dhe ku mungon furnizimi me ujë të pijshëm.

II.9.Tokat si pasuri natyrore. Llojet e dherave, cilësitë dhe shpërndarja


II.9.1.Burimet e tokës

Në territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut gjenden toka të tipit zonal, azonal dhe intrazonal. Tokat zonale, diferencimi i të cilave bëhet në bazë të lartësisë mbi nivelin e detit, përfaqësohen nga brezi i tokave të hirta kafe së bashku me nëntipet e saj (tokat e hirta kafe të zakonshme dhe tokat livadhore të hirta kafe). Këto toka shtrihen në 78.69% të hapësirës territoriale të bashkive Durrës dhe Shijak. Krahas tokave të hirta kafe prezente janë edhe tokat azonale si: tokat aluvionale, tokat ranore dhe tokat intrazonale (tokat e kripura). Tokat aluvionale gjenden përgjatë shtretërve të lumenjve Erzen dhe Ishëm, ndërsa tokat ranore gjenden në hapësirën bregdetare. Ato zënë rreth 12.81% të sipërfaqes së territoreve të Durrësit dhe të Shijakut. Tokat e kripura shtrihen në territoret e ish-Kënetës së Durrësit dhe zënë 8.5% të sipërfaqes¹²¹. Një rëndësi të veçantë ka evidentimi i karakteristikave kryesore nëpërmjet analizës së cilësive dhe veçorive fizike, kimike dhe organike të tyre. Në hartën e mëposhtme paraqitet shpërndarja hapësinore e llojeve të tokave në territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut.

¹²⁰Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave(2010). *Raporti final për projektin e Monitorimit të lumit Erzen*. Bashkëpunim me SGI dhe Qendra për Kërkim dhe Zhvillimi, Itali.

¹²¹ Llogaritje nga programi Arc GIS 10.1

Harta 10. Tokat në bashkinë e Durrësit dhe të Shijakut



Punuar: Arc GIS 10.1, viti 2016

II.9.2. Tokat zonale

Tokat e hapësirës administrativo-territoriale të Durrësit dhe të Shijakut janë relativisht më të reja krahasuar me brezat tokësor të lartësive më të mëdha. Tokat e hirta kafe, në hapësirën në studim, kanë shtrirje deri në lartësinë 269 m mbi nivelin e detit. Ato zënë një sipërfaqe prej 33 519 ha tokë. Këto toka janë formuar në kushte specifike natyrore. Klima më e përshtatshme për formimin e tyre është klima mesdhetare fushore, gjysëm e thatë dhe klima mesdhetare kodrinore. Karakteristikat e kësaj klime janë temperaturat 15-18⁰C dhe sasia e reshjeve 1000-1800 mm në vit.

Si lëndë parentale (prindërore) kanë shërbyer depozitimet koluviale, ku këto të fundit janë krijuar nga alterimi i gëlqerorëve, shisteve argjilore, konglomeratëve dhe aluvialeve. Rëndësi ka edhe prania e ujërave nëntokësore pranë sipërfaqes së tokës, e cila luhetet 1-1.5 m në verë dhe 0.4-0.5 m në dimër, duke ndikuar në procesin e livadhizimit. Vazhdimi i procesit të tokëformimit të brezit të hirtë kafe kërkon edhe praninë e shkurreve mesdhetare, por sidomos bimësinë kalimtare drunore-barishtore (drurët: gjineshtra, frashri, koçimarja, dushku, shqopa; barërat: bishtpëlza, bishtmiu, bishtajoret e ndryshme etj)¹²².

Në një prerje tërthore të tokave të hirta kafe, vëmë re profilin e tyre, i cili mund të jetë A-C. A-(B)-C dhe A-B-C. Këto toka kanë horizont humusor të thellë, nivel humusor 2-3 % të tipit të butë, reaksion neutral, kompleks koloidal të ngopur me baza (Ca²⁺), përmbajtje karbonesh në të gjithë profilin, teksturë të mesme në të rëndë dhe tendencë argjilimi në horizontin B. Pavarësisht veçorive të përgjithshme, të njëjta, të këtij brezi toke, në shtrirjen hapësinore vihen re ndryshime të karakterit morfologjik dhe fiziko-kimik. Për këtë arsye tokat e hirta kafe ndahen në disa nëntipa: toka të hinjta kafe të zakonshme ose tipike; toka të hinjta kafe të shpërlara; toka të hinjta kafe të kuqerremta; toka livadhore të hinjta kafe (LHK) dhe toka të hinjta kafe livadhore (HKL)¹²³. Në territoret e bashkisë Durrës dhe Shijak gjendet nëntipi i tokave të hirta kafe të zakonshme dhe nëntipi i tokave livadhore të hirta kafe.

Tokat e hirta kafe të zakonshmes trihen në kodrat e Durrësit, Rodonit dhe kodrat e ulta Shënavlash-Arapaj, aty ku pjerrësia e shpateve është mbi 12%. Këto toka zënë një sipërfaqe prej 17 288 ha. Ato formohen mbi depozitimet koluviale, kryesisht nga alterimi i gëlqerorëve kimik dhe organogjenë. Në profilin e këtij nëntipi dallohen horizontet A-B-C, ku horizonti i sipërm (A) ka ngjyrë të hirtë kafe të çelët, horizonti (B) është iluvial dhe horizonti (C) ka ngjyrë të hirtë në të verdhë. Horizonti (A) ka teksturë të mesme dhe strukturë granulare kokrrizore, horizonti (B) ka përbërje mekanike subargjilore të mesme dhe strukturë kokrrizore, me pika të bardha dhe pseudomicele të karbonatit të kalciumit. Ndryshe prej horizontit (B), horizonti (C) ka më shumë pika të bardha dhe pseudomicele, si dëshmi e akumulimit të karbonateve. Në përgjithësi në këto toka zhvillohen reaksione neutrale, por me prirje bazike (pH 7.2-7.5). Kompleksi thithës koloidal është i ngopur me baza. Tokat e hinjta kafe të zakonshme kanë përmbajtje mesatare të humusit (2-3%) dhe azotit total (0.09-16 %). Kosiderohen si toka shumë të varfra me fosfor dhe të pasura me kalcium. Në bazë të përbërjes fizike këto toka kanë porozitet (50-60%)¹²⁴, çka do të thotë se ajrim dhe cilësi fiziko-mekanike janë të mira. Horizonti (A) ka densitet vëllimor 1-1.5 g/cm³ dhe densitet specifik 2.6-2.75 g/cm³. Nga bimësia spontane drunore mbizotëron gjineshtra (*Spartiumjunceum*), ndërsa nga bimësia barishtore bathra (*Asphodelis microcarpa brot*).

¹²² Gjoka, F. (2015). *Pedogjeografia*. Tiranë.

¹²³ Gjoka, F., Brahushi, F. (2007). *Tokat, natyra, cilësia, shpërndarja dhe përdorimi i tyre*. Tiranë.

¹²⁴ Po aty.

Tokat livadhore të hirta kafe gjenden në territorin fushor të bashkisë Durrës dhe Shijak, në pjesën më të madhe të fushës së Durrësit. Ato zënë një sipërfaqe prej 16 231 ha tokë. Këto toka formohen mbi depozitimet kuaternare, të përbëra nga aluvione, deluvione dhe depozitime detare. E rëndësishme është prania e bimësisë barishtore, që kushtëzohet nga Ujërat nëntokësore afër sipërfaqes (50-80 cm në dimër dhe 120-180 cm gjatë verës). Procesi pedologjik kryesor i këtyre tokave është livadhizimi. Para vitit 1945 këto toka përdoreshin si livadhe për kullotjen e bagëtive, mbasi gjatë dimrit përmyteshin. Mbas vitit 1965, këto toka u bonifikuan plotësisht. Edhe ky nëntip i tokave ka profil të diferencuar (A-B-C), ku në sipërfaqe ngjyra është e hirtë e errët dhe në thellësi e hirtë e verdhë.

Përbërja mekanike e horizonteve është subargjilore dhe argjilore. Toka është e pasur me karbonate kalciumi, ka reaksion neutral, ka përmbaje rezerva mesatare humusi, azoti, fosfori e potasi. Kjo tokë njaft poroze dhe si rrjedhojë kanë përshkueshmëri ujore të mirë. Densiteti vëllimor është 1.2-1.5 g/cm³ dhe densiteti specifik 2.65-2.75 g/cm³¹²⁵. Në këto toka rriten bimësi spontane livadhore, të përbëra nga barëra shumëvjeçarë leguminoze e graminore, bimë të kultivuara si dhe bimë spontane, si: Grami (*Cynodon dactylon L. Pers*) Telishi (*Dactylis glomerata*) etj. Tokat e hirta kafe kanë pjellori të lartë. Me shumë rëndësi është vendosja e tyre nën kulturë.

II.9.3. Tokat azonale

Në grupin e tokave azonale bëjnë pjesë tokat aluvionale-A (fluvisol, kambisol, regosol, arenosol, gleisol), të cilat konsiderohen gjenetikisht të reja. Ato zhvillohen në depozitime lumore e detare, në kushtet e klimës mesdhetare fushore, nën bimësinë barishtore dhe drunore (shelgu, plepi, verriri, marina etj) dhe nën ndikimin e ujërave nëntokësore që gjenden afër sipërfaqes së tokës. Në bazë të kushteve të formimit dhe shkallës së zhvillimit të tyre këto toka i ndajmë në: toka aluvionale të lumenjve (me nëndarjet: livadhore aluvionale dhe zallishtore) dhe toka aluvionale të bregut të detit (me nëndarjet: ranore të pazhvilluara dhe ranore të dunave të vjetra pak të zhvilluara)¹²⁶. Tokat azonale zënë një sipërfaqe prej 5 795 ha.

Tokat aluvionale të lumenjve formohen mbi depozitimet lumore në zonat e vërshimit të lumenjve Erzen dhe Ishëm. Ato zënë një sipërfaqe prej 4946 ha. Formimi dhe veçoritë e tokave aluvionale janë të lidhura me rregjimin ujqor të këtyre lumenjve, sidomos me luhatjet e nivelit gjatë vitit. Formacionet aluvionale zakonisht karakterizohen nga 2 shtresa. Në shtresën e parë vendosen depozitimet shtratore (të njëjta me ato të shtratit të lumit), të përbëra nga rëra, zhavorre e gurë. Në shtresën e dytë, mbi atë të parën vendosen subargjilat dhe argjilat në formë brezash horizontale, trashësia e të cilave ndryshon sipas vendeve. Në zonën e formimit të tokave aluvionale rritet një bimësi spontane e shumëllojshme, ku mbizotërojnë bimë drusorë si: shelgu, plepi dhe pemë barishtore si grami (*Agropyrum cristatum*), telishi (*Dactylis glomerata*) etj. Karakteristikat e nëntipeve të këtyre tokave paraqiten si më poshtë.

Tokat livadhore aluvionale (LA) shtrihen në të dyja anët e rrjedhjes të poshtme të lumenjve Erzen dhe Ishëm dhe evoluimi i tyre lidhet me ndërprerjen e procesit të sedimentimit. Këto toka zënë një sipërfaqe prej 120 ha. Ato karakterizohen nga ndërtimi shtresor i profilit, i cili është i thellë dhe prania e horizontit humusor pak i shprehur. Këto janë toka me struktura të pazhvilluara mirë dhe me përmbajtje të pakët agregatesh të qëndrueshme. Janë toka neutrale deri në bazik me reaksion (pH 7-

¹²⁵ Gjoka, F., Brahuhi, F. (2007). *Tokat, natyra, cilësia, shpërndarja dhe përdorimi i tyre*. Tiranë.

¹²⁶ Po aty.

8). Reaksioni pak bazik lidhet me përmbajtjen e CaCO_3 që shkon nga 3-15 %. Përmbajtja e humusit në sipërfaqe shkon deri në 2% dhe bie në thellësi. Kanë përmbajtje të ulët azoti dhe fosfori të asimilueshëm, ndërsa përmbajtja e potasit të këmbyeshëm është mesatar.

Tokat zallishtore formohen nga depozitimet e padiferencuara të materialeve të trasha si: zaje, gurë, zhavorre, rërë dhe fraksioneve të imta si: lymi dhe argjila. Ato gjenden në të dyja krahët e rrjedhjes së poshtme të lumenjve Erzen dhe Ishëm dhe zënë një sipërfaqe prej 7 ha. Procesi tokëformues sapo ka filluar, për shkak të përmbytjeve periodike, prandaj tokat zallishtore kanë pjellori të ulët. Këto toka kanë karakter shtresor të theksuar. Në vendet më të ngritura zhvillohet bimësia, që i hap rrugë procesit pedogjenetik dhe diferencimit të horizontit (A). Zallishtorën nuk kanë strukturë, kanë kapacitet ujor të ulët, përshkueshmëri të lartë, përcjellshmëri termike të lartë, kapacitet thithës të vogël dhe nivel të ulët të lëndës organike. Ato kanë aftësi ujëmbajtëse të vogël, përmbajtje humusi 0.15-0.4% në sipërfaqe dhe 0.1 % në thellësi. Janë toka me përmbajtje të ulët të elementeve ushqyese: azoti përmbahet në rreth 2-10 kg/ ha, fosfori 2-7 kg/ ha dhe potasi 30-140 kg/ ha¹²⁷.

Tokat ranore të pazhvilluara janë rërat e plazheve përgjatë bregdetit të Durrësit dhe zënë një sipërfaqe prej 425 ha. Ato formohen nën veprimtarinë e valëve detare dhe prurjet që ato sjellin. Më në brendësi të tokës(duke u larguar nga vija bregdetare) rritet lartësia e tyre. Në këto toka vegjetacioni pothuajse mungon dhe tokëformimi i është i vogël. Rrëra është e imët deri në e mesme(92-98%) dhe kanë profil të padiferencuar nga tekstura dhe mineralogjia. Ngjyra e tokave ranore të pazhvilluara është e hirtë, ndërsa Ujërat nëntokësore të kripura janë afër sipërfaqes. Këto toka janë shumë të përshkueshme dhe të ndjeshme ndaj erozionit. Cilësitë kryesore të tyre janë: reaksioni bazik, përmbajtja 3-10% e CaCO_3 , kapaciteti thithës i vogël i rendit 1-5 mek/100 gr tokë, përmbajtja e ulët e humusit (0.1-0.4%), azoti total (0.02%), fosforit të asimilueshëm (P_2O_5 :0.4-0.8 mg / 100 gr tokë) dhe kaliumit të këmbyeshëm (K_2O : 2-3 mg/ 100 gr tokë). Këto toka kanë pjellori të ulët.

Tokat ranore të dunave të vjetra pak të zhvilluara, gjenden menjëherë mbas tokave ranore të pazhvilluara. Këto toka zënë një sipërfaqe prej 297 ha. Në këto toka procesi pedogjenetik sapo ka filluar dhe kjo dëshmohet nga zhvillimi i bimësisë. Tokat shfaqin një gjendje bashkimi të grimcave dhe aftësi për të mbajtur ujë dhe elemente ushqyese. Ato paraqesin cilësi pak më të mira kimike, fizike dhe biologjike se tokat ranore të pazhvilluara. Në këto toka, argjila shkon 3-15%, pH 7-8, humusi 0.15-2%, azoti 0.015-0.1%, P_2O_5 0.2-1.5 mg në 100 gr/tokë, K_2O 2.5-8 mg/100 gr tokë dhe CaCO_3 2.5-8%¹²⁸.

II.9.4.Tokat intrazonale

Në grupin e tokave intrazonale bëjnë pjesë *tokat e kripura (Sollonçake, Sollonece)*. Ato gjenden në zonën bregdetare të bashkisë së Durrësit dhe zënë një sipërfaqe prej 3687 ha. Këto toka formohen kryesisht në depozitime aluviale lumore/detare me teksturë të lehtë, në kushtet e klimës mesdhetare fushore me një sezon të qartë thatësire. Procesi themelor i formimit të këtyre tokave është procesi i kripëzimit, i cili vjen si rezultati i përmbytjes së tokave të Durrësit nga uji i detit Adriatik. Në bazë të disa veçorive tokat e kripura ndahen në dy nëntipa: të kripura dhe të kripura sodike¹²⁹.

¹²⁷ Gjoka, F., Brahusi, F. (2007). *Tokat, Natyra, cilësia,shpërndarja dhe përdorimi i tyre*. Tiranë, faqe 163-164.

¹²⁸ Gjoka, F. (2015). *Pedogjeografia*. Tiranë.

¹²⁹ Po aty.

Tokat e kripura paraqiten me profil të qartë. Në sipërfaqe gjendet një shtresë e hollë, në formën e kores, rreth 0.5-2 cm trashësi. Kjo shtresë është një përzierje e kripës me grimca minerale të imta. Më poshtë gjenden me radhë shtresat A-B-C. Horizonti A ka një trashësi rreth 25 cm, me ngjyrë të murrme të kaltër, por me njolla ndryshku dhe shkëlqim të kristaleve të holla të kripës. Në këtë shtresë ka nivel të ulët të lëndës organike dhe të karbonateve. Horizonti (B) gjendet më thellë dhe ka ngjyrë më të kaltërt se horizonti (A). Në disa vende vihet re procesi i gleizimit. Karakteristikë për këtë horizont është shtresëzimi i materialeve, e cila është tipike për depozitimet aluvionale. Në horizontin (C) gjenden rëra, subrëra detare dhe lumore si dhe argjila të gleizuar të kënetës. Ujërat nëntokësore janë të cekëta dhe me përmbajtje të lartë të kripës (20-50 g/l). Tokat e kripura gjatë verës thahen dhe çahen në shkallë të ndryshme. Këto toka kanë përqindje të lartë të joneve Na⁺ dhe aktivitet biologjik të ulët.

Të gjitha llojet e tokave, që gjenden në territoret e të dyja bashkive konsiderohen si resurse natyrore dhe pasuri me vlera të paripërtëritshme mjedisore, ekonomike dhe sociale.

II.10. Pasuritë e biodiversitetit- vlerësimi si potenciale

Territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut vazhdojnë të ruajnë shumëllojshmëri dhe sasi të konsiderueshme të biodiversitetit. Këto territore bëjnë pjesë në *zonën biogeografike mesdhetare* dhe shquhen për diversitet të lartë të ekosistemeve detare, bregdetare, lagunore, kënetore, lumore, të shkurretave mesdhetare përherë të gjelbërta dhe gjetherënëse dhe dushqeve. Megjithatë, grupe të shumta bimore dhe shtazore janë ende të panjohura e të pastudiuara¹³⁰. Mungesa e njohurive shkencore rreth potencialit dhe vlerave të botës bimore dhe shtazore ka bërë që në vazhdimësi kjo pasuri të mos vlerësohet ekonomikisht, çka do të sillte rritje të të ardhura tek banorët vendas.

Sipas Konventës së Biodiversitetit (1994): “Pasuritë gjenetike, organizmat, popullimet apo çdo komponent tjetër biotik me potenciale aktuale të vlerës dhe përdorim të njeriut konsiderohen resurse biologjike”¹³¹. Territoret e të dyja bashkive kanë bimësi të katit të shkurreve mesdhetare (përherë të gjelbërta e gjetherënëse), bimësi të katit të dushqeve dhe përfaqësues të katit të ahut pavarësisht lartësisë së vogël mbi nivelin e detit. Në këto territore gjendet edhe një pasuri e madhe shtazore, si tokësore dhe ujore. Bota shtazore tokësore ka si habitat hapësirat e pasura me botë bimore, ndërsa bota shtazore ujore gjendet si në Ujërat e kripura të detit Adriatik, lagunave bregdetare, por edhe në Ujërat e ëmbla të lumenjve Erzen dhe Ishëm. Në vazhdim do të trajtohet i gjithë potenciali i biodiversitetit në bashkinë e Durrësit dhe të Shijakut.

¹³⁰ Dragoti, N. (). *Përmbledhje e Florës dhe Faunës Shqiptare*.

¹³¹ Konventa e Biodiversitetit, 1994

II.10. 1. Pasuria bimore (Flora)

II.10.1.1. Pasuria bimore tokësore

Burimet pyjore janë të gjithë elementete natyrore të një sipërfaqeje pylli a toke pyjore, me vlerë të konsiderueshme, të përdorshme për nevojat e njeriut¹³². Territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut bëjnë pjesë në katin fito-klimatik të shkurreve mesdhetare (makje-shibjaku) dhe të dushqeve. Fizionomia e bimësisë së kësaj zone karakterizohet kryesisht nga shkurre gjithmonë të blerta dhe pjesërisht nga shkurre që i lëshojnë gjethet gjatë stinës së dimrit. Nga shkurret me gjethë gjithmonë të blerta, që bëjnë pjesë në ndërtimin e makjes, më karakteristike janë: mareja (*Arbutus unedo* L.) mërsina (*Myrtus communis* L.), xina (*Pistacia lentiscus* L.), shqopa (*Erica arborea* L.), gjëneshtira (*Spartium junceum* L.), dafina e egër (*Laurus nobilis*) etj¹³³.

Mareja (*Arbutus unedo* L.), është një bimë shkurre me lartësi deri në 10m, me një ose disa degë¹³⁴.

Mërsina (*Myrtus communis* L.), është një bimë shkurre që gjendet në territoret e Durrësit dhe të Shijakut.

Xina (*Pistacia lentiscus* L.), njihet edhe me emri Liqe (në Ishëm). Xina është një shkurre me shumë degë që rritet zakonisht prej 1 deri në 4 m. Lëvoren e ka të murme, degët e reja i ka me push dhe në ngjyrë gështenjë, kurse gjetet i ka çifte të pupluara dhe lulet e vogla të kuqërremta. Fryti është një kokërr e kuqe, që kur piqet merr ngjyrë të zezë¹³⁵.

Shqopa (*Erica arborea* L.), është bimë shumëvjeçare që rritet deri në lartësinë 6 metra. Degët e reja i ka të bardhëreme e me push, gjethet lineare dhe lulet e bardha me ngjyrë trëndafili me pak erë¹³⁶.

Gjëneshtira (*Spartium junceum* L.), është një shkurre e vogël që rritet rregullisht prej 1 deri në 2 m lartësi. Degët i ka të holla e të gjata me disa gjethë të rralla. Gjethet i ka të vogla, kurse lulet të verdha e të mëdha me erë të këndshme dhe të grumbulluara në majë të degëve. Gjendet nëpër vende të thata e toka të pasura me qëlqere¹³⁷.

Nënkati i shibjakut përfaqësohet nga bungëbuta (*Quercus pubescens*), shkoza e zezë (*Carpinus orientalis*) dhe frashëri i bardhë (*Fraxinus ornus* L.)¹³⁸.

Bungëbuta (*Quercus pubescens*), është një lloj dushku me lartësi deri në 18-20 m e lartë. Lëvoret e drurëve të vjetër janë të çarë me pllaka-pllaka pak a shumë të drejta. Degët e reja i ka me push. Gjethet obovate janë 6-12 cm të gjata dhe 4-6 cm të gjera, përfundi të rumbullakëta. Gjendet në kodrat e Shijakut¹³⁹.

Shkoza e zezë (*Carpinus orientalis*) rritet në trajtë shkurre ose të një druri të vogël 6-8 m i lartë, me shumë degë të holla të mbuluara me push. Gjethet i ka më të vogla se shkoza e bardhë, kurse fruti një aken i rrethuar prej një mbështjellëse me 3 lapëza. Shkoza e zezë gjendet në kodrën Rodon-Prezë¹⁴⁰.

Frashëri i bardhë (*Fraxinus ornus* L.) është një dru deri në 8-10m i lartë dhe me diametër deri në 60 cm. Gjethet i ka të përbëra prej 7 fletëzash, ndërsa lulet janë të

¹³² Ligji Nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”

¹³³ Qendra e Studimeve Gjeografike (1990). *Gjeografia fizike e Shqipërisë*. volumni 1, Tiranë.

¹³⁴ www.agroweb.org

¹³⁵ Mitrushi, I. (1955). *Drurët dhe shkurret e Shqipërisë*. Tiranë, faqe 258-259

¹³⁶ Po aty, faqe 439-440

¹³⁷ Po aty, faqe 188-189

¹³⁸ Sirika, Sh. (2015). *Alternativat e zhvillimit të qëndrueshëm të hapësirës bregdetare Ishëm-Porto Romano*. Disertacion, Tiranë, faqe 56.

¹³⁹ Mitrushi, I. (1955). *Drurët dhe shkurret e Shqipërisë*. Tiranë, faqe 358-359.

¹⁴⁰ Po aty, faqe 335-336.

bardha dhe me erë të këndshme. Ka përhapje në kodrat Rodon-Prezë¹⁴¹.

Në këto territore gjenden formacione të vogla natyrore të pyjeve të lagura (higrofile). Ato janë të përhapura në grykëderdhjen e lumenjve Erzen dhe Ishëm, në tokat aluvionale dhe në tokat bregdetare me nivel të lartë të ujërave nëntokësore. Përgjatë rrjedhjes së poshtme të Erzenit dhe Ishmit gjenden formacione me Vidha (*Alnus glutinosa*), Rrape (*Platanus orientalis*), Shelg të bardhë (*Salix alba*), Shelg të kuq (*Salix purpurea*) dhe Plepa të bardhë (*Populus alba*)¹⁴². Në zonën e Rrushkull-Hamallajt gjendet një brez i ngushtë i pyjeve halorë mesdhetare me specie dominante: Pishë bregdetare (*Pinus pinaster*), Pishë e egër (*Pinus halepensis*) dhe rrallëherë Pishë e butë (*Pinus pinea*), e kultivuar 40 – 50 vjet më parë për stabilizimin e dunave ranore dhe mbrojtjen e tokave bujqësore¹⁴³.

Vidhi (*Ulmus foliacea*), është një dru i bukur që rritet deri në 30-40 m lartësi. Lëvoren e ka mjaft të çarë dhe me ngjyrë hiri, gjetet janë me bisht të shkurtër, lulet pothuajse pa bisht, kurse fruti është aken i rrumbullakët dhe i fillashkët i rrethuar prej një cipe të hollë. Gjendet në Hamallë dhe Sukth¹⁴⁴.

Rrapi (*Platanus orientalis*), është dru deri në 40m lartësi, me lëvore të bardhë që ndahet pllaka- pllaka. Gjendet në zaje të lumit Erzen¹⁴⁵. Një nga rrapet më të veçanta është “Rapi i Rubjekës”, që ndodhet në fshatin Rubjekë (njësia administrative Maminas), i cili mban statusin e biomonumentit. Ky rrap, i cili është një dru rreth 17 m i lartë, me diametër të trungut 7 m dhe moshë 500-600-vjeçare, ka vlera shkencore dhe biologjike, prandaj është pjesë e Zonave të Mbrojtura në vendin tonë¹⁴⁶.

Shelgu i bardhë (*Salix alba*), është dru deri në 20-22 m, me lëvore të përhimtë dhe degë të shumta të shpërndara dhe majëvarura. Lulëzon në mars-prill. Përdoret si lëndë ndërtimi dhe për objekte dhe vegla pune.

Shelgu i kuq (*Salix purpurea*) është një shkurre deri në 4-5 m. Degët e reja janë hollake, të drejta, shogëta, të shndritshme, ndërsa gjethet të këmbyera¹⁴⁷.

Plepi i bardhë (*Populus alba*), është dru deri në 30-35 m, me kurrorë të gjerë të rrumbullakosur dhe me lëvore të përhimë të bardhë e të lëmuar¹⁴⁸.

Pisha e detit (*Pinus pinaster*), është një dru deri në 40 m, me lëvore të murrme të kuqërremtë, të carrë thellë për së gjati. Degëzat janë të shogëta dhe halat janë dyshe. Boçet janë konike deri vezëngjashme¹⁴⁹.

Pisha e egër (*Pinus halepensis*), është dru deri në 25 m i lartë, me kurrorë të çrregullt dhe me lëvore të çarë thellë. Halat janë dyshe, të buta dhe me ngjyrë të blertë të çelët. Boçet janë të murrme dhe të shndritçme¹⁵⁰.

Pisha e butë (*Pinus pinea*), është dru deri në 28-30 m lartësi, me kurrorë ombrellore dhe me lëvore të murrme të përhimë, të çarë thellë që rripet pllaka- pllaka. Halat janë dyshe, majëmprehta dhe të forta. Boçet pothuajse janë pa gjemba¹⁵¹.

¹⁴¹ Mitrush, I. (1955). *Drurët dhe shkurret e Shqipërisë*. Tiranë, faqe 379-380.

¹⁴² Dragoti, N. *Vegjetacioni i pellgut ujëmbledhës i lumenjve Ishëm dhe Erzen*.

¹⁴³ Dragoti, N. *Përmbledhje e Florës dhe Faunës Shqiptare*.

¹⁴⁴ Mitrush, I. (1955). *Drurët dhe shkurret e Shqipërisë*. Tiranë, faqe 457-458.

¹⁴⁵ Akademia e Shkencave të Rep. së Shqipërisë (1988). *Flora e Shqipërisë 1*. Qendra e Studimeve Biologjike, Tiranë, faqe 401.

¹⁴⁶ Qiriaz, P., Sala, S., (2006). *Monumentet e natyrës të Shqipërisë*. Botim Elektronik.

¹⁴⁷ Akademia e Shkencave të Rep. së Shqipërisë (1988). *Flora e Shqipërisë 1*. Qendra e Studimeve Biologjike, Tiranë, faqe 103

¹⁴⁸ Po aty, faqe 105

¹⁴⁹ Po aty, faqe 83

¹⁵⁰ Po aty, faqe 85

¹⁵¹ Po aty, faqe 85

Krahas katit të shkurreve mesdhetare gjendet edhe sipërfaqe pyjore me ah. Kështu, afërsi të fshatit Bizë, njësia administrative Ishëm, gjenden rreth 60 drurë ahu të veçuar, të përshtatur në këto territore në kushte të veçanta. Ky pyll ahu, që gjendet në lartësi të vogla përfaqëson një zonë të mbrojtur në vendin tonë dhe mban statusin e biomonumentit.

Si shoqërues i katit shkurre dhe pyjor është mbulesa bimore, kryesisht e tipit umbrofil. Shoqërizimet kryesore bimore të zonës janë: Fieri (*Petris aquiliana*), Lisna ose Timusi (*Thymus vulgaris*), Shelgu i Bardhë (*Salix alba L.*), Telishi (*Dactylis glomerata*), Vicia (*Vicia Dasycarpa*), Menishtet (*Cistus salvifolius*), Festuca (*Festuca varia*), Teukli (*Teucrium polium*), Bocka (*Urginea maritima bok*), Tërfili (*Trifolium pratense*), Shpendra (*helleborus edours*), Lule shqerra (*Bellis perennis*), Geranium (*Geranium pyrenacium*), Barbstari (*Sanguisorba officina*), Ban i bletës (*Meishema officinalis*), Hedera (*Hedera helix*), Qumështorja (*Euphorbia cuparisias*), Hithra (*Urtica dioica*) Mellaga (*Althaea officinalis*) etj.

Hithra (*Urtica dioica*), është bimë shumëvjeçare rreth 30-150cm, me kërpeç zvarritës, e mbuluar dendësisht me qime djegëse. Hithra rritet në toka të pasura azotike¹⁵².

Mëllaga (*Althaea officinalis*), përdoren gjethet si burim ushqimi dhe në mjekësi për të luftuar çrregullimet në sistemin e frymëmarrjes dhe tretjes.

Shelgu i Bardhë (*Salix alba L.*), rritet deri në 30 m i lartë dhe deri në 1 m i trashë. Lëvorja e tij është e çarë për së gjati dhe me ngjyrë hiri, ndërsa degët i ka të varura poshtë në ngjyrë ulliri. Shelgu lotues gjendet pranë lumenjve Erzen dhe Ishëm dhe në fushën e Shijakut¹⁵³.

Në këto territore rritet bimë mjekësore dhe aromatike si: Mimoza (*Acacia dealbata*), Petriku kulper (*Aristolochia clematitidis*), Pelini i Zi (*Artemisa vulgaris*), Minuri si pelin deti (*Chenopodium ambrisioidos*), Menishtja me push (*Cistus incanus*), Ekualipti rruazor (*Ecualiptus glopulus*), Dëllinja e kuqe (*Juniperus oxycedrus*), Fidhësi (*Juniperus communis*), Dafina (*Laurus nobilis*), Mëllaga (*Malva silvestris*), Rigoni i Bardhë (*Origanum vulgare*), Lulëkuqja (*Papaver rhoeas*), Majdanoz (*Petroselinum sativum*), Pisha e butë (*Pinus pinea*), Trumza (*Saturea montana*), Bar majasëlli (*Teucrium polium*), Matriku (*Vinca major*) dhe Konopica (*Vitex agnus-castus*)¹⁵⁴.

Petriku kulper (*Aristolochia clematitidis*), është bimë barishtore shumëvjeçare e shogët, me erë të keqe. Rritet në vendet me bar, të lëna djerrë dhe shkurreve. Petriku kulper është bimë mjekësore¹⁵⁵.

Lulëkuqja (*Papaver rhoeas*), është bimë njëvjeçare rreth 25-90 cm, e grathët, me qime të hapura e me kërcej të degëzuar. Rritet në vende me bar. Lulëkuqja është bimë e helmët dhe mjekësore¹⁵⁶. Pjesa tjetër e bimëve mjekësore dhe aromatike janë pjesë e librit të kuq. Karakteristikat dhe statusi i tyre do të trajtohet më poshtë.

II.10.1.2. Statusi i mbrojtjes

Sipas Librit të Kuq, në hapësirën territoriale të këtyre bashkive gjenden:

¹⁵² Akademia e Shkencave të Rep. së Shqipërisë (1988). *Flora e Shqipërisë 1*. Qendra e Studimeve Biologjike, Tiranë, faqe 129.

¹⁵³ Mitrushi, I. (1955). *Drurët dhe shkurret e Shqipërisë*. Tiranë, faqe 471-472.

¹⁵⁴ Pazari, F. (2014). *Vlerësimi Ekonomik dhe ekologjik i bimëve mjekësore dhe aromatike të Shqipërisë në funksion të zhvillimit të ekonomisë rurale*. Disertacion, Tiranë, faqe 190.

¹⁵⁵ Akademia e Shkencave të Rep. së Shqipërisë (1988). *Flora e Shqipërisë 1*. Qendra e Studimeve Biologjike, Tiranë, faqe 138.

¹⁵⁶ Po aty, faqe 294-295.

- Bimë që mund të zhduken (Ex) si:

Rrënja (Quercus robur) e familjes Fagaceae-Ahore. Rrënja është një lloj druri rreth 30-40 m e lartë, me lëvore të murrme të errët. Konsiderohet si gjetherënëse dhe lulëzon në prill-maj. Gjendet në kryesisht në pyet aluviale në fushën e Hamallës dhe të Rrushkullit¹⁵⁷.

- Bimë të rrezikuara (E), ku bëjnë pjesë:

Rodhëza (Agrimonia eupatoria) e familjes Rosaceae-Trëndafilore, është një bimë barishtore shumëvjeçare me rizomë që lulëzon në maj-korrik. Kjo bimë gjendet në pyjet e rralluara e në vendet me bar në zonën të Durrësit.

Dishël, bar uzo, lule mastike (Distamnus albus) e familjes Rutaceae-Ruzore, është bimë shumëvjeçare deri 50 cm, e drunjëzuar në bazë. Gjendet në zonën kodrinore e shoqëruar me pyje termofile gjetherënëse submesdhetare.

Pleçgjaje, luletogëz (Digitalis lanata) e familjes Scrophulariaceae-Sarushtore, është bimë barishtore shumëvjeçare rreth 30-100cm. Përhapet në shkorrë të pyje të zonës fushore të Durrësit dhe Shijakut.

Gjunjëza (Ephedra distachya) e familjes Ephedraceae-Gjunjëzore, është një shkurre deri në 0.5 m e lartë. Gjendet në zonën bregdetare të Durrësit, mbi dunat ranore bregdetare.

Mëtergonë, bar i trashë (Hyosciamus niger) e familjes Solanaceae-Hikërore, është një bimë një ose dyvjeçare, leshtore me erë të keqe.

Lulebasani, balç, lulegjaku, lulemaji (Hypericum perforatum) e familjes Guttiferae-Gutifere, është bimë shumëvjeçare me kërcëj rreth 10-110 cm. Lulëzon në periudhën maj-gusht. Rritet në vendet me bar, buzë rrugëve, në livadhe, kullota etj.

Dëllinja e zezë (Juniperus communis) e familjes Cupressaceae-Selviore, është shkurre deri 7-8 e lartë, me lëkurë të lëmuar të murrme të përhimtë. Lulëzon në muajt prill-maj. Përhapet në të gjithë territorin e këtyre bashkive

Dëllinja e kuqe (Juniperus oxycedrus) e familjes Cupressaceae-Selviore, është shkurre deri 4-5 m e lartë. Degët i ka të hapura dhe me hala treshe, gjëmbore. Lulëzon në muajt mars-prill. Gjendet si në pjesë bregdetare por edhe në pjesën perëndimore të kodrave, përballë erërave detare.

Dafina (Laurus nobilis) e familjes Lauraceae-Dafinore, është shkurre ose dru i vogël dioik, 2 -20m. Ka përhapje në zonën e makies.

Pllatkë trimajëshe (Matthiola tricuspidata) e familjes Cruciferae-Kryqore, është bimë barishtore njëvjeçare me qime leshtake, 7-40 cm. Gjendet në zonat ranore të bregdetit të Durrësit.

Zambaku i detit (Panicum maritimum) i familjes Amaryllidaceae-Amarilidore, është një bimë barishore shumëvjeçare me qepijë. Gjendet në ranishtet bregdetare.

Dorëvatë (Sarcopoterium spinosum) e familjes Rosaceae-Trëndafilore, është një shkurre gjëmbore shumë e degëzuar, 30-60 cm e lartë. Gjendet në pjesën shkëmbore të Shkëmbit të Kavajës.

- Në kategorinë e bimëve të prekshme (V) bëjnë pjesë:

Biliqin (Butomus umbellatus) e familjes Butomaceae-Bliqinore, është bimë shumëvjeçare ujore. Gjendet në kanalet me ujë, ligatina dhe buzë ujërave të ndenjura.

Klad marisk (Cladium mariscus) e familjes Cyperaceae-Cyperore, është bimë barishtore shumëvjeçare me kërcëj deri 2.5 m dhe përhapet në zona ligatinore.

- Ndërsa në Bimët e ralla (R) bën pjesë:

Aster shqiptar (Aster albanicus) e familjes Compositea-kompozite, është bimë

¹⁵⁷Mitrusi, I. (1955). *Drurët dhe shkurret e Shqipërisë*. Tiranë, faqe 355.

barishtore deri 30 cm e lartë dhe ka lule gjuhëzore ngjyrë manushaqe. Gjendet në ranishtet bregdetare me shumë lagështirë të Durrësit. Mund të përdoret si bimë zbukuruese.

Sipas të dhënave zyrtare, për vitin 2016, të territorin e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut gjenden 9 263.61 ha ose rreth 92.7 km² bimësi natyrore¹⁵⁸. Në bashkinë e Durrësit gjenden 8 772.16 ha tokë me bimësi natyrore, nga të cilat 5 494.55 ha janë të zëna me pyje, 1 983.9 ha të zëna nga shkurret mesdhetare (makje dhe shibjak), 692.41 ha janë kullota, 54.19 ha bimësi ujore, 20.85 ha bimësi pyjore dhe 4.3 ha pyll gështenje¹⁵⁹. Bashkia e Shijakut, që ka një sipërfaqe më të vogël, ka rreth 491.45 ha tokë me bimësi natyrore, nga të cilat 295.74 ha janë të zëna me pyje, 143.26 ha të zëna nga shkurret mesdhetare (makje dhe shibjak), 31.7 ha janë kullota dhe 17.5 ha bimësi pyjore¹⁶⁰.

II.10.1.3.Kati medialitoral (bregdetar)

Pjesë e pasurisë bimore të zonës së studim janë edhe bimët e zonës bregdetare dhe detare të Adriatikut. Kati medialitoral përfaqësohet nga facie me depozitime të gjetheve të vdekura të Posidonies dhe leshterikëve të tjerë. Në aspektin ekologjik këto depozitime (mbetje) përbëjnë bazën për një rrjet trofik të veçantë, që karakterizohet nga prania e shumë krustaceve izopode. Në aspektin sedimentar, kjo facie, sidomos kur është e përfaqësuar qartë, përbën një mbrojtje natyrore shumë efektive për mbrojtjen e brigjeve nga erozioni. Këto depozitime nuk janë të përfaqësuara qartë në të gjithë zonën. Shoqërimi me *Fucus virsoides* është ekskluziv i brigjeve lindore (nga Shqipëria në Sloveni) e veriore të Adriatikut dhe zhvillohet në pjesën e poshtme të katit mediolitoral. Ky përfaqëson të vetmen popullatë të *Fucus*-it në Mesdhe, e kufizuar në Adriatikon e Sipërm dhe në pak pika në brigjet lindore të Adriatikut.

Duke qenë një relikto pre-Messinian, ky shoqërim është shumë i rëndësishëm nga pikpamja e trashëgimisë natyrore¹⁶¹.

II.10.1.4.Kati infralitoral (detar)

Në katin infralitoral të detit Adriatik gjenden livadhe bimore nënujore. Pasuria më e madhe bimore ujore është është Posedonia. Bimësia detare e Posedonias gjendet në afërsi të Kepit të Rodonit, në thellësinë 3-4 m nën nivelin e detit. Kjo thellësi përfaqëson kufirin më të sipërm të rritjes së Posedonias, ndërsa kufiri më i poshtë është deri në thellësinë 17-20 m. Në këtë thellësi gjenden livadhe të vazhdueshëm ose në trajtë njollash. Në zonën e Kepit të Rodonit, Posedonia, rritet kryesisht mbi “matte”, por takohet dhe në funde ranore dhe shkëmbore. Në “matte” të vdekura rriten alga dritëdashëse (fotofile) si: *Padina pavonica*, *Halopteris scopariadhe Acetabularia acetabulum*¹⁶². Në rizome dhe në fundet e mbuluara nga gjethet e dendura të Posidonies zhvillohet një komunitet i qartë hijedashës (sciafil) i dominuar nga algat të tilla, si: *Sphaerocoçus coronopifolius*, *Peyssonelia squamaria*, *Utricularia*

¹⁵⁸Urdhër nr.62, datë 04.04.2016 “Për miratimin e Listës së Llojeve të Shpendëve të Egër, veçanërisht vulnerabël”, (www.mjedisi.gov.al).

¹⁵⁹Urdhër nr.62, datë 04.04.2016 “Për miratimin e Listës së Llojeve të Shpendëve të Egër, veçanërisht vulnerabël”, (www.mjedisi.gov.al).


¹⁶⁰Fletoria Zyrtare, Vendimi nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/ bashkive”;

¹⁶¹Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave (2010). *Vlerësimi i Mangësive në Zonat e Mbrojtura, Biodiversiteti Detar dhe legjislacioni për Zonat e Mbrojtura*. Tiranë, faqe 31-49.

¹⁶²Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave (2010). *Vlerësimi i Mangësive në Zonat e Mbrojtura, Biodiversiteti Detar dhe legjislacioni për Zonat e Mbrojtura*. Tiranë, faqe 31-49.

macrophysa, *Pseudolythophyllum expansum* dhe *Flabellia petiolata*¹⁶³. *Posidonia* njihet si “mushkëria e gjelbër e Mesdheut” pasi prodhon 14 litra oksigjen në ditë në 1 metra katror¹⁶⁴.

Harta 11. Mbulesa bimore në territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut



Punuar: Arc GIS 10.1, viti 2016

¹⁶³ Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave (2010). *Vlerësimi i Mangësive në Zonat e Mbrojtura, Biodiversiteti Detar dhe legjislacioni për Zonat e Mbrojtura*. Tiranë, faqe 31-49.

¹⁶⁴ Po aty, faqe 31-49

II.11.Pasuria e kafshëve (Fauna)

II.11.1.Pasuria e kafshëve tokësore

Në këtë grup të madh të faunës hyjnë kafshët gjitarë të tokës (mishngrënës dhe barnngrënës), shpezët, zvarranikët, amfibët, insektet etj. Të gjitha kafshët tokësore të hapësirës territoriale të bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut, janë pothuajse të ngjashme me ato të të gjithë Shqipërisë dhe mbarë Mesdheut. Pavarësisht dëmtimeve nga dora e njeriut, fauna është e ende e pasur.

II.11.1.1. Gjitarët

Lepuri i egër (*Lepus europaeus*, Pall, L. *Capensis*, L) është gjitar brejtës i familjes së lepujve (*Leporidae*). Është një kafshë që ka përhapje të gjerë nga bregdeti e deri në viset më të larta, por parapëlqen shumë livadhet, arat e mbjella sidomos me jonxhë, tërfil e grurë, vreshtat e kopshtet, sidomos në viset fushore e kodrinore.

Ketri (*Scirus Vulgarus*, L.) është një gjitar brejtës shumë i vogël dhe i rrallë që jeton nëpër drurë, sidomos në ahët, dushqet, pishat, arrat, lajthitë etj, ku ushqehet me kokrrat e tyre. Gjuhët për gëzofin e tij me ngjyrë të murrme ose të zezë.

II.11.1.2.Shpezët (ornitofauna)

Bashkia e Durrësit dhe e Shijakut janë të pasur me lloje të shumta shpezësh të tokës e të ujit, sedentarë dhe shtegtarë. Një pjesë e madhe e shpezëve banojnë në këto territore në mënyrë të përhershme, e si të tillë ato janë sedentarë. Por ka edhe një numër të madh shpendësh, të quajtur shtegtarë, që vijnë nga viset e Europës Veriore për të kaluar dimrin në këto territore. Disa të tjerë e kalojnë tek ne muajin e verës, ndërsa në dimër zbresin në viset më të ngrohta të Afrikës Veriore dhe Qëndrore.

Pjesa më e madhe e shpezëve sedentarë i ndërtojnë foletë e tyre atje ku dimërojnë. Por ka edhe shumë prej tyre që bëjnë migracione sezonale, kryesisht vertikale brenda vendit. Interesantë janë edhe migracionet ditore të shumë shpendëve, të cilët lidhen kryesisht me sigurimin e ushqimit. Krahas shpezëve të tokës, kemi edhe shpezët e ujit, që gjenden në Ujërat bregdetar. Ato janë të familjes së rosave, patave (*Anatidae*), të shapkave (*Scrolopacidae*) etj. Ky grup shpendësh ushqehet me peshq, amfibë e më rrallë me insekte e zvarranikë.

Thëllëza e fushës(*Perdix perdix*, L), është më e vogël se thëllëza e malit dhe parapëlqen të jetojë në viset e ulta dhe bregdetare të Durrësit, gjatë periudhës së dimrit. Thëllëza e fushës është pakësuar shumë si rezultat i rritjes së sipërfaqeve urbane¹⁶⁵.

Shkurta (*Coturnix coturnix* L) është shpend i vogël shtegëtar, objekt i rëndësishëm gjuetie sportive (në gusht-shtator para shtegtimin të saj). Jeton nëpër arat të kultivuara me drithëra, tërfil, grurë të njomë si dhe kullota me bar¹⁶⁶.

Shpendët shtegtarë, të cilët vijnë në territoret e dy bashkive në pranverë për të folezuar e për të kaluar verën, e pastaj për t'u larguar përsëri në vjeshtë, ose për të dimëruar dhe për t'u larguar në pranverë. Kemi dy grupe shpendësh, që shtegëtojnë në distanca të vogla dhe në distanca të mëdha (shtegtime ndërkontinentale). Shpendët që vijnë për të dimëruar në territoret e Durrësit janë tushat, laureshat etj nga rendi i harabelave (*Passeriformes*), rosat e patat nga rendi i patorëve (*Anseriformes*), disa shpendë nga rendi i pëllumbave të egër (*Colmbiformes*), nga rendi shapkave dhe i

¹⁶⁵Qiriazi, P.(2001). *Gjeografia fizike e Shqipërisë*. Tiranë.

¹⁶⁶Po aty.

gjelzave të ujit (*Charadriiformes*) etj.

Nga shpezët e grupit të dytë mund të përmendim disa lloje nga rendi i harabelorve, siç janë bilbilat (*Lucinia megarhyncha*), bilbilthat (*gjinia Sylyvia*), bishtatundësit (*gjinia Motacilla*), dallëndyshet, bengat etj., si dhe nga rende të tjera si: shkurtat, turtujt etj. Gjatë kohës së folëzimit ato zhdukin një numër të madh insektesh e dëmtuesish të tjerë të kulturave bujqësore. Rrushkulli konsiderohet si zonë ligatinore me rëndësi për shpendët migratorë (less important). Në ditët e sotme RMN e Rrushkullit mban statusin e zonave me rëndësi për shpendët, sipas urdhrorit të MB, nr.2, datë 26.12.1995¹⁶⁷. Ajo ka një sipërfaqe prej 800 ha.

II.11.1.3. Zvarranikët (reptilët)

Bota e zvarranikëve është mjaft e pasur me lloje dhe ekzemplarë. Midis zvarranikëve të tokës përhapje më të madhe kanë breshkat, gjarpërinjtë dhe hardhucat.

Breshkat e tokës përfaqësohen nga breshkat e zakonshme (*Testudo hermanni* Gmel.).

Gjarpërinjtë janë më të shumtë e më të shumëllojtë. Përhapje të gjërë kanë ata johelmues si: Shigjetat (*Coluber gemonensis*, *C. Najadum* e *C. Jugularis*) dhe disa bolla, si bolla e shtëpisë (*Elaphe longissima*), e cila është e dobishme sepse ushqehet me minj dhe bolla me katër vija (*Elaphe quatuorlineata*)¹⁶⁸. Nga gjarpërinjtë helmues më i rrezikshmi është nepërka e zakonshme (*Vipera ammodytes*) kafshimi i së cilës mund të shkaktojë edhe vdekjen.

Hardhucat- më e përhapur është hardhuca e mureve (*Lacerta muralis*) dhe zhapiku i gjelbër (*Lacerta viridis*, L), që banon në vende të mbuluara me shkurre e ferra¹⁶⁹.

II.11.2. Pasuria e kafshëve të ujërave të ëmbla

Komplesi faunor i ujërave të ëmbla është mjafti pasur. Ai përfaqësohet nga peshq, moluskë (butakë), gastropodë, bivarvorë, këmbënyjtorë, gamrra, insekte ujore etj. Shpesh në ujërat e ëmbla përfshihen edhe kafshë të tjera si shpendë, amfibë e ndonjë gjitar, siç është lundërza (vidra). Fauna e ujërave të ëmbla përfshin faunën e lumenjve, të rezervuarëve, të kanaleve ujore.

II.11.3. Pasuria e kafshëve të ujërave detare

Ujërat detare në bregdetin e Durrësit janë mjaft të pasura me lloje të ndryshme peshqish, zvarranikësh, molusqesh etj. Në faunën e ujërave bregdetare dallohen si format vendase (autoktone), siç janë levreku, qefulli, koca, spalci, dental (*sinagridha*) ashtu edhe ato migratore, si stavridi, toni, shpata etj. Nga vertebrorët rëndësinë dhe përhapjen më të madhe në sasi dhe shumëllojshmëri e kanë peshqit, të cilët përfaqësohen nga lloje të shumta e me rëndësi industriale siç është sardelja (*Srdina pilchardus sardina*). Sardenja riprodhohet kryesisht në jug të bregdetit të Durrësit (

Nga kepi i Lagjit deri në ishullin e Sazanit) në thellësitë 80-100 m dhe në temperaturë të ujit shumë të përcaktuar (13.8-14.3°C). Peshq të tjerë, me rëndësi të madhe ekonomike, janë qefulli (*Mugli cephalus* e lloje të tjera), i cili gjendet në Ujërat bregdetare të Durrësit por sidomos në grykëderdhjet e lumit Erzen dhe Ishëm, nëpërmjet të cilave futet edhe në rrjedhjet e poshtme të tyre. Llojet e peshqve më të

¹⁶⁷Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave(2013). *Miratimi i listës së sipërfaqeve ligatinore bregdetare, që shërbejnë si habitate për shpendët migratorë*. Drejtoria e Biodiversitetit, Tiranë.

¹⁶⁸Qiriazi, P.(2001). *Gjeografia fizike e Shqipërisë*. Tiranë.

¹⁶⁹Po aty.

zakonshëm të raportuar për këtë bregdet janë: trigoni (*Dasyatis pastinaca*), skallina (*Squatina squatina*), peshku elektrik (*Torpedo marmorata*), spari bishtzi (*Diplodus annularis*), stavridhi (*Trachurus trachurus*), lojba (*Lichia amia*), barbuni (*Mullus barbatus*) dhe çeliku laraman (*Aphanius dispar*)¹⁷⁰.

Në ujërat bregdetare të Durrësit rriten edhe peshq më të mëdhenj si toni (*Thunnus thunnus*) me rëndësi industriale, pelamidi (*Sarda sarda*), që ngjan shumë me tonit etj. Nga jovertebrorët, në ujërat e bregdetit të Durrësit takohen me shumicë moluskë (butakë), sfungjerë, celenteratë, lëkurëgjemborë (ekinoderma) si iriq, yje, zambakë deti etj. Molusqet më të zakonshëm të raportuar në livadhet me Posidonia në Kepin e Rodonit janë gastropodët *Clanculus cruciatus*, *Clanculus corallinus*, *Homalopoma sangunium*, *Jujubinus exasperatus*, *Jujubinus striatus*, *Calliostoma conulum*, *Tricolia tenuis*, *Bittium reticulatum*, *Cerithium vulgatum*, *Hexaplex trunculus*, *Columbella rustica*, *Nassarius incrassatus*, *Hypseldoris tricolor* dhe dykapakorët *Pinna nobilis*, *Callista chione*, *Parvicardium exiguum*¹⁷¹. Molusqet (*Jujubinus striatus* dhe *Calliostoma conulus*) janë pjesë e Listës së Kuqe të florës së vendit tonë dhe konsiderohen me rrezik të ulët zhdukje, por jo e varur nga masat konservuese (LR nt)¹⁷². *Tricolia tenuis* është pjesë e Listës së Kuqe, që ka përhapje më të vogël se 100 km². Nga gastropodët rriten patelat (*Patella*), muresket (*Murex*) etj. Nga krustacët rriten karkalecët e deti (*Panaeus*). Në Ujërat detare rriten dhe mjaft zvarranikë, si breshka, gjarpërinj uji etj.

Në këto territore ka pasuri nëntokësore (qymyrguri, naftë dhe gaz natyror); pasuri mbitokësore (argjila, rëra, zhavorre dhe forma të veçanta relievi); pasuri ujore (detare, lumore, kënetore dhe ujëmbledhësa); burime të pasura drite, lagështire dhe nxehtësie; sipërfaqe të konsiderueshme toke bujqësore dhe biodiversitet të pasur.

Në hapësirën territoriale të këtyre bashkive gjenden qymyrguret e Manzës, nafta dhe gazi natyror në shelfin bregdetar të Durrësit, argjilat e Currilave, rërat e bregdetit të Durrësit, zhavorret e sektorit të poshtëm të lumit Erzen, gjeomonumentet e Zonave të Mbrojtura; ujërat territoriale të detit Adriatik, Ujërat e ëmbla të lumit Erzen dhe Ishëm, Ujërat kënetore të Bishtarakes, 35 ujëmbledhësat artificiale; sasi të mëdha të dritës, reshjeve dhe ngrohtësisë diellore; sipërfaqet e konsiderueshme të tokave të hirta kafe dhe bota bimore e shtazore (tokësore dhe ujore). E gjithë kjo pasuri natyrore përbën një burim natyror me vlera ekonomike, ekologjike dhe humane, me rëndësi lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare.

¹⁷⁰ Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave (2010). *Vlerësimi i Mangësive në Zonat e Mbrojtura, Biodiversiteti Detar dhe legjislacioni për Zonat e Mbrojtura*. Tiranë, faqe 31-49.

¹⁷¹ Po aty, faqe 31-49.

¹⁷² Akademia e Shkencave (1995). *Libri i Kuq, Bimët e kërcënuara dhe të rralla të Shqipërisë*. (Instituti i Kërkimeve Biologjike), Tiranë

KAPITULLI III

III. POPULLSIADHE PËRDORIMI I BURIMEVE NATYRORE NË TERRITORIN E BASHKISË SË DURRËSIT DHE TË SHIJAKUT

Burimet natyrore konsiderohen si resurse vetëm në rastin kur ato përdoren nga njeriu në kushte të caktuara të zhvillimit ekonomik. Resurset natyrore ndikohen dhe ndikojnë në zhvillimin human. Sasia e burimeve të natyrës ndikon në përcaktimin e nivelit të zhvillimit social-ekonomik të banorëve vendas, por nga ana tjetër zhvillimi human ndihmon ose pengon zhvillimin e qëndrueshëm të mjedisit. Territorët e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut njihen për popullimin e tyre të hershëm, gati 30-shekullor. Në këtë periudhë të gjatë kohore është ushtruar presion mbi natyrën dhe për rrjedhojë vihen re ndryshime në cilësinë dhe sasinë e burimeve të natyrës. Në *çështjen e parë* dhe *të dytë*, të kapitullit të tretë është trajtuar një historik i shkurtër i popullimit të kësaj hapësire territoriale. Dinamika e zhvillimit të popullsisë është trajtuar në dy periudha: periudha e parë që nga fillimet e popullimit deri në vitin 1990 dhe periudha e dyta nga viti 1990 deri në ditët e sotme. Në *çështjen e tretë* bëhet një analizë e shpërndarjes hapësinore të popullsisë duke evidentuar njëkohësisht dallimet dhe të përbashkëtat midis bashkisë së Durrësit dhe Shijakut. Pjesë e kësaj çështje është trajtimi i strukturës moshore dhe gjinore, si dhe niveli i punësimit dhe papunësisë për popullsinë e të dyja bashkive. Pjesë e *çështjes së katërt* është analiza e mënyrës së përdorimit të burimeve natyrore të këtyre territoreve. Këtu trajohet përdorimi i pasurisë minerale nëntokësore dhe mbitokësore, i burimeve klimatike, i pasurive ujore, i tokës dhe biodiversitetit.

III.1. Popullimi i territoreve të Durrësit dhe Shijakut

Vendndodhja në gjerësitë gjeografike mesatare, pozicioni midis lindjes dhe perëndimit, dalja e gjerë në detin Adriatik, relievi pothuajse tërësisht fushor, klima mesdhetare, shumëllojshmëria e tokave dhe e biodiversitetit kanë mundësuar popullimin e hershëm dhe të vazhdueshëm të territoreve të bashkisë Durrës dhe Shijak. Banorët e parë i përkasin periudhës së prehistorisë. Kjo dëshmohet nga objektet arkeologjike (çekanë guri, sopata bronxi etj.), të shekullit XII-VII para erës sonë, të gjendura përgjatë vijës bregdetare të Durrësit. Duke qenë se të dhënat historike rreth kësaj periudhe janë të pakta, historianët, kur flasin për themelimin e qytetit të Durrësit, bazohen tek një legjendë e lashtë, e riprodhuar nga historiani grek, Apiani (shek I-II i erës sonë). Sipas tij: “Ishte pikërisht Epidamni, mbreti i barbarëve të këtij vendi, që ndërtoi një qytet dhe i vuri emrin e tij. Pranë tij, u ndërtua një liman nga Dyrrahu (nipi i Epidamnit) e në nder të tij qyteti më vonë mori emrin Dyrrah”¹⁷³.

Po sipas Apianit, ky qytet u zotërua me rradhë nga fiset ilire si: brygët, taulantët dhe liburnët. Taulantët në luftën kundër liburnëve u ndihmuan nga korkyrasit (Korfuzi i sotëm). Pikërisht në këtë periudhë filloi kolonizimi helen. Studimet historike në vendin tonë njohin vitin 627 para erës sonë, si vitin e themelimit të qytetit të Dyrrahut. Sipas Ciceronit (106-43 para erës sonë), Durrësi ishte një qytet me popullsi të madhe, të gjallë e të zhurmshme¹⁷⁴.

Pavarësisht se për këtë periudhë nuk kemi të dhëna statistikore mbi popullsinë,

¹⁷³ Xaxa, I., Shuke, A. (2002). *Durrësi, vendlindja jonë*. Globus R.,Durrës

¹⁷⁴ Po aty.

studiuesit historianë, bëjnë një llogaritje të saj mbi madhësinë e objekteve të ndërtimit. Kështu, gjatë shekullit I–II të erës sonë është ndërtuar amfiteatri i Durrësit, i cili kishte rreth 15 000 vende për spektatorët¹⁷⁵. Nga kjo e dhënë mendohet se në qytetin e Durrësit jetonin rreth 30 000 banorë. Gjatë periudhës së mesjetës dhe asaj osmane, numri i popullsisë ka ndryshuar në vazhdimësi, herë është shtuar dhe herë është pakësuar.

Rritja e numrit të popullsisë lidhet me periudhat e lulëzimeve ekonomike dhe të mbizotërimit të paqes. Periudhat kohore të luftimeve të mëdha, të shoqëruara me ritme të ulta të zhvillimit ekonomik (veçanërisht të produkteve bujqësore dhe blegtorale), si dhe periudhat e katastrofave natyrore kanë ndikuar në rënien e numrit të popullsisë në territoret e këtyre bashkive. Territoret bregdetare e fushore të Durrësit dhe të Shijakut kanë qenë historikisht beteja luftimesh; hapësira të rrezikuara nga përmbytjet e prurjeve të lumenjve Erzen e Ishëm dhe nga ujërat e detit Adriatik, por njëkohësisht edhe terrene me paqëndrueshmëri të lartë sizmike. Pavarësisht këtyre dukurive negative, territoret e të dyjave bashkive kanë qenë të populluara në vazhdimësi.

Të dhënat e para zyrtare për numrin e popullsisë i përkasin vitit 1923, ku sipas këtij regjistrimi, numri i popullsisë së qytetit të Durrësit ishte 4 785 banorë, ndërsa në vitin 1938 rreth 10 506 banorë¹⁷⁶. Për periudhën 1938-‘45 nuk ka të dhëna zyrtare si rezultat i zhvillimit të Luftës II Botërore. Vetëm gjatë periudhës komuniste (1945-1990), pati rritje të shpejtë e të vazhdueshme të numrit të popullsisë në këto territore, ashtu si në të gjithë hapësirën territoriale të vendit tonë. Sistemi socialist, në vendin tonë, ndoqi politika (pro-nataliste), të cilat nxisnin shtimin e numrit të lindjeve tek femrat në moshë riprodhuese. Sipas kësaj ideologjie të zhvillimit human, familjet e mëdha (me shumë fëmijë), do të merrnin ndihma ekonomike dhe sociale. Nën atë me shumë fëmijë konsideroheshin “heroina”. Nga ana tjetër, rritja e shërbimeve, e kujdesit shëndetësor, rritja e nivelit dhe numrit të të arsimuarëve dhe sidomos zhvillimi ekonomik (industrialo-bujqësor) do të ndikonte në uljen e nivelit të vdekjeve dhe sidomos të vdekshmërisë foshnjore.

Sistemi komunist, nëpërmjet politikave të tij, nuk kontrollonte vetëm lëvizjen natyrore të popullsisë, por edhe lëvizjen hapësinore (emigrimet dhe imigrimet). Duke qenë se në territoret e Durrësit dhe të Shijakut mori përparësi zhvillimi urban dhe ai rural, kjo u shoqërua me zhvillim ekonomik (industrialo-bujqësor); me zhvillim të infrastrukturës; të turizmit etj. Këto zhvillime kërkonin fuqi puntore, të cilat mund të siguroheshin nga qytetet apo fshatrat e tjerë të vendit tonë. Gjatë këtyre viteve kishte më shumë të ardhur sesa të largur. Lëvizjet hapësinore zhvilloheshin si nga brenda territorit (nga hapësirat rurale në ato urbane dhe rurale-rurale), por edhe nga jashtë territoreve të Durrësit dhe të Shijakut. Pjesa më e madhe e popullsisë së ardhur, u vendos në zonat që konsideroheshin urbane (Durrës, Shijak, Sukth dhe Manzë) dhe një pjesë e tyre në zonat rurale kur gjendeshin kooperativat (organizime bujqësore). Si qendra më të rëndësishme ekonomike me efekte punësimi të popullsisë konsideroheshin: zona industrial e Shkozetit dhe e Porto Romanos, porti i Durrësit, miniera e Manzës dhe kooperativat bujqësore të Rrashbullit, Sukthit etj.

Gjatë periudhës komuniste regjistrimi i popullsisë bëhej çdo 5 vjet. Duke u bazuar tek buletinet statistikor pranë zyrës së INSTAT-it, në prefekturën e Durrësit, për periudhën 1945-1989, ka një ndryshim të numrit të popullsisë nga 74 500 në 259

¹⁷⁵Xaxa, I., Shuke, A. (2002). *Durrësi, vendlindja jonë*. Globus R., Durrës

¹⁷⁶Bërzholi, A. (2014). *Migrimet e popullsisë së Shqipërisë brenda vendit dhe ndikimet në dinamikën e popullsisë*. Revistë nr.1 Demografia, Tiranë.


100 banorë¹⁷⁷. Tabela dhe grafiku i mëposhtëm shpreh ndryshim e popullsisë në territoret e bashkisë së Durrësit dhe Shijakut në vitet përkatëse.

Tabela 26. Popullsia mesatare vjetore e rrethit Durrës në vitet 1945-1990

Vitet	Popullsia e përgjithshme	Banorë në qytet	Banorë në fshat
1945	74500	26500	48000
1950	82800	29200	53600
1955	103800	43600	60200
1960	126600	60200	66400
1965	148800	69400	79400
1970	170500	77300	93200
1975	190100	90800	99300
1980	209500	101400	108100
1985	234472	112425	122047
1990	259100	128459	130641

Burimi: Zyra e INSTAT-it pranë Prefekturës së Durrësit

Grafiku 24. Popullsia mesatare vjetore për periudhën (1945-1990)



Burimi: Zyra e INSTAT-it pranë Prefekturës së Durrësit

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme kuptohet që rritja më e madhe e popullsisë ka ndosur në zonat urbane. Në këtë periudhë 45-vjeçare, popullsia banuese në territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut u rrit me 3 herë. Ky ndryshim i theksuar i numrit të popullsisë, i ndikuar më tepër nga lëvizja natyrore e popullsisë dhe më pak nga lëvizja hapësinore, ka sjellë një rritje të vazhdueshme të presionit human mbi tokën, biodiversitetin dhe pasurinë ujore të këtyre territoreve. Një ndër ndërhyrjet më të mëdha të njeriut në këto territore është kryer gjatë vitit 1965-së, me bonifikimin e kënetës së Durrësit¹⁷⁸.

Bonifikimi u shoqërua me ndryshime të ekosistemeve ujore dhe tokësore përreth. Krahas saj, hapja e tokave të reja në rrëzë të kodrave të Durrësit dhe të

¹⁷⁷Prefektura e Durrësit (2015). *Buletini Statistikor 1989*. Zyra e INSTAT-Durrës.

¹⁷⁸Qendra e Studimeve Gjeografike (1990). *Gjeografia fizike e Shqipërisë*. volumni 1, Tiranë.

Rodon-Prezës, u shoqëruan me aktivizimin e proceseve të shpatit dhe humbje të vlerave të biodiversitetit. Hapja e minierës së Manzës do të sillte ndotje të tokës, të ujërave tokësore në zonën përreth saj, çka do të pengonte më vonë zhvillimin e kulturave bujqësore. Zhvillimi i industrisë së gomës dhe plastikës në zonën e Shkozetit dhe të industrisë kimike në Porto Romano do të sillte ndotje të tokës, ujit dhe ajrit brenda dhe përreth hapësirës industriale.

Rritja e numrit të popullsisë, zhvillimi i ekonomisë bujqësore në zonat rurale dhe i degëve të industrisë në zonat e lartpërmendura, kanë ndikuar në uljen e vlerave të resurseve dhe pasurive natyrore që ofrojnë territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut. Prandaj, zhvillimet e pakontrolluara humane mbas vitit 1990, mungesa e politikave menaxhuese dhe problematikat mjedisore të trashëguara kërkojnë domosdoshmërinë e marrjes së masave mbrojtëse për ruajtjen e vlerave natyrore. Në politikën menaxhuese ka rëndësi studimi dhe evidentimi i trendeve të zhvillimit human gjatë viteve të fundit për të mundësuar ruajtjen dhe mirëpërdorimin e resurseve natyrore që ofrojnë këto territore.

III.2. Popullsia e Bashkisë Durrës dhe Shijak mbas vitit 1990

Në territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut, zhvillimet më të mëdha demografike kanë ndodhur mbas vitit 1990. Në këtë periudhë 25-vjeçare është rritur numri i popullsisë dhe për rrjedhojë ka ndryshuar struktura moshore, gjinore dhe arsimore e saj. Sipas të dhënave të Institutit të Statistikave (INSTAT-it), popullsia në vitin 2014, në të dyja bashkitë është 349 010 banorë¹⁷⁹. Duke e krahasuar me numrin e popullsisë në vitin 1991, i cili ishte 165 219 banorë, mund të themi se popullsia është 2-fishuar. Megjithatë, ritmet e rritjes së popullsisë nuk kanë qenë të njëjta nga njëri vit në tjetrin. Sipas të dhënave zyrtare në fillim të viteve 1990-të ka pasur rënie të përgjithshme të numrit të popullsisë dhe kjo lidhet me emigrimet masive.

Ndryshimet politike në vendin tonë dhe rënia e vazhdueshme ekonomike e trashëguar nga periudha e sistemit komunist do të sillnin dobësim deri në humbje të koshencës regjionale (lidhja e njeriut me tokën) dhe kohezionit social (lidhjet njeri-njeri) midis banorëve të Durrësit dhe të Shijakut. Në vitet e para të tranzicionit u braktisën zonat industriale, u shpërbënë kooperativat bujqësore dhe për rrjedhojë një numër i madh punonjësish mbetën të papunë. Në fillim të vitit 1990, vendi ynë, i izoluar për një periudhë 45-vjeçare, lejoi lëvizjen e lirë të njerëzve. Mungesa e një punë, dëshira për të njohur botën dhe mundësitë e reja të jetesës bënë që një numër i madh njerëzish, nga territoret e këtyre bashkive, të përfshihen nga lëvizjet hapësinore, sidomos nga migrimi i jashtëm.

Si rrugë emigrimi njerëzit përdorën transportin ujor dhe ajror. Porti i Durrësit u përdor si një portë dalëse, për t'ju drejtuar brigjeve të Italisë (Barit dhe Brindizit). Korriku i vitit 1990, njihet si muaji i eksodit apo lëvizjeve më masive të popullsisë. Një periudhë e dytë e lëvizjeve migruese është mars-korriku i vitit 1991, nëpërmjet ambasadave të huaja në vendin tonë, ku një pjesë e mirë e popullsisë ju drejtua shteteve më të largëta të Europës. Largimi masiv i popullsisë çoi në braktisjen e plotë të tokës dhe pasurisë familjare të krijuar. Po sipas të dhënave të INSTAT-it, në vitin 1992 rezultojnë rreth 162 846 banorë në këto territore¹⁸⁰. Kjo e dhënë është një tregues i lëvizjeve masive të popullsisë.

Në vitet në vazhdim numri i popullsisë filloi të rritej, i ndikuar nga lëvizjet e brendshme të popullsisë. Ajo çka e nxiti dhe e ndihmoi masivizimin e kësaj lëvizje

¹⁷⁹ INSTAT(Institutit të Statistikave) -Buletini Statistikor 2014.

¹⁸⁰ INSTAT(Institutit të Statistikave) -Buletini Statistikor 1992.

migruese ishte ligji “7501” i tokës, sipas të cilit, toka (si pasuri natyrore) i kthehej ish-pronarëve, si dhe njëkohësisht mund të shitej e të blihej. Territorët e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut janë konsideruar në vazhdimësi shumë atraktive për popullsinë e zonave urbane dhe rurale të bashkive të tjera të Shqipërisë. Sipas Censurit të vitit 2000, numri i popullsisë në territoret e të dyja bashkive ishte 181 662 banorë¹⁸¹. Vetëm mbas vitit 2000 popullsia e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut kalon shifrat e vitit 1989 dhe vazhdon rritjen e mëtejshme. Sipas të dhënave zyrtare, në periudhën 14 vjeçare, pra nga viti 2000 deri në vitin 2014, ka një dyfishim të numrit të popullsisë nga 181 662 në 349 010 banorë¹⁸². Ritmet më të mëdha të rritjes së popullsisë evidentohen deri në vitin 2005 (312 656 banorë)¹⁸³ dhe kjo si rezultat i numrit të lartë të popullsisë së ardhur. Vetëm në vitin 2005 evidentohen 27 114 persona të ardhur dhe vetëm 12 885 persona të larguar, pra shtesa mekanike është 14 229 individë¹⁸⁴. Po gjatë këtij viti shtesa natyrore e popullsisë (raporti lindje-vdekje) ishte e vogël, 1 432, çka do të thotë që peshën më të madhe në rritjen e popullsisë në këtë territorë e zënë ardhjet masive të popullsisë. Në vitet në vazhdim, ritmet e rritjes së popullsisë do të jenë të më ulta, si rezultat i ritmeve të ulta të lëvizjeve migruese, të rënies së numrit të lindjeve dhe rritjeve së numrit të vdekjeve. Nga të dhënat e INSTAT-it vihet re një rënie e vlerës së koeficientit të lindshmërisë nga 8.4 në vitin 2005 në 7.1 në vitin 2011, ndërsa koeficienti i vdekshmërisë paraqitet në rritje, në vlerat 3.9 dhe 4.3 në vitet e lartpërmendura. Nëpërmjet të dhënave të mëposhtme pasqyrohet ndryshimi i numrit të popullsisë së të dyja bashkive, në vitet e dhëna më poshtë.

Tabela 27. Dinamika e popullsisë në territorin e ish-rrethit Durrës

Vitet	Popullsia (Bashkia Durrës dhe Shijak)	% e ndryshim të popullsisë nga 1989	% e ndryshimit të popullsisë nga viti paraardhës i dhënë	Dendësia
1989	187000	-	-	434.8
1991	165219	-12	-12	384.2
1992	162846	-13	-0.12	378.7
1995	193639	+1.03	+1.18	450.3
1996	188963	+1.01	-0.03	436.5
2000	181662	-2.86	-0.04	422.4
2002	195157	+1.04	+1.07	453.8
2003	209989	+1.12	+1.07	488.3
2004	296996	+1.58	+1.41	690.6
2005	312656	+1.67	+1.05	727.1
2006	314684	+1.68	+1.00	731.8
2007	321607	+1.71	+1.02	747.9
2008	329603	+1.76	+1.05	766.5
2009	334871	+1.79	+1.02	778.7
2010	339962	+1.81	+1.02	790.6
2013	344398	+1.84	+1.01	800.1
2014	349010	+1.86	+1.01	811.6

Burimi: INSTAT, Buletini Statistikor 1989, 1991, 1992, 1995, 1996, 2000, 2002, 2003, 2004, 2005, 2009, 2010, 2013, 2014.


¹⁸¹ INSTAT (Instituti i Statistikave) - Censuri 2001.

¹⁸² INSTAT (Instituti i Statistikave) - Buletini Statistikor 2014.

¹⁸³ INSTAT (Instituti i Statistikave) - Buletini Statistikor 2005.

¹⁸⁴ Po aty.

Grafiku 25. Numri i popullsisë në territoret e bashkisë Durrës dhe Shijak mbas 1990-s.




Burimi: Instituti i Statistikave, Buletini Statistikor 1989, 1991, 1992, 1995, 1996, 2000, 2002, 2003, 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, 2013, 2014.

Sipas të dhënave të INSTAT-it, numri i popullsisë së Shqipërisë në vitin 2014 është 2 895 000 banorë, kurse numri i popullsisë në bashkinë e Durrësit dhe të Shijakut 349 000 banorë¹⁸⁵. Duke bërë një analizë për vitin 2014, dalim në përfundimin se gjatë këtij viti në territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut jeton rreth 12% e popullsisë së vendit tonë, pavarësisht se këto territore zënë vetëm 1.5% të të gjithë territorit të Shqipërisë. Siç mund të vihet re, presioni mbi mjedisin është i madh, ku një individ të vetëm i takon rreth 1 238 m² tokë.

Ritmet e rritjes së popullsisë pasqyrojnë një ndryshim të raportit të popullsisë për njësi të sipërfaqes. Gjatë periudhës 25-vjeçare, 1989-2014, vihet re një dyfishim i dendësisë së popullsisë, nga 434.8 b / km² në 1989-n, në 811.6 b / km² në vitin 2014. Ndryshimet më të shpeshtë (uljet dhe ngritjet) të dendësisë së popullsisë vihen re gjatë periudhës kohore 1989-2000 dhe kjo lidhet me lëvizjen më të madhe natyrore dhe hapësinore të popullsisë. Ritmet më të shpejta të rritjes së dendësisë së popullsisë i takojnë vitit 2000-2004. Mbas këtyre viteve ritmet e rritjes së numrit të popullsisë për njësi të sipërfaqes do të jenë më të vogla dhe graduale. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet ndryshimi i dendësisë së popullsisë në disa vite përkatëse. Vlera prej 811.6 b/km², e përfshin Durrësin dhe Shijakun në grupin e bashkive me dendësi të lartë të popullsisë.

¹⁸⁵INSTAT(Instituti i Statistikave) -Buletini Statistikor 2014

Grafiku 26. Ecuria e dendësisë së popullsisë në bashkinë Durrës dhe Shijak



Burimi: Instituti i Statistikave, Buletini Statistikor 1989, 1991, 1992, 1995, 1996, 2000, 2002, 2003, 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, 2013, 2014.

Krahas evidentimit të dinamikës së përgjithshme të popullsisë së kësaj hapësire territoriale, e rëndësishme është paraqitja e dinamikës së popullsisë sipas bashkive dhe njësive administrative të tyre. Bashkia me ritmet më të larta të rritjes së popullsisë është Durrësi, nga 159 537 banorë në vitin 1995 në 304 448 banorë në vitin 2014¹⁸⁶, ndërsa bashkia e Shijakut ka ritme më të ultra rritjeje, nga 34 102 banorë në 1995 në 44 562 banorë në 2014¹⁸⁷. Në bashkinë Durrës pothuajse ka ndodhur një dyfishim i numrit të popullsisë, kurse në bashkinë e Shijakut rritja e popullsisë është bërë në shkallën 30%.

Në brendësi të bashkisë Durrës ritmet më të larta të shtimit të popullsisë (130%) janë në njësinë administrative të Sukthit, nga 11 811 banorë në vitin 1995 në 27 495 banorë në vitin 2014, ndërsa ritmet më të ultra (17%) në njësinë administrative të Ishmit, nga 7 582 banorë në vitin 1995, në 8 904 banorë në vitin 2014¹⁸⁸.

Pavarësisht se Sukthi ka ritmet më të mëdha të rritjes, njësia administrative e Durrësit ka numrin më të lartë të të ardhurëve dhe popullsia ka ndryshuar nga 103 661 banorë në vitin 1995, në 210 897 banorë në 2014. Njësia administrative e Durrësit ka rritje të popullsisë në këto vite me 103%. Pas saj vjen njësia administrative e Rrashbullit me ritme të rritjes së popullsisë në 102% dhe njësia administrative Manzë me 31%.

Të dhënat e mëposhtme paraqesin dinamikën e popullsisë për secilën njësia administrative të bashkisë Durrës.

Tabela 28. . Numri i popullsisë në Bashkinë Durrës mbas vitit 1990

Vitet	Bashkia Durrës						
	Gjithsej	Njësitë administrative					
		Durrës	Sukth	Manzë	Katund i Ri	Rrashbull	Ishëm
1995	159537	103661	11811	8889	12947	14647	7582

¹⁸⁶ INSTAT (Instituti i Statistikave) - Buletini Statistikor, 1995 dhe 2014.


¹⁸⁷ Po aty.

¹⁸⁸ Po aty.

1996	185535	124416	14952	9009	13145	16499	7514
2000	154888	98792	13093	7587	10942	17719	6755
2003	249745	174201	20921	10076	15159	21393	7995
2004	257580	180297	21565	10209	15376	22092	8041
2005	270077	189648	23350	10377	15604	25143	7955
2006	273569	189648	24139	10555	15480	25642	8105
2007	279833	197699	24589	10757	15488	26099	5201
2008	287287	200311	25139	10952	15665	26903	8317
2009	292002	203547	25767	11002	15613	27645	8428
2010	296423	206254	26400	11184	15801	28159	8502
2011	175110	113249	15966	6652	10161	24081	5001
2013	299989	208082	26856	11464	15565	29124	8898
2014	304448	210897	27495	11678	15786	29688	8904

Burimi: INSTAT, Buletini Statistikor, 1995, 1996, 2000, 2003, 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, 2013, 2014

Grafiku 27. Dinamika e popullsisë në bashkisë Durrës



Burimi: Instituti i Statistikave, Buletini Statistikor i rrethit Durrës, 1995, 1996, 2000, 2003, 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2013, 2014

Në bashkinë e Shijakut ritmet më të larta të rritjes së popullsisë (64%) vihen re në njësinë administrative të Xhafzotajt, nga 11 132 banorë në vitin 1995, në 18 328 banorë në vitin 2014¹⁸⁹. Njësitë administrative me ritmet më të ulëta të rritjes së popullsisë (4%) është Gjepalaj, nga 5 634 banorë në vitin 1995, në 5 893 banorë në vitin 2014¹⁹⁰. Për ritme të ulëta të rritjes së numrit të popullsisë dallohet edhe njësitë administrative Shijak e Maminas, përkatësisht 15 dhe 19%. Në tabelën dhe grafikët e mëposhtëm paraqitet ecuria e popullsisë në vite sipas njësive administrative për bashkinë Shijak.

Tabela 29. Numri i popullsisë në Bashkinë Shijak mbas vitit 1990

Vitet	Bashkia Shijak				
	Gjithsej	Njësitë administrative			
		Shijak	Maminas	Gjepalaj	Xhafzotaj
1995	34102	11408	5928	5634	11132
1996	34966	11567	5947	5637	11815


¹⁸⁹INSTAT(Instituti i Statistikave) -Buletini Statistikor, 1995 dhe 2014.

¹⁹⁰Po aty.

2000	26774	8097	4629	5041	9007
2003	38629	12353	6201	5987	14086
2004	39 416	12553	6368	5958	14537
2005	40579	1698	6472	5823	15586
2006	41115	12698	6579	5850	15988
2007	41774	12840	6698	5849	16387
2008	42316	12893	6808	5892	16723
2009	42869	12902	6923	5924	17120
2010	43539	13051	7017	6008	17463
2011	27861	7568	4463	3449	12381
2013	44409	13113	7075	5879	18036
2014	44562	13231	7110	5893	18328
Sipërfaqja (km ²)	100	4	33	42	21
Dendësia (b / km ²)	446	3308	215	140	873

Burimi: INSTAT, Buletini Statistikor 1995, 1996, 2000, 2003, 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, 2013, 2014.

Grafiku 28. Dinamika e popullsisë në bashkisë Shijak



Burimi: Instituti i Statistikave, Buletini Statistikor i rrethit Durrës, 1995, 1996, 2000, 2003, 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2013, 2014


III.3. Shpërndarja hapësinore e popullsisë në territoret e bashkisë së Durrësit dhe Shijakut

Krahas dinamikave dhe ritmeve të rritjes së popullsisë në secilën bashki, shpërndarja e saj nuk është e njëjtë në të gjithë territorin. Në përputhje edhe me ndarjen e re administrativo-territoriale, studimi i mëposhtëm i popullsisë është bërë në rang bashkie, përkatësisht për bashkinë e Durrësit dhe të Shijakut. Me ndarjen e re territoriale rreth 87.2% e popullsisë (ose 304 448 banorë) së ish-rrethit Durrës bën pjesë në bashkinë Durrës, ndërsa 12.8 % e popullsisë (ose 44 562 banorë) është e përqëndruar në bashkinë e Shijakut¹⁹¹. Madje edhe në brendësi të territorit të bashkive të lartpërmendura ka shpërndarje të pabarabarta të popullsisë. Në grafikët e

¹⁹¹INSTAT(Instituti i Statistikave) -Buletini Statistikor 2014

mëposhtëm paraqitet shpërndarja e popullsisë sipas njësive administrative të bashkisë Durrës.

Grafiku 29. Shpërndarja e popullsisë në njësitë administrative të bashkisë Durrës



Burimi: INSTAT, Buletini Statistikor i rrethit Durrës, 2014

Në bazë të grafikut të mësipërm rezulton se rreth 69 % e popullsisë (ose rreth 210 897 banorë)¹⁹² së bashkisë Durrës është e përqëndruar në njësinë administrative Durrës. Numri i madh i popullsisë në 17 km² sipërfaqe shprehet në densitetin e lartë të popullsisë, e cila arrin në 12 405.7 b/ km². Ky raport është tregues i urbanizimit të gjerë që ka përfshirë të gjithë njësinë administrative të Durrësit, duke qenë se rreth 90% e sipërfaqes së tokës është e përdorur për truall ndërtimi dhe zhvillim të infrastrukturës.

Pjesa tjetër, ose 31% (ose 93 551 banorë) e popullsisë së bashkisë Durrës gjenden në 5 njësitë administrative (në Sukth, Manzë, Katund të Ri, Rrashbull dhe Ishëm). Njësia administrative e Rrashbullit ka 29 688 banorë¹⁹³ dhe zë vendin e dyta për numrin e popullsisë, mbas njësive administrative Durrës. Në hapësirën territoriale prej 61 km², të njësive administrative të Rrashbullit, dendësia e popullsisë është rreth 500 b/ km². Përqëndrimi i lartë i popullsisë në këtë hapësirë lidhet me zhvillimin e rrjetit rrugor dhe afërsinë me zonën urbane të Durrësit. Për numër të lartë popullsie vlerësohet edhe njësia administrative Sukth. Sipas të dhënave të Institutit të Statistikave, për vitin 2014, në territoret e Sukthit gjenden 27 495 banorë ose 9 % e popullsisë së bashkisë Durrës. Krahasuar me njësinë administrative të Rrashbullit, Sukthi pavarësisht se ka numër më të ulët të popullsisë, ka dendësi më të lartë popullsie (561 b/ km²), sepse sipërfaqja e njësive është më e vogël, 49 km². Për numër të ulët të popullsisë vlerësohen njësitë administrative Manzë, Katundi i Ri dhe Ishëm, përkatësisht me 11 678 (ose 4%), 15 786 (ose 5%) dhe 8 904 banorë (ose 3%)¹⁹⁴.

Dendësinë më të ulët të popullsisë e ka njësia administrative e Ishmit (108.6 b/ km²), pasi kjo është njësia me sipërfaqe më të madhe (82 km²) dhe ka numrin më të vogël të popullsisë në bashkinë Durrës. Njësia administrative e Katundit të Ri dhe e Manzës kanë dendësi pothuajse të përafërt (përkatësisht 232.1 b/ km² dhe 212.3 b/ km²). Numri i vogël i popullsisë, në tri njësitë administrative të lartpërmendura, lidhet


¹⁹² INSTAT (Institut i Statistikave) -Buletini Statistikor 2014

¹⁹³ INSTAT (Institut i Statistikave) -Buletini Statistikor 2014

¹⁹⁴ Po aty.

me largësinë më të madhe nga qendra urbane e Durrësit, si dhe mungesa e plotë e infrastrukturës së përgjithshme. Prania e numrit më të vogël të popullsisë tregon një shkallë më të vogël të ndërhyjes dhe dëmtimit të peizazheve natyrore. Megjithatë nuk mungojnë zonat ku vihen re humbje të vlerës së tokës, ndotje të ujit dhe ulje të numrit të specieve të gjalla. Grafiku i mëposhtëm shpreh dendësinë e popullsisë sipas njësive administrative në bashkinë Durrës.


Grafiku 30. Dendësia e popullsisë në njësitë administrative të bashkisë Durrës



Burimi: INSTAT, Buletini Statistikor i rrethit Durrës, 2014

Bashkia e Shijakut paraqitet me karakteristika të tjera (të ndryshme) të popullsisë. Siç u përmend edhe më sipër, në bashkinë e Shijakut gjendet vetëm 12.8 % e popullsisë së përgjithshme të ish-rrethit Durrës. Popullsia është e shpërndarë në mënyrë të pabarabartë midis njësive administrative Shijak, Maminas, Gjepalaj dhe Xhafzotaj, ashtu siç paraqitet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 31. Shpërndarja e popullsisë në njësitë administrative të bashkisë Shijak




Burimi: INSTAT, Buletini Statistikor i rrethit Durrës, 2014

Pavarësisht se njësia administrative e Shijakut përfaqëson një zonë urbane, rreth gjysma e popullsisë është e përqendruar në njësinë administrative të Xhafzotajt (ish-komunë). Në këtë njësi administrative, me sipërfaqe prej 21 km², gjenden rreth

18 328 banorë¹⁹⁵. Dendësia e popullsisë së Xhafzotajt është 872.8 b/ km². Njësia administrative e Shijakut, e cila është një zonë urbane, pavarësisht se ka rreth 5 097 banorë¹⁹⁶ më pak se Xhafzotaj, ka dendësi shumë të lartë të popullsisë, rreth 3 307.7 b/ km². Numri i popullsisë së njësive administrative të Shijakut është 13 231 banorë, ndërsa sipërfaqja e hapësirës territoriale është vetëm 7 km²¹⁹⁷. Shijaku është njësia administrative me sipërfaqe më të vogël dhe me dendësi më të lartë në të dyja bashkitë e marra në studim. Kjo dendësi e lartë e popullsisë është tregues i dendësisë së urbanizimit dhe presionit të madh mbi resurset natyrore. Grafiku i mëposhtëm pasqyron ndryshimin e dendësisë së popullsisë sipas njësive administrative të bashkisë Shijak.

Grafiku 32. Dendësia e popullsisë në njësitë administrative të bashkisë Shijak



Burimi: INSTAT, Buletini Statistikor i rrethit Durrës, 2014

Në bashkinë Shijak, njësia administrative me sipërfaqe më të madhe është Gjepalaj, 42 km². Pavarsisht kësaj, kjo njësi administrative ka numrin më të ulët të popullsisë në të gjithë bashkinë Shijak, vetëm 5 893 banorë¹⁹⁸. Për rrjedhojë dendësia e popullsisë prej 140.3 b / km², është më e ulta në bashkinë Shijak, por edhe në të gjithë territorin e marrë në studim. Në njësinë administrative të Maminasit gjendet vetëm 15.9 % e popullsisë së bashkisë Shijak. Duke qenë se sipërfaqja e Maminasit është 33 km², edhe dendësia e popullsisë është e vogël vetëm 215.5 b / km². Të dyja këto njësi përfaqësojnë zona rurale dhe kanë përdorim bujqësor të tokës. Nga të 10 njësitë administrative, presionin më të madh të popullsisë mbi tokën e ka njësia administrative e Shijakut dhe e Durrësit. Të dyja njësitë përfaqësojnë zona urbane dhe qendra të bashkive përkatëse. Njësia administrative Gjepalaj, Maminas dhe Ishëm kanë numrin në të vogël të popullsisë, pavarësisht sipërfaqeve mesatarisht të mëdha të tyre. Të trija njësitë e lartpërmendura janë hapësira rurale, me relief dominues kodrinor dhe mungesë të infrastrukturës.

Në hartat e mëposhtme paraqitet shpërndarja dhe dendësia e popullsisë për njësitë administrative të secilës prej bashkive.


¹⁹⁵ INSTAT(Instituti i Statistikave) -Buletini Statistikor 2014

¹⁹⁶ Po aty.

¹⁹⁷ Po aty.


¹⁹⁸ Po aty.

Harta 12. Shpërndarja hapësinore e popullsisë në bashkinë Durrësit dhe të Shijakut



Punuar: Arc GIS 10.1, viti 2016

Harta 13. Dendësia e popullsisë në bashkinë e Durrësit dhe të Shijakut



Punuar: Arc GIS 10.1, viti 2016


Numri i lartë i popullsisë në bashkinë Durrës dhe Shijak, shpërndarja e pabarabartë dhe për rrjedhojë dendësia e ndryshme për njësi të sipërfaqes, janë tregues të presionit të ndryshëm të njeriut mbi pasuritë natyrore. Në njësitë administrative ku popullsia është më e lartë ka përdorim më të madh të resurseve natyrore, dhe për rrjedhojë, edhe shkallë më të lartë të dëmtimit të tyre. Shkalla e përdorimit dhe e ruajtjes së pasurive natyrore nuk lidhet vetëm me numrin e popullsisë së kësaj hapësire territoriale, por edhe me tipet e strukturave të kësaj popullsie.

III.4.Struktura e popullsisë

III.4.1.Struktura moshore e popullsisë

Krahas përcaktimit të numrit të popullsisë dhe shpërndarjes hapësinore së saj, për të dyja bashkitë, është e rëndësishme analiza e strukturës moshore dhe gjinore. Struktura moshore është një tregues i raportit të grupeve moshore me njëra-tjetrën. Në të gjithë territorin e marrë në studim rreth 42 383 banorë (ose 21% e tyre) janë të moshës 0-14 vjeç, 138 066 banorë (ose 68%) janë të moshës 15-64 vjeç dhe 22 495 banorë (ose 11%) janë të moshës mbi 65 vjeç¹⁹⁹. Raporti i grupmoshave të popullsisë është një tregues i tendencës së rritjes së moshës mesatare të popullsisë njëkohësisht edhe e rritjes së moshës së tretë (mbi 65 vjeç). Grafiku i mëposhtëm paraqet raportin e grupmoshave të popullsisë në tërësi, për të dyja bashkitë.

Grafiku 33. Grupmoshat e popullsisë në territoret e bashkisë Durrës dhe Shijak



Burimi: INSTAT, Census 2011


Tendencat e viteve të fundit janë të tilla që numri i lindjeve është drejt uljes, si rrjedhojë e hyrjes në martesë në një moshë më të madhe (si për meshkujt dhe për femrat) si dhe tendenca për të pasur sa më pak fëmijë. Niveli i ulët i lindjeve do të sjellë një përmbysje të piramidës moshore në të ardhmen dhe për rrjedhojë do të sjellë probleme sociale, ekonomike dhe mjedisore. Rritja e moshës mesatare të popullsisë do të thotë më pak fuqi puntore, nevoja për më shumë shërbime për moshën e tretë dhe kosto më e lartë ekonomike e mjedisore (përdorim të resurseve).

Dallime të strukturën gjinore vihen re si midis dy bashkive, por edhe midis

¹⁹⁹ INSTAT(Instituti i Statistikave) -Censusi 2011

njësive administrative të tyre. Kështu, bashkia e Durrësit ruan të njëjtin raport të grupmohave, ku individët e moshës nga 0-14 vjeç zënë 21% të popullsisë, individët e moshës 15-64 vjeç zënë 68%, dhe individët e moshës mbi 65 vjeç përbëjnë 11% të popullsisë së saj. Në bashkinë Shijak vihen re disa ndryshime të raportin midis grupmohave. Sipas të dhënave të Censurit (2011) individët e moshës nga 0-14 vjeç zënë 20% të popullsisë, individët e moshës 15-64 vjeç zënë 67%, dhe individët e moshës mbi 65 vjeç përbëjnë 13% të popullsisë. Këto të dhëna janë një tregues i numrit më të ulët të lindjeve, tendencës së largimit të popullsisë, sidomos e moshave të reja dhe tendencës drejt “plakjes” së popullsisë. Duke bërë një krahasim midis dy bashkive, vëmë re se bashkia Durrës ka një popullsi më të re dhe më aktive dhe kjo lidhet edhe me nivelin e zhvillimit ekonomik dhe numrin më të madh të të ardhurve në moshë të re. Dallimet midis bashkive janë të dukshme në grafikët e mëposhtëm.

Grafiku 34. Grupmoshat e popullsisë në bashkinë e Shijakut dhe Durrësit



Burimi: INSTAT, Census 2011

Ndryshime të raporteve të grupmohave të popullsisë vihen re edhe midis njësive administrative të secilës bashki. Në bashkinë e Durrësit, përqindjen më të lartë të grupmohës 0-14 vjeç e ka njësi administrative e Sukthit (25% ose 4058 individë), e shoqëruar nga njësi administrative e Katundit të Ri dhe Rrashbullit (përkatësisht nga 24%). Njësi administrative e Durrësit, pavarësisht se ka numrin më të lartë të popullsisë, e njëkohësisht edhe numrin më të lartë të lindjeve, ka vlerat më të ulta (rreth 19%) të grupmohës 0-14 vjeç.

Grupmosha 14-64 vjeç është treguese e popullsisë aktive të një grupi individësh të caktuar. Në bashkinë e Durrësit nivelin më të lartë të kësaj grupmoshe kanë njësi administrative Durrës (rreth 69% ose 78 528 banorë), kurse nivelin më të ulët e ka njësi administrative e Ishmit (rreth 65% ose 3229 banorë). Qyteti i Durrësit, duke qenë se është një zonë urbane, ka tërhequr gjithnjë e më shumë popullsi të re (aktive), kurse Ishmi është një nga njësitë më të largëta (në distancë kohore) dhe më kodrinore në bashkinë e Durrësit dhe për rrjedhojë, kjo grupmoshë është larguar në pamundësi për punësim. Njësi administrative e Rrashbullit, Manzës dhe Katundit të Ri kanë raporte pothuajse të përafërta (përkatësisht 67%, 66% dhe 66%) të grupmohës së dytë.

Grupmosha e tretë (mbi 65 vjeç), është një tregues i plakjes së popullsisë. Përqindja më e lartë e kësaj grupmoshe gjendet në njësinë administrative të Durrësit dhe të Ishmit (12%), ndërsa përqindja më e ulët (9%) është në njësinë administrative


të Rrashbullit dhe të Sukthit. Vlera prej 12% e grupmoshës mbi 65 vjeç është një tregues i fillimit të plakjes së popullsisë, ç’ka kërkon marrjen e masave për ndryshimin e kësaj vlere. Në mënyrë tabelare dhe grafike, më poshtë janë paraqitur strukturat moshore për secilën njësi administrative.



Tabela 30 . Grupmoshat e popullsisë në bashkinë Durrës

Njësia administrative	Grupmoshat e popullsisë		
	0-14	15-64	65+
Durrës	21799	78528	12922
Sukth	4058	10502	1379
Manzë	1502	4400	750
Katundi i Ri	2453	6715	993
Rrashbull	5700	16092	2289
Ishëm	1174	3229	598
Gjithsej	36686	119466	18931

Burimi: INSTAT, Census 2011

Grafiku 35. Grupmoshat e popullsisë për secilën njësi administrative të bashkisë Durrës





Burimi: INSTAT, Census 2011


Ndryshe nga bashkia Durrës, në bashkinë e Shijakut vihen re dallime më të theksuara midis njësive administrative. Duke analizuar secilën prej tyre, evidentojmë se njësia administrative me përqindje më të lartë të grupmoshës 0-14 vjeç është Xhafzotaj (22% ose 2 767 banorë), ndërsa për raportet më të ulta përcaktohet qyteti i Shijakut (18% ose 1 341 banorë). Edhe grupmoshat e popullsisë aktive janë shumë të ndryshme. Përqindjen më të lartë kjo grupmoshë (15-64 vjeç) e ka në njësinë administrative të Shijakut (69% ose 5 249 banorë), kurse përqindjen më të ulët e gjejmë në njësinë administrative të Maminasit (65% ose 2 916 banorë). Njëkohësisht në këtë njësi administrative gjendet përqindja më e lartë e moshës së tretë, mbi 65 vjeç, (rreth 16% ose 688 banorë), çka do të thotë se, është një njësi ku ndihet së tepërmi fenomeni i plakjes së popullsisë. Njësia administrative e Shijakut, Gjepalajt dhe Xhafzotajt sigurisht që kanë vlera të larta të moshës së tretë, çka do të thotë se ka filluar procesi i plakjes edhe në këto njësiadministrative.

Tabela 29. Grupmoshat e popullsisë në bashkinë Shijak

Njësia administrative	Grupmoshat e popullsisë		
	0-14	15-64	65+
Shijak	1341	5249	978
Maminas	859	2916	688
Gjepalaj	730	2294	425
Xhafzotaj	2767	8141	1473
Gjithsej Shijak	5697	18600	3564

Burimi: INSTAT, Census 2011

Grafiku 36. Grupmoshat e popullsisë për secilën njësi administrative të bashkisë Shijak



Burimi: INSTAT, Census, 2011

Grafikët e mësipërm shprehin raportin e grupmoshave të popullsisë në brendësi të njësive administrative të bashkisë Shijak. Raportet e paraqitura më sipër janë efektet e drejtpërdrejta të lëvizjeve hapësinore të popullsisë, sidomos i largimeve të grupmoshave të reja si rezultat i nevojave më të mëdha ekonomike dhe kulturore. Fenomeni i largimeve lidhet edhe me mungesën e punësimit, shërbimeve, infrastrukturës së nevojshme dhe mungesës së hapësira të mirëfillta urbane.

III.4.2. Struktura gjinore e popullsisë


Krahas evidentimit të strukturës moshore të popullsisë ka rëndësi edhe evidentimi i strukturës gjinore në të gjithë territorin e marrë në studim, në rang bashkie dhe njësie administrative. Në të gjithë territorin e marrë në studim vihet re një raport i njëjtë midis meshkujve dhe femrave, 101 425 meshkuj dhe 101 425 femra. Në bashkinë e Durrësit ekziston një raport 87 613 meshkuj me 87 497 femra, ndërsa në bashkinë Shijak gjenden 13 933 meshkuj dhe 13 928 femra, çka do të thotë që në të dyja bashkitë dominojnë meshkujt. Raporti i meshkujve me femrat për secilën njësi administrative paraqitet në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm.

Tabela 32. Struktura gjinore sipas grupmoshave në bashkinë Durrës

Bashkia	Gjinia dhe grup mosha							
	Meshkuj				Femra			
	Gjithsej Total	0-14	15-64	65+	Gjithsej Total	0-14	15-64	65+
Durrës	56511	11467	38817	6227	56738	10332	39711	6695
Sukth	7999	2136	5178	685	7967	1949	5324	694
Manëz	3351	778	2204	369	3301	724	2196	381
Katund i Ri	5071	1273	3332	466	5090	1180	3383	527
Rrashbull	12194	3022	8045	1127	11887	2678	8047	1162
Ishëm	2487	596	1598	293	2514	578	1631	305
Bashkia Durrës	87613	19272	59174	9167	87497	17441	60307	9764

Burimi: INSTAT, Census 2011

Grafiku 37. Raporti meshkuj-femra në njësitë administrative të bashkisë Durrës dhe Shijak



Burimi: INSTAT, Census, 2011

Tabela 31. Struktura gjinore sipas grupmoshave në bashkinë Shijak

Bashkia	Gjinia dhe grup mosha							
	Meshkuj				Femra			
	Gjithsej Total	0-14	15-64	65+	Gjithsej Total	0-14	15-64	65+
Shijak	3782	692	2628	462	3786	649	2621	516
Maminas	2262	468	1446	348	2201	391	1470	340
Gjepalaj	1729	366	1152	211	1720	364	1142	214
Xhafzotaj	6160	1391	4049	720	6221	1376	4092	753
Bashkia	13933	2917	9275	1741	13928	2780	9325	1823

Shijak								
--------	--	--	--	--	--	--	--	--

Burimi: INSTAT, Census 2011

Në secilën prej bashkive dhe njësive administrative të tyre vihet re një raport pothuajse i njëjtë i meshkujve dhe femrave. Diferenca më e madhe vihet re në njësinë administrative të Rrashbullit, në të cilën gjenden rreth 307 meshkuj më shumë se femra. Në njësinë administrative të Durrësit, Katundit të Ri, Ishmit dhe Shijakut mbizotërojnë femrat me një diferencë të vogël.

Njohja me strukturën gjinore ndikon në përcaktimin e shkallës dhe llojin e resursit natyror të përdorur, e ndikuar kryesisht me llojin e aktivitetit ekonomik që mund të zhvillohet sipas llojit të gjinisë.

III.4.3. Struktura arsimore e popullsisë

Në bazë të të dhënave (në rang Qarku) të Censurit të vitit 2011, janë nxjerrë disa të dhëna të përafërtë rreth strukturës arsimore të dy bashkive, Durrës dhe Shijak. Sipas tij, rreth 2.5% e popullsisë është analfabete, 3% e banorëve dinë shkrim e këndim por nuk kanë një diplomë shkolle; rreth 15% e popullsisë mbi 10 vjeç kanë përfunduar ciklin e ulët dhe kanë një diplomë të saj; rreth 43% kanë kryer ciklin e lartë (7 ose 8-vjeçar); 28% kanë përfunduar shkollimin e mesëm (të përgjithshëm ose profesional); 8% kanë përfunduar universitetin dhe vetëm 0.5% e tyre kanë përfunduar studimet pasuniversitare. Nga këto të dhëna dalim në përfundimin se vetëm 1/3 e popullsisë ka arsim mbi 8 vjet shkollë.

Gjatë përpunimit të të dhënave të INSTAT-it rezulton se vetëm 40% e popullsisë deri në moshën 30-vjeç ka arsim të mesëm e të lartë. Mungesa e të dhënave të detajuara reflekton një mungesë të plotë të analizës së strukturës arsimore dhe profesionale të popullsisë, ç'ka do të na ndihmonte në një analizë të tregut të punës dhe të orientimit të zhvillimit të degëve të ekonomisë. Numri i popullsisë, struktura moshore, gjinore dhe arsimore e saj pasqyrojnë mënyrën dhe shkallën e përdorimit të burimeve natyrore që ofron zona, si dhe nivelin e mbrojtjes e të menaxhimit të tyre.

III.5. Punësimi dhe papunësia

III.5.1. Niveli i punësimit

Niveli arsimor i popullsisë së një territori të caktuar nuk reflekton drejtpërsëdrejti nivelin e punësimit. Numri i të punësuarve lidhet me grupmoshën aktive (15-65 vjeç) të një popullsie të caktuar dhe vendet e punës. Sipas të dhënave të INSTAT-it, në vitin 2014 në bashkinë e Durrësit dhe të Shijakut evidentohen rreth 43 448 persona të punësuar²⁰⁰. Duke ditur që numri i popullsisë aktive në të dyja bashkitë është 138 066 banorë, përcaktojnë se nga kjo grupmoshë janë të punësuar vetëm 31.5% e individëve. Rreth 80% e të punësuarëve (ose 34 702 individë) janë të punësuar në sektorin privat dhe 20% (ose 8746 persona) janë të punësuar në sektorin shtetëror²⁰¹. Në tabelën e mëposhtme paraqitet numri i të punësuarve në të dyja bashkitë, sipas sektorëve të ekonomisë.

Tabela 32. Numri i të punësuarve sipas sektorëve të ekonomisë

Sektori/Punësimi	Punësimi privat	Punësimi shtetëror
Sektori I	290	164

²⁰⁰ INSTAT(Instituti i Statistikave) -Buletini Statistikor 2014


²⁰¹ Po aty.

Spektori II	8112	710
Spektori III	9559	5950
E padeklaruar	16641	1922

Burimi : INSTAT (Buletini Statistikor 2014)

Në sektorin e parë të ekonomisë (në bujqësi, pylltari, peshkim dhe industri nxjerrëse) janë të punësuar 454 persona, nga të cilët 164 janë të punësuar në shtet, 290 personat e tjerë janë të punësuar në privat. Në sektorin e dytë janë të punësuar 8 822 persona, nga të cilët rreth 6 894 janë të punësuar në industrinë përpunuese, rreth 900 persona janë të punësuar në industrinë e energjisë dhe ujit dhe rreth 1 028 persona të punësuar në ndërtimtari. Në sektorin e tretë janë të punësuar rreth 15 509 persona, nga të cilët rreth 4 284 janë të punësuar në tregti, 2 437 janë të punësuar në sektorin e shërbimeve (hoteleri dhe restorante), 3 854 janë të punësuar në transport dhe komunikacion, 2 865 të punësuar në arsim dhe 2 069 në shëndetësi²⁰². Rreth 18 563 persona janë të punësuar në aktivitete të tjera të padeklaruar. Nga të dhënat e mësipërme rezulton se pjesa më e madhe e individëve janë të punësuar në ndërmarje privat, të cilat i përkasin sektorit të tretë të ekonomisë (kryesisht në tregti, turizëm dhe transport). Në grafikun e mëposhtëm paraqitet përqindja e të punësuarve sipas sektorëve të ekonomisë.

Grafiku 38. Përqindja e të punësuarve sipas sektorëve të ekonomisë



Burimi : INSTAT (Buletini Statistikor 2014)

Grafiku i mësipërm shpreh disa të dhëna zyrtare rreth punësimit në të dyja bashkitë, por nuk jep saktësi në peshën që zë secili sektor në punësimin e banorëve të zonës. Niveli i ulët i punësimit (i deklaruar), shfaqet i tillë sepse në këto territore një grup individësh kryejnë veprimtari jashtësistemit të taksimit, të cilat quhen veprimtari ekonomike joformale. Këto veprimtari përfshijnë veprimtaritë vetëfurnizuese (kopshtari, peshkim, mbjedhje frutash etj.); shkëmbimettë të mirave materiale ndërmjet njësisve ekonomike familjare si: produkte ushqimore, veshmbathje, orendi, pajisje etj; dhe një gamë të gjerë shërbimesh si: riparimi ose mirëmbajtja të shtëpive, kopshteve etj²⁰³. Këtu përfshihen më tepër individët e popullsisë aktive, që jetojnë në zonat rurale dhe punësimi i tyre lidhet drejtpërdrejt me përdorimin e burimeve natyrore, të papërpunuara, që ofrojnë territoret e bashkisë së Durrësit dhe të

²⁰² INSTAT (Institut i Statistikave) -Buletini Statistikor 2014

²⁰³ Laçi, S., Kola, E., Xhafa, S., Laçi, E. (2014). *Gjeografia Rurale*. Tiranë, faqe 234.

Shijakut. Nga analiza e mësipërme është e vështirë të përcaktosh shkallën e papunësisë në popullsinë e të dy bashkive.

III.5.2. Papunësia

Papunësia është një tregues social, i numrit të personave të moshës 15-65 vjeç, jo të punësuar. Shkalla e papunësisë është një tregues i problemeve sociale që ka një hapësirë socio-geografike. Në bashkinë e Durrësit dhe të Shijakut janë përlllogaritur rreth 8 135 punëkërkuës, pranë zyrave të punësimit në vitin 2014²⁰⁴. Kjo shifër punëkërkuësish zë vetëm 2% të popullsisë aktive të të dyja bashkive, një shifër shumë e ulët për të shprehur papunësinë. Nuk ka dallime të mëdha gjinore tek punëkërkuësit, pasi 48.1% janë femra dhe 51.9% janë meshkuj. Në grupin e punëkërkuësve rreth 52 % e tyre janë me shkollë 8-vjeçare, rreth 25.6% janë me shkollë të mesme; 10.8 % janë me shkollim profesional dhe vetëm 11.6 % janë me shkollë të lartë.

Tabela 35. Numri i punëkërkuësve sipas nivelit arsimor

Nr. Shkollimi	8-vjeçare	E Mesme	Profesionale	E Lartë
Papunësia	4233	2083	880	936

Burimi: INSTAT (Buletini Statistikor 2014)

Pavarësisht këtyre raporteve vihet re se edhe punëkërkuësit me shkollë të lartë zënë një përqindje të lartë. Kjo lidhet me numrin e madh të të diplomuarëve rreth vitit 2014, pasi rreth ½ e tyre konsiderohen të papunë për herë të parë në tregun e punës. Në grupin e punëkërkuësëve, rreth 55.7% e tyre janë të moshës mbi 35 vjeç, 35.2 % i përkasin grupmoshës 20-30 vjeç dhe vetëm 9.1% janë të moshë nën 20 vjeç. Niveli i lartë i papunësisë në grupmoshën mbi 35 vjeç vjen si rezultat i nivelit më të ulët të arsimit dhe mungesës së një profesioni.

Një nga dukuritë më shqetësuese të papunësisë në bashkinë e Durrësit dhe të Shijakut është numri i lartë i të papunëve kryefamiljarë, rreth 3028 ose 37.2%. Nga të gjithë punëkërkuësit, vetëm 17.5 % tyre përfitojnë pagesë papunësie dhe ndihma ekonomike. Krahas tyre ka edhe individë të tjerë që janë në statusin e të papunit, por që nuk janë punë kërkuës të regjistruar në zyrat e punësimit.

Të dhënat zyrtare mbi nivelin e punësimit dhe të papunësisë nuk janë tregues të shkallës së përdorimit të burimeve natyrore që ofron hapësira territoriale e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut. Numri i lartë i popullsisë në të dyja bashkitë dhe dendësia e lartë reflektojnë një përdorim të madh të resurset që ofrojnë dy bashkitë e lartpërmendura.

III.6. Përdorimi i pasurive natyrore

III.6.1. Përdorimi i pasurive nëntokësore

Nëntoka e territoreve të Durrësit dhe të Shijakut është e pasur me mineralin jometal të qymyrgurit, naftës dhe gazit natyror. Deri në ditët e sotme është përdorur vetëm minerali i qymyrgurit, i cili gjendet në fshatin Kuçokë dhe Manzë. Miniera e Manzës i ka fillimet e veta në vitin 1967. Ajo është hapur me punime minerare horizontale nga sipërfaqja dhe me punime të pjerrëta nëntokësore²⁰⁵. Në këtë minierë gjendet edhe një pus rreth 255m i thellë, i cili i ka fillimet në sipërfaqen +60

²⁰⁴INSTAT (Instituti i Statistikave) -Buletini Statistikor 2014

²⁰⁵Korini, Th. (2015). *Elemente të Teknologjisë së Gërmimit të Shkëmbinjve*. leksione online

m dhe arrin deri në kuotën 195 m thellësi. Në tërësi, thellësia e minierës arrin deri në 3500 m²⁰⁶.

Miniera e Manzës është konsideruar si ndër minierat më të vështira në vendin tonë për shkak të nivelit të lartë të lagështirës, rrezikshmërisë së shëmbjeve dhe çlirimit të gazit karbonik, gazit metan e dioksidit të karbonit. Puna në minierën e Manzës ka vazhduar për rreth 26 vjet, deri në vitin 1993, ndërsa mbyllja e plotë e minierës është bërë mbas vitit 2000. Gjatë të gjithë viteve të ekzistencës së saj kanë qenë të punësuar më tepër se 3 mijë puntorë, ndërsa gjatë një viti numri i të punësuarëve shkante deri në 384 individë²⁰⁷. Në brendësi të minierës është punuar me lëndë plasëse për të bërë të mundur rrëzimin e qymyrit, kurse drejtimi i tavanit bëhej me shëmbje të plotë. Prej saj janë nxjerrë rreth 1317 000 ton qymyr. Qymyrguri i Manzës është përdorur në vazhdimësi në fabrikën e tullave në Durrës, në fabrikën e çimentos në Fushë-Krujë, në ndërmarjen e material ndërtimit Laç etj.

Aktualisht miniera e Manzës është jashtë funksionit dhe konsiderohet një zonë e papërdorur, por sipas Agjensisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, ekziston zona 27, me përmbajtje qymyri, e cila është e licënsuar për tu përdorur²⁰⁸.

III.6.2. Përdorimi i materialeve të ndërtimit

Në territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut gjenden burime argjilash, rërash dhe zhavorresh. Gjatë periudhës së sistemit komunist janë përdorur argjilat e Kodrave të Currilave, si lëndë e parë në fabrikën e tullave në Durrës. Pavarësisht formës së saj veshullore, e pjekur në temperatura të lartë, merr fortësinë e një guri. Njëkohësisht, këto argjila janë përdorur për përgatitjen e tretësirës argjilore për shpimin e puseve të naftës në vendin tonë. Aktualisht, argjilat e territoreve të bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut nuk kanë përdorime masive, pavarësisht se, sipas Agjensisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, në bashkinë e Durrësit gjendet zona 124, 134 dhe 326 të licënsuara, duke qenë se janë të pasura me argjila në 3 000 000m³²⁰⁹.

Mbas rënies së regjimit komunist dhe me rritjen e ndërtimeve informale është rritur edhe shkalla e përdorimit të burimeve të rërës dhe zhavorreve që gjenden në territoret bashkiake. Gjatë dekadës së fundit, të shekullit të kaluar, si lëndë e parë për ndërtimin e banesave dhe ndërtimeve industriale është përdorur rëra e plazheve të Durrësit si dhe rërat e zhavorret e lumit Erzen. Për vite me radhë është nxjerrë dhe përpunuar rëra e lumit Erzen në fshatin Romanat, pikërisht aty ku lumi futet në territoret bashkiake të marra në studim. Në vitet e fundit, rërat e zhavorret e Erzenit janë përdorur për ndërtimin e Unazës së Re të Tiranës dhe për ndërtimin e rrugës Tiranë-Elbasan, duke qenë se rreth 17% e tyre janë rëra, 71% gurë mesatarë dhe 7 % fraksione më të mëdha.

III.6.3. Përdorimi i pasurive klimatike

Pasuritë e dritës, ngrohtësisë dhe lagështirës, janë përdorur gjerësisht për konsum familjar dhe në zhvillimin e degëve të ndryshme të ekonomisë, në territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut. Burimet e dritës kanë përdorim në konsum familjar, në ngrohjen e ujit, në ngrohjen e ambienteve të brendshme të shtëpive, në funksionimin e pajisjeve elektroshtëpiake dhe në prodhimin e energjisë elektrike.

²⁰⁶ Ministria e Industrisë dhe Energjitikës. Materiale online

²⁰⁷ Arkivat Durrës

²⁰⁸ www.akbn.gov.al

²⁰⁹ www.akbn.gov.al

Territoret e të dyja bashkive marrin rreth 2 606 orë me diell gjatë të gjithë vitit. Shpërndarja mujore e orëve me diell paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Tabela 34. Sasia e orëve me diell sipas muajve

Vendndodhja	Muajt												Vjetore
	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	
Durrës	120	125	183	216	265	304	356	331	275	211	119	101	2606

Burimi: Instituti i Hidro-Meteorologjisë Shqiptar

Sipas Censurit të vitit 2011, rreth 17.8% e ndërtesave përdorin si ngrohës panelet diellore, gazin ose qymyrin. Nga kjo e dhënë kuptohet se në rreth 1/10 e ndërtimeve përdoren panele diellore. Rreth 87% e paneleve diellore gjenden në ndërtesat e bashkisë së Durrësit dhe 13% në ndërtesat e bashkisë së Shijakut. Në bashkinë e Durrësit rreth 86% e ndërtesave me panele diellore, gjenden në njësinë administrative Durrës, 7% në njësinë administrative Rrashbull dhe 7% një njësitë administrative Sukth, Manzë, Katundi i Ri dhe Ishëm. Në bashkinë e Shijakut rreth 47% e ndërtimeve me panele diellore gjenden në njësinë administrative Shijak, 36% në njësinë administrative Xhafzotaj dhe 17% në njësitë administrative Maminas dhe Gjepalaj. Në tabelat e mëposhtme paraqitet numri i ndërtimeve me ngrohës alternativë, për të dyja bashkitë.

Tabela 37. Numri i ndërtimeve me ngrohje alternative në bashkinë Durrës

Njësitë administrative	Durrës	Sukth	Manzë	Rrashbull	Katundi i Ri	Ishëm	Gjithësej
Nr.Ndërtimeve	6994	215	115	603	172	33	8132

Burimi: INSTAT, Census 2011, Qarku Durrës

Tabela 38. Numri i ndërtimeve me ngrohje alternative në bashkinë Shijak

Njësitë administrative	Shijak	Maminas	Gjepalaj	Xhafzotaj	Gjithësej
Nr.Ndërtimeve	558	118	71	427	1174

Burimi: INSTAT, Census 2011, Qarku Durrës

Nga analiza e tabelave të mësipërme rezulton se pjesa më e madhe e ndërtimeve, që përdorin panele diellore gjenden në zonat urbane dhe suburbane, të të dyja bashkive. Kjo diferencë shpreh nivelin e ndryshëm ekonomik, duke qenë se panelet diellore kanë një kosto fillestare instalimi.

Përdorim më të gjerë nga njeriu kanë burimet e ngrohtësisë dhe të lagështirës. Elementi bazë i klimës, në zhvillimin e bujqësisë dhe të turizmit në territorin e Durrësit dhe të Shijakut, është temperatura. Në zhvillimin e kulturave të ndryshme bujqësore ka rëndësi njohja e fillimit dhe përfundimit të periudhës së vegetacionit, luhatjet e temperaturave, temperaturat maksimale dhe minimale brenda kësaj periudhe. Zhvillimi i bujqësisë lidhet drejtpërdrejt me periudhën e vegetacionit, e cila në literaturat më të njohura është temperatura 10⁰C.

Sipas të dhënave nga Instituti Hidrometeorologjik Shqiptar, temperaturat më të larta se 10⁰C fillojnë në muajin mars dhe vazhdojnë deri në fund të muajit dhjetor. Në territoret e të dyja bashkive, periudha e vegetacionit zgjat rreth 400 ditë. Për çdo 100 m rritje të lartësisë në reliev, periudha e vegetacionit zvogëlohet me 8 ditë²¹⁰. Në relievet kodrinore të territoreve të Durrësit dhe të Shijakut periudha e vegetacionit

²¹⁰Zorba, P. (2007) : “Klimatologjia” Tiranë, faqe 193

mund të zvogëlohet deri në 20 ditë. Kultura të ndryshme bujqësore kanë periudha të ndryshme të vegjetacionit.

Burimet e ngrohtësisë merren parasysh edhe në fillimin dhe përfundimin e sezonit të plazhit. Temperaturat e ajrit mbi 20°C janë më të përshtatshme për banjo dielli. Në plazhet e Durrësit temperaturat mesatare më të larta se 20°C fillojnë në muajin qershor dhe vazhdojnë deri në muajin shtator²¹¹. Duke vëzhguar tabelën e temperaturave mujore më të larta, kuptohet që ditë me temperatura më të larta se 20°C ka që në muajin maj deri në muajin nëntor. Rrezet e diellit nxisin prodhimin e vitaminës D në lëkurën e njeriut dhe rrisin imunitetin e njeriut.

Megjithatë shpërndarja e ditëve me diell përgjatë një viti nuk është uniforme edhe energjia diellore e përfituar nuk është e njëjtë. Gjatë muajit dhjetor, sasia ditore e rrezatimit diellor është shumë e vogël (2.3 kwh/ m²), kurse gjatë muajit korrik ka vlera të mëdha (8030 kwh/m²)²¹². Ditët “të mira” me diellëzim konsiderohen ditët me diellëzim ditor jo më të vogël se 5.5 orë, ndërsa ditët “të këqia” me diellëzim konsiderohen ato me më pak se 1.5 orë, ku këto të fundit, në territoret e Durrësit dhe të Shijakut janë ditë shumë të pakta. Intensiteti dhe kohëzgjatja e lartë e rrezatimit diellor, temperaturat dhe lagështia e ajrit lejojnë përdorimin e qëndrueshëm të energjisë diellore.

Burimet e lagështirës kanë rëndësi në zhvillimin e kulturave bujqësore dhe drufrutorëve. Sasia e reshjeve, që bie në territorin e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut, konsiderohet mesatarisht e ulët. Pavarësisht këtij fakti, reshjet në formë shiu kanë ndikojnë në uljen e kostos së prodhimit bujqësor dhe blektorat, duke qenë se konsiderohen si ujitës natyrorë.

III.6.4. Përdorimi i pasurisë ujore

Uji është baza e jetës. Pa ujë nuk do të kishte jetë në planetin tokë. Përdorimet e ujit janë tepër të gjera. Ai gjen përdorim në të gjitha degët e ekonomisë. Si i tillë, uji ka një vlerë ekonomike. Vlera ekonomike epasurisë ujore në territorin e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut, vjen nga përdorimi direkt i tij në zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë, pylltarisë, bletarisë, ndërtimtarisë, dhe nga përdorimi indirekt në turizëm, rekreacion, transport, tregti etj. Burimet e ndryshme ujore kanë përdorim për qëllime të ndryshme.

III.6.4.1. Përdorimi i ujit të detit Adriatik

Deti Adriatik është pasuria më e madhe ujore që kanë këto territore dhe në veçanti bashkia e Durrësit. Sipas konventës “Ligji i detit”, brenda ujërave territoriale dhe Zonës ekskluzive ekonomike (EEZ), shteti shqiptar dhe bashkia e Durrësit kanë të drejtën e navigimit dhe përdorimit të pasurisë ujore. Duke qenë se bashkia e Durrësit ka dalje në det në 61.8 km vijë bregdetare, ajo kontrollon dhe përdor më tepër se 1000 km² sipërfaqe ujore. Hapësira detare e Durrësit ka vlerë ekonomike nga përdorimi indirekt i tij. Me këtë hapësirë ujore lidhen drejtpërdrejt zhvillimi i turizmit blu, rekreacionit, i peshkimit, i transportit dhe i tregtisë.

Turizmi i detit zhvillohet në bregdetin e ulët (akumulativ), kryesisht në gjirin e Lalëzit dhe në gjirin e Durrësit. Përgjatë vijës bregdetare të Durrësit njihen disa plazhe, si: Plazhi Shën Pjetrit, i Hamallajt, i Rushkullit, i Sektorit Rinia, i Portezit, i Kallmit, i Currilave dhe plazhi i Durrësit (nga Porti deri tek Përroi i Agait). Duke përjashtuar plazhin e Kallmit, i cili është plazh shkëmbor, të gjithë plazhet e tjera janë plazhe ranorë. Vlerat konkurruese të ujërave bregdetare të Durrësit janë të përcaktuar

²¹¹ Shikoni tabelat e temperaturave mesatare në Aneks

²¹² Sadikaj, D. (2014): “Energjia diellore”, Publikim Online

nga thellësia jo shumë e madhe në një distancë të gjatë nga bregdeti, nga mungesa e valëve me lartësi të madhe, nga përqindja e lartë e kripësisë dhe temperaturat e ujit të përshtatshme për tu larë.

Përgjatë të gjithë vijës bregdetare të Durrësit, cekëtina bregdetare është e ulët, e krijuar nga deltat e vjetra e grykëderdhjet ekzistuese të lumenjve por edhe nga baret nënujore²¹³. Valëzimi nuk është i lartë, pasi erërat jugperëndimore, që janë të forta, nuk janë mbizotëruese në bregdetin e Durrësit. Gjatë sezonit turistik, sasia e ujërave të derdhura në detin Adriatik është më e ulët, sasia e avullimit më e madhe dhe për pasojë kripësia është më e lartë.

Karakteristika më e domosdoshme për zhvillimin e turizmit blu është temperatura e ujit. Kushtet më të përshtatshme për larjen e individit në këto ujra janë, 18⁰C për ujin e detit dhe 20⁰C për temperaturën e ajrit²¹⁴. Muajt me temperaturë mesatare uji më të larta se 18⁰C janë qershori, korriku, gushti, shtatori dhe tetori. Ditët me temperatura uji më të lartë se 20⁰C fillojnë që një muajin maj dhe vazhdojnë deri në tetor. Në qoftë se gjatë muajve maj, qershor dhe tetor mund të vihen re temperatura uji më të ulta se 18⁰C, në muajin korrik, gusht dhe shtator nuk zbresin nën këtë kufi. Sipas disa studimeve, qëndrimi i njeriut në ujin e detit ndikon në funksione fiziologjike dhe në gjendjen psikologjike të tij. Krahas efekteve trapeutike, fiziko-mekanike dhe fiziologjike, uji i detit përmes kripësisë, jodit dhe bromit, nxit sistemin nervor, si dhe rekomandohet për disa lloj sëmundjesh²¹⁵. Së bashku me turizmin blu, në bregdetin e Durrësit janë të zhvilluara një sërë sportesh me varka, motor uji, noti dhe peshkimi.

Peshkimi është një aktivitet që lidhet drejtpërdrejt me potencialin e biodiversitetit, që përmban zona bregdetare. Këto zona konsiderohen më vetalet pasi përmbajnë rreth 90% të të gjithë specieve detare²¹⁶. Në ujërat territoriale të Durrësit peshkohen lloje të ndryshëm peshqish si: levreku, qefulli, koca, sardelja dhe toni etj. Njëkohësisht peshkohen edhe një sërë molusqesh dhe krustacësh.

Transporti dhe tregtia në ujërat detare të Durrësit lidhen me portin e Durrësit dhe portin industrial të Porto Romanos. Nëpërmjet dy porteve bëhet shkëmbimi i mallrave (rifuxho dhe me kontenier) dhe i njerëzve. Linjat e shumta të tragetit bëjnë të mundur transportimin (import dhe eksportin) e njerëzve, makinerive të ndryshme dhe produkteve bujqësore, blegtorale dhe industriale.

III.6.4.2.Përdorimi i ujërave të lumenjve Erzen dhe Ishëm

Ujërat e rrjetit hidrografik të lumit Erzen dhe Ishëm përdoren për ujitjen e tokave bujqësore të bashkive Tiranë, Durrës, Shijak dhe Krujë. Kanali Ndroq-Çallëk-Shijak që është ndërtuar gjatë viteve 1976 -1978, merr ujë në pjesën e poshtme të rrjedhjes së lumit Erzen dhe ujit 2 500 hatokë fushore të zonës së Shijakut. Ky kanal ka një gjatësi 7 km dhe aftësi ujëpërcjellëse 4,5 m³/s. Ky kanal furnizohet me ujë nëpërmjet digës së Ndroqit. Kjo digë e ndërtuar drejtpërsëdrejti në shtratin e lumit është e tipit kapërderdhëse, me lartësi 6 m, që lejon kalimin e prurjes maksimale deri 1450 m³ / s në një front kapërderdhje prej 40 ml²¹⁷. Nëpërmjet shkarkuesit të kësaj dige kalojnë tranzit edhe të gjitha aluvionet fundore, pa e prekur fare regjimin e rrjedhjes së ngurtë të këtij lumi.

²¹³Pano, N. (2008). *Pasuritë ujore të Shqipërisë*, Tiranë, faqe 46.

²¹⁴Draçi, B. (2002). *Model turistik i perdorimit racional të potencialit hidrografik*. Studime gjeografike Nr. 14,Tiranë

²¹⁵Po aty.

²¹⁶Dollma, M. (2013). *Gjeografi ekonomike*. Tiranë, faqe 78.

²¹⁷Pano, N. (2008). *Pasuritë ujore të Shqipërisë*, Tiranë, faqe 230- 233.

III.6.4.3.Përdorimi i burimeve alternative të ujit

Ujëmbledhësat, së bashku me ujërat e ricikluara, Ujërat e shiut dhe rezervuarët, konsiderohen si burime alternative të ujit²¹⁸. Pasuritë ujore sipërfaqësore, të ëmbla, të territorit të Durrësit dhe të Shijakut, janë përdorur në vazhdimësi për ujitjen e sipërfaqeve bujqësore dhe për zhvillimin e peshkimit. Aktualisht, në këto territore, pavarësisht se ekzistojnë 35 ujëmbledhësa, vetëm 13 prej tyre funksionojnë dhe përdoren në ujitjen e sipërfaqeve bujqësore. Sipas të dhënave të Bordit të Kullimit Durrës, nga të 13 ujëmbledhësat (Likesh, Maskuri e Vogël, Shkallnur, Karpen, Rubjekë, Bilalas, Shkallë, Topana, Ishëm, Shpitallë 1, Radë 1, Radë 2 dhe Kareç) ujiten rreth 1 119 ha tokë, e cila bëhet me rrjedhje të lirë²¹⁹.

Sipërfaqet e ujitura janë 3 274 ha ose 17% e tokave bujqësore. Të gjithë ujëmbledhësat që gjenden në këto territore janë projektuar për të ujitur 18 512 ha tokë bujqësore, çka do të thotë që vetëm 6% e tokave të projektuara, ujiten nga këto ujëmbledhës. Krahas përdorimit bujqësor, ujëmbledhësat përdoren për peshkim dhe rekreacion nga banorët e zonës.

III.6.5.Përdorimi i tokës

Toka, si resurs natyror mund të përdoret në shumë mënyra, në varësi të faktorëve klimatiko-tokësorë dhe socialo-kulturorë. Përdorimi i tokës i njohur me termin “*land use*” ka të bëjë me mënyrën si toka mbahet dhe përdoret në aspektin e llojit të aktiviteteve antropogjene që zhvillohen në të.

Duke u mbështetur në “Sistemin Mixhigan të Klasifikimit të Përdorimit të Tokës”, në hapësirën territoriale të bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut janë identifikuar 7 kategori të nivelit të parë dhe një sërë kategorish të nivelit të dytë, të përdorimit të tokës²²⁰. Në tabelën e mëposhtme janë të evidentuara emërtimet e çdo niveli.

Tabela 39. Kategoritë e përdorimit të tokës sipas niveleve

Nr. Kategoritë	Niveli I	Niveli II
1	Zona urbane dhe e ndërtuar	Ndërtime banimi,
		Qendra tregtimi, shërbimesh dhe institucionale
		Zona industriale
		Hapësira transporti, komunikimi
		Përdorime mikse
		Atraktive
		Vende të hapura, etj
2	Toka agrokulturore	Toka bujqësore
		Pemishte
		Vreshtari
		Pjergulla
		Ullishte etj
3	Tokat me kullota dhe me shkurre	Kullota
		Shkurre
		Pisha
4	Tokat me pyje	Dushk
		Plepa

²¹⁸ STOA (2013). *Sustainable management of natural resources ÷ith focus on ëater and agriculture*. Final Report.

²¹⁹ Bordi i Kullimit Durrës-Krujë, Të dhëna statistikore 2013


²²⁰ Lusch, D., Goodwin, R. (2012). *Land Cover/Use Classification System*. Published by Department o Geography Michigan State University, Decembre.

5	Sipërfaqet ujore (Ujërat)	Lumenj
		Liqene
		Rezervuarët
6	Tokat e lagura	Ligatina
7	Tokat joproductive	Plazhe
		Duna rëre
		Pjesë shkëmbore të ekspozuara
		Sipërfaqe tranzitore

Burimi: LULC-Universiteti i Michiganit, 2012

Gjatë krijimit të hartës së përdorimit të tokës në territorin e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut, nëpërmjet programit Arc GIS 10.1, u përllogarit përqindja që zë secila prej kategorive të nivelit të parë. Kështu, zona urbane dhe e ndërtuar zë rreth 14% të territorit, toka agrokulturore 59%, toka me kullota dhe shkurre 8%, toka pyjore 14%, sipërfaqet ujore 1.5%, tokat e lagura 2% dhe tokat joproductive 1.5%. Në hartën e mëposhtme paraqitet përdorimi i tokës në territoret e dy bashkive në studim.

Harta 14. Harta e përdorimit të tokës në bashkinë e Durrësit dhe të Shijakut



Punuar: Arc GIS, viti 2016

III.6.5.1. Zona urbane dhe e ndërtuar

Zonat urbane dhe ato të ndërtuara janë sipërfaqet intensivisht të përdorura, ku pjesa më e madhe e tokës është e zënë me ndërtime. Në territoret e të dyja bashkive këto zona zënë një sipërfaqe prej rreth 5 800 ha. Në këtë kategori përfshihen ndërtimet në qytetin e Durrësit dhe të Shijakut, në qytezën e Sukthit, Manzës dhe qendrave rurale në njësitë administrative Rrashbull, Katund të Ri, Ishëm, Xhafzotaj, Gjepalaj dhe Maminas. Ndërtimet për qëllime banimi janë të disa llojeve si: shtëpi individuale, shtëpi pjesërisht të veçuara, shtëpi në rend dhe apartamente me disa kate.


Në të gjithë territorin e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut gjenden 42 511 ndërtime për qëllime banimi, nga të cilat 34 746 gjenden në bashkinë e Durrësit dhe 7 765 ndërtime në bashkinë e Shijakut²²¹. Në këtë kategori bëjnë pjesë edhe hapësirat e ndërtuara, për qëllime shërbimi, përgjatë rrugëve kryesore si: rruga interurbane kryesore Durrës-Tiranë, Durrës-Ndroq-Tiranë, Durrës-Kavajë dhe përgjatë rrugëve interurbane dytësore që lidhin qytet me qendrat e fshatrave. Pjesë e kategorisë së zonave të ndërtuara është edhe hapësira industriale (duke përfshirë edhe ish-minierën e Manzës), hapësirat e zëna nga institucionet (arsimore, shëndetësore, fetare, qeverisëse etj), qendrat komerciale e të shërbimeve dhe qendrat e qyteteve Durrës dhe Shijak.

Në zonat urbane dhe të ndërtuara bën pjesë edhe hapësira e zënë nga porti i Durrësit dhe i Porto Romanos, stacioni i trenit në Durrës dhe i gjithë rrjeti hekurudhor brenda këtyre territoreve si dhe i gjithë rrjeti rrugor, i të gjithë kategorive (rrugë interurbane, rrugë urbane dhe rurale, të asfaltuara ose jo). Në këtë kategori janë të përfshira edhe hapësirat agrokulturore, sipërfaqet pyjore dhe ujore të vogla midis ndërtimeve me densitet mesatar dhe të ulët²²².

III.6.5.2. Toka agrokulturore

Hapësirat agrokulturore në bashkinë e Durrësit dhe të Shijakut zënë rreth 26 186 ha ose 59% të të gjithë sipërfaqes territoriale. Tokat agrokulturore kanë përdorim bujqësor dhe jobujqësor siç paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Tabela 40. Përdorimi i tokës agrokulturore në territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut



Punuar: Ermiona Braholli

²²¹ INSTAT (Instituti i Statistikave) - Censusi 2011

²²² Lusch, D., Goodwin, R. (2012). *Land Cover/Use Classification System*. Published by Department of Geography Michigan State University, Decembre.

Këto hapësira agrokulturore janë të përqëndruara më tepër në njësinë administrative Katundi i Ri, Sukth dhe Xhafzotaj dhe më pak në njësinë administrative të Rrashbullit, Maminasit, Gjepalajt, Manzës dhe Ishmit. Vetëm tokat bujqësore, të mbjella me bimët e arrave zënë rreth 41% të hapësirës territoriale të të dyja bashkive dhe 71% të tokës agrokulturore.

Sipërfaqja bujqësore në të dyja bashkitë është 18 044.79 ha. Rreth 84% e fondit të tokës bujqësore gjendet në bashkinë e Durrësit, përkatësisht 15 160.7 ha tokë²²³, ndërsa në bashkinë e Shijakut gjendet 16% e tokës bujqësore ose 2 884.09 ha. Në bashkinë e Durrësit sipërfaqja e tokës bujqësore për banor është 0.5 ha/ b, kurse në bashkinë e Shijakut është 0.06 ha/ b. Në tabelën e mëposhtme paraqiten kulturat bujqësore të mbjella në tokat bujqësore të bashkisë Durrës dhe Shijak.

Tabela 41. Sipërfaqet e kulturës bujqësore në bashkinë e Durrësit dhe të Shijakut

Nr B. Durrës/ Shijak	Kultura bujqësore	Sipërfaqja	Përqindja
1	Drithëra	4264.5	23.5%
2	Perime	1699.29	9.5%
3	Patate	299	1.5%
4	Fasule	761	4%
5	Duhan	42	0.5%
6	Foragjere	10979	61%
7	Gjithsej	18044.79	100%

Burimi: Ministria e Bujqësisë, 2012

Nga analiza e tabelës së mësipërme rezulton se kultura që zë sipërfaqet më të mëdha është ajo e foragjereve, ndërsa kultura bujqësore më pak e kultivuar është duhani. Foragjeret janë kultura bujqësore që përdoren si lëndë e parë në zhvillimin e blegtorisë. Kultura e perimeve ku përfshihen domatet, tranguj, specat, patëllxhanët, bamjet etj. Perimet mbillen në rreth 1/ 10 e tokës bujqësore dhe shkojnë për konsum familjar dhe tregti. Kultura e drithërave përfaqësohet nga gruri (1545 ha), misri (2087 ha), elbi (4.5 ha) dhe tagjia (628 ha)²²⁴.

Krahas tokës bujqësore në tokat agrokulturore të bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut gjenden toka të mbjella me pemë. Këto toka zënë një sipërfaqe prej 7 443.21 ha ose 29% të tokës agrokulturore (18% të sipërfaqes territoriale). Në këtë sipërfaqe janë të mbjella rreth 472 000 rrënjë pemë frutorë (mollë, kumbulla, dardha etj), 236 000 rrënjë ullinj, 64 000 rrënjë agrume (portokallë, mandarina, limon), 866 000 rrënjë rrush (në vreshta dhe pjergull)²²⁵.

III.6.5.3.Toka me kullota dhe me shkurre

Tokat me kullota dhe shkurre zënë një sipërfaqe prej 3 430.67 ha, nga të cilat 724.11ha janë kullota dhe 2 706.56 ha janë shkurre. Kullotat janë sipërfaqe me bar natyror ku mungojnë bimët e larta, ndërsa sipërfaqet me shkurre janë hapësirat

²²³Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim, (2014). *Programi i Zonës Funktionale- Bashkia e Re Durrës*. Tiranë.

²²⁴ Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave (2013). *Statistikat e vitit 2012*. Tiranë.

²²⁵ Po aty.

territoriale të mbuluar nga shkurre dhe bimë të ulta, ku dominojnë ferrat, shelqet, pishat bregdetare, pishat e buta, pishat e egër etj.

III.6.5.4. Tokat me pyje

Tokat pyjore janë toka që mbështesin rritjen e pyjeve ose të cilat janë formuar nën vegjetacionin pyjor dhe që nuk kanë ndryshuar dukshëm për shkak të përdorimeve. Në hapësirën territoriale të bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut gjenden rreth 5 832.94 ha pyje, nga të cilat 5 519.7 ha gjenden në bashkinë e Durrësit dhe 313.24 ha në bashkinë e Shijakut²²⁶. Tokat pyjore zihen nga pemët drunorë (të lartë) si: vidhi (*Ulmus foliacea*), rrapë (*Platanus orientalis*), plepi i bardhë (*Populus alba*) etj.

III.6.5.5. Sipërfaqet ujore (Ujërat)

Në sipërfaqet ujore përfshihen sipërfaqet e tokës të zëna nga liqenet, lumenjtë, kanalet kulluese dhe ujëmbledhësat. Sipërfaqja ujore zë rreth 603 ha ose rreth 1.5 % të territoreve të Durrësit dhe të Shijakut. Pjesë e sipërfaqeve ujore janë liqeni i Godullës dhe Bishtarakës, sipërfaqja e luginës së lumit Erzen dhe Ishëm, i kanaleve kulluese në fushën e Durrësit dhe e 35 ujëmbledhësave artificial të ndërtuar gjatë periudhës së sistemit komunist.

III.6.5.6. Tokat e lagura

Në tokat e lagura bëjnë pjesë sipërfaqet e përmbytura nga uji. Ato gjenden përgjatë vijës bregdetare të Durrësit në të majtë dhe në të djathtë të grykëderdhjes së lumit Erzen. Këto toka janë pothuajse gjatë gjithë vitit të përmbytura nga baticat e detit Adriatik dhe nga plotat e lumit Erzen gjatë periudhës së vërshimeve të lumit. Sipërfaqja e tokave të lagura është 729 ha ose rreth 2% e sipërfaqes së territorit bashkiak.

III.6.5.7. Tokat joproductive

Në tokat joproductive përfshihen sipërfaqet e plazheve, të dunave të rërës, sipërfaqet e zhveshura nga bimësia dhe të ekspozuara ndaj erozionit. Plazhet, që shtrihet që nga grykëderdhja e Ishmit në veri e deri në përroin e Agait në jug, zënë një sipërfaqe prej 256 ha. Sipërfaqet e rërës dhe të dunave shtrihen në plazhin e Shën Pjetrit, të Hamallës, Rrushkullit, Sektorit Rinia, Portezit, Kallmit, Currilave dhe plazhit të Durrësit. Këto plazhe kanë përdorim në zhvillimin e turizmit banlear, gjatë sezonit të verës. Sipërfaqet e zhveshura gjenden në kodrat e Currilave, në disa zona të kodrave të Arapajt, në kodrat Rodon-Prezë dhe përgjatë bregdetit abrazit të Adriatikut.

Kodrat e Currilave përbëhen prej argjilave dhe janë toka që përfshihen herë pas here nga rrëshqitjet. Pjesë e kodrave të Arapajt është Shkëmbi i Kavajës (monument natyre), i cili në pjesë perëndimore është i ekspozuar ndaj erozionit eolik. Në bregdetin e lartë, në Kepin e Rodonit dhe në Kepin e Lalit (Pallës) gjenden faleza të krijuara nga erozioni detar, të cilat konsiderohen të gjalla duke qenë se janë ende aktive. Toka joproductive gjenden edhe pranë shtratit të lumit Erzen, i cili gjatë vërshimeve i gryen dhe i erodon.

²²⁶ Fletoria Zyrtare, Vendimi nr. 433, datë 08.06.2016 “ Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/ bashkive”;

III.6.6.Përdorimi i biodiversiteti


Biodiversiteti i territoreve të Durrësit dhe të Shijakut është një potencial me vlera të larta përdorimi. Flora dhe fauna e këtyre territoreve përfaqëson një potencial të madh ekonomik, ekologjik dhe social, jovetëm për dy bashkitë por për të gjithë vendin tonë.

III.6.7.Përdorimi i gjallesave bimore

Vlera ekonomike e bimësisë përcaktohet nga vlera e përdorimit direkt dhe indirekt i tyre. Vlera e përdorimit direkt përfitohet nga përdorimi direkt i produkteve drunore dhe jodrunore, ndërsa vlera e përdorimit indirekt vjen nga përdorimet për rekreacion i tyre.

Bashkia e Durrësit dhe ajo e Shijakut, kanë një fond pyjor prej 9 263.61 ha, nga të cilat 5 790.29 ha janë me dushk dhe 3 473.32 ha pyje të tipit higrofil.

Tabela 42. Përdorimi i pasurisë bimore në territorin e Bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut



Punuar: Ermiona Braholli

Produkti drunor që merret direkt pyjet është lëndë drusore. Sasia totale e lëndës drusore nga e gjithë sipërfaqja pyjore është 173 014 m³. Pavarësisht përdorimeve të gjera të drurit, në industrinë e drurit, tekstileve dhe letrës, përdorimet më të mëdha shkojnë për dru zjarri. Sipas burimeve të Drejtorisë së Pyjeve në Durrës rreth 41 385 m³ janë të përshtatshme për lëndë punimi dhe 131 829 m³ për dru zjarri²²⁷. Llojet e drurëve që përdoren për dru zjarri dhe për prodhimin e qymyrit të drurit janë: Mareja (*Arbutus unedo L.*), Xina (*Pistacia lentiscus L.*), Gjineshtra

²²⁷ Drejtoria Rajonale e Shërbimit Pyjor Durrës (Krujë)

(*Spartium junceum L.*), Bungëbuta (*Quercus pubescens*), Shkoza e zezë (*Carpinus orientalis*) dhe Frashëri i bardhë (*Fraxinus ornus L.*)²²⁸.

Sipas të dhënave të INSTAT-it, nga Censusi 2011, rreth 59.1% e banesave në territorin e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut përdorim stufa druri dhe oxhakë. Vetëm në bashkinë e Durrësit rreth 54% e banesave përdorim stufa dhe oxhaqe për ngrohjen e ambienteve të tyre. Në njësinë administrative të Durrësit përdoren më pak stufa dhe oxhaqe, në rreth 43% të banesave, ndërsa në njësinë administrative të Ishmit përdoren stufa dhe oxhaqe në rreth 93% të banesave. Pavarësisht se qyteti i Durrësit ka përqindjen më të ulët, ka numrin më të lartë të banesave që përdorin stufa dhe oxhaqe, në të gjithë bashkinë. Në njësitë administrative të tjera të Durrësit përdorimi i stufave dhe oxhaqeve është rreth vlerës 80%. Në tabelën e mëposhtme paraqitet numri i banesave që përdorin stufë dhe oxhak për ngrohje.

Tabela 43. Banesat e banuara në bashkinë e Durrësit dhe lloji i ngrohjes

Bashkitë Njësi administrative	Bashkia Durrës	Durrës	Sukth	Manzë	Rrashbull	Katundi i Ri	Ishëm
Nr. i banesave	45079	30499	3795	1583	5633	2323	1246
%	54%	43%	85%	81%	81%	82%	93%
Banesa me stufë	24698	12925	3221	1219	4414	1880	1039
Banesa me oxhakë	881	456	37	74	157	36	121

Burimi: INSTAT, Census 2011

Në bashkinë e Shijakut rreth 75 % e banesave ngrohen me stufë dhe oxhak. Në njësinë administrative Xhafzotaj dhe Maminas, stufat dhe oxhaqet përdoren përkatësisht në 79% dhe 83% të banesave. Në njësinë administrative Gjepalaj stufat dhe oxhaqet përdoren në 88% të banesave, kurse në njësinë administrative të Shijakut vetëm në 58% të tyre. Në bashkinë e Shijakut, në njësinë administrative të Xhafzotajt gjendet numri më i lartë i banesave që përdorin stufa dhe oxhaqe.

Tabela 44. Banesat e banuara në bashkinë e Shijakut dhe lloji i ngrohjes

Bashkitë Njësi administrative	Bashkia Shijak	Shijak	Maminas	Gjepalaj	Xhafzotaj
Nr. i Banesave	7091	2016	1183	854	3038
%	75%	58%	83%	88%	79%
Stufë	4992	1066	875	748	2303
Oxhakë	328	107	107	9	105

Burimi: INSTAT, Census 2011

Krahas përdorimeve për dru zjarri, lënda drusore ka përdorime edhe në industri, në prodhimin e veglave të punës, në industrinë e letrës etj. Lënda drusore me rëndësi industriale është: Mërsina (*Myrtus communis L.*), Xina (*Pistacia lentiscus L.*), Gjineshtra (*Spartium junceum L.*), Bungëbuta (*Quercus pubescens*), Shkoza e zezë (*Carpinus orientalis*), Frashëri i bardhë (*Fraxinus ornus L.*), Rrapi (*Platanus orientalis*), Shelgu i kuq (*Salix purpurea*), Plepi i bardhë (*Populus alba*), Pisha

²²⁸ www.agroweb.org

Bregdetare (*Pinus pinaster*), Pisha e egër (*Pinus halepensis*) dhe Vidhi (*Ulmus foliacea*). Më poshtë jepen përdorimet drunore të secilit prej drurëve që gjenden në territorin e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut. Kështu:

- Mërsina (*Myrtus communis* L), përdoret si ngjyruës;
- Xina (*Pistacia lentiscus* L), gjethet e së cilës përmbajnë 11-18% taninë, përdoren për regjien e lëkurave. Me ujin e zjerrë të tyre pastrohen butet (vozet) e verës²²⁹;
- Gjineshtra (*Spartium junceum* L.) degët e së cilës përdoren për të thurur shporta, kurse druri i saj për të gdhendur sende të vogla zbukurimi²³⁰;
- Bungëbuta (*Quercus pubescens*), përdoret për të përgatitur qerre të vogla bujqësore dhe shtylla druri²³¹;
- Shkoza e zezë (*Carpinus orientalis*), druri i së cilës përdoret për të përgatitur vegla bujqësore²³²;
- Frashëri i bardhë (*Fraxinus ornus* L.), druri i të cilit përdoret për orendi të ndryshme në bujqësi. Degët e holla përdoren për të thurur shporta, kanistra dhe koshe²³³;
- Rrapi (*Platanus orientalis*) është dru zbukurues, që përdoret në zdrukthëtari dhe për skulptura²³⁴;
- Shelgu i kuq (*Salix purpurea*), thuprat e tij përdoren në industrinë e xungthtarisë²³⁵;
- Plepi i bardhë (*Populus alba*), konsiderohet si dru industrial me përdorim në prodhimin e veglave e orendive bujqësore²³⁶;
- Pisha Bregdetare (*Pinus pinaster*), përdoret për prodhimin e letrës, marrjen e rrëshirës si dhe për zbukurimin e parqeve dhe kopshteve²³⁷;
- Pisha e egër (*Pinus halepensis*), Lënda e pishës së egër vlerësohet për ndërtim detare, rrëshirë dhe në industri²³⁸;
- Vidhi (*Ulmus foliacea*), është një dru i mirë në përdorimin e rrotave dhe për të mbajtur galeritë e minierave. Përdoret në sdrukthëtari për përgatitjen e mobiljeve dhe orendive. Përdoret edhe si dru zbukurues pranë rrugëve²³⁹;
- Rrënja (*Quercus robur*) druri i së cilës mund të përdoret për trarë, rimeso, fuçi ose traversa hekurudhash.
- Shelgu i Bardhë (*Salix alba* L.) përdoret për thupra, për të përgatitur shporta e kosha²⁴⁰.

Krahas produkteve drunore, nga pyjet përfitohen edhe produkte jodrunore. Në produktet jo drunore përfshihen frutat, kërpudhat, erëzat dhe produktet mjekësore, farmaceutike e kozmetike. Në territorin e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut gjenden një shumëllojshmëri bimësh mjekësore dhe aromatike. Nga përdorimi i pjesë të tyre si: gjethja, lulja, rrënja, lëvorja apo e gjithë bima, përfitohen produkte me vlera përdorimi në mjekësi, farmaceutikë dhe kozmetikë. Në këto territore rritet: Mimoza (

²²⁹ Mitrushi, I. (1955). *Drurët dhe shkurret e Shqipërisë*. Tiranë, faqe 258-259.

²³⁰ Po aty, faqe 188-189.

²³¹ Po aty, faqe 358-359.

²³² Po aty, faqe 335-336.

²³³ Po aty, faqe 379-380.

²³⁴ Akademia e Shkencave të Rep. së Shqipërisë (1988). *Flora e Shqipërisë I*. Qendra e Studimeve Biologjike, Tiranë, faqe 401.

²³⁵ Po aty, faqe 103.

²³⁶ Po aty, faqe 105.

²³⁷ Po aty, faqe 83.

²³⁸ Po aty, faqe 85.

²³⁹ Mitrushi, I. (1955). *Drurët dhe shkurret e Shqipërisë*. Tiranë, faqe 457-458.

²⁴⁰ Po aty, faqe 471-472.

Acacia dealbata), Petriku kulper (*Aristolochia clematitidis*), Pelini i Zi (*Artemisa vulgaris*), Minuri si pelin deti (*Chenopodium ambrisioidos*), Menishtja me push (*Cistus incanus*), Ekualipti rruazor (*Ecualiptus glopulus*), Dëllinja e kuqe (*Juniperus oxycedrus*), Fidhësi (*Juniperus communis*), Dafina (*Laurus nobilis*), Mëlllaga (*Malva silvestris*), Gjuhë nusja (*Ononis spinosa*), Rigoni i Bardhë (*Origanum vulgare*), Lulëkuqja (*Papaver rhoeas*), Majdanoz (*Petroselinum sativum*), Pisha e butë (*Pinus pinea*), Trumza (*Saturea montana*), Bar majasëlli (*Teucrium polium*), Matriku (*Vinca major*) dhe Konopica (*Vitex agnus-castus*) etj²⁴¹. Më poshtë do të evidentojmë përdorimet mjekësore, farmaceutike dhe kozmetike të bimëve mjekësore dhe aromatike të lartpërmendura.

Disa nga bimët , nga ku merren produkte ushqyese dhe mjekësore përmendim:

- Xina (*Pistacia lentiscus L*), kokrrat e xinës përdoren si bimë mjekësore në dhimbjet e stomakut dhe të barkut;
- Frashëri i bardhë (*Fraxinus ornus L.*) Nga lëvorja e frashërit të bardhë nxiret një lëng i trashë (manë), i cili përdoret në mjekësi si laksativ dhe purgativ;
- Petriku kulper (*Aristolochia clematitidis*) është bimë mjekësore që përdoret kundër çregullimeve nervore, epilepsisë, kundër ulçerave dhe dhimbjeve muskulare²⁴²;
- Dëllinja e kuqe (*Juniperus oxycedrus*), e distiluar prodhon një vaj që përdoret kundës sëmundjeve të lëkurës²⁴³ ;
- Dëllinja e zezë (*Juniperus communis*), përdorimi i fryteve ka veti diuretike e stimuluese;
- Dafina (*Laurus nobilis*), gjethet e dafinës përdoren kundër gripit dhe bronshiteve kronike. Ka vlera ekonomike të mëdha ekonomike pasi nga një bimë e vetme mund të sigurohet 1 kg gjethe dafine të thata;
- Mëlllaga (*Malva silvestris*), përdoren lulet dhe gjethet e saj, në sëmundjet e aparatit tretës, urinar dhe kundër acarimit të lëkurës dhe mukozave²⁴⁴;
- Rigoni i Bardhë (*Origanum vulgare*) përdoret në mjekësi për dhimbjen e gojës dhe të dhëmbëve, por edhe si çaj²⁴⁵;
- Lulëkuqja (*Papaver rhoeas*) është bimë e helmët dhe mjekësore. Petalet e luleve të saj përdoren kundër ftohjes, kollit, pagjumësisë dhe për shërimin e organeve të frymëmarrjes²⁴⁶;
- Trumza (*Saturea montana*) është një bimë që përdoret e gjithë në mjekësi për nxjerrjen e sekrecioneve të grykës, për përmirësimin e tretjes, në rrugët e frymëmarrjes (kolla e bardhë);
- Mërsina (*Myrtus communis L*), kokrrat e mërsinës përdoren për reçel, liker, çaj etj;
- Shqopa (*Erica arborea L.*), përdorim kanë gjethet e shqopër për trajtimin e infeksioneve urinare, dhe largimin e koksineve nga organizmi;
- Hithra (*Urtica dioica*), përdoret kundër hemorragjive e ulçerave të zorrës e të stomakut²⁴⁷.

²⁴¹ Pazari, F. (2014). *Vlerësimi Ekonomik dhe ekologjik i bimëve mjekësore dhe aromatike të Shqipërisë në funksion të zhvillimit të ekonomisë rurale*. Disertacion, Tiranë, faqe 190.

²⁴² Akademia e Shkencave të Rep. së Shqipërisë (1988). *Flora e Shqipërisë 1*. Qendra e Studimeve Biologjike, Tiranë, faqe 138.

²⁴³ Pazari, F. (2014). *Vlerësimi Ekonomik dhe ekologjik i bimëve mjekësore dhe aromatike të Shqipërisë në funksion të zhvillimit të ekonomisë rurale*. Disertacion, Tiranë, faqe 171.

²⁴⁴ Papatopuli, G. (1976). *Bimët mjekësore dhe aromatike të Shqipërisë*. Tiranë, faqe 239.

²⁴⁵ Po aty, faqe 297

²⁴⁶ Po aty, faqe 206

²⁴⁷ Akademia e Shkencave të Rep. së Shqipërisë (1988). *Flora e Shqipërisë 1*. Qendra e Studimeve Biologjike, Tiranë, faqe 129.

- Gjunjëza (*Ephedra distachya*), përdoren kundër asmës, urthit dhe ekzemave;
- Mëtergonë, bar i trashë (*Hyosciamus niger*), mund të përdoret kundër nevralgjisë spazmore, kollës, pagjumësisë, reumatizmës etj;
- Lulebasani, balç, lule gjaku, lulemaji (*Hypericum perforatum*), përdoret kundër sëmundjeve të aparatit tretës, mëçisë, tëmthit, veshkave etj;
- Dorëvatë (*Sarcopoterium spinosum*), ka të dhëna që lëvorja e rrënjëve mund të përdoret kundër diabetit.

Disa nga bimët që përdoren si produkte aromatike përdoren:

- Xina (*Pistacia lentiscus L*), prej kokrave të tyre nxirret vaji i xinës që përdoret edhe si erë sapuni;
- Dëllinja e kuqe (*Juniperus oxycedrus*), nga frytet prodhohet një esencë aromatike për pije alkoolike;
- Dafina (*Laurus nobilis*), gjethet e së cilës përdoren në gjellëra të ndryshme;
- Gjuhë nusja (*Ononis spinosa*) ka përdorim aromatik kundër krimbave dhe insekteve²⁴⁸;
- Dëllinja e zezë (*Juniperus communis*) prej kokrave të tyre prodhohet pije alkalike e freskuese.
- Dafina (*Laurus nobilis*) e familjes Lauraceae-Dafinore konsiderohet si zbukurim aromatik.

III.6.8.Përdorimi i gjallesave shtazore

Bota shtazore tokësore dhe ujore e territoreve të Durrësit dhe të Shijakut shfrytëzohet nga njeriu si ushqim dhe dekorues. Përdorimi i gjallesave lidhet me veprimtarinë e peshkimit dhe të gjuetisë. Ndër gjitarët që njeriu konsumon (mishin e tyre) është leperi i egër (*Lepus europaeus, Pall, L. Capensis, L*), ndërsa nga shpendët: Thëllëza e fushës (*Perdix perdix, L*), Shkurta (*Coturnix coturnix L*) dhe Rosat e Patat nga rendi i patorëve (*Anseriformes*).

Gjallesat ujore që përdoren ushqyes për njeriun dhe që rriten dhe zhvillohen në hapësirat ujore të ëmbla dhe të kripura, të territoreve të marra në studim, janë llojet e ndryshme të peshqëve si:levreku, qefulli, koca,toni dhe nga krustacët (karkaleci i detit) etj. Peshqit dhe krustacët shërbejnë si lëndë e parë në guzhinën e restoranteve të bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut.

Nga analiza e potencialit human në territoret e Bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut rezulton se zhvillimet më të mëdha humane kanë ndodhur mbas vitit 1990, si rezultat i ndryshimit të sistemit politik dhe sistemit ligjor në vendin tonë. Si zhvillim human kuptojnë rritjen e numrit të popullsisë deri në dyfishim të tij brenda një periudhe 20-vjeçare, prej lëvizjeve hapësinore dhe lëvizjeve natyrore të popullsisë. Pjesa më e madhe e popullsisë është e përqëndruar në Bashkinë e Durrësit, përkatësisht në njësinë administrative Durrës dhe Rrashbull, ku gjendet edhe përqëndrimi më i madh i zonës urbane dhe të ndërtuar. Zonat urbane kanë numër më të lartë të popullsisë aktive, ndërsa zonat rurale janë prekur nga mplakja e popullsisë. Pavarësisht gjendjes së strukturës gjinore, moshore dhe profesionale të popullsisë së dy bashkive, ndërhyrjet e banorëve në burimet natyrore janë prezente.

Banorët e Durrësit dhe të Shijakut kanë pasur një ndikim të madh në burimin e tokës, ku rreth 59% e saj është përdorur në zhvillimin e agrokulturës. Në një nivel të lartë përdorimi është edhe burimi i ujit, sidomos i ujit të detit Adriatik, ujërave të

²⁴⁸ Pazari, F. (2014). *Vlerësimi ekonomik dhe ekologjik i bimëve mjekësore dhe aromatike të Shqipërisë në funksion të zhvillimit të ekonomisë rurale*. Disertacion, Tiranë, faqe 172.

lumi Erzen dhe ujërave nëntokësore. Burimet natyrore me nivel të ulët përdorimi janë: burimet minerale nëntokësore dhe mbitokësore, burimet e klimës dhe biodiversitetit. Përdorimi i burimeve natyrore dhe pozita gjeografike e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut kanë mundësuar zhvillimin e një sërë degëve të ekonomisë.

KAPITULLI IV

ZHVILLIMI EKONOMIK DHE NDIKIMI NË MJEDISIN E BASHKISË SË DURRËSIT DHE TË SHIJAKUT

Zhvillimi human, sasia e burimeve natyrore dhe shkalla e përdorimit të tyre nga banorët vendas janë tregues të zhvillimit ekonomik të një hapësire socio-gjeografike. Territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut karakterizohen nga një popullim i hershëm dhe i vazhdueshëm dhe nga pasuri të shumëllojshme natyrore. Zhvillimi i veprimtarisë humane, duke përdorur teknika dhe teknologji të kohës, pozita gjeografike dhe kushtet e përshtatshme natyrore, kanë mundësuar ekzistencën e disa degëve të ekonomisë. Në *çështjen e parë* janë të trajtuara karakteristikat e përgjithshme të ekonomisë, duke analizuar me rradhë sektorët e ekonomisë. Aty do të njiheni me degët kryesore të ekonomisë së të dyja bashkive, drejtimet dhe orientimet e reja ekonomike. Në *çështjen e dytë* pasqyrohet ndryshimi i përdorimit të tokës mbas vitit 1990-të si rezultat i zhvillimit human dhe ekonomik. Nëpërmjet hartave të përdorimit të tokës analizohen ndryshimet e evidentuara në hapësirat urbane dhe rurale të bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut, të cilat shoqërohen me efekte negative mbi mjedisin në tërësi. Në *çështjen e tretë* analizohen problemet mjedisore, (në ajër, tokë dhe ujë), shpërndarja hapësinore e tyre dhe faktorët që i kanë shkaktuar ato.

IV.1.Karakteristika të përgjithshme të ekonomisë

Zhvillimi ekonomik në territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut lidhet drejtpërdrejt me llojin e burimit natyror të përdorur dhe me numrin e lartë të popullsisë në moshë pune. Pozicioni gjeografik i përshtatshëm midis rrugëve kryesore të vendin tonë, kushtet natyrore të favorshme për prodhimin e lëndës së parë, si dhe popullsia e angazhuar në punë, bën që në hapësirën territoriale të Durrësit e të Shijakut të ketë rreth 19 280 ekonomi (aktivitete) bujqësore e blegtorale dhe 10 306 ekonomi jobujqësore të regjistruara në vitin 2014²⁴⁹. Në *sektorin e parë* të ekonomisë ku përfshihen degë si: bujqësia, blegtoria, pylltaria, peshkimi, bletaria dhe nxjerrja e mineraleve, përllogariten rreth 19 478 aktivitete. Në *sektorin e dytë* të ekonomisë, ku bëjnë pjesë industria e përgjithshme dhe ndërtimtarinë, përfshihen 1715 aktivitete, ndërsa në *sektorin e tretë* ku bëjnë pjesë dega e turizmit, shërbimeve, tregtisë dhe transportit, përfshihen 8393 aktivitete²⁵⁰. Studimi më i hollësishëm i sektorëve të ekonomisë është bërë si më poshtë, duke filluar nga sektori i parë.

IV.1.1. Sektori i parë

Sektori i parë i ekonomisë përfshin degët: bujqësi, blegtori, pylltari, peshkim, bletari dhe nxjerrje minerale. Në hapësirat rurale të bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut më tepër përparësi kanë degët bujqësi dhe blegtori. Në të dyja bashkitë gjenden rreth 19 280 ekonomi bujqësore dhe blegtorale, nga të cilat 14 111²⁵¹ gjenden në bashkinë e Durrësit dhe 5 169²⁵² në bashkinë e Shijakut. Sektori i parë i ekonomisë është më tepër i zhvilluar në njësitë administrative të Rrashbullit, Manzës, Sukthit, Xhafzotajt dhe Maminasit. Raporti i ekonomive bujqësore dhe blegtorale midis dy

²⁴⁹INSTAT(Instituti i Statistikave) -Buletini Statistikor 2014

²⁵⁰ Po aty,

²⁵¹Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim, (2014). *Programi i Zonës Funktionale- Bashkia e Re Durrës*. Tiranë.

²⁵² Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim, (2014). *Zonë Funktionale Shijak*. Tiranë.

bashkive është 73% me 27%, përkatësisht në bashkinë Durrës dhe në bashkinë Shijak. Fermat në disa raste janë vetëm bujqësore ose vetëm blegtorale dhe në disa raste të tjera të përziera. Në bashkinë e Durrësit fermat thjesht bujqësore janë 4 374, kurse në bashkinë e Shijakut rreth 833 të tilla. Në fermat bujqësore kultivohen kultura të ndryshme bujqësore si drithëra, perime, patate, fasule, duhan dhe foragjere. Rendimenti i bimëve të arave është 49 kv/ha drithëra, 293 kv/ ha perime, 240 kv/ patate, 20 kv/ ha fasule, 13 kv/ ha duhan dhe 288 kv/ ha foragjere²⁵³. Në hapësirën bujqësore të të dyja bashkive, që zë një sipërfaqe prej 1804.79 ha, prodhohen rreth 22 996 ton drithëra, 59 711 ton perime, 7377 ton patate, 1659 ton fasule, 56 ton duhan dhe 333 939 ton foragjere në vit²⁵⁴. Krahas kulturave bujqësore, një peshë të madhe në ekonominë bujqësore të dyja bashkive zë edhe pemtaria. Në sipërfaqen prej 7 443.21 ha, ku janë të kultivuara rreth 472 000 rrënjë pemë frutorë, 236 000 rrënjë ullinj, 64 000 rrënjë agrume dhe 866 000 rrënjë rrush, merret prodhim prej 9 912 ton fruta, 5 101 ton ullinj, 995 ton agrume dhe 12 275 ton rrush²⁵⁵.

Zhvillimi i blegtorisë është aktiviteti i ekonomisë që lidhet me mbarështrimin e kafshëve të ndryshëm, si: gjedhë, të imta, derra, njëthundrakë dhe shpendë. Prodhimet kryesore blegtorale janë mishi, qumështi, leshi dhe vezët. Në tabelën e mëposhtme paraqitet numri i krerëve të mbarështruara në hapësirat blegtorale sipas llojit të tyre.

Tabela 45. Numri i krerëve të mbarështruara në hapësirat blegtorale të bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut

Territori /Krerë	Gjedhë	Të imta	Derra	Njëthundrakë	Shpendë
Bashkia e Durrësit dhe Shijakut	20 883	35 701	4 423	1718	957 400

Burimi: Ministria e Bujqësisë, viti 2012

Në hapësirat blegtorale të bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut rriten dema, lopë, viça, dele, dhi, derra, dosa, kuaj, gomerë, pula, pata, rosa etj. Në këto territore nga 20 883 krerë gjedhë, rreth 14 291 krerë janë lopë, të cilat prodhojnë rreth 44 903 ton qumësht gjatë një viti, dhe 6 592 krerë janë dema e viça. Sasia totale e prodhimit të mishit të gjallë prej gjedhëve është 3 195 ton²⁵⁶. Bagëtitë e imta përfshijnë të leshtat dhe të dhirtat. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet gjendja e të imtave në territoret bashkiake të Durrësit dhe të Shijakut.

Tabela 46. Numri i krerëve të imta dhe i nënlojeve të tyre

Lloji	Të imta	Të leshta	Dele	Të dhirta	Dhi
Nr. krerëve	35 701	28 572	23 942	7 129	5 423

Burimi: Ministria e Bujqësisë, viti 2012

Duke analizuar tabelën e mësipërme rezulton se rreth 80% të të imtave janë të leshta dhe vetëm 20% janë të dhirta. Në të leshtat rreth 84% janë dele dhe 16% deshinj, ndërsa në të dhirtat rreth 76% janë dhi dhe 24% cjepër. Nga 23 942 dele

²⁵³Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave (2013). *Statistikat e vitit 2012*. Tiranë.

²⁵⁴Po aty.

²⁵⁵Po aty.

²⁵⁶Po aty.

prodhohen rreth 2 155 ton qumësht dhe nga 5 423 dhi rreth 998 ton qumësht në vit. Në total prodhohen rreth 48 056 ton qumësht (lope, dele dhe dhie). Nga bagëtitë e imta prodhohen rreth 835 ton mish i gjallë dhe rreth 80 ton lesh. Nga mbarështrimi i derrit prodhohen rreth 458 ton mish i gjallë, ndërsa nga shpendët prodhohen rreth 508 ton mish dhe rreth 282 439 000 vezë në vit.

Bletaria dhe *pylltaria* janë degë të ekonomisë të zhvilluara kryesisht në zonat kodrinore të territoreve të Durrësit dhe Shijakut, aty ku mjediset janë më pak të ndikuara nga dora e njeriut. Bletaria është zhvilluar nga rritja dhe kujdesi ndaj bletëve. Në territoret e dy bashkive gjenden 5 608 koshere me bletë, nga të cilat prodhohen rreth 78 000 ton mjaltë²⁵⁷. Pylltaria është zhvilluar nga prerja dhe tregtimi i lëndës drusore. Në sipërfaqen pyjore prej 5 832.94 ha gjendet një fond pyjor prej 173 014 m³, i cili pjesërisht përdoret nga banorët vendas për dru zjarri dhe pjesërisht në industri. Memorandiumi i vitit 2016 ka penguar përdorimin e lëndës drusore prej banorëve apo firmave shfrytëzuese. Fondi pyjor gjeneron edhe të ardhura nga produktet jodrunore, të lartpërmendura, por mungesa e monitorimeve rreth sasisë së bimëve mjekësore dhe aromatike që mblidhen, nuk pasqyron një të dhënë rreth sasisë së të ardhurave që gjenerojnë këto bimë. Pjesë e memorandiumit është edhe ndalimi i peshkimit e gjuetisë së botës së gjallë tokësore dhe ujore.

Në sektorin e parë të ekonomisë bën pjesë edhe *nxjerrja e mineraleve*. Pavarësisht se nëntoka e territoreve të Durrësit është e pasur me mineralin jometalor të qymyrgurit, veprimtaria nxjerrëse është ndërprerë prej vitit 2000-jëdhe si rezultat ajo nuk gjeneron të ardhura për banorët vendas.

Duke marrë një mesatare të çmimit të tregut për secilën prej produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tabelën e mëposhtme pasqyrohen të ardhurat që gjenerojnë degët (bujqësi, blegtori dhe bletari) të sektorit të parë të ekonomisë.

Tabela 47. Të ardhurat bruto nga kultivimi i kulturave të arrave në bashkinë e Durrësit dhe të Shijakut

	Drithëra	Perime	Patate	Fasule	Duhan	Foragjere
Sasia në kg	22 996 000	59 711 000	7 377 000	1 659 000	56 000	333 939 000
Çmimi (mes.)lek/ kg	40	70	40	250	1500	20
Sasia e të ardhurave / lek	919 840 000	4 179 770 000	295 080 000	414 750 000	84 000 000	6 678 780 000

Burimi: Ministria e Bujqësisë, viti 2012

Tabela 48. Të ardhurat bruto nga zhvillimi i pentarisë në bashkinë e Durrësit dhe të Shijakut

	Fruta	Ullinj	Agrume	Rrush
Sasia në ton	9 912 000	5 101 000	995 000	12 275 000
Çmimi (mes.) lek/ kg	80	150	100	120
Sasia e të ardhurave / lek	792 960 000	765 150 000	99 500 000	1 473 000 000

Burimi: Ministria e Bujqësisë, viti 2012

²⁵⁷ Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave (2013). *Statistikat e vitit 2012*. Tiranë.

Tabela 49. Të ardhurat bruto nga zhvillimi i blegtorisë në bashkinë e Durrësit dhe të Shijakut

Produkti		Sasia në kg / kokrra	Çmimi (mes.) lek/ kg	Sasia e të ardhurave / lek
Qumësht	Lope	44 903 000	70	3 143 210 000
	Dele	2 155 000	80	172 400 000
	Dhie	998 000	60	59 880 000
Mish	Gjedhi	3 195 000	700	2 236 500 000
	Të imta	835 000	500	417 500 000 000
	Derri dhe shpendë	458 000	450	206 100 000 000
Vezë		282 439 000	10	2 824 390 000
Lesh		80 000 000	350	28 000 000 000

Burimi: Ministria e Bujqësisë, viti 2012

Produktet e drejtpërdrejta bujqësore dhe blektorale të lartpërmendura gjenerojnë rreth 469 845 mil. lek të ardhura bruto/ vit. Këto janë të ardhura monetare që vijnë nga hapësirat rurale si rezultat i përdorimit të tokës, ujit dhe botës bimore natyrore e të kultivuar.

IV.1.2. Sektori i dytë

Pjesë e sektorit të dytë të ekonomisë janë industria dhe ndërtimtaria. Industria, si degë e ekonomisë, përfshin industrinë e rëndë dhe të lehtë. Në territorin e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut është e zhvilluar industria përpunuese, e energjisë dhe ujit. Në total numri i ndërmarrjeve të sektorit të dytë të ekonomisë është 1715 njësi²⁵⁸. Përparësi në këtë sektor ka industria përpunuese, kryesisht agroindustria. Kjo degë e ekonomisë është e lidhur me lëndën e parë që vjen nga dega e bujqësisë, ose nga sektori i parë i ekonomisë. Pavarësisht sasisë së madhe të produkteve bujqësore dhe blektorale në këto territore përpunohet vetëm një sasi shumë e vogël e tyre.

Në bashkinë e Durrësit dhe të Shijakut gjenden 1171 ndërmarrje përpunuese ose 3.5% të ndërmarrjeve të të gjithë vendit tonë. Rreth 99% e ndërmarrjeve janë private dhe vetëm 1 % e tyre shtetërore. Në bashkinë e Durrësit gjenden 1167 ndërmarrje dhe në bashkinë e Shijakut vetëm 4 ndërmarrje përpunuese të produkteve bujqësore dhe blektorale²⁵⁹. Numri i të punësuarve në këtë sektor është 7 794 individë²⁶⁰.

Tabela 50. Të ardhurat nga përpunimi bujqësoro-blegtoral në bashkinë e Durrësit

Nj.administrative / Degët e ekonomisë	Bujqësia	Blegtoria	Total
Sukthi	31474	15630	47104
Rashbulli	19843	10235	30078
Manza	17344	11560	28904
Katundi i Ri	9745	10448	20193
Ishmi	7430	8642	16072
Totali	85836	56515	142351

Burimi: Ministria e Bujqësisë, 2012

²⁵⁸ INSTAT(Instituti i Statistikave) -Buletini Statistikor 2014

²⁵⁹ Po aty.

²⁶⁰ Po aty.

Në bashkinë e Shijakut përpunohet vetëm një përqindje shumë e vogël e produkteve bujqësore dhe blegtorale. Në këtë bashki gjenden 4 ndërmarrje përpunuese të produkteve bujqësore (në njësinë administrative Xhafzotaj), 1 ndërmarrje përpunuese produkteve blegtorale në njësinë administrative të Shijakut dhe 1 ndërmarrje përpunuese e produkteve mikse, po në Shijak. Krahas ndërmarrjeve industriale përpunuese në dy bashkitë, gjenden edhe 538 ndërmarrje ndërtimi, në të cilën janë të punësuar rreth 1028 individë. Në këto ndërmarrje janë të punësuar persona, të cilët nuk kanë një nivel të lartë arsimor dhe që kanë kërkesa të ulta në nivelin e pagave.

IV.1.3.Sektori i tretë

Peshën më të madhe në ekonominë e bashkisë e Durrësit dhe të Shijakut e ka sektori i tretë, pjesë e të cilit janë 8 393 aktivitete ekonomike²⁶¹. Si degë të ekonomisë të këtij sektori njihen turizmi, transporti, tregtia dhe shërbimet. Secila prej tyre është plotësuese dhe zhvilluese e njëra-tjetrës. Sipas të dhënave të INSTAT-it (Institutit të Statistikave), rreth 3 546 aktivitete ekonomike janë tregtare, rreth 2075 aktivitete janë hotele dhe restorante, rreth 915 aktivitete i përkasin transportit dhe komunikacionit, 74 aktivitete janë arsimore, 210 aktivitete janë shëndetsore dhe 1 573 aktivitete të llojeve të tjera²⁶².

Gjatë 25-viteve të fundit prioritet ka pasur *dega e turizmit* dhe sidomos turizmi banlear (i detit, rërës dhe diellit). Turizmi banlear (blu) zhvillohet gjatë një periudhe të caktuar kohore, që fillon nga fillimi i muajit maj deri në fund të muajit shtator dhe kjo lidhet me temperaturën mbi 20⁰C, të ujit të detit Adriatik dhe temperaturën e ajrit e rërës në plazhe. Bashkia e Durrësit, duke qenë se ka një vijë të gjatë bregdetare rreth 61.8 kmdhe kryesisht bregdet të ulët (akumulativ), mundëson zhvillimin masiv të turizmit banlear. Ky lloj turizmi është i zhvilluar në plazhet e gjirit të Durrësit e të gjirit të Lalëzit. Mjaft të njohur janë plazhet e Shkëmbit të Kavajës, Durrësit, Currilave, Kallmit, Portezi, plazhi i Sektorit Rinia, i Rrushkullit, i Hamallës dhe plazhi i Shën Pjetrit. Krahas turizmit banlear përparësi është duke marrë ekoturizmi dhe gjeoturizmi, të cilët mbështeten në produktin natyror (resurset natyrore).

Ekoturizmi po zhvillohet më tepër në zonat rurale të bashkisë Durrës dhe Shijak, duke u mbështetur në fermat bujqësore-blegtorale dhe në produktet natyrore. Si rasti më tipik është qendra ekoturistike “Huqi”, e cila gjendet në njësinë administrative të Manzës (Bashkia Durrës).

Gjeoturizmi është një dukuri e re globale. Është pjesë e ekoturizmit dhe në thelb është “turizëm gjeologjik”. Ai bazohet dhe zhvillohet në gjeosite dhe gjeomonumente. Sipas përkufizimit të Newsome dhe Dowling, gjeoturizmi është një formë e turizmit natyror dhe specifikisht fokusohet në gjeologji dhe peizazh. Gjeoturizmi në Durrës dhe Shijak tërheq njerëz që duan të lidhen me tokës me qëllim njohjen dhe vlerësimin e saj²⁶³.Edukimi rreth strukturave gjeomorfologjike të relievit dhe interpretimi gjeologjik i depozitimeve në këtë zonë, janë një mënyrë e mirë për të krijuar kënaqësi dhe një eksperiencë të vërtetë gjeoturistike. Kuptimi i formës dhe pamjes gjeologjike të Kepit të Rodonit, përshkrimi i mënyrës dhe kohës së formimit të plazhit të Kallmit dhe Shën Pjetrit, janë elementët kryesor të interpretimit gjeoturistik. Kjo formë turizmi tërheq një spektër të gjerë turistësh, nga turistët me pak njohuri

²⁶¹ INSTAT(Instituti i Statistikave) -Buletini Statistikor 2014

²⁶² Po aty.

²⁶³ Braholli, E. (2015). *The management of Geosites in Durrës*. The 4-th International Multidisciplinary Conference on Integrating Science in Neë Global Challenges, ICTEA, Dubrovnik, Croatia, faqe 245-249.

gjeologjike e deri tek gjeo-specialistët dhe gjeo-ekspertët. Gjeoturizmi dhe turizmi në tërësi nuk mund të kuptohet dhe zhvillohet pa elementët si akomodimi dhe udhëtimi²⁶⁴.

Duke iu referuar të dhënave zyrtare në Qarkun e Durrësit, në territoret e bashkisë Durrës dhe Shijak gjenden 94 hotele, me rreth 2173 dhoma dhe kapacitet akomodues për rreth 4883 persona në një natë²⁶⁵. Rreth 82 % e hoteleve gjenden përgjatë bregdetit që nga Gjiri i Lalëzit deri tek Përroi i Agasit, ndërsa pjesa tjetër në akset kryesore rrugore që lidhin qytetin e Durrësit me Shijakun dhe Tiranën. Pjesa më e madhe e hoteleve (rreth 39% e tyre) janë të përqendruar në zonën nga Plepat deri tek Përroi i Agait. Në këtë sektor gjenden 37 hotele me 911 dhoma dhe 2274 shtretër. Zona e dytë me densitet të lartë të hoteleve është lagjia 13, Plazh (Durrës). Përgjatë vijës bregdetare Plepa-Porti i Durrësit gjenden 28 hotele (29%) me rreth 811 dhoma dhe 1622 shtretër. Duke krahasuar këto shifra dalim në përfundimin se në zonën e parë jo vetëm që gjenden më tepër hotele, por janë edhe të përmasave më të mëdha akomoduese.

Një zonë e tretë me përqëndrim të lartë hotelerie është sektori nga Porti i Durrësit deri në Plazhin e Kallmit. Në këtë zonë gjenden rreth 11 hotele (12% e tyre) me 178 dhoma dhe 389 shtretër. Kjo zonë, duke qenë se gjendet shumë afër qendrës urbane dhe historike të qytetit të Durrësit, akomodon turistë të të gjithë llojeve. Në hotelet e zonës Porti i Durrësit-Përroi i Agait akomodohen më tepër pushues që përfshihen të turizmin banlear, i cili është sezonal. Të gjithë hotelet ofrojnë edhe shërbim bari dhe restoranti jove të për akomoduesit, por edhe për turistë ditorë. Në tabelën e mëposhtme paraqitet shpërndarja hapësinore e hoteleve, numri i dhomave dhe numri i shtretërve.

Tabela 51. Shpërndarja hapësinore e hoteleve në territorin e Bashkisë Durrës dhe Shijak

Zona	Numri i hoteleve	Numri i dhomave	Numri i shtretërve	Pozicioni gjeografik
1	2	31	82	Gjiri i Lalëzit
2	28	811	1622	Lagjia 13, Plazh
3	37	911	2274	Shkëmbi i Kavajës
4	11	178	389	Lagjia 1, Taulantia
5	6	113	266	Rruga Interurbane Durrës-Tiranë
6	2	32	64	Lagjia 14, Shkozet
7	4	61	114	Rruga Interurbane Durrës-Ndroq
8	4	36	72	Rruga Interurbane Durrës-Shijak
Total	94	2173	4883	

Burimi: Qarku Durrës, Sektori i Projekteve dhe Politikave Sociale

Ajo çka e ndihmon edhe më tepër zhvillimin e turizmit është akomodimi familjar, çka e bën edhe më masiv zhvillimin e turizmit banlear dhe i jep përparësi formave të reja të tij. Si turistë konsiderohen edhe emigrantët që kthehen në vendin e lindjes për të

²⁶⁴ Po aty.

²⁶⁵ Qarku Durrës, Sektori i Projekteve dhe Politikave Sociale

qëndruar në banesat e tyre me qëndrim sezonal, pra, që nuk akomodohen në hotele, por në banesat e tyre. Në hartën e mëposhtme paraqitet shpërndarja hapësinore e hoteleve të lartpërmendura.



Harta 15. Shpërndarja hapësinore e hoteleve në bashkinë e Durrësit dhe të Shijakut

Punuar: Arc GIS 10.1, viti 2016

Transporti është një degë mjaft e zhvilluar në bashkinë Durrës dhe Shijak. Në hapësirën territoriale të bashkive të lartpërmendura janë të zhvilluar *transporti ujqor, rrugor dhe hekurudhor*, të cilët ndikohen dhe ndikojnë tek njëri-tjetri. Transporti ujqor ka rëndësi ndërkombëtare pasi bën lidhjen e komunikimin e territoreve të vendit tonë me shtetet bregdetare nga e gjithë bota. Transporti ujqor në bashkinë e Durrësit zhvillohet nëpërmjet Portit të Durrësit dhe Portit të Porto Romanos.

Porti i Durrësit është më i madhi në vendin tonë. Ai është krijuar fillimisht si një port natyror në veri të gjirit të Durrësit dhe ka funksionuar si i tillë, që në periudhat e hershme të qytetërimeve. Konsiderohet si një nga portet më të vjetër të Europës në detin Adriatik. Porti gjendet në një pozicion të përshtatshëm gjeografik, i mbrojtur nga erërat e veriut dhe me shelf bregdetar të përshtatshëm për një port.

Sipërfaqja tokësore e portit është 65 ha, kurse sipërfaqja ujore 67 ha²⁶⁶. Në Portin e Durrësit gjenden 11 kalata me gjatësi nga 30 deri në 400 milje detare dhe thellësi nga 7.1-9.9 m²⁶⁷. Kanali hyrës ka gjatësi 6755 m, thellësi 9.5 m dhe gjerësi 120 m²⁶⁸. Në hapësirën territoriale ujore të portit mund të akomodohen anije të përmasave dhe llojeve të ndryshme. Porti përbëhet nga 4 terminalë: terminali i trageteve, i kontenierëve, terminali lindor dhe perëndimor, në të cilat lëvizin udhëtarët, ngarkohen dhe shkarkohen mallra rifuzo apo në kontenier. Në total, në portin e Durrësit, për vitin 2014, janë ankoruar 1 702 tragete²⁶⁹. Po gjatë këtij viti, në terminalin e kontenierëve janë numëruar 165 anije me një volum prej 1 300 539 ton.




Foto 3 Porti i Durrësit

Në foton e mësipërme paraqitet organizimi i brendshëm i portit të Durrësit. Porti i Durrësit njihet edhe si pikënisje e Korridorit VIII në Ballkan. Afërsia me portin

²⁶⁶ www.apdum.al/res.co

²⁶⁷ Po aty.

²⁶⁸ Po aty.

²⁶⁹ Po aty.

e Barit (Itali) bën që ai të konkurojë në Ballkan portin e Barit (në Mal të Zi) dhe portin e Selanikut (në Greqi). Përmes Korridorit VIII, bëhet lidhja e tij me portet e Bullgarisë (Burgas dhe Varnas).

Prania e Portit të Durrësit, zhvillimi ekonomik dhe rritja e vendbanimeve urbane e rurale, në territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut, ka mundësuar rritjen dhe intensifikimin e rrjetit rrugor. Duke u bazuar në parametrat dhe funksionet që kanë rrugët njihen disa kategori: rrugë interurbane kryesore e dytësore, rrugë urbane kryesore e dytësore dhe rrugë lagjeje të paasfaltuara. Si rrugë interurbane kryesore njihet:

- Aksi Porti i Durrësit- mbikalimi i Kamzës, i cili kalon pranë qendrës urbane të Sukthite Maminasit dhe ka funksion lidhës të qytetit dhe portit të Durrësit me aeroportin e Rinasit dhe qytetin e Tiranës.
- aksi rrugor Përroi i Agait-Plepa- mbikalimi i Shkozetit, është pjesë e korridorit bregdetar, që do të lidhë jugun me veriun e vendit tonë.

Rrugët interurbane dytësore kanë funksione lidhëse të qytetit të Durrësit dhe Shijakut me qendrat urbane dhe rurale të tjera. Në rrugët interurbane dytësore bëjnë pjesë:

- aksi qyteti i Durrësit-Shkozet-Rrashbull-4 Rrugët-Shijak;
- aksi Maminas-Sukth-4 Rrugët-Pjezë;
- aksi Plepa-Romanat deri në Ndroq të Tiranës;
- aksi Sukth-Hamallaj;
- aksi Maminas-Manzë- gjiri i Lalëzit-Kepi i Rodonit;
- aksi Shkozet-Sektorin Rinia-Fllakë-Shinavlash.

Rrugët urbane kryesore dhe dytësore janë rrugët kryesore dhe midis lagjeve në qytetin e Durrësit, në qytetin e Shijakut, Sukthit dhe Manzës. Qyteti i Durrësit ka tri rrugë kryesore hyrëse për në qendër të tij:

- 1) rruga paralel me Portin e Durrësit;
- 2) rruga Ura e Dajlanit-qendër;
- 3) rruga e ish-Kënetës.

Qendrat urbane të tjera kanë vetëm nga një rrugë hyrëse duke qenë se kanë edhe shtrirje hapësinore më të vogël të tyre. Krahas rrugëve interurbane dhe urbane në hapësirën territoriale të dy bashkive ka rrjete të mëdha rruge, të paasfaltuara, të krijuara si rezultat i zhvillimit të zonave informale pranë qyteteve dhe zgjerimit të hapësirës së ndërtuar në qendrat rurale të bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut.

Të gjitha rrugët kanë funksione lidhëse dhe komunikuese për banorët e secilës prej bashkive dhe njësive administrative të tyre. Nëpërmjet rrjetit rrugor interurban, urban e informal dhe shërbimit shtetëror dhe privat të transportit, mundësohet lidhja dhe lëvizja e njerëzve, mallrave, ideve, për qëllime ekonomike e kulturore.

Forma tjetër e komunikimit është nëpërmjet rrjetit hekurudhor. Nga stacioni hekurudhor i qytetit të Durrësit fillojnë dy lidhja hekurudhore; një në drejtim të Tiranës e Shkodrës dhe tjetra me drejtim Vlorë e Pogradec. Mungesa e investimeve dhe shërbimi i ulët i ofruar në transportin hekurudhor, e ka penguar zhvillimin e këtij lloji transporti. Investimet në vitet e ardhshme do të riaktivizojnë funksionimin dhe fuqizimin e transportit hekurudhor.

Në 915-të aktivitete transportuese dhe komunikuese, që funksionojnë si pjesë e transportit ujqor, tokësor dhe hekurudhor, janë të punësuar rreth 3 854 persona, nga të cilët 1 950 janë të punësuar në privat dhe 1904 të punësuar në aktivitete shtetërore. Me zhvillimin e transportit është i lidhur edhe zhvillimi i tregtisë. Kjo degë e ekonomisë ka numrin më të lartë të ndërmarrjeve ekonomike (3 546 ndërmarrje), në

të cilën janë të punësuar rreth 4 284 individë²⁷⁰.


Shërbimet arsimore dhe shëndetsore përfaqësohen nga 284 aktivitete, në të cilat janë të punësuar rreth 4 934 individë, nga të cilët 888 janë të punësuar në privat dhe 4 046 të punësuar në shtet. Në shërbimet arsimore përfshihen çerdhet, kopshtet, shkollat 9-vjeçare, shkollat e mesme dhe Universiteti i Durrësit. Në shërbimet shëndetësore përfshihet spitali i Durrësit dhe i Shijakut, si dhe qendrat shëndetësore në qendrat urbane dhe rurale të secilës prej bashkive.

Rritja e veprimitarisë humane në funksion të zhvillimit ekonomik dhe social për banorët e zonës, ka ndikuar në ndryshimin dhe transformimin e hapësirave urbane dhe rurale të bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut.

IV.2.Ndikimi i zhvillimit human në urbanizim

Ndryshimet e numrit të popullsisë dhe zhvillimi ekonomik i evidentuar në bashkinë e Durrësit dhe të Shijakut, si dhe në njësitë administrative të tyre kanë ndikuar në ndryshimin e fizionominë e hapësirave urbane. Rritja e numrit të popullsisë, e ndikuar më së shumti nga lëvizjet hapësinore (ardhjet e individëve), ka ndikuar në shtrirjen hapësinore dhe në peizazhin urban të këtyre territoreve. Për të paraqitur në mënyrë hartografike ndryshimet, tek të dyja bashkitë, ishte i nevojshëm ndërtimi i hartave të hapësirave urbane për vitin 1982 dhe vitin 2015, nëpërmjet programit Arc Gis 10.1. Harta, ku pasqyrohet zona urbane e vitit 1982, u ndërtua mbi bazën e 12 hartave topografike të shkallës 1: 25 000, të krijuara nga Instituti Ushtarak Gjeografik, gjatë viteve 1982-1985. Në paraqitjen e hapësirave urbane të vitin 2015, u shfrytëzuan imazhet satelitore, nga Google Earth-i. Në dy hartat e mëposhtme paraqiten shtrirjet hapësinore të zonave urbane për vitet e lartpërmendura.

Harta 16 /17. Hapësirat urbane në territoret e bashkisë Durrës dhe Shijak, 2015 dhe 1982



Punuar: Arc Gis 10.1, 2016

²⁷⁰INSTAT(Instituti i Statistikave) -Buletini Statistikor 2014

Ndryshimet e shtrirjes hapësinore të zonës urbane janë mëse të dukshme. Në bazë të përlllogaritjeve matematikore, të cilat i mundëson programi Arc Gis 10.1, rezulton se gjatë vitin 1982, sipërfaqjat e ndërtuara urbane zinin një sipërfaqe prej 215 ha (ose rreth 0.5 % të sipërfaqes prej 430 km²). Hapësirat e ndërtuara gjendeshin në qytetin e Durrësit dhe të Shijakut. Deri në vitin 1982, zona e ndërtuar urbane e Durrësit shtrihej nga ura e Dajlanit në lindje deri në Currila në perëndim, nga Porti i Durrësit në jug deri në afërsi të Porto Romanos në veri. Qyteti i Shijakut, gjatë periudhës komuniste kishte shtrirje nga “4-Rrugët e Shijakut” e deri në afërsi të kodrave të ulta të këtij qyteti. Shtrirja e Shijakut ishte në të dyja anët e lumit Erzen. Të dyja zonat urbane kanë qenë të shtrirë pjesërisht në fushë (përkatësisht Durrësi në fushën e Spitallës dhe Shijaku në fushën e Shijakut) dhe pjesërisht në zonë kodrinore (qyteti i Durrësit, në Malin e Durrësit dhe Shijaku, rrëzë kodrave të Shijakut). Në vitin 2015 zona e ndërtuar urbane zë një sipërfaqe prej 1914 ha ose 4.5% të sipërfaqes. Vetëm në 31 vite ka ndodhur pothuajse një 9-fishim i sipërfaqes urbane. Më poshtë trajtohet evolucioni i zonave të ndërtuara urbane në të dyja bashkitë.

IV.2.1.Zona urbane Durrës

Sipas të dhënave të Censurit 2011, deri në vitin 1980, në qytetin e Durrësit kishte rreth 1906 ndërtime për qëllim banimi, ndërsa në qytetin e Shijakut kishte rreth 341 ndërtime. Gjatë kësaj periudhe 31-vjeçare (1982-2011), kanë ndodhur ndryshime të vazhdueshme, por me intensitet të ndryshëm nga njëri vit në tjetrin. Ndryshime të fizionomisë urbane u evidentuan më tepër mbas vitit 1990 si rezultat i lejimit të lëvizjes së lirë të njerëzve dhe hyrjes në fuqi të ligjit “7501”, për tokën. Qyteti i Durrësit dhe i Shijakut, të konsideruara si atraktive për banorët e zonave urbane apo rurale të tjera, janë populluar nga një numër i lartë banorësh.

Vetëm në qytetin e Durrësit, popullsia është dyfishuar nga 87 428 (1990)²⁷¹ në 210 897 banorë (2014), si rezultat i numrit të lartë të popullsisë së ardhur nga zonat rurale përreth, por edhe nga hapësirat territoriale të bashkive të tjera të Shqipërisë. Dendësia mesatare e popullsisë në qytetin e Durrësit është 12 406 b/ km². Popullsia e ardhur është vendosur si në brendësi të qytetit të vjetër të Durrësit, por edhe në zonat periurbane, në zonën e Plazhit, Shkozetit, ish-Kënetës dhe Porto Romanos. Pra, qyteti i Durrësit është shtrirë në drejtim të juglindjes, lindjes, verilindjes, veri dhe pjesërisht në pjesën perëndimore.

Në juglindje të qytetit të vjetër të Durrësit gjendet lagjia e Plazhit (nr.13), dikur një zonë turistike përgjatë bregdetit dhe bujqësore më në lindje, kurse tashmë plotësisht një lagje e konsoliduar e qytetit. Kjo lagje shtrihet deri në rrëzë të kodrave të Arapajt. Po në lindje të qytetit të vjetër të Durrësit, gjendet lagjia (nr. 14) e Shkozetit, dikur një zonë industriale. Në këtë hapësirë ka qenë e përqendruar industria e gomë-plastikës dhe e traktorëve. Në brendësi të kësaj hapësire gjendeshin vetëm dy ndërtime për qëllime banimi, për punonjësit e ardhur nga territore jashtë Durrësit.

Mbas vitit 1990, industria ndëpreu funksionin e saj. Hapësirat përreth dhe në brendësi të këtyre zonave u kthyen në truall ndërtimi. Ajo që mundësoi urbanizimin e kësaj zone ishte rruga interurbane që lidh Durrësin me qytetin e Shijakut dhe më tej me Tiranën.


Ndër lagjet me nivelin më të ulët të urbanizimit janë ish-Kënetë dhe Porto Romano, që gjenden në verilindje dhe në veri të Durrësit të vjetër. Problemet mjedisore (të tokës, ujit dhe ajrit) në këto zona, të trashëguara që para vitit 1990 dhe

²⁷¹ INSTAT (Instituti i Statistikave) -Buletini Statistikor 1991

mbizotërimi i informalitetit gjatë krijimit të këtyre lagjeve, ka ngadalësuar procesin e integritit urban. Lartësia e vogël mbi nivelin e detit, cilësitë e ulëta fiziko-kimike dhe ndotja e tokës në zonën e Porto Romanos prej industrisë së pesticideve, kanë krijuar probleme dhe vështirësi në jetën e banorëve të ardhur e të vendosur në këto lagje. E gjithë zona e ish-Kënetës dhe një pjesë e Porto Romanos, deri në vitin 1965 ishte e mbuluar me ujë, në formën e një kënete. Bonifikimi i saj në këto vite, nëpërmjet krijimit të kanaleve kulluese dhe derdhjes së ujit në detin Ardiatik me anë të motorpompave, bëri të mundur kthimin e saj në tokë për qëllime bujqësore. Sasia e madhe e përmbajtjes së kripës nuk mundësoi zhvillimin e bujqësisë, por përdorimin e saj si truall ndërtimi mbas vitit 1990.

Aktualisht, në njësinë administrative të Durrësit gjenden 18 623 ndërtime për qëllime banimi, ku pjesa më e madhe është ndërtuar në periudhën 1991-2000, e lidhur kjo edhe me numrin më të madh të ardhjeve të popullsisë në këtë periudhë kohore. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet numri i ndërtimeve sipas periudhës kohore të ndërtimit në njësinë administrative Durrës.

Grafiku 39. Periudha e ndërtimit të ndërtesave për qëllime banimi në njësinë administrative Durrës



Burimi: INSTAT, Census 2011

Nga të dhënat e Censurit të vitit 2011, në qytetin e Durrësit, deri në vitin 1990 kishte rreth 2 774 ndërtime për qëllime banimi, ndërsa mbas vitit 1990 janë ndërtuar rreth 10 678 ndërtime, pavarësisht se 5 182 ndërtimeve nuk u është deklaruar periudha e ndërtimit. Pavarësisht paqartësisë së informacionit, evident është fakti që mbas vitit 1990 numri i ndërtimeve është 5-fishuar. Sipas deklarimeve zyrtare gjatë periudhës 1991-2000 janë ndërtuar 6 009 ndërtime, gjatë periudhës 2001-2005 janë ndërtuar 2911 ndërtime dhe në periudhën më të fundit 2006-2011 vetëm 1 758 ndërtime²⁷².

Rënia e numrit të ndërtimeve, për 5 vitet e fundit (vitet 2006-2011) lidhet me stabilizimin e lëvizjeve hapësinore të popullsisë, si dhe me vështirësitë ekonomike të ndikuara nga kriza ekonomike botërore e vitit 2008. Ndërtimet e reja janë ndërtuar në zonat e lartpërmendura (Plazh, Shkozë, Kënetë dhe Porto Romano), nga të cilat: 75% e tyre (14 442 ndërtime) janë shtëpi individuale, 9.4% (1746 ndërtime) janë

²⁷² INSTAT(Instituti i Statistikave) -Censusi 2011

shtëpi pjesërisht të veçuara dhe 4.5% (1 595 ndërtime) janë shtëpi në rend²⁷³. Shtëpitë private (individuale, pjesërisht të veçuara dhe në rend) zakonisht janë të rrethuara me mure, me oborre para ndërtesës dhe kopshte ku kultivohen pemë të ndryshme (fruta, agrume, ullinj) si dhe perime. Bujqësia që zhvillohet në këto kopshte të vogla private, plotëson vetëm nevojat familjare.

Krahas tyre, rreth 11 % ose 1 595 ndërtime²⁷⁴ janë apartamente pallati, të cilat janë përqëndruar në brendësi të qytetit të vjetër të Durrësit, si dhe përgjatë bregdetit në lagjen e Plazhit. Pjesa më e madhe e tyre janë ndërtuar për qëllime banimi, por edhe në funksion të zhvillimit të turizmit. Rreth 14 343 (76 %) e ndërtimeve janë njëkatëshe, 2 275 (ose 12%) e ndërtimeve janë dykatëshe, 732 (ose 3%) janë ndërtime 3-4 katëshe dhe 1193 (ose 6%) janë ndërtime mbi 4- katëshe²⁷⁵. Duke qenë se pjesa më e madhe e tyre janë njëkatëshe, dalim në përfundimin se gjithnjë e më shumë po konsumohet sipërfaqe më e madhe e tokës bujqësore, për truall ndërtimi.

Në 18 634 ndërtime gjenden rreth 51 650 banesa, nga të cilat 30 375 (58%) konsiderohen si banesa të banuara nga persona me vendbanim të zakonshëm, 9 616 banesa (22%) të destinuara për qëllime dytësore apo sezonale dhe rreth 11 659 (ose 20 %) banesa të pabanuara²⁷⁶. Sipas këtyre të dhënave kuptojmë se gjysma e banesave që gjenden në qytetin e Durrësit janë përkohësisht apo plotësisht të papërdorshme. Ato mund të përdoren përkohësisht gjatë periudhës së verës, për qëllime turistike, si shtëpi dytësore ose janë të papërdorshme duke qenë se familjet janë emigrantë ndërkombëtarë. Në bashkinë e Durrësit janë të shumta ndërtimet, të cilat janë pjesërisht të ndërtuara dhe që kanë konsumuar sipërfaqe të mëdha toke bujqësore.

IV.2.2. Zona urbane Shijak

Qyteti i Shijakut, pavarësisht se shtrihet në një sipërfaqe hapësinore më të vogël se qyteti i Durrësit, transformimet urbane janë të pranishme dhe të dukshme. Faktori kryesor i zgjerimit të hapësirës urbane është shtimi i numrit të popullsisë si rezultat i ardhjes së popullsisë dhe sigurisht, nga shtesa natyrore pozitive e popullsisë. Qyteti i Shijakut përbëhet nga tri lagje kryesore: lagjja Erzen, lagjja Popullore dhe lagjja Kodër²⁷⁷. Për të paraqitur ndryshimin e numrit të popullsisë mjafton të krahasojmë vitin 1995 dhe vitin 2014. Sipas të dhënave të zyrës së INSTAT-it, pranë prefekturës së Durrësit, në vitin 1995 numri i popullsisë ishte 11 408 banorë, ndërsa në vitin 2014 numri i popullsisë është 13 231 banorë²⁷⁸. Rritja e popullsisë me 1 823 banorë ka sjellë një dendësi të lartë të popullsisë, në rreth 3 308 b/ km². Rritja e popullsisë së qytetit të Shijakut është shoqëruar edhe me shtim të vendbanimeve apo ndërtesave dhe njëkohësisht, të zhvillimit të infrastrukturës fizike. Deri në vitin 1981 në qytetin e Shijakut kishte rreth 341 ndërtime, ndërsa deri në vitin 1990 rreth 456 ndërtime²⁷⁹. Në periudhën 1991-2011 janë ndërtuar rreth 671 ndërtime të reja, ku më shumë se gjysma e tyre janë ndërtuar në 10-vjeçarën e parë. Brenda periudhës 1981-2011 numri i ndërtimeve është dyfishuar. Mbas vitit 2000, si rezultat i stabilizimit të lëvizjeve, por edhe mungesës së të ardhurave monetare, kryesisht remitanca (dërgesat e emigrantëve), është ngadalësuar apo ndërprerë ndërtimi i vendbanimeve

²⁷³ Po aty.

²⁷⁴ INSTAT(Instituti i Statistikave) -Censusi 2011.

²⁷⁵ Po aty.

²⁷⁶ Po aty.


²⁷⁷ Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim, (2014). *Zonë Funktionale Shijak*. Tiranë, faqe 35-36.

²⁷⁸ INSTAT(Instituti i Statistikave) –Buletini Statistikor i rrethit Durrës 1995 dhe 2015

²⁷⁹ INSTAT(Instituti i Statistikave) -Censusi 2011

të reja. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet numri i ndërtimeve në qytetin e Shijakut për periudha të ndryshme kohore.

Grafiku 40. Periudha e ndërtimit të ndërtesave për qëllime banimi në njësinë administrative Shijak



Burimi: INSTAT, Census 2011

Grafiku i mësipërm paraqet periudhën e ndërtimeve në qytetin e Shijakut. Numri total i ndërtimeve për qëllime banimi në këtë qytet është 1 617²⁸⁰. Po sipas Censurit të vitit 2011, në qytetin e Shijakut gjenden 1 158 shtëpi individuale (72%), 317 shtëpi pjesërisht të veçuara (20 %), 75 ndërtime në rend (5 %) dhe 67 pallate (3%). Rreth 77% ose 1 239 ndërtime janë njëkatëshe, kryesisht shtëpi private, me oborre dhe kopshte²⁸¹. Shtëpitë me dy kate zënë vetëm 17% të ndërtimeve ose 282 të tilla, shtëpitë me 3 deri në 5 kate zënë vetëm 5 % dhe shtëpitë mbi 6 kate vetëm 1% të ndërtimeve. Nga këto të dhëna kuptojmë se qyteti i Shijakut ka më tepër një shtrirje horizontale sesa vertikale. Në ndërtimet e qytetit të Shijakut gjenden 2 672 banesa, ku rreth 2 003 banesa janë të banuara nga persona me vendbanim të përhershëm, 41 banesa të destinuara për qëllim sezonal (dytësor) dhe rreth 615 banesa të pabanuara²⁸².

Pjesë e zonave urbane të territoreve të bashkisë Durrës dhe Shijak janë edhe sipërfaqet urbane në njësinë administrative të Sukthit dhe të Rrashbullit. Qendër Sukthi konsiderohet si qendër sekondare urbane plotësuese e shërbimeve dhe produkteve bujqësore për qytetin e Durrësit dhe të Shijakut.

Zona urbane e Rrashbullit është krijuar si rezultat i pozicionit gjeografik ndërmjetës midis qytetit të Durrësit dhe qytetit të Shijakut. Kjo zonë urbane shtrihet përgjatë rrugës interurbane kryesore Durrës-Shijak. Si rezultat i zhvillimit të ndërtimitarisë dhe infrastrukturës fizike, sipërfaqet urbane në territoret e bashkisë Durrës dhe Shijak arrijnë deri në 19.14 km².

IV.2.3.Ndryshimi i hapësirave rurale

Në territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut, hapësirat rurale zënë rreth 90% të sipërfaqes. Si hapësira rurale të bashkisë Durrës konsiderohen njësitë administrative Rrashbull, Katundi i Ri, Manzë (duke përfshirë qytezën e Manzës), Sukthi (duke përfshirë Sukthin qendër) dhe Ishmin. Në bashkinë e Shijakut, hapësirat rurale gjenden në njësitë administrative të Xhafzotajt, Gjepalajt dhe Maminasit. Sipas organizimit të ri administrativo-territorial, hapësirat rurale janë të

²⁸⁰INSTAT(Instituti i Statistikave) -Censusi 2011

²⁸¹Po aty.

²⁸²Po aty.

organizuara në fshatra. Në bashkinë e Durrësit gjenden 39 fshatra, ndërsa në bashkinë e Shijakut gjenden 25 fshatra, ku pjesa më e madhe e tyre konsiderohen fshatra kodrinorë.

Në bazë të lartësisë mbi nivelin e detit, fshatrat e bashkisë Durrës dhe Shijak i ndajmë në fshatra fushorë dhe fshatra kodrinorë. Si fshatra fushorë konsiderohen *Hamallaj, Sektor Hamallaj, Armathi, Shkalla, Hidrovori, Rushkull, Erzen, Adriatik, Perlat, Kulla, Shkallnur, Vadardha, Borçi, Juba, Fllaka, Sukthi fshat, Rinia, Bisht Kamëz, Qerreti, Katundi i Ri, Gjuzaj, Rreth, Pjezë, Xhafzotaj, Maminas dhe Hardhishtë.*

Si fshatra kodrinorë konsiderohen: *Shetaj, Draçi, Biza, Likmetaj, Kërtushaj, Gjericaj, Lalzi, Kuratni, Kapitanaj, Manza, Kameronas, Rada, Bilalas, Karreç, Vlashaj, Karpen, Metallaj, Koxhas, Sallmone, Borakaj, Shahinaj, Likesh, Shtrazë, Kënetë, Sheteli, Gjepalaj, Eminas, Çizmeli, Gjuzaj, Romanat, Bozanhije, Maskuri, Shkallnur, Arapaj, Rrashbull, Shinavlash dhe Vllazërimi.* Fshatrat fushorë kanë shtrirje më të madhe hapësinore krahasuar me fshatrat kodrinorë.

Në tabelën e mëposhtme jepen fshatrat në secilën njësi administrative të bashkisë Durrës dhe Shijak.

Tabela 52. Qendrat rurale (fshatrat) sipas njësive administrative në bashkinë e Durrësit dhe të Shijakut

Bashkia	Njësia administrative	Hapësirat rurale (fshatrat)
Durrës	Durrës	-
	Sukth	Hamallaj, Kullë, Perlat, Vadardhë, Rrushkull, Hidrovori.
	Manzë	Armath, Borç, Hamallaj, Kameronas, Radë, Shkallë, Fshati Manëz.
	Rashbull	Rrashbull, Arapaj, Shënavlash, Shkallnur, Manskuri, Romanat, Bozanhije, Xhafzotaj.
	Katund i Ri	Katundi i Ri, Jubë, Qerret, Fllakë, Bisht-Kamëz, Rinia, Erzen, Sukth, Adriatik.
	Ishëm	Likmetaj, Kërtushaj, Kapidanaj, Gjericaj, Lalëz, Kuraten, Bizë, Draç, Shetaj.
Shijak	Shijak	-
	Maminas	Maminas, Karreç, Vlashaj, Karpen, Bodinak, Metallë, Bilalas, Rubjekë.
	Gjepalaj	Gjepalaj, Hardhishtë, Çizmeli, Eminas i Vogël, Likesh, Kënetë, Shtrazë, Shahinaj, Shetël.
	Xhafzotaj	Xhafzotaj, Pjezë, Rreth, Sallmone, Koxhas, Borake, Guzaj, Vllazërimi.


Burimi: Ligji i ndarjes territoriale- Fletorja Zyrtare

Karakteristikë e zonave rurale është prania e vendbanimeve të vogla rurale (zonave të ndërtuara rurale) dhe prania e sipërfaqeve të mëdha bujqësore. Vendbanimet rurale të këtyre bashkive kanë forma të ndryshme, por karakteristike është krijimi i tyre përgjatë rrugëve interurbane kryesore dhe dytësore. Kështu, përgjatë rrugës Maminas – Gjiri i Lalëzit janë krijuar vendbanimet rurale si:

Maminas, Bilalas, Rubjekë, Radë, Kameronas, Manzë, Shkallë, Armath, Hamallaj. Këto fshatra shtrihen pjesërisht në shpatin perëndimor të vargut kodrinor Rodon-Prezë dhe pjesërisht në fushën e Durrësit. Përgjatë rrugës Sukth-Shijak-Romanat gjenden fshatrat: Koxhas, Sallmone, Gjuzaj, Rreth, Pjezë, Hardhishtë, Maskuri dhe Romanat, të cilët shtrihen në kodrat e ulta. Këto fshatra konsiderohen lineare pasi shtrihen përgjatë rrjetit rrugor. Krahas tyre ka edhe fshatra të grumbulluara, ku shtëpitë vendosen ngjitur njëra me tjetrën dhe të grumbulluara pa një rregull të caktuar në një hapësirë të dhënë. Në shumë raste rrugët rrethojnë ose ndërfiten në formë të çrregullt midis ndërtesave, të ndërtuara për qëllime banimi ose ekonomike. Fshatrat Gjericaj, Kapedanaj, Kërtushaj dhe Likmetaj gjenden në shpatin lindor të vargut kodrinor Rodon-Prezë, përgjatë rrjedhjes së poshtme të lumit Ishëm. Këto fshatra konsiderohen fshatra të vegjël, të cilët kanë më tepër lidhje me zonat rurale të Krujës, pasi vargu kodrinor i lartpërmendur përbën një barrierë natyrore në komunikimin me qendrën e bashkisë Durrës.

Në hartën e mëposhtme paraqitet vendndodhja e qendrave rurale në dy bashkitë, të Durrësit dhe të Shijakut.


Harta 18. Qendrat rurale në territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut në vitin 2015



Punuar: Arc GIS 10.1, viti 2016

Në hartën e mëposhtme paraqitet shtrirja hapësinore e zonave të ndërtuara rurale në bashkinë e Durrësit dhe të Shijakut gjatë vitit 1982 dhe në vitin 2015.

Harta 19 / 20. Vendbanimet rurale në territoret e bashkisë Durrës dhe Shijak, 1982 dhe 2015



Punuar: Arc GIS 10.1


Vendbanimet konsiderohen të përhershme (sipas kohës së qëndrimit të njerëzve) dhe vendbanime mesatarisht ose plotësisht të përqendruara (sipas formës së tyre). Duke qenë se edhe në territoret rurale, në këto vitet e fundit, janë shtuar sipërfaqet e vendbanimeve kundrejt tokës bujqësore, ato i kanë ndryshuar fizionominë (formën e përgjithshme në plan apo hapësirë) zonës rurale. Ajo që vihet re është rritja e shtrirjes hapësinore të vendbanimeve rurale tek njësitë administrative Rrashbull, Katund i Ri, Sukth, Manzë, Ishëm, Maminas, Xhafzotaj dhe Gjepalaj.

Ndryshimet më të mëdha hapësinore i ka njësi administrative e Rrashbullit, në të cilën deri në vitin 1990 kishte rreth 1 090 ndërtime, ndërsa në periudhën 1990-2011 janë ndërtuar rreth 4 647 ndërtime, pavarësisht faktit që rreth 714 ndërtimeve nuk i dihet periudha e ndërtimit të tyre²⁸³. Duke parë periudhën e ndërtimit të tyre kuptojmë se ndërtimet kanë vazhduar gjatë gjithë periudhës 20-vjeçare.

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet numri i ndërtimeve në këtë njësi administrative, për periudha të ndryshme kohore.

²⁸³ INSTAT (Instituti i Statistikave) - Censuri 2011

Grafiku 41. Periudha e ndërtimit të ndërtesave për qëllime banimi në njësinë administrative Rrashbull




Burimi: INSTAT, Census 2011

Pjesa më e madhe e ndërtimeve në njësinë administrative të Rrashbullit gjenden përgjatë vijës bregdetare dhe janë të llojit pallate(fshati Arapaj), por edhe në fshatin Rrashbull dhe Shënnavlash. Intensiteti i lartë i ndërtimeve lidhet edhe me pozicionin më të afërt të tyre me qytetin e Durrësit dhe praninë e infrastrukturës bazë, si dhe shërbimeve më lehtë të disponueshme.

Njësia administrative e Sukthit renditet menjëherë mbas Rrashbullit për numrit e ndërtimeve për qëllime banimi. Brenda hapësirës territoriale të saj prej 49 km² gjenden rreth 3 643 ndërtime, nga të cilat vetëm 389 kanë qenë të ndërtuara para vitit 1990. Mbas këtij viti në këto hapësira janë ndërtuar rreth 2 442 ndërtime, pavarësisht se 814 ndërtimeve nuk u dihet periudha e ndërtimit²⁸⁴. Ndërtimet janë të përqendruara në afërsi të qytetit të Sukthit, në sektorin Hamallaj dhe në Rrushkull. Për t'u theksuar është ndërtimit i një kompleksi vilash në afërsi të bregdetit, në gjirin e Lalëzit. Infrastruktura rrugore e ndërtuar dhe kushtet natyrore të përshtatshme kanë ndikuar në zgjerimin e vendbanimeve rurale.

Grafiku 42. Periudha e ndërtimit të ndërtesave për qëllime banimi në njësinë administrative Sukth




Burimi: INSTAT, Census 2011

²⁸⁴INSTAT(Instituti i Statistikave) -Censusi 2011

Në njësinë administrative të Manzës numri i ndërtimeve është 1645, më i ulët krahasuar me të gjitha njësitë administrative të bashkisë Durrës. Deri në vitin 1990 në Manzhë kishte 511 ndërtime, ndërsa në periudhën 1990-2011 janë ndërtuar 680 të tilla, në fshatrat Radë, Kamas, Manzhë, Shkallë, Armathë dhe Hamallaj²⁸⁵.


Grafiku 43. Periudha e ndërtimit të ndërtesave për qëllime banimi në njësinë administrative Manzhë



Burimi: INSTAT, Census 2011

Në njësinë administrative të Katundit të Ri gjenden 2 562 ndërtime, nga të cilat rreth 1 391 janë ndërtuar gjatë periudhës 1990-2011. Rreth 711 ndërtime nuk dihen kur janë ndërtuar dhe 460 kanë qenë të ndërtuara para vitit 1990.

Grafiku 44. Periudha e ndërtimit të ndërtesave për qëllime banimi në njësinë administrative Katund i Ri




Burimi: INSTAT, Census 2011

Ishmi është njësi administrative më e largët e bashkisë së Durrësit. Gjendet pothuajse tërësisht në një relief kodrinor. Pavarësisht terrenit kodrinor dhe

²⁸⁵INSTAT(Instituti i Statistikave) -Censusi 2011

vështirësive në infrastrukturë në këtë hapësirë territoriale gjenden rreth 1 811 ndërtime, nga të cilat 536 janë ndërtuar para vitit 1990, 592 ndërtime nuk dihen kur janë ndërtuar dhe 683 janë ndërtuar mbas vitit 1990 deri në 2011²⁸⁶.


Grafiku 45. Periudha e ndërtimit të ndërtesave për qëllime banimi në njësinë administrative Ishëm



Burimi: INSTAT, Census 2011

Në bashkinë e Shijakut gjendet tri njësi administrative, të cilat konsiderohen si zona rurale. Në njësinë administrative të Maminasit, që përfshin fshatrat Rubjekë, Bilalas, Karreç, Vlashaj, Maminas, Karpen, Metallaj dhe Bodinakë, gjenden rreth 1 456 ndërtime, nga të cilat 499 ndërtime janë ndërtuar para vitit 1990 dhe 671 ndërtime të periudhës 1990-2011.

Grafiku 46. Periudha e ndërtimit të ndërtesave për qëllime banimi në njësinë administrative Maminas




Burimi: INSTAT, Census 2011

²⁸⁶INSTAT(Instituti i Statistikave) -Censusi 2011

Njësia administrative Gjepalaj ka numrin më të ulët të ndërtimeve (1 038) në të gjithë bashkinë e Shijakut. Para vitit 1990, në këto territore ishin ndërtuar 380 ndërtime, ndërsa pas vitit 1990 rreth 356 ndërtime (302 ndërtime nuk dihen në çfarë periudhe janë ndërtuar)²⁸⁷.


Grafiku 47. Periudha e ndërtimit të ndërtesave për qëllime banimi në njësinë administrative Gjepalaj



Burimi: INSTAT, Census 2011

Në njësinë administrative të Xhafzotajt janë ndërtuar më shumë ndërtime (3 654), madje edhe krahasuar me qytetin e Shijakut. Duke qenë se Xhafzotaj gjendet në një terren kryesisht fushor, përgjatë rrugës Shijak-Sukth, është bërë e mundur ndërtimi i pjesës më të madhe të ndërtimeve. Deri në vitin 1990 në këto territore kishte 856 ndërtime, ndërsa pas vitit 1990 aty janë ndërtuar më tepër se 1 735 ndërtime²⁸⁸. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet koha e ndërtimit në këtë njësi administrative.

Grafiku 48. Periudha e ndërtimit të ndërtesave për qëllime banimi në njësinë administrative Xhafzotaj



Burimi: INSTAT, Census 2011

²⁸⁷INSTAT(Instituti i Statistikave) -Censusi 2011

²⁸⁸INSTAT(Instituti i Statistikave) -Censusi 2011

Një element i rëndësishëm i peizazhit rural është aspekti i jashtëm i banesave. Në përgjithësi, të gjitha banesat, të cilat i përkasin një periudhe më të madhe se 50-vjeçare, janë njëkatëshe dhe me çati tjegullash. Këto banesa janë të ndërtuara me tulla (zjarrduruese) ose me gurë. Banesat e ndërtuara në 25 vitet e fundit mund të jenë me një, dy ose tri kate. Rreth 80% e ndërtesave janë një dhe dykatëshe dhe me sipërfaqe më të madhe se 100 m². Si materiale bazë për ndërtimin e tyre është përdorur blloku ose tulla dhe shumë pak guri (duke qenë se mungon në këtë zonë). Si rregull, banesat me dy ose tri kate janë me çati. Shtëpitë mund të jenë individuale, pjesërisht të veçuara, në rend apo dhe pallate.

Në bashkinë e Durrësit rreth 88% e ndërtimeve, të zonave rurale, janë shtëpi individuale, 6.2 % e ndërtimeve janë shtëpi pjesërisht të veçuara, 3.2 % janë ndërtime në rend dhe vetëm 2.6% të ndërtimeve janë pallate. Në bashkinë e Shijakut rreth 89% e ndërtimeve janë 1-katëshe, 8% e ndërtimeve janë 2-katëshe, 1.7% janë 3-5 kate dhe vetëm 1.3% e ndërtimeve janë mbi 6- kate. Edhe në zonat rurale vendbanimet janë të zhvilluara horizontalisht (në plan) dhe shumë pak vertikalisht (me kate).


Zhvillimet urbane dhe rurale të lartpërmendura kanë ndikuar në ndryshimin e përdorimit të tokës. Nëpërmjet krijimit të hartave, të shkallës 1: 150 000, për vitet 1982 dhe vitin 2015, evidentohen ndryshimet e përdorimit të tokës në bashkinë e Durrësit dhe të Shijakut. Në hartat e mëposhtme paraqitet ndryshimi i përdorimit të tokës nga viti 1982 në vitin 2015.

Harta nr.21.Harta e përdorimit të tokës në bashkinë e Durrësit dhe të Shijakut, në vitin 1982



Punuar: Arc GIS 10.1

Harta nr.22. Harta e përdorimit të tokës në bashkinë e Durrësit dhe të Shijakut, në vitin 2015



Punuar: Arc GIS 10.1

Tabela Nr. 53.Ndryshimi i përdorimit të tokës nga viti 19820 në vitin2015

Nr. Kategoritë	Niveli I	Sipërfaqet në 1982	Përqindja	Sipërfaqet në 2015	Përqindja
1	Zona urbane dhe e ndërtuar	961	2.2 %	5 800	13.4 %
2	Toka agrokulturore	28 966	67 %	26 186	60.6 %
3	Tokat me kullota dhe me shkurre	2 227	5.1 %	3430.67	8.3 %
4	Tokat me pyje	9 168	21.2 %	5832.94	13.5 %
5	Sipërfaqet ujore (Ujërat)	603	1.3 %	603	1.3 %
6	Tokat e lagura	729	1.5 %	729	1.5 %
7	Tokat joproductive	883	1.7 %	664	1.4 %

Burimi: Arc GIS 10.1

Ndryshimet e përdorimit të tokës pasqyrohen edhe në tabelën e mësipërme. Sipas rezultateve të përfituara nga programi Arc GIS 10.1, sipërfaqet urbane dhe të ndërtuara janë 6-fishuar, ndërsa sipërfaqet e tokës me kullota dhe shkurre janë rritur me 3.2%. Sipërfaqet ujore dhe tokat e lagura nuk kanë pësuar ndryshime të dukshme. Sipërfaqet agrokulturore, tokat me pyje dhe tokat produktive janë zvogëluar në këtë periudhë 33-vjeçare. Humbjet më të mëdha i ka toka pyjore, deri në 7.7% të sipërfaqes së saj. Ulja e sipërfaqeve pyjore është shkaktuar nga mungesa e mirëmenaxhimit të fondit të pyjeve.Humbjet të mëdha ka edhe toka agrokulturore, në rreth 6.4 % e tyre. Kjo sipërfaqe toke bujqësore është kthyer në truall ndërtimi, për vendbanime dhe në zhvillim të aktiviteteve ekonomike. Rënia e sipërfaqeve të tokave joproductive me 0.3% lidhet me përdorimin e sipërfaqeve të plazheve përgjatë gjirit të Durrësit në truall ndërtimi. Transformimet urbane dhe rurale që kanë shoqëruar dy bashkitë janë shoqëruar me probleme mjedisore, të cilat do të ndikojnë negativisht në sasinë dhe cilësinë e resurseve natyrore si dhe në jetën e njeriut.

IV.3. Dëmtimi i mjedisit tokësor, ujqor dhe të ajrit

IV.3.1. Dëmtimi i tokës

Përdorimet intensive dhe të vazhdueshme të tokës në hapësirën territoriale të bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut, kanë ndikuar në dëmtimin apo degradimin fizik, kimik dhe biologjik të saj.Degradimi i tokës nënkupton humben e produktivitetit biologjik dhe ekonomik të saj, shkaktuar nga kushtet natyrore ose nga aktivitetet njerëzore²⁸⁹.

Me degradim fizik kuptojmë humbjen fizike të tokës nga erozioni dhe rrëshqitjet, ngjeshja e tokës, humbja e vegjetacionit dhe humbja e biodiversitetit.

Degradimi kimik është rritja e vlerave të aciditetit, kripëzimit, ndotjes kimike dhe humbja e pjellorisë së tokës. Për të përcaktuar shkallën e degradimit kimik kërkohen monitorime të vazhdueshme të tokës.

²⁸⁹Co-PLAN, Revista Periodike Shkencore. *Habitat* 1. Online, faqe 102

Degradimi biologjik ka të bëjë me humbjen e funksioneve biologjike të tokës dhe kjo shkaktohet kryesisht gjatë periudhave të ndryshimeve klimatike, përmytjeve etj.

Degradimi i tokës konsiderohet si një rrezik me natyrë të pakthyeshme ose të kthyeshme. Në grupin e dëmtuesve të pakthyeshëm bëjnë pjesë: humbja e tokës nëpërmjet betonizimit, minierave dhe erozionit, acidifikimi i avancuar dhe ngjeshja shumë e thellë e tokës. Në rreziqet e kthyeshme bëjnë pjesë ato dëmtues që kanë një ndikim të ulët dhe të riparueshëm në mjedis. Në këtë grup futen ngjeshja e tokës nga komponimet organike të biodegradueshme, e cila shkatëron strukturën e sipërfaqes së tokës. Si dëmtues të tokës në bashkinë e Durrësit dhe të Shijakut vlerësohen urbanizimi dhe industrializimi, ndotja (urbane dhe industriale), erozioni, humbja e lëndës organike, humbja e biodiversitetit, kripëzimi, alkaliniteti, përmytjet dhe rrëshqitjet.

Urbanizimi dhe industrializimi ndikon në humbjen e sipërfaqes faktike të tokës agrokulturore dhe në humbjen e funksioneve kryesore të saj. Në tridhjetë e tre vitet e fundit, si rezultati i shtimit të sipërfaqeve të ndërtuara urbane dhe industriale, nga 215 ha në 1 914 ha, ka një humbje prej 1699 ha të tokës agrokulturore. Këto sipërfaqe toke të kthyera në truall ndërtimi gjenden në periferi të qytetit të Durrësit, Shijakut, Sukthit dhe pothuajse në të gjitha qendrat rurale të secilës bashki. Humbjet më të mëdha të tokës janë pjesët periferike të qytetit të Durrësit si në: Porto Romano, Kënetë, Shkozë, Plazh deri në Rrashbull. Kjo sipërfaqe toke konsiderohet si tokë e dëmtuar dhe e pakthyeshme.

Zgjerimi i zonave urbane dhe industriale ka ndikuar në shtimin e mbetjeve urbane dhe industriale. Mbetjet urbane janë më të mëdha në qendrat urbane ku ka përqëndrim më të madh të popullsisë, si në qytetin e Durrësit, në Rrashbull, Sukth, Xhafzotaj dhe Shijak. Mbetjet urbane janë të përqëndruara në qendrat e grumbullimit në Porto Romano dhe vetëm 1 km nga qyteti i Shijakut. Këto mbetje janë në gjendje të papërpunuar dhe nuk ekziston ndonjë landfill në përpunimin e tyre. Në bashkinë e Durrësit prodhohen rreth 219 202 ton mbetje çdo ditë²⁹⁰. Mbetjet urbane janë një problem edhe më i gjerë në hapësirën gjeografike të bashkisë së Durrësit. Sipas të dhënave të Ministrisë së Mjedisit, sasia mesatare e mbetjeve urbane është 0.72 ton / banor në vit. Për numrin e popullsisë së zonës llogaritet që zona e Shkozëtit të ketë rreth 19633 ton/ vit. Në bashkinë Shijak prodhohen rreth 30 ton mbetje çdo ditë, të cilat mund të jenë mbetje inerte, mbetje industriale dhe bimore²⁹¹.

Ndotja e tokës shkaktohet nga *ndotja industriale* e trashëguar dhe ndotësit industrialë aktualë. Si zona me ndotje fizike, kimike dhe biologjike të tokës vlerësohen zona përreth ish-industrisë kimike në Porto Romano, zona brenda ish-zonës industriale të Shkozëtit dhe zona rreth minierës së Manzës. Në afërsi të uzinës së pesticideve në Porto Romano gjenden ndotje me burime të zhivës²⁹². Zona ish-industriale e Shkozëtit është e ndotur nga mbetjet urbane dhe mbetjet industriale. Vetëm në 3-4 km rrugë janë rreth 8 pika karburanti²⁹³. Afërsia me banesat është një rezik i madh dhe i vazhdueshëm. Ndotja e tokës përreth minierës së Manzës është shkaktuar nga sterilet e nxjerra nga nëntoka dhe të depozituara në sipërfaqe. Gjatë të gjithë periudhës së përdorimit të minierës janë nxjerrë rreth 183 000 m³

²⁹⁰ Llogaritje në bazë të numrit të popullsisë.

²⁹¹ Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim, (2014). *Zonë Funktionale Shijak*. Tiranë, faqe 35-36.

²⁹² Co-PLAN, Revista Periodike Shkencore. *Habitat 1*. Online, faqe 206.

²⁹³ Braholli, E. (2015). *Problemet e zhvillimit urban në zonën e Shkozëtit-Durrës*. Studime Gjeografike Nr.18, faqe 467-476, Tiranë.

sterile²⁹⁴. Sheshet e depozitimit të sterileve kanë një shtrirje rreth 2.5 km gjatësi. Sterilet e dala nga hapja e pusit janë përdorur për sistemimin e terrenit përreth pusit duke krijuar taracën e nevojshme për lehtësi të punimeve në minierë. Tokat në të gjithë sipërfaqen ku shtrihet miniera nuk është produktive.

Erozioni i tokës ushtrohet nga veprimtaria e forcës goditëse e disperguese të ujit. Në territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut erozioni i tokës është zhvilluar prej forcës goditëse të valëve të detit Adriatik, të forcës neto të lumenjve Erzen e Ishëm dhe energjisë gjërryerëse dhe transportuese të rrjedhjes sipërfaqësore të ujit. Veprimtaria gjërryerëse e valëve të detit Adriatik shprehet si në bregdetin e lartë, por edhe në bregdetin e ulët të Durrësit. Erozioni është një fenomen natyror i shfaqur në të dyja krahët e kepit të Rodonit, në krahun perëndimor të Kepit të Palit e Malit të Durrësit, si dhe në plazhin e Rrushkullit. Veprimtaria gjërryerëse e valëve të detit shoqërohet me rrëshqitje dhe rëzime, duke krijuar falezat e gjalla në sektorët e mësipërm. Erozioni apo gryertja në plazhin e Rrushkullit kryhet duke qenë se forca gjërryerëse e valëve të detit është me madhe se sasia e materialeve që sjell lumi Erzen, pavarësisht se ky lum konsiderohet si ndër lumenjtë që sjell sasi të mëdha të lëndëve të ngurta. Në territoret e bashkisë Shijak dhe Durrës kalon rrjedhja e poshtme e lumit Erzen. Megjithëse mund të konsiderohet si sektor i poshtë dhe ku duhet të mbizotërojë veprimtaria depozituese, lëvizjet tektonike ngritëse që kanë karakterizuar të gjithë territorin, bën që kjo luginë të ketë shpate të thellë dhe të pjerrët. Gjatë periudhës së plotave, uji i lumit Erzen ushtron veprimtari gjërryerëse në shpatet e tij, duke dëmtuar tokat përgjatë kësaj lugine.

Erozioni i tokës ushtrohet edhe nga veprimtaria e forcës goditëse e disperguese të pikës së shiut dhe energjisë gjërryerëse e transportuese të rrjedhjes sipërfaqësore të ujit. Studiuesit kanë përllogaritur se një pikë shiu me diametër 1 mm ka shpejtësi 15 km/orë dhe gjatë goditjes ajo dispergon tokën, i merr grimcat në suspension dhe gjatë kundërveprimit i shpërndan në sipërfaqe të tokës. Me vazhdimin e reshjeve, grimcat e shpërndara të tokës formojnë shtresëzime sipërfaqësore, duke bllokuar porët e tokës dhe kufizojnë kapacitetin infiltrues të saj. Ujërat e painfiltruara të reshjeve grumbullohen dhe lëvizin në drejtim të pjerrësisë, duke formuar rrjedhjen sipërfaqësore. Fluksi i rrjedhjes sipërfaqësore është funksion i intensitetit të reshjeve, kohëzgjatjes dhe ritmit të infiltrimit.

$$\text{Rrjedhja sipërfaqësore} = (\text{Intensiteti i reshjeve} - \text{Infiltrim}) * \text{kohë}$$

Veprimtaria gjërryerëse fillon me përroskat dhe përrenjtë nëkodrat e Rodon-Prezës dhe Malit të Durrësit-Kepi i Palit. Ajo që e ndihmon intensitetin e veprimtarisë gjërryerëse të ujit sipërfaqësor është përbërja terrigjene, relievi kodrinor, intensiteti i reshjeve të shiut dhe mungesa e bimësisë. Në bashkinë e Durrësit, si vatër e erozionit konsiderohet kodra e Currilave. Shpati perëndimor i Currilave, i cili përbëhet prej argjilave, duke qenë se ka një kënd të madh të rënies së shtresave shkëmbore, është përfshirë në vazhdimësi nga rrëshqitjet masive. Ky fenomen ndodh në periudhën e shirave intensive, gjatë të cilës, argjilat e ngopura me ujë bëhen të paqëndrueshme dhe rrëshqasin. Në foton e mëposhtme paraqitet ky shpat, i cili pavarësisht masave mbrojtëse me rrjeta dhe mbjelljes së pemëve vazhdon të jetë problematike.

²⁹⁴Ministria e Industrisë dhe Energjitikës. Materiale online



foto 4: Rrëshqitjet në shpatin perëndimor të Malit të Durrësit (Kodrat e Currilave)

Ngjeshja e tokës është një proces, i cili shoqëron pothuajse të gjitha praktikatat bujqësore dhe si e tillë dhe në kohët e sotme ekzistojnë dilema në lidhje me këtë proces. Bimët që kultivohen herët në pranverënë përgjithësi kanë një potencial prodhues më të lartë sesa ato që mbillen në periudhën e vjeshtës. Operacionet e ndryshme që kryen në pranverën e hershme, duke u shoqëruara me kushte të lagëta dhe të përshtatshme shpesh herë çojnë në prishjen e strukturës së tokës. Me anë të traktorëve dhe makinerive të ndryshme që punohet toka, ushtrohet mbi të një peshë specifike e cila çon në ngjeshjen e saj. Gjatë procesit të ngjeshjes porët e mëdha ndërmjet agregatëve humbasin si pasojë e shtypjes apo ngjeshjes së poreve të afërta së bashku. Faza tjetër e ngjeshjes përfshin agregatat e dobësuar, i cili është një proces që ndodh në mënyrë intensive. Me rritjen e ngjeshjes apo shtypjes do të ndeshim një ulje të volumit total të tokës duke bërë të mundur mbajtjen e ujit në një potencial të lartë dhe një pakësim të raportit të poreve të mëdha me porët e vogla. Prosesi i ngjeshjes ndikon më ndjeshëm në vetitë fizike dhe hidrologjike të tokës duke bërë të mundur uljen e treguesve të këtyre vetive.

Duke qenë se toka është e përbërë nga agregate të madhësive të ndryshme, të cilat janë të rrethuara nga pore të madhësive të ndryshme. Këto agregate duke qenë me peshë vëllimore më të lartë dhe mbajtës të ujit si dhe ruajtjen e elementeve të ndryshme ushqyes. Sipërfaqet relativisht të mëdha të hapësirave poroze ndërmjet agregateve strukturorë krijojnë mundësinë e një lëvizje të shpejtë të ujit nga lart poshtë në thellësi të profilit të tokës, një kullim më të mirë të tokës, shkëmbimin më të mirë dhe më të shpejtë të ajrit si dhe rritjen dhe zhvillimin normal të sistemit rrënjor të bimëve. Prosesi i ngjeshjes do të çojë në dobësimin e agregatëve strukturorë. Si rrjedhojë, duke qenë se porët e madhësive të vogla dominojnë në tokat e ngjeshura, kemi një ritëm të ulët të infiltrimit, një cilësi më të ulët të kullimit, një ajrim më të reduktuar dhe një rritje të rezistencës ndaj penetrimit të rrënjëve të bimëve.

Rritja e sipërfaqeve të tokave të kripura shkaktohet nga mungesa e sistemit të kullimit dhe lënia e tokës djerrë. Në rastin kur në thellësinë 30-40cm të tokës, kripësia është më e madhe së 1% bimët nuk mund të kultivohen, ndërsa në tokat me përmbajtje kripe 0.4-0.6% mund të kultivohen disa bimë që janë rezistente ndaj kripërave. Serat konsiderohen si burim ndotje pasi në to depozitohen sasi të mëdha

kripërash. Një pjesë e fushës së Spitallës është një tokë e kripur, pasi është përfituar nga bonifikimi i kënetës. Pavarësisht masave të marra shkripëzimin e saj dhe kthimin në tokë bujqësore, ky proces nuk përfundoi mbas ndryshimit të sistemit politik. Duke qenë se një pjesë e kësaj toke tashmë është kthyer në truall ndërtimi, disa prej kanaleve kulluese janë kthyer në gropa septike dhe niveli i ujërave nëntokësore është i lartë, bën që kjo tokë të ketë persëri nivele të larta kripe. Për të evidentuar shkallën e ndotjes duhet realizuar monitorime dhe vëzhgime të vazhdueshme.

Territori tërësisht fushor, vetëm 1-1.5 mbi nivelin e detit bën që zonat me ujëra sipërfaqësore të depërtojnë brenda një kohe të shkurtër në shtresat ujëmbajtëse. Për më tepër dëmtimi i kanaleve kulluese dhe mungesa e tyre tek ndërtimet e reja ka bërë që zona në kohë shirash intesive të përfshihet nga *përmbytjet*. Nga ana tjetër, studimet serioze në këtë drejtimungojnë.

IV.3.2.Ndotja e ujit

Mosha e ujit është afërsisht 4.5 miliard vjet (po aq e vjetër sa planeti Tokë). Në përgjithësi uji paraqitet në natyrë si një substancë e pastër (në disa raste ka elementë kimikë të tokës që alternojnë cilësinë e tij) dhe gjatë përdorimit nga njeriu, për qëllime bujqësore (ujitje), për qëllime industriale (prodhimi i të mirave materiale dhe si faktor në ngrohje, ftohje), për qëllime shtëpiake (pirje, higjienë personale, larje dhe çlodhje) etj., ai arrin të ndotet kimikisht, fizikisht dhe termikisht. Në territorin e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut, si rezultat i veprimtarisë humane, jovetëm të banorëve të zonës, janë shfaqur zona të ndotura ujore. Ndotjet kimike, fizike dhe termike janë evidentuar në ujërat bregdetare të Adriatikut, në lumin Erzen dhe Ishëm dhe në ujërat nëntokësore.

Ujërat e detit Adriatik kanë ndotës me origjinë të ndryshme. Ndotës të tij janë mbjetjet e ngurta dhe të lëngëta të derdhura nga anijet e transportit, që ankorohen në Portin e Durrësit, por edhe nga ndotjet që vijnë nga toka. Duke qenë se në bashkinë e Durrësit dhe të Shijakut nuk ka infrastrukturë të mjaftueshme të trajtimit të ujërave të përdorura, ato derdhen drejtpërsëdrejti në det, duke filluar që nga zona e Plazhit e deri në grykëderdhjen e Ishmit në veri. Ujërat e papërpunuara derdhen në detin Adriatik përmes kanalit të Shkëmbi i Kavajës, kanalit të Plazhit, të Vollgës, të Jubës, hidrovorit të Porto Romanos, përroit të Tarinit, përrenjve të Manzës dhe lumenjve Erzen e Ishëm. Ujërat e Adriatikut kanë nivele të ndryshme ndotjeje përgjatë 61.8 km vijë bregdetare. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen vlerat e ndotësve kimikë në zona të ndryshme përgjatë vijës bregdetare të Durrësit.

Tabela 54. Analiza fiziko-kimike e ujit të detit, grykëderdhjeve të lumenjve dhe hidrovoreve në bashkinë e Durrësit

Vendndodhja	NH ₄ mg/l	NO ₂ mg/l	NO ₃ mg/l	PH	Transparenc a	Fosfor total mg/l	Hidro- karbure mg/l	Oxidues hmëria mg/l
Spektori Ura e Dajlanit	0.35	0.007	1.0	7.92	>1 m	<0.05	<0.5	2.05
Spektori Teuta	0.40	0.007	1.0	8.02	>1 m	<0.05	<0.5	2.56
“Apollonia	0.45	0.007	1.0	7.98	>1 m	<0.05	<0.5	5.76
“Hekurudha	0.85	0.007	1.5	8.02	>1 m	<0.05	<0.5	6.27
“Iliria	0.35	0.002	1.5	8.00	>1 m	<0.05	<0.5	6.28
Rezidencat qeveritare Iliria	0.20	N.D.	1.5	8.00	>1 m	<0.05	<0.5	4.24
Shtepia pushimit	0.05	0.002	1.0	8.01	-1 m	<0.05	<0.5	2.04

M.brendshme Plepa								
“Tropikalit	0.45	0.007	1.5	8.01	-1 m	<0.05	<0.5	3.57
Pranë kanalit të ujërave të Kodrave të Shkallnurit	1.25	0.010	2	8.02	-1 m	<0.25	<0.5	10.28
Shkëmbi i Kavajës	0.80	0.006	2	8.01	<1 m	<0.25	<0.5	10.22
Currila	0.80	0.025	2	8.00	<1 m	<0.05	<0.5	6.33
Mini plazhi i Currilave(Brryli)	0.75	0.065	2	8.00	<1 m	<0.05	<0.5	6.72
Plazhi Bishti i Pallës	0.75	0.025	2	8.04	<1 m	<0.15	<0.5	5.94
Gjiri i Lalëzit	0.80	0.025	2	8.03	<1 m	<0.20	<0.5	9.34
Gjiri i Rodonit	0.95	0.025	2	8.06	<1 m	<0.05	<0.5	10.04
Grykëderdhja e Hidrovorit Porto Romano	2.25	0.080	4.0	8.22	<1 m	<0.25	<0.5	10.33
Grykëderdhja e Hidrovorit Hamallaj	1.75	0.080	3.0	7.27	<1 m	<0.20	<0.5	11.08
Grykëderdhja e lumit Erzen	1.25	0.040	2.0	8.00	<1 m	<0.15	<0.5	10.22
Grykëderdhja e lumit Ishëm	1.75	0.080	2.0	7.44	<1 m	<0.20	<0.5	10.44
Grykëdedhja e kanalit “Sheshi Taulantia”	2.25	0.090	2.0	8.02	<1 m	<0.25	<0.5	12.76

Burimi: Lala, S., Lala, M. (2011). Mjedisi dhe impakti i tij në shëndetin e qytetarëve Durrsakë.

Nga analiza e tabelës së mësipërme vëmë re se Ujrat bregdetare më të ndotura janë ato të gjirit të Durrësit. Vlerat më të larta (2.25 mg/ l) të azotit amoniak (NH₄) gjenden në grykëderdhjen e kanalit “Sheshi Taulantia”, ndërsa vlerat më të vogla (0.05 mg/l) gjenden tek plazhi i Ministrisë së Brendshme, në Plepa. Dioksidi i azotit (NO₂) gjendet më i përqëndruar në miniplazhin e Currilave, ndërsa në sasi më të pakta te Sektori Iliria dhe te Ministria e Brendshme. Ph-i është neutral me tendencë drejt bazave. Pranë grykëderdhjeve të lumenjve dhe kanaleve me sasi të mëdha uji, transparenca e ujit të detit është më e vogël. Në qoftë se vlera e përmbajtjes së hidrokarbureve është e njëjtë gjatë të gjithë vijës bregdetare, vlerat e oksidueshmërisë janë të ndryshime sipas zonave të studiuara.

Ndotja e lumit Erzen dhe Ishëm shkaktohet nga derdhja në të të mbetjeve të ngurta urbane, të ujërave të zeza të qytetit të Tiranës dhe rrethinave. Lumi Erzen, ndotja më e madhe i vjen nga infiltrimi i lëngët i mbetjeve të grumbulluara dhe të përpunuara në landfillin e Sharrës. Ndotja e lartë është rezultat i grumbullimit në këtë pikë e të gjitha mbeturinave spitalore, industriale, komunale të një qyteti si Tirana. Nga rezultatet e marra në stacionin e Sallmones (bashkia Shijak), nga monitorimet e kryera në ujërat e lumit Erzen, rezulton se gjendja është e moderuar, ose e kategorisë së III. Përcjellshmëria e madhe elektrike është një tregues i shkarkimeve të lëngëta urbane dhe industriale. Lumi Ishëm ndotet jo vetëm nga

mbetjet e ngurta dhe të lëngëta që vijnë nga qyteti i Tiranës (lumi i Tiranës), por dhe nga qyteti i Fushë-Krujës.

IV.3.3.Ndotja e ajrit

Asnjë periudhë historike nuk ka kaluar pa pasur atmosferë krejtësisht të pastër. Me ndotje të ajrit duhet kuptuar prania apo ndërfitja e lëndëve kimike, substancave e materialeve biologjike në atmosferë, të krijuara nga aktivitetet njerëzore ose proceset natyrore, që shkaktojnë efekte të dëmshme në shëndetin e njeriut dhe mjedisin.Ndotësit e ajrit mund të klasifikohen si primare dhe sekondare.

Ndotësit primarë quhen ato substanca që emetohen direkt në atmosferë si: monoksidi i karbonit (CO, i emetuar nga automjetet e vjetra) dhe dioksidi i sulfurit (SO₂, i lëshuar nga oxhaqet e fabrikave).Ndotësit primarë më të mëdhenj janë:

-Oksidet e sulfurit (SO_x), veçanërisht dioksidi i sulfurit SO₂, i cili prodhohet nga procese të ndryshme industriale. Qymyrguri dhe nafta kanë në përbajtje të tyre përbërës të sulfurit, i cili gjatë djegies gjeneron SO₂. Oksidimi i mëtejshëm i SO₂, zakonisht në prani të katalizatorit (NO₂), formon acidin sulfurik H₂SO₄, që shkakton shiun acid.

-Oksidet e azotit (NO_x), veçanërisht dioksidi i azotit, i cili paraqitet me ngjyrë të kuqërremtë në të kafenjtë, me erë djegëse dhe shpuese. Ai emetohet nga djegia ematerialeve të ndryshme në temperatura të larta. Krahas tij janë edhe Monoksidi i karbonit (CO) dhe dioksidi i karbonit (CO₂).

Ndotësit sekondarë janë gazra që zakonisht nuk emetohen direkt, por ato formohen në ajër, kur ndotësit primarë veprojnë ose ndërveprojnë me njëri-tjetrin.Zonat më problematike janë hapësirat e ish-ndërmarrjeve industriale, të cilat sot janë jashtë përdorimit të nevojshëm dhe të efektivitetit. Një pjesë e ndërmarrjeve janë privatizuar dhe vazhdojnë aktivitetin e tyre industrial brenda një zone tashmë urbane. Emetimet e ndërmarrjeve në ajër janë të rrezikshme për banorët e zonës. Emetimet e plumbit, oksid squfurit, oksid azotit etj, kanë rritur sasinë e ndotësve në ajër. Këto të dhëna paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Tabela 55. Sasia e emetimeve në ajër

Durrësi	LNP	LM10	LM2.5	NO2	SO2	O3	Pb
2003-04	207	93	-	23	16	99	0.34
2005-07	201	91	-	22	16	98	0.29
2009	235	110	-	32	20	75	0.27
2010	192	91	-	28.1	20.1	67.4	0.25
Normat Shqiptare	140	60	-	60	20	65	1
Normat e BE-së	-	40	-	40	60	-	0.5

Burimi: “Raport për gjendjen e mjedisit”, Ministria e Mjedisit, viti 2012

Një pjesë e ndërmarrjeve janë kthyer në vendgrumbullime të mbetjeve industriale. Ato nuk janë të ruajtura dhe ende nuk ka ndonjë plan për largimin e tyre. Ndërtesat e ish-ndërmarrjeve tashmë janë vjetëruar dhe rrezikojnë shembjen. Problem për zonën janë edhe sasia e madhe e pikave të karburanteve. Afërsia me banesat është një rrezik i madh dhe i vazhdueshëm. Ndotja e ajrit dhe tokës krijon probleme për gjallesat dhe banorët e zonës. Rreziku i përfshirjes nga zjarri është i madh. Sasia e madhe mbetjeve dhe mungesa e tërheqjes në kohë të mbetjeve bën që të kemi ndotje të tokës, ujit dhe ajrit.

Mungesa e koshave të grumbullimit lejon hedhjen e mbeturinave në afërsi të rrugëve dytësore dhe kryesore. Një nga problemet që shqetëson më së shumti zonën e Shkozetit është përmytja.

Zhvillimi ekonomik në bashkinë e Durrësit dhe të Shijakut lidhet drejtpërdrejtë me përdorimin e burimit të tokës dhe të ujit. Përdorimi i tokës për qëllime bujqësore, ndërtimi dhe industriale ka mundësuar zhvillimin e bujqësisë, industrisë përpunuese dhe ndërtimtarisë. Resursi ujor ka mundësuar zhvillimin e turizmit, tregtisë , transportit dhe shërbimeve. Resurset nëntokësore dhe materialet e ndërtimit kanë ndikim minimal në të ardhurat ekonomike të dy bashkive. Resurset e klimës dhe të biodiversitetit ndikojnë kanë përdorim të ulët dhe gjenderojnë të ardhura të pakta për banorët e zonës. Zgjerimi i vendbanimeve urbane dhe rurale ka sjellë transformime të hapësirave urbane dhe rurale.

KAPITULLI V

V.MENAXHIMI I RESURSEVE NATYRORE TË BASHKISË DURRËS DHE SHIJAK

Pasuritë natyrore janë asete të natyrës që duhen vlerësuar, përdorur dhe mbrojtur nga njeriu. Numri i lartë i popullsisë në hapësirën territoriale të bashkisë Durrës dhe Shijak ka ushtruar një presion të madh mbi resurset natyrore të zonës dhe për rrjedhojë dëmet dhe ndotjet janë të disa kategorive. Për të ruajtur vlerat e mëdha ekologjike të resurseve natyrore të territoreve bashkiake dhe njëkohësisht mundësimin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe social, ka rëndësi analiza e mënyrës më të mirë menaxhuese, bazuar në konventat ndërkombëtare, legjislacionin vendas dhe institucionet përgjegjëse. Në *çështjen e parë* të kapitullit V do të trajtohen të gjitha konventat ndërkombëtare ku vendi ynë ka aderuar si dhe ku fokusohet puna e tyre. Në *çështjen e dytë* do të trajtohet kuadri ligjor kombëtar dhe VKM (Vendimet e Këshillit të Ministrave), në fuqi, që i kushtojnë vëmendje burimeve natyrore mbi dhe nëntokësore. Pjesë e *çështjes së tretë* janë institucionet përgjegjëse dhe aktorët kryesorë të menaxhimit të burimeve natyrore, të cilët e ushtrojnë veprimtarinë e tyre duke zbatuar konventat ndërkombëtare dhe legjislacionin vendas. Pjesë e kësaj çështje janë planet e planifikimit afatmesme dhe afatgjata të përdorimit të pasurisë natyrore të bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut. Në *çështjen e katërt* jepen gjerësisht disa nga format më të mira menaxhuese të pasurive minerale, të pasurive klimatike, tokës, ujit dhe botës bimore e shtazore.

V.1.Kuadri ligjor ndërkombëtar

Vendi ynë është pjesë e një sërë konventave ndërkombëtare. Ato synojnë ruajtjen e pasurisë natyrore me vlerat e tyre estetike, shkencore, kulturore, çlodhëse, ekonomike dhe qenësore të brendshme, që kanë rëndësi të ruhet dhe t'i transmetohen brezave të ardhshëm²⁹⁵. Njohja e secilës prej konventave, ku vendi ynë ka aderuar dhe evidentimi i objektivave kryesore të tyre, mundëson një menaxhim më të qëndrueshëm të burimeve natyrore që zotërojnë territoret e Durrësit dhe të Shijakut. Në zbatim edhe të konventës së Ahrusit, në të cilën është pjesë edhe vendi ynë prej 01.08.2001, mbi të drejtën e informimit shkencor qytetar, më poshtë po trajtojmë me radhë çdonjërin prej tyre.

1-Konventa Espoo, (*Konventa mbi Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor në Kontekstin Ndërkufitar*), e mbajtur në Espo të Finlandës, në 25.02.1991, është ratifikuar nga vendi ynë në datën 04.10.1991²⁹⁶. Duke qenë se edhe territoret e bashkisë së Durrësit konsiderohet kufitare, gjatë ndërtimit të objekteve industriale të mëdha brenda këtyre territoreve, duhet të merret në konsideratë kuadri ligjor i mbrojtjes mjedisore, pra, të bëhet një vlerësim i ndikimit në mjedis për çdo lloj aktiviteti industrial.

2-Konventa e Stokholmit, (*Konventa për Ndotësit Organikë të Qëndrueshëm*), e mbajtur në Stokholm të Suedisë, në 22.05.2001, është ratifikuar nga Shqipëria më

²⁹⁵Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) (2011). *Aktet Ndërkombëtare Mjedisore, Biodiversiteti*. Tiranë, faqe 12.

²⁹⁶Ministria e Punëve të Jashtme (2010). *Lista e Konventave të Kombeve të Bashkuara ku Republika e Shqipërisë është Palë*. Online.

04.10.2004. Qëllimi i kësaj konvente është që çdo shtet duhet të marrë masa për të reduktuar ose eliminuar shkarkimin e ndotësve organikë të qëndrueshëm. Ndër ndotësit organikë të qëndrueshëm bëjnë pjesë: dioksinë-dibenzo-p e polikloruar dhe dibenzofurans (PCDD/PCDF), heksaklorobenzene (HCB) dhe bifenils i polikloruar, të cilët formohen dhe çlirohen në krematorët e mbeturinave²⁹⁷. Kjo konventë duhet të zbatohet gjatë menaxhimit të mbetjeve urbane dhe sidomos ato spitalore, në të dyja bashkitë.

3-Konventa e Kombeve të Bashkuara, (*Konventa për të luftuar Shkretërizimin në ato vende që vuajnë nga thatësira serioze*), e mbajtur në Paris, më 14.10.1994 dhe e ratifikuar nga vendi ynë, më 27.04.2000. Objektivi i kësaj konvente është të luftojë shkretëtirëzimin dhe të zbusë efektet e thatësirës²⁹⁸. Mbi bazën e kësaj konvente dhe duke u mbështetur në legjislacionin vendas, i duhet dhënë vëmendja e duhur tokave, që rrezikojnë degradimin të mëtejshëm fizik, biologjik dhe kimik, në territoret e Durrësit dhe të Shijakut.

4-Konventa e OKB-së, (*Konventa për të Drejtat e Detit*), mbajtur në Montego Bay, Xhamajkë, më 10.12.1982 dhe që hyri në fuqi në vendin tonë më 16.11.1994²⁹⁹. Nëpërmjet kësaj konvente parashikohet kuadri ligjor për të gjitha llojet e veprimtarive detare. Ajo njëkohësisht përcakton juridiksionin për të gjitha zonat detare dhe oqeanike. Bashkia e Durrësit duke qenë se ka dalje të gjerë në ujërat e detit Adriatik duhet të monitorojë veprimtaritë në ujërat territoriale dhe në zonën ekskluzive ekonomike.

5-Konventa e Barcelonës, (*Konventa për Mbrojtjen e Mjedisit Detar*) është miratuar në vitin 1976 nga 16 vende anëtare. Aktualisht ka 21 vende anëtare dhe vendi ynë aderon prej vitit 2000. Objektivat e saj janë vlerësimi, kontrolli dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve bregdetare dhe detare për zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik. Durrësi si vendi bregdetar i Adriatikut duhet të zbatojë këtë dhe konventat e mëposhtme mbi detin.

6-Konventa e Londrës, (*Konventa për Parandalimin e Ndotjes Detare nga Hedhja e Mbeturinave*) ka hyrë në fuqi në vitin 1975. Ajo konsiderohet si një nga konventat e para në shkallë botërore për të mbrojtur mjedisin detar. Qëllimi kryesor i kësaj konvente është të promovojë kontrollin e të gjithë burimeve të ndotjes detare dhe të marrë të gjitha hapat për të parandaluar ndotjen e detit nga hedhja e mbeturinave³⁰⁰.

7-Konventa MARPOL, (*Konventa për Parandalimin e Ndotjeve nga Anijet*) e mbajtur në vitin 1973 dhe e ndryshuar me protokollin e vitit 1978. Vendi ynë ka aderuar në këtë konventë më 17.08.2006. Qëllimi kryesor i saj është kufizimi i shkarkimeve të dëmshme të anijeve dhe përcaktimi i zonave që kërkojnë mbrojtje të veçantë nga aktivitetet detare³⁰¹.

8-Konventa e Helsinkit, (*Konventa për Mbrojtjen dhe Përdorimin e Ujërave Ndërkufitare*) e mbajtur në 17.03.1992 dhe e ratifikuar nga vendi ynë më 05.01.1994³⁰². Nëpërmjet kësaj konvente lehtësohet bashkëpunimi ndërkufitar,

²⁹⁷ Ligji nr. 9263, datë 29.07.2004 Për Ratifikimin e Konventës së Stokholmit “Për Ndotësit Organik të Qëndrueshëm, faqe 3.

²⁹⁸ Ministria e Mjedisit (www.mjedisi.gov.al)

²⁹⁹ Ligji nr. 9055, datë 24.04.2003, Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën mbi të drejtën e Detit” të OKB-së (www.transporti.gov.al)

³⁰⁰ Ministria e Punëve të Jashmte (2010). *Lista e Konventave të Kombeve të Bashkuara ku Republika e Shqipërisë është Palë*. Online

³⁰¹ Po aty.

³⁰² Po aty.

reduktohet pasiguria dhe rritet menaxhimi i ujërave ndërkufitare.

9-Konventa e Bazelit, (*Konventa e Kontrollit të Lëvizjes Ndërkufitare të Mbetjeve të Rrezikshme*) e mbajtur në 22.03.1989 dhe e ratifikuar nga vendi ynë në 29.06.1999. Sipas kësaj konvente shtetet duhet të jenë të përgjegjshëm që lëvizjet ndërkufitare të mbetjeve të tilla nga shteti prodhues në një shtet tjetër duhet të lejohet vetëm kur ato trajtohen sipas kushteve që nuk rrezikojmë shëndetin e njeriut dhe mjedisit³⁰³.

10-Programi Globali i veprimit për mbrojtjen e mjedisit nga aktivitetet tokësore është një marrëveshje me baza vullnetare, e cila synon ndërhyrjen në zonat bregdetare dhe detare në gjendje kritike. Programi merret me identifikimin e habitateve kritike si: livadhet detare, lagunat bregdetare dhe zonave detare dhe bregdetare.

Krahas konventave në mbrojtjen e mjedisit tokësor dhe ujqor, vendi ynë ka aderuar në konventat në mbrojtje të biodiversitetit.

1-Konventa e Bonn-it, (*Konventa e Ruajtjes së Specieve Migratore të Kafshëve të Egra*) e mbajtur në vitin 1983, ka si objektivi të saj mbrojtjen e specieve të rrezikuara dhe migratore me një status të pafavorshëm. Konventa merret me ruajtjen e jetës së egër dhe habitateve në nivel global. Sipas saj “Specie shtegtuese” do të thotë popullata ose ndonjë pjesë e ndarë gjeografikisht e popullatës së një specie ose taksoni më të ulët të kafshëve të egra, një propocion sinjifikant i të cilëve në mënyrë rrethore dhe të parashikueshme kalon një ose më shumë kufij në juridiksion kombëtar³⁰⁴.

2-Konventa CITES, (*Konventa mbi Tregtimin Ndërkombëtar të Specieve të Rrezikuara të Florës dhe Faunës së Egër*) e mbajtur në 03.03.1973. Vendi ynë ka aderuar në konventë në vitin 2003³⁰⁵. Objektivi i konventës CITES është ndalimi i tregtimit (export, import) i bimëve dhe kafshëve të rezikuara për zhdukje.

3-Konventa e Bernës, (*Konventa e Ruajtjes së Florës dhe Faunës së Egër*) e mbajtur në vitin 1979. Qëllimi i Konventës është përshkruar për të ruajtur florën e egër, faunën dhe habitatet e tyre natyrore, veçanërisht për të ruajtur ato specie dhe habitate konservimi i të cilave kërkon bashkëpunimin e shumë shteteve. Kjo Konventë synon promovimin e bashkëpunimit për speciet e rrezikuara dhe vulnerable, duke përfshirë këtu dhe ato migratore³⁰⁶.

4-Konventa për Biodiversitetin e mbajtur në Rio de Janeiro, në vitin 05.06.1992. Konventa është instrumenti më i rëndësishëm që adreson zonat e mbrojtura dhe është ratifikuar nga vendi ynë 05.01.1994. Ajo ka tri objektiva: ruajtjen globale të biodiversitetit, përdorimin e qëndueshëm të resurseve biologjike dhe ndarjen e drejtë dhe të barabartë të të mirave që rrjedhin nga përdorimi i burimeve. Kjo konvente mbulon shumë çështje që variojnë nga kërkesat për vendosjen e një zone të mbrojtur deri në promovimin e praktikave dhe njohurive përkatëse të konservimit dhe përdorimit të qëndrueshëm³⁰⁷.

Vendi ynë ka nënshkruar edhe një sërë konventash e marrëveshesh të tjera, të cilat promovojnë mbrojtjen dhe menaxhimin e burimeve natyrore të të gjithë vendit tonë. Çdo shtet palë merr në konsideratë përgjegjësinë e tij ndërkombëtare për ruajtjen

³⁰³ Konventa e Bazelit mbi kontrollin e Lëvizjeve Ndërkufitare të mbetjeve të rrezikuara dhe asgjësimit të tyre përshtatur nga Konferenca e Plenipotenciares në 22 Mars 1989.

³⁰⁴ Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) (2011). *Aktet Ndërkombëtare Mjedisore, Biodiversiteti*. Tiranë, faqe50.

³⁰⁵ Ligji nr. 9021, datë 06.03.2003, Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për Tregëtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rezikuara të Florës dhe Faunës së Egër (CITES)

³⁰⁶ Ministria e Punëve të Jashtme (2010). *Lista e Konventave të Kombeve të Bashkuara ku Republika e Shqipërisë është Palë*. Online

³⁰⁷ Po aty.

dhe përdorimin racional të resursit natyror, për të cilën konventa apo marrëveshja është krijuar. Madje, në zbatim të konventave ku Republika e Shqipërisë është pjesë, janë miratuar akte me karakter ligjor e nënligjor si dhe një sërë vendimesh të Këshillit të Ministave.

V.2.Menaxhimi ligjor i resurseve natyrore

Institucionet qendrore dhe vendore në vendin tonë e ushtrojnë aktivitetin e tyre mbi bazën e ligjeve, urdhërave dhe VKM-ve kombëtare dhe marrëveshjeve ndërkombëtare. Në mbrojtjen dhe ruajtjen e sasisë dhe cilësisë së resurseve natyrore dhe përdorimin racional të tyre ekzistojnë një sërë ligjesh dhe aktesh nënligjore. Shpesh herë ligjet janë të ndërlidhur apo të mbivendosur. Për secilën prej resurseve të natyrës ekzistojnë ligje që synojnë mbrojtjen in-situ dhe ex-situ. Më poshtë janë të listuara të gjitha ligjet që duhet të merren parasysh gjatë përdorimit të resurseve, për të mundësuar shfrytësimin e qëndrueshëm të tyre.

V.2.1.Legjislacioni për burimet minerale

Për përdorimin e burimeve minerale në territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut duhet merren në konsideratë ligjet e mëposhtme:

Ligji nr. 111/ 2015 “ *Për shërbimin Gjeologjik Shqiptar*”, i cili ka si qëllimi të përcaktojë parimet e organizimit, drejtimi, bazat dhe detyrat e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar. Nëpërmjet këtij ligji synohet rregullimi i marrëdhënieve ndërmjet ShGjSh-së dhe sektorëve privat, duke synuar nxitjen e përdorimit të resurseve minerale, duke sjellë përfitime maksimale në banorëve³⁰⁸.

Ligji nr. 10 304, datë 15. 7. 2010. “*Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë*” dhe të gjitha aktet nënligjore të dala në zbatim të tij;Ky ligj është përcaktuesi i rregullave për zhvillimin e veprimtarive minerare e postminerare në vendin tonë. Ai ka si qëllim nxitjen e veprimtarisë minerare në vendin tonë duke siguruar transparencë dhe konkurrencë të lirë, rritjen maksimale të të përfitimeve dhe mbrojtjen e mjedisit nga mbetjet dhe rreziqet minerare³⁰⁹. Në mbështetje të këtij ligji janë miratuar edhe dy VKM, të cilat mbështesi strategjinë e përdorimit të resurseve natyrore. Dy VKM-të janë:

- VKM nr. 440, e datës 16.06.2011 “ Për miratimin e formës, të kushteve të rikthimit dhe të mënyrës së llogaritjes së garancive financiare për rehabilitimin e mjedisit, për realizimin e programit minimal të punës dhe për realizimin e investimeve”;
- VKM nr. 479, e datës 29.06.2011 “Për miratimin e strategjisë minerare të Republikës së Shqipërisë”.

V.2.2.Baza ligjore në menaxhimin e hapësirave urbane dhe rurale

Ligji Nr. 107/ 2014 “*Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*”, nëpërmjet së cilit synohet zhvillimi i qëndrueshëm i territorit, përmes përdorimit racional të tokës dhe burimeve të tjera natyrore; vlerësimin e potencialit aktual e perspektiv për zhvillimin e territorit; mbrojtjen e burimeve natyrore dhe nxitjen e jetës ekonomike, shoqërore e kulturore³¹⁰.

Ligji nr. 50/ 2014 “ *Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*” i ndryshuar, synon të ndihmojë procesin e kalimit të pronësisë së parcelës

³⁰⁸ www.energija.gov.al

³⁰⁹ Ligji Nr. 10 304, datë 15.07.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” (www.energji.gov.al)

³¹⁰ Ligji Nr. 107/ 2014 “*Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*”, (www.zhvillimiurban.gov.al)

ndërtimore, ku është ngritur ndërtimi pa leje³¹¹. Brenda këtij ligji gjenden të gjitha rregullat që duhet ë ndiqen për të gjitha llojet e ndërtimeve pa leje, që kërkojnë ose jo legalizim.

Ligji nr. 8934, datë 05.09.2002 “*Për mbrojtjen e mjedisit*” synon të rregullojë marrëdhënien njeri-mjedis; të mbrojë elementët përbërës të mjedisit dhe proceset mjedisore duke siguruar kushtet materiale për zhvillimin e qëndrueshëm³¹².

Ligji nr. 9817, datë 22.10.2007 “*Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural*” përmban masat dhe programimin e politikave bujqësore e të zhvillimit rural, si dhe të shërbimeve publike bujqësore, të kërkimit dhe trajnimit profesional³¹³.

Ligji nr. 8752, datë 26.03.2001 “*Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës*” të ndryshuar, i cili ka si qëllim të përcaktojë të gjitha strukturat pranë Qarqeve për ruajtjen dhe administrimin e tokës

Ligji nr. 10257, datë 25.03.2010, për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8752, datë 26.03.2001 “*Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës*”;

Ligji nr. 8312, datë 26.03.1998 “*Për tokat bujqësore të pandara*”;

Ligji nr. 8318, datë 01.04.1998 “*Për dhënien me qira të tokave bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore*”;

Ligji nr. 130/ 2014 Për disa shtesa dhe një ndryshim në ligjin nr 8752, datë 26.03.2001 “*Për krijimin dhe funksionimin e strukturave të administrimit dhe mbrojtjes së tokës*” të ndryshuar;

Ligji nr. 10263, datë 08.04.2010 “*Për përdorimin dhe përdorimin e tokës bujqësore të pakultivuar*” ka për qëllim të përcaktojë rregullat dhe procedurat për përdorimin dhe përdorimin e tokave bujqësore të pakultivuara, për të garantuar funksionimin ekonomik të pronës, pa cënuar të drejtën e pronësisë, të përfutur sipas ligjit, në kuadrin e zhvillimit të qëndrueshëm bujqësor dhe rural³¹⁴.

Ligji nr. 8990, datë 23.01.2003 “*Për vlerësimin e ndikimit në mjedis*” ka si qëllim të sigurojë nivele të larta mbrojtjeje të mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projekte të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim³¹⁵;

Ligji nr. 162/ 2014 “*Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis*” ka si qëllim të përmirësojë shëndetin publik dhe të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, nëpërmjet integritimit të çështjes së mbrojtjes së ajrit në politika të tjera, si dhe përcaktimit të kërkesave për pakësimin e shkarkimeve, monitorimin, vlerësimin, planet e cilësisë së ajrit, dhe për bashkëpunim në nivel ndërkombëtar për këtë qëllim³¹⁶.

Ligji nr.9010, datë 13.02.2003 “*Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta*”synon të mbrojë mjedisin dhe njeriun nga ndotja dhe dëmtimi prej mbetjeve të ngurta, nëpërmjet administrimit mjedisor të tyre në çdo fazë, përfshi krijimin, grumbullimin, ndarjen, ruajtjen, transportimin, riciklimin, përpunimin dhe asgjesimin, të cilat çojnë në pakësimin e mbetjeve dhe zvogëlimin e ndikimeve të tyre të rrezikshme e të dëmshme³¹⁷.

³¹¹ Ligji nr. 50/ 2014 “*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*” (www.zhvillimiurban.gov.al)

³¹² www.dogana.gov.al

³¹³ Ligji nr. 9817, datë 22.10.2007 “*Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural*”

³¹⁴ www.bujqesia.gov.al (Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës) Baza Ligjore

³¹⁵ Ligji nr. 8990, datë 23.01.2003 “*Për vlerësimin e ndikimit në mjedis*”

³¹⁶ Ligji nr. 162/ 2014 “*Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis*”

³¹⁷ Ligji nr.9010, datë 13.02.2003 “*Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta*”

V.2.3. Legjislacioni në menaxhimin e ujit

Ligji nr. 9115, datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura” ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut nga ndikimet negative të ujërave të ndotura, duke përcaktuar rregullat e trajtimit mjedisor të tyre, si dhe përcaktimin e detyrimeve të shkarkuesve të ujërave të ndotur³¹⁸.

Ligji 8518 datë 30. 07. 1999 “ Për ujitjen dhe Kullimin”, i ndryshuar ka si qëllim të krijojë kuadrin ligjor, institucional për krijimin dhe funksionimin e shoqatave të përdoruesve të ujit, të federatave, të shoqatave të përdoruesve të ujit dhe të bordeve të kullimit; të rregullojë transferimin e të drejtave të përdorimit të sistemeve të ujitjes shoqatave të përdoruesve të ujit dhe federatave të përdoruesve të ujit³¹⁹

Ligji 8681 datë 02. 11.2000 “ Për projektimin, ndërtimin, përdorimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe të dambave” dhe rregulloren përkatëse sipas VKM nr. 147 datë 18. 03. 2004 “ për miratimin e rregullores së sigurisë së digave dhe dambave”

Ligji nr. 8905, datë 06.06.2002 “ Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi” ka si qëllim mbrojtjen e mjedisit detar të Republikës së Shqipërisë nga ndotja e dëmtimet, parandalimin dhe shmangien e tyre, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore në det e në zonë bregdetare, të cilat prishin cilësinë e ujit, dëmtojnë buirimet e detit e të bregdetit, rrezikojnë faunën dhe florën, kërcënojnë shëndetin e njeriut, si dhe vështirësojnë zhvillimin normal të veprimtarive në këtë mjedis³²⁰

Ligji nr.10234, datë 18.02.2010 për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin “Për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare në Mesdhe” të Konventës së barcelonës “Për mbrojtjen e mjedisit detar dhe të rajoneve bregdetare të mesdheut”.

V.2.4. Legjislacioni për biodiversitetin

Ligji nr. 68/2014 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9587 datë 20.07.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”. Nëpërmjet këtij ligji synohet mbrojtja dhe ruajtja e diversitetit biologjik dhe integrimi i qëndrueshëm i përbërësve të diversitetit biologjik në strategjitë, planet , programet dhe vendimtarjet e të gjitha niveleve³²¹.

Ligji nr. 7/2014 “ Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë”, i cili ka si qëllim përmirësimin e gjendjes së llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie nëpërmjet ndalimit të ushtrimit të gjuetisë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë deri në vitin 2018.

Ligji nr. 8294, datë 02.03.1998 “Për ratifikimin e Konventës së Bernës”. Në bazë të këtij ligji vendi ynë bëhet pjesë e Konventës së Ruajtjes së Florës dhe Faunës së egër dhe mjedisit natyror të Europës³²².

Urdhër nr.62, datë 04.04.2016 “ Për miratimin e Listës së Llojeve të Shpendëve të Egër, veçanërisht vulnerabël”, i cili në shtojcën e tij përmban listën e llojeve të shpendëve të egra, veçanërisht vulnerabël. Ky urdhër është miratuar në bazë të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 14 të ligjit nr.10006, datë 23.10.2008, “Për mbrojtjen e faunës së egër”³²³;

³¹⁸ Fletoria Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, nr 145 dhjetor 2006 (www.legjislacionishqiptar.gov.al)

³¹⁹ Ligji 8518 datë 30. 07. 1999 “ Për ujitjen dhe Kullimin”, (www.qbz.gov.al)

³²⁰ Ligji nr. 8905, datë 06.06.2002 “ Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi (www.mjedisi.gov.al)

³²¹ Ligji nr. 9587 datë 20.07.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”(www.mjedisi.gov.al).

³²² Ligji nr. 8294, datë 02.03.1998 “Për ratifikimin e Konventës së Bernës”.(www.mjedisi.gov.al).

Urdhër nr. 726, datë 26.10.2015 “Për miratimin e formatit të dokumentave standard në përputhje me dispozitat ligjore për tregtinë ndërkombëtare të llojeve të rrezikuara të faunës dhe florës së egër” në bazë të së cilit Ministria e Mjedisit miraton kërkesat dhe jep leje ose jo për importin apo eksportin e llojeve të rrezikuara të faunës dhe florës së egër³²⁴.

Ligji nr 9868 date 4.2.2008 për disa shtesa dhe amendime në ligjin nr 8906 datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, ka si objekt shpalljen, ruajtjen, administrimin, menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura dhe të burimeve natyrore e biologjike të tyre; lehtësimin e kushteve për zhvillimin e turizmit mjedisor; për informimin dhe edukimin e publikut dhe për përfitime ekonomike, të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, nga popullsia vendase, nga sektori publik dhe privat³²⁵.

Rregullore nr. 12, datë 04.06.2012 “Për përcaktimin e procedurave për pajisjen me leje peshkimi dhe të konkurrimit public për ushtrimin e veprimtarisë së peshkimit në det, në Ujërat e brendshme dhe akuakulturën tokësore dhe ujore detare”, e miratuar në mbështetje të ligjit nr. 7908 datë 05.04.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën”. Kjo rregullore përcakton rregullat, kriteret dhe procedurat për aplikimin për leje peshkimi, shqyrtimin e kërkesave dhe të dokumentacionit që e shoqëron atë dhe lëshimin e aktit të miratimit të saj³²⁶.

V.2.5. Legjislacioni për pyjet³²⁷

Projekt-Ligji për “Administrimin e Fondit Pyjor dhe Kulloror Kombëtar ë Republikën e Shqipërisë”; përcakton rregullat, detyrimet, të drejtat, përgjegjësitë dhe marrëdhëniet e institucioneve shtetërore e të bashkive, për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave, pasuri kombëtare me rëndësi të veçantë³²⁸.

Projekt-Ligji për “Shpalljen e Moratoriumit të Gjuetisë në Republikën e Shqipërisë” ka si qëllim të ndalojë ushtrimin e aktivitetit të gjuetisë, në të gjithë vendin tonë dhe për rrjedhojë edhe në territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut, me qëllim përmirësimin e gjendej së llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie dhe jo vetëm³²⁹.

Ligji nr. 9533, datë 15.05.2006, për disa ndryshime në Ligjin Nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” ka si objekt të tij përcaktimin e rregullave të njëjta për marrëdhëniet, detyrat, të drejtat dhe përgjegjësitë e insitucioneve shtetërore, bashkive, organizatave jofitimprurëse, pronarëve privatë dhe të biznesit, për ruajtjen, administrimin, menaxhimin dhe përdorimin e fondit pyjor kombëtar, të tokës pyjore dhe të burimeve natyrore e biologjike të tyre³³⁰;

Ligji nr 49/ 2016, Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kulloror” të ndryshuar, përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e bashkive dhe të pronarëve të kullotave dhe livadheve. Sipas këtij ligji termi “kullotë komunale” zëvendësohet me termin “kullotë bashkiake”, ndërsa termi “organe të qeverisjes

³²³Urdhër nr.62, datë 04.04.2016 “ Për miratimin e Listës së Llojeve të Shpendëve të Egër, veçanërisht vulnerabël”,(www.mjedisi.gov.al).

³²⁴Urdhër nr. 726, datë 26.10.2015 “Për miratimin e formatit të dokumentave standart në përputhje me dispozitat ligjore për tregëtinë ndërkombëtare të llojeve të rrezikuara të faunës dhe florës së egër”(www.mjedisi.gov.al).

³²⁵Ligji nr 9806, datë 06.06.2002 “Për zonat e mbrojtura”,(www.mjedisi.gov.al).

³²⁶Botime të Fletores Zyrtare nr. 81 , datë 13.07.2012 (www.qbz.gov.al)

³²⁷ (Ministria e Mjedisit) (www.mjedisi.gov.al)

³²⁸Projekt-Ligji për “Administrimin e Fondit Pyjor dhe Kulloror Kombëtar ë Republikën e Shqipërisë”;

³²⁹www.mjedisi.gov.al

³³⁰Ligji nr. 9533, datë 15.05.2006, për disa ndryshime në Ligjin Nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” (www.mjedisi.gov.al)

vendore” zëvendësohet me termin “bashki”. Bashkitë dhe pronarët privatë të kullotave dhe livadheve duhet t’i japin Ministrisë së Mjedisit të dhëna të nevojshme për inventarizimin e kullotave që zotërojnë³³¹.

Urdhën nr. 1937, datë 21.10.2014 “*Mbi përcaktimin e detyrimit të subjekteve për të zëvendësuar sipërfaqet pyjore dhe përmirësuar sipërfaqet kullimore që hiqen nga fondi pyjor dhe kullor nëpërmjet pyllëzimit, ripyllëzimit dhe përmirësimit të tyre*” ka si qëllim përcaktimin e detyrimeve të subjekteve gjatë zëvendësimit të sipërfaqeve pyjore dhe kullimore. Sipas këtij urdhëri subjektet kanë si detyrim të ripyllëzojnë trefishin e sipërfaqes që hiqet nga fondi pyjor për pyjet trungishte, dyfishin e sipërfaqeve kullimore dhe sipërfaqen e njëjtë të sipërfaqes me bimësi pyjore³³².

Urdhën nr. 444, datë 30.08.2012 “*Për procedurat e eksportit të druve të zjarrit dhe qymyrit të drurit*” synon frenimin e eksporteve të materialeve drusore kryesisht për dru zjarri dhe qymyr të drurit, aq të domosdoshëm për ngrohje për nevojat e vendit tonë³³³. Ky ligj shfuqizohet nga vendimi nr. 438, datë 08.06.2016 “Për kriteret dhe rregullat e përdorimit të pyjeve dhe shitjes së materialeve drusore e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore”.

Vendimi nr. 433, datë 08.06.2016 “*Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/ bashkive*” ka si qëllim transferimin në pronësi të bashkive të fondit pyjor dhe kullor publik, më parë në pronësi të ish-komunave dhe bashkive. Sipas këtij vendimi, sipërfaqet pyjore dhe kullimore, sipas listës së inventarit, që transferohen në pronësi të Bashkisë Durrës, janë sipas shtojcës 10... me numër rendor 1(një) deri 427 (katërqind e njëzet e shtatë), ndërsa sipërfaqet pyjore dhe kullimore që transferohen në pronësi të Bashkisë së Shijakut, janë sipas shtojcës 11... me numër rendor 1 (një) deri 30 (tridhjetë)³³⁴.

V.3. Aktorët e menaxhimit të resurseve natyrore të bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut

Konventat dhe baza ligjore e lartpërmendura përdoren dhe zbatohen nga institucionet përgjegjëse (qëndrore, vendore, institucionet kërkimore-shkencore), OJF-të dhe grupet e interesit, të cilat synojnë mbrojtjen dhe ruajtjen e qëndrueshme të resurseve natyrore. Organi më i lartë menaxhues është qeveria, e cila i jep kompetencat përkatëse ministrive dhe institucioneve vartëse të tyre. Ministrinë, që kanë lidhje të drejtpërdrejtë menaxhuese me burimet/ resurset natyrore janë: Ministria e Mjedisit, Ministria e Energjitikës dhe Industrisë, Ministria e Zhvillimit Urban dhe Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

Ministrinë dhe institucionet varëse të tyre në shumë projekte dhe plane menaxhimi janë bashkëpunuese dhe kanë përgjegjësi të përbashkëta. Me ndarjen e re administrativo-territoriale, një sërë kompetencash i janë kaluar bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut, si zbatuesit kryesor të planeve dhe strategjive afatmesme dhe afatgjata në territoret përkatëse të tyre.

³³¹Ligji nr 49/ 2016, Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullor” të ndryshuar, (www.mjedisi.gov.al)

³³²Urdhën nr. 1937, datë 21.10.2014 “*Mbi përcaktimin e detyrimit të subjekteve për të zëvendësuar sipërfaqet pyjore dhe përmirësuar sipërfaqet kullimore që hiqen nga fondi pyjor dhe kullor nëpërmjet pyllëzimit, ripyllëzimit dhe përmirësimit të tyre*”(ëëë.mjedisi.gov.al)

³³³Urdhën nr. 444, datë 30.08.2012 “*Për procedurat e eksportit të druve të zjarrit dhe qymyrit të drurit*”

³³⁴ëëë.mjedisi.gov.al (Ministria e Mjedisit)

Ministria e Mjedisitështë institucioni kryesor, i cili merret me njohjen, monitorimin dhe ruajtjen e zonave të mbrojtura (tokësore dhe detare), pasurive të botës bimore dhe shtazore dhe pasuritë klimatike. Në varësi të saj janë: Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia Rajonale e Mjedisit Durrës, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Drejtoria e Shërbimit Pyjor Krujë, Agjencia e Ujit dhe Bazeneve dhe Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare, të cilët luajnë edhe role kërkimore-shkencore.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) është krijuar mbi bazat e Agjensisë së Mjedisit dhe Pyjeve, në bazë të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011³³⁵. AKM-ja siguron dhe pasqyron gjendjen mjedisore përmes monitorimit dhe vëzhgimeve në terren.

Drejtoria e Shërbimit Pyjor Krujë është insitucioni që menaxhon, mbikqyr dhe zhvillon planin e menaxhimit të pyjeve në të gjithë qarkun e Durrësit.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura është krijuar me VKM nr. 102, datë 04.02.2015 dhe ka si qëllim menaxhimin, mbrojtjen, zgjerimin dhe funksionimin e zonave të mbrojtura në vendin tonë³³⁶. Kjo agjensi menaxhon dhe mbron të gjitha monumentet e natyrës që gjenden në bashkinë e Durrësit dhe të Shijakut. Qëllimi kryesor i saj është zgjerimi i zonave të mbrojtura dhe rritja e të ardhurave nga zhvillimi i llojeve të ndryshme të turizmit.

Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD) siguron menaxhimin dhe kontrollin e kufirit detar shqiptar dhe sigurimin e jetën në det³³⁷. QNOD-ja është institucioni kombëtar që garanton menaxhimin e integruar të burimeve natyrore, mbi dhe nënujore.

Përdorimi dhe përdorimi sa më efektiv i pasurisë natyrore nën dhe mbitokësorë kërkon një mirëmenaxhim institucional dhe ligjor përkatës.

Institucioni më i lartë, i cili mbron dhe lejon përdorimin e pasurisë gjeologjike është *Ministria e Energjisë dhe Industrisë*. Në varësi të saj janë një sërë institucionesh si: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Nisma për transparencë në industrinë nxjerrëse, Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial dhe Reparti i Inspektimit dhe Shpim Minerave³³⁸.

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) ka si funksion zhvillimin dhe mbikqyrjen e përdorimit racional të burimeve natyrore. Gjithashtu kjo agjensi propozon, konsulton dhe bashkëpunon me ministrinë në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe strategjive në fushën e minierave dhe energjisë. Njëkohësisht AKBN-ja bën promovimin e burimeve minerare, negocimin dhe përgatitjen e dokumentacionit dhe praktikave të nevojshme për dhënie e lejeve apo autorizimeve përkatëse. AKBN-ja monitoron në vazhdimësi zonat e përdorura, mbi bazën e të cilës harton dhe publikon bilancin energjistik vjetor, në nivel kombëtar dhe rajonal.

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) konsiderohet si këshilltar teknik dhe shkencor i qeverisë në fushën e gjeoshkencës në bazë të ligjit nr. 8366. Në veprimtarinë e SHGJSH-s përfshihen studimet e thelluara shkencore gjeologjike dhe metalogjenine; studime dhe promovime të mineraleve të dobishme, studime, vlerësime dhe monitorime të gjeomonumenteve³³⁹.

Sekretariati i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse përfaqëson një Ent Publik të financuar nga qeveria dhe donatorë vendas e të huaj. Qëllimi kryesor i

³³⁵ www.akm.gov.al (Agjencia Kombëtare e Mjedisit)

³³⁶ www.akmz.gov.al

³³⁷ www.mbrojtja.gov.al (Ministria e Mbrojtjes)

³³⁸ Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Faqja Zyrtare

³³⁹ Shërbimi Gjeologjik Shqiptar

sekretariatit është realizimi i të gjithë hapave të antarësimit të vendit tonë, në Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI).

Reparti i Inspektim dhe Shpim Minerave (RISHM) ka si funksion kontrollin teknik dhe monitorimin mjedisit nëntokësor dhe sipërfaqësor të minierës, duke mundësuar sigurimin në punë dhe parandalimin e rreziqeve humane dhe mjedisore në veprimtaritë minerare.

Krahas ministrive të larpërmendura, të cilat merren drejtpërdrejt me resurset natyrore të vendit tonë, (pjesë e tyre resurset natyrore të bashkisë Durrës dhe Shijak), veprojnë edhe dy ministri që trajtojnë dhe ndikojnë në menaxhimin e hapësirave urbane dhe rurale të bashkisë Durrës dhe Shijak. Hapësirat urbane, që janë të pabarabarta, për nga sipërfaqja, dendësia e popullimit dhe intensitetit të përdorimit me hapësirat rurale menaxhohen nga *Ministria e Zhvillimit Urban*. Kjo ministri ka në varësi të saj: Agjencinë e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/ Ndërtimeve Informale (ALUIZNI), Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit dhe Agjencinë e Zhvillimit të Territorit, të cilat kanë funksione planifikuese dhe integruuese të zonave urbane³⁴⁰

Agjencia Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT), është krijuar në vitin 2009, në bazë të ligjit për planifikimin e territorit. Ajo ka funksione koordinuese dhe mbështetëse për autoritetin e planifikimit në çdo nivel hapësinor³⁴¹

Institucionet në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave janë Drejtoria e Bujqësisë në Durrës, Bordi i Kullimit Durrës, Agjencia e Zhvillimit Bujqësor Rural dhe Drejtoria e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës. Drejtoria Rajonale e Bujqësisë Durrës është krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 95, datë 13.02.2003 “Për krijimin në qarqe të Drejtorive Rajonale të Bujqësisë”. Drejtoria e Bujqësisë në Durrës ka si qëllim mbrojtjen e shëndetit të bimëve, kafshëve dhe garantimin e shëndetit të njerëzve³⁴². Në këtë mund të sigurohen informacione bujqësore, asistencë teknike dhe teknologjike për fermerët si dhe mbështetje për agroindustrinë.

Bordi i kullimit Durrës është krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 280, datë 16. 04. 2004, “ Për ngritjen e Bordit të Kullimit në Zonën e Shërbimit të Kullimit të Durrësit”. Bordi i Kullimit, i cili financohet nga buxheti i shtetit ka si detyra të shfrytëzojë dhe të mirëmbajë të gjithë sistemin e kullimit në bashkinë e Durrësit dhe të Shijakut. Në sistemin e kullimit bëjnë pjesë kanalet kulluese dhe mbledhëse, stacionet e pompave të kullimit dhe hidrovoret në të dyja bashkitë. Ky institucion çdo vit merr masa për pastrimin dhe mirëmbajtjen e të gjithë sistemit të kullimit, por njëkohësisht edhe për menaxhimin e përrrenjëve për të parandaluar procesin e erozionit³⁴³.

Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural ka si mision kryesor zhvillimin agrikor dhe rural në vendit tonë, duke mbështetur sipërmarrësit në sektorin ushqimor, përgatitjen e institucionit për përfitimin e fondeve nga buxheti i Bashkimit Europian, me qëllim ristrukturimin, modernizimin dhe specializimin në produktet dhe tregjet specifike bazuar në avantazhet konkurruese të vendit³⁴⁴.

Drejtoria e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës, është krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 719, datë 20.10.2011 “ Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e drejtorisë së shërbimeve të midhjes dhe peshkimit, Sarandë”. Kjo

³⁴⁰ (Ministria e Zhvillimit Urban)www.zhvillimiurban.gov.al

³⁴¹ (Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit)www.planifikimi.gov.al

³⁴² (Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave)www.bujqësia.gov.al

³⁴³ Bordi i Kullimit Durrës

³⁴⁴ Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (www.azhbr.al)

drejtori merret me menaxhimin e infrastrukturës së peshkimit, duke përfshirë këtu edhe portin e Durrësit si dhe qëndrën e peshkimit në bashkinë e Durrësit³⁴⁵. Në këtë institucion gjenden informacione rreth peshkimit dhe ripopullimit të kategorive ujore.


Reforma e re administrativo-territoriale ka funksione decentralizuese të pushtetit. Nëpërmjet kësaj reforme do të fuqizohet pushteti i bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut në ruajtjen e burimeve natyrore dhe mirëpërdorimin e resurseve që ofrojnë këto territore. Bashkitë drejtohen prej kryetarëve të bashkisë, të cilët e ushtrojnë funksionin e tyre së bashku me nënkryetarët dhe këshillin bashkiak. Kontrolli i njësive administrative të secilës prej bashkive bëhet nga administratori, i cili emërohet nga kryetari i bashkisë³⁴⁶.

Në mirëmenaxhimin e resurseve natyrore ka rëndësi bashkëveprimin horizontal dhe vertikal institucional dhe bashkëpunimi i këtyre të fundit me shoqërinë civile. Shoqëria civile përfaqëson të gjitha banorët vendas të bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut, por edhe investitorët kombëtar dhe të huaj. Ajo luan një rol të rëndësishëm në menaxhimin e resurseve të natyrës, pasi është e lidhur drejtpërdrejt me to. Tabela e mëposhtme shpreh raportin dhe lidhjen midis institucioneve përgjegjëse.

³⁴⁵ Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave (www.bujqesia.gov.al)

³⁴⁶ Ligji 115/2014 “ Pwr menaxhimin e ri administrativo-territoriale”

Tabela 56.. Skema e lidhjeve vertikale dhe horizontale të institucioneve menaxhuese të resurseve natyrore



Burimi: Ministria e Mjedisit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Ministria e Zhvillimit Urban dhe Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave

V.4. Planet për rehabilitime të territoreve urbane dhe rurale

Për rehabilitimin e hapësirës urbane ka një skemë planifikimi të qytetit të Durrësit që në vitin 1942, sipas së cilës qyteti do të zgjerohej përtej mureve të kalasë bizantine, në drejtim të detit dhe portit. Në ditët e sotme ekzistojnë një sërë planesh kombëtare dhe lokale, të mbivendosura dhe të ndërthurura, të cilat synojnë të përmirësojnë funksionimin dhe përdorimin e hapësirave urbane dhe rurale.

Në nivel kombëtar përmendim Planin e Përgjithshëm Kombëtar (PPK), Planin e Integruar Ndërsektorial të Bregdetit (PINsBregdeti) dhe Planin e Integruar Ndërsektorial Durana (PINs Durana), ndërsa në nivel lokal përmendim Planin Zhvillimor të Zonës Industriale Spitallë, Planin Zhvillimor të Zonës Industriale Rrëshbull dhe Planin e Integruar të Zonës Energjitike dhe industriale të Porto Romanos³⁴⁷.

³⁴⁷Bashkia Durrës (2015). *Strategjia e Zhvillimit Territorial 2015-2020*, faqe 7.

Plani më i rëndësishëm është Plani i Përgjithshëm Kombëtar (PPK-ja), i cili jep orientimet bazë për zhvillimin urban dhe rural të të gjithë vendit tonë dhe njëkohësisht edhe për bashkinë Durrës dhe Shijak³⁴⁸. Ky plan paraqitet vetëm në mënyrë hartografike dhe synon orientimin dhe zhvillimin e territoreve bashkiake në degët e ekonomisë si: shërbime, tregti, turizëm, transport, bujqësi dhe industrisë. Sipas këtij plani, në hapësirat urbane synohet rigjenerimi, konsolidimi dhe sigurimi i integruar fizik e territorial, ndërsa në hapësirat rurale të mbrohen burimet natyrore nëpërmjet krijimit të korridoreve lidhës të zonave të mbrojtura dhe jo vetëm³⁴⁹.

Një plan tjetër i rëndësishëm kombëtar, por që përfshin të gjithë territorin e bashkisë Durrës dhe Shijak, me përjashtim të hapësirës territoriale të njësisë administrative Ishëm, është Plani i Integruar Ndërsektorial Durana. Sipas këtij plani synohet që qyteti i Durrësit të shndërrohet në një qendër primare me në fokus shërbimet portuale, turistike dhe industriale. Po sipas këtij plani, qyteti i Shijakut të konsiderohet si qendër dytësore, si një alternativë banimi ekonomike mbas qytetit të Durrësit dhe njëkohësisht shndërrimit të saj në një qendër të shërbimeve bujqësore, ku mund të grumbullohen dhe të tregëtohen produktet bujqësore. Krahas këtyre dy qendrave, e rëndësishme do të ishte promovimi i Sukthit dhe Rrashbullit si qendra lokale, me rëndësi agro-turistike për hapësirat rurale.

Plani i Integruar Ndërsektorial i Bregdetit (PIN-sB) fokusohet vetëm në hapësirën bregdetare. Pjesë e këtij plani janë hapësirat bregdetare të bashkisë Durrës në një sipërfaqe prej 6 479.2 ha, nga të cilat 1 594.6 ha gjenden në njësinë administrative Durrës, 1 633.2 ha në njësinë administrative Katund i Ri dhe 3 251 ha në njësinë administrative Ishëm³⁵⁰.

Qëllimi kryesor i PIN-s Bregdetit është zhvillimi, përdorimi dhe menaxhimi i qëndrueshëm i zonës bregdetare në funksion të turizmit, pa dëmtuar pasuritë natyrore të zonës bregdetare. Krahas planeve territoriale gjithëpërfshirëse janë ndërtuar edhe plane lokale me rëndësi ekonomike, mjedisore dhe sociale.

Një nga planet me rëndësi ekonomike është ai i Zonës Industriale Spitallë (ZIS), i cili zë një sipërfaqe prej 485.08 ha³⁵¹. Zona e lirë ekonomike (Spitallë) është planifikuar në veri të qytetit të Durrësit ose në lindje të vargut kodrinor Mali i Durrësit-Spitallë. Sipas këtij plani synohet krijimi i një kompleksi industrial (përpunues dhe tregëtues) me mundësi punësimi për rreth 30 000 persona në moshë pune. Në afërsi të Zonës Industriale Spitallë është planifikuar ndërtimi i Zonës Energjitike dhe Industriale Porto Romano (ZEIPR) me një sipërfaqe rreth 859 ha³⁵². Brenda kësaj sipërfaqe parashikohet ndërtimi i TEC-eve, një impiant pastrimi, një mini-rafineri si dhe një sërë objektesh të tjera industriale. Të dyja zonat ekonomike janë planifikuar pranë dy porteve (i Durrësit dhe i Porto Romanos) dhe njëkohësisht afër qendrës më të madhe urbane (Durrësit). Në një distancë jo shumë të largët nga qyteti i Durrësit, është miratuar nga KKT-ja Zona Industriale e Rrashbullit (ZIR). Sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 105, datë 09.02.2011, kjo zonë është shpallur Zonë e Lirë me Statusin e Parkut Industrial. Zona ka një sipërfaqe prej 16.52 ha³⁵³.

³⁴⁸ AKPT (2015). *Plani i Përgjithshëm Kombëtar*. Draft, Nëntor.

³⁴⁹ Bashkia Durrës (2015). *Strategjia e Zhvillimit Territorial 2015-2020*, faqe 9.

³⁵⁰ Ministria e Zhvillimit Urban (2015). *Plani i Integruar Ndërsektorial për Bregdetin*. Korrik, Tiranë.

³⁵¹ Albania Free Trade Zone Concept Master Planning

³⁵² Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës, (2007). *Zhvillimi i Integruar i zonës energjitike dhe industriale të Porto-Romanos, Durrës*. Online.

³⁵³ Bashkia Durrës (2015). *Strategjia e Zhvillimit Territorial 2015-2020*, faqe 14.

V.5. Alternativat më të mira menaxhuese të resurseve natyrore

V.5.1. Menaxhimi i pasurive minerale

Pasuritë gjeologjike konsiderohen si pasuri kombëtare. Pasuritë minerale mbrohen dhe vihen në përdorim prej të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe Këshillit të Ministrave. Sipas planit minerar vjetor 2014 mund të shfrytëzohet zona e Shënavlashit e pasur me argjila. Në këtë hapësirë territoriale gjenden rreth 3 000 000 m³ argjila. Sipërfaqja e përgjithshme është 1 300 086 m². Vlera minimale e investimit është 28 milion lekë³⁵⁴.

Sipas planit vjetor minerar 2015, mund të shfrytëzohet zona e Metallajt prej 350 000 m³ argjila. Ajo ka një përmbajtje prej 52.5 % Al₂O₃. Sipërfaqja e përgjithshme është 10 000 m². Vlera fillestare e investimit është 21 milion lekë³⁵⁵. Përdorimi i qëndrueshëm i burimeve minerare kërkon që institucioni shfrytëzues të trajtojë mjedisin minerar duke rehabilituar mjedisin e zonës së lejuar minerare dhe të sheshit të depozitimit të mbetjeve. Minierat janë njësi prodhuese të ndërmarrjeve minerare që zhvillojnë veprimtaritë e tyre në drejtim të hapjes, përgatitjes dhe përdorimit të mineraleve të dobishme mbas gjetjes dhe sqarimit të formës dhe përmasave të vendbanimeve deri në evidentimin e rëndësisë industriale në sasi e cilësi të rezervave sipas karakteristikave të vendosjes së trupave mineral mbajtës³⁵⁶.

V. 5.2. Menaxhimi i gjeomonumenteve

Njohja dhe vlerësimi i gjeomonumenteve ka mbetur në nivele akademike. Informacioni shkencor ende nuk është vënë në përdorim për krijimin dhe organizimin e itinerareve gjeoturistike. Për promovimin e gjeomonumenteve dhe zhvillimin e gjeoturizmit është i nevojshëm bashkëpunimi i aktorëve të menaxhimit. Njohja dhe përdorimi i vlerave shkencore, edukuese dhe turistike të gjeomonumenteve në territoret e dy bashkive kërkon angazhimin e institucioneve përgjegjëse, zbatimin e legjislacionit, financim dhe teknologjinë e përshtatshme.

Një vendin tonë ekzistojnë disa institucione qendrore dhe vendore, qeveritare dhe joqeveritare në mbrojtje dhe reklamimin e gjeomonumenteve. Këtu mund të përmendim: Ministrinë e Mjedisit, Ministrinë e Turizmit dhe Zhvillimit Urban, Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, Agjensinë Kombëtare të Bregdetit, prefekurat, bashkitë dhe njësitë administrative, Fakultetin e Gjeologji-Minierave, Departamentin e Gjeografisë etj. Shqipëria është edhe anëtare e shoqatës Europiane për Konservimin e Trashëgimisë Gjeologjike (ProGEO) e krijuar në 1988 në Hollandë. Gjithashtu, Shqipëria madje ka hartuar dhe miratuar një sërë ligjesh në mbrojtje dhe menaxhimin e gjeomonumenteve, siç janë: “Ligji për mbrojtjen e mjedisit”, “Ligji për mbrojtjen e zonave të mbrojtura”, “Ligji për mbrojtjen e tokës”, “Ligji minerar i Shqipërisë”, “Ligji për strategjinë e turizmit në Shqipëri” etj.

Financimi për mbrojtjen, rivitalizimin dhe reklamimin e gjeomonumenteve mund të bëhet në dy mënyra. Mënyra e parë e financimit është investimi i drejtpërdrejtë në gjeopark dhe gjeomonument. Kjo ka të bëjë me krijimin kufijve mbrojtëse ndaj ndërhyrjeve të paligjshme të njeriut, ndërtimin e muzeumeve gjeologjike dhe tabelave orientuese dhe informuese për gjeoturistët. Ky financim mund të vijë direkt nga buxheti i shtetit por edhe nga financime lokale (bashki dhe njësi administrative). Organizatat jofitim prurëse janë financues dhe promovues mjaft të

³⁵⁴ Ministria e Energjisë dhe Industrisë. *Plani Vjetor 2014*

³⁵⁵ Ministria e Energjisë dhe Industrisë. *Plani Vjetor 2015*

³⁵⁶ Korini, Th, (2015). *Elemente të Teknologjisë së Gërmimit të Shkëmbinjve*. leksione online

mire. Mënyra e dytë e financimit ka të bëjë me trajnimin e operatorëve turistik, banorëve të zonës dhe reklamimin e zonës. Banorët e zonës shërbejnë jo vetëm si udhëheqës turistikë por ata ofrojnë lehtësira dhe shërbime shtesë.

Përdorimi i teknologjisë GIS është një mënyrë e mirë për dixhitalizimin e informacionit dhe krijimin e një sistemi dixhital rreth gjeomonumenteve. Ndërtimi i hartës dixhitale të gjeomonumenteve të bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut është një rrugë për krijimin e të gjithë hartës dixhitale të gjeomonumenteve të Shqipërisë. Informacioni shkencor dhe itineraret e krijuara do të ndihmojnë në orientimin dhe zhvillimin e gjeoturizmit.

V.5.2.1. Itinerare gjeoturistike në bashkinë e Durrësit dhe të Shijakut

Itineraret turistike janë një formë e mirë për të orientuar turistët gjatë udhëtimeve apo tureve turistike. Krijimi i itinerareve gjeoturistike është një risi për turistët dhe turizmin. Përdorimi i programit Arc Gis përbën një avantazh në dixhitalizimin e të dhënave, identifikimin e gjeomonumenteve dhe përcaktimin e rrugëve që duhen ndjekur për të arritur në to.

Itinerari I : Tiranë-Maminas-Manzë-Shën Pjetër-Ishëm-Darç-Kepi i Rodonit

Udhëtimi drejt Kepit të Rodonit është një udhëtim drejt bregdetit të lartë të bashkisë së Durrësit, në ekstremin në veri-perëndimor të tij. Është një udhëtim rreth 45 km nga kryeqyteti i Shqipërisë, Tirana. Rruga nëpër të cilën kalon ky udhëtim bën pjesë në Ultësirën Pranadriatike, ku shkëmbinjtë sedimentar, molasa të neogjenit mbulohen nga depozitimet e shkrufta të kuaternarit. Nga ana tektonike relievi përfaqësohet nga zona antiklinale Rodon-Prezë-Krrabë dhe zona sinklinale e Ishmit, të cilët në relievin përfaqësohen përkatësisht nga kodrat Rodon-Erzen dhe fusha e Ishmit. Relievi kodrinor së bashku me masivin pyjor të dushkut vërehet që nga Maminasi e deri në afërsi të Rodonit. Përgjatë kësaj rruge në afërsi të fshatit Bizë gjendet pylli i Kolndrekajve (pyll ahu), i cili është një biomonument në bashkinë e Durrësit. Veçantia e këtij pylli është se ndodhet vetëm 160 m mbi nivelin e detit, kur zakonisht ahu rritet në lartësitë mbi 1000-1200 m. Shumë pranë rrugës automobilistike ndodhet plazhi i Shën Pjetrit, me peizazhin dhe vlerat turistike të tij.

Vetëm 1-2 km në tej ndodhet Kepi i Rodonit, me përmasat, formën dhe ndërtimin gjeologjik të veçantë. Falezat e gjalla janë një peizazh me vlera shkencore dhe edukuese. Edhe më interesante e bën kepin, kalaja që ndodhet në pjesën veriore të tij. Njihet si kalaja e Skëndërbeut dhe i përket shekullit të XV. Kalaja është një monument i kulturës shqiptare për shkak të vlerave artitektonike dhe pozicionit strategjik. Nga Kepi i Rodonit mund të shihet gjiri i Drinit deri në Shëngjin në veri dhe gjiri i Lalzit deri në Bishtin e Pallës në jug. Mundësitë për të zhvilluar kamping, ecje në këmbë, sporte ujore, peshkim e bëjmë më të tërheqës kepin e Rodonit. Peshku i Rodonit e bën guzhinën durrsake më të pëlqyer. Infrastruktura e mire rrugore dhe prania e bujtinave pritëse po e ndihmon zhvillimin e gjeoturizmit.

Itinerari II: Tiranë-Ndroq-Shkëmbi i Kavajës-Durrës- Plazhi i Kallmit. Në këtë itinerar mund të vështrijmë formacionet molasike të Ultësirës Pranadriatike. Në fshatin Arapaj, shumë pranë bregdetit Adriatik gjendet Shkëmbi i Kavajës, me shtresëzimet e kithta të shtresave ranore dhe gryerjet e krijuara nga era. Përballë Shkëmbit të Kavajës vrojtohet gjiri i Durrësit dhe qyteti i Durrësit. Gjiri i Durrësit është një ndër plazhet më të frekuentuar në Shqipëri si nga turistët vendas dhe të huaj. Qyteti i Durrësit ose Dyrrahu është një nga qytetet më të vjetra në vend, i themeluar në vitin 627 para erës së re dhe Korkyrasit. Pozita gjeografike e përshtatshme, si pranë detit Adriatik dhe rrugëve më të rëndësishme (rruga Egnatia) e ka zhvilluar qytetin ndër shekuj. Qyteti i Durrësit është një park arkeologjik i nëndheshëm, ku

zbulimet më të mëdha arkeologjike janë: Amfiteatri i Durrësit, Bukuroshja e Durrësit e shekullit IV-III para erës së re, teatri Bazilika³⁵⁷ etj. Në perëndim të qytetit gjendet plazhi i Currilave dhe sferat gjigante erozionale në Malin e Durrësit. Më në veri të plazhit të Currilave gjendet plazhi i Kallmit, i cili ka edhe vlera gjeoturistike. Mënyra e formimin gjeomorfologjik dhe mundësitë e zhvillimit të turizmit banlear, në një mjedis të virgjër dhe të qetë, e bën plazhin potencial në zhvillimin e gjeoturizmit. Udhëtimet me varkë dhe motoskafë janë një aktivitet terheqës për turistët.

V.5.3. Menaxhimi i territorit urban

Konflikti i resurseve lind midis zhvillimit ekonomik dhe respektimit të ekuilibrave të ekosistemeve. Në zonat urbane, problemi më shqetësues është informaliteti. Problemi kryesor në lidhje me konsumimin e resurseve natyrore të shkaktuara nga rritja urbane nuk është shtrirja hapësinore e qyteteve, por më shumë është ndotja e mjedisit që lidhet me rritjen e shkallës së përdorimit automjeteve, ndërtimeve dhe depozitimin e mbetjeve urbane.

Në kuadër të këtyre problemeve shërben koncepti i krijimit të mjediseve të përshtatshme për të jetuar, që do të thotë më shumë hapësira publike, përfshirje qytetare, përdorimi të shumëllojshëm të tokës dhe ruajtjen e strukturave historike për të nxitur zhvillimin e ndjesisë së përkatësisë. Arsyeet e dështimit të menaxhimit shpesh gjenden në zhvillimet e paparashikuara ekonomike apo shoqërore, ndryshimet në strukturën ekonomike e teknologjike.

Në kushtet kur procesi i globalizimit shpesh gjëtohet gjithnjë e më shumë lidhjet e individëve me vendet e tyre, rilindja e identitetit lidhet ngushtë me trashëgiminë e mjedisit³⁵⁸.

V.5.4. Menaxhimi i territorit rural

Ndër synimet kryesore të Strategjisë së Zhvillimit Rural të Shqipërisë përmendet rritja e aftësisë konkurruese të sektorit bujqësor dhe agroushqimor, mbrojtja dhe përmirësimi i mjedisit duke menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme burimet natyrore, nxitja e aktiviteteve të shumëllojshme ekonomike nëpërmjet krijimit të vendeve të reja të punës etj.

Zhvillimi rural është një strategji për përmirësimin e jetës shoqërore të një grupi specifik njerëzish³⁵⁹. Zhvillimi i integruar rural synon përmirësimin e nivelit të jetesës së popullsisë rurale, përdorimin racional të pasurive natyrore në zonën rurale, sidhe zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë e sektorëve të tjerë të ekonomisë. Zhvillimi rural është i qëndrueshëm kur ai rrit në vazhdimësi prodhimet dhe të ardhurat që vijnë nga sektori i bujqësisë duke ruajtur dhe rritur cilësinë e jetës së fermerëve dhe të popullsisë, plotësimin e nevojave për lëndë të parë për agroindustrinë, industrinë, turizmin e degë të tjera të ekonomisë, duke ruajtur e përdorur në mënyrë racionale pasuritë natyrore dhe mjedisin në tërësi³⁶⁰.

Krahas hapësirës urbane, në territorin e bashkisë Durrës dhe Shijak, gjenden edhe hapësirat rurale. Kjo hapësirë zë rreth 90 % të sipërfaqës së përgjithshme të të dyja bashkive. Në brendësi të bashkisë së Durrësit, njësi administrative e Rashbullit, e Katundit të Ri dhe e Ishmit konsiderohen si hapësira rurale dhe zënë një sipërfaqe

³⁵⁷Hoti, A. (2003). *Durrësi, Epidamni-Dyrrahu*. Tiranë

³⁵⁸Karaguni, M. (2010). *Domosdoshmëria e planifikimit vizionar urban përballë tensioneve urbane*. Studime Albanologjike Nr.IV, Tiranë, faqe 443-450.

³⁵⁹Kosovrastri, A., Kola, E., Papathimiu, S. (2015). *Sfidat dhe reformat e ndërmarra për zhvillimin e qëndrueshëm rural në Shqipëri*. Studime Gjeografike Nr. 19, faqe 5-16, Tiranë.

³⁶⁰Po aty.

prej 211 km², ndërsa në bashkinë e Shijakut, rreth 93 km² konsiderohet rurale duke qenë se kjo sipërfaqe zihet nga ish-komuna e Xhazotajt, e Maminasit dhe e Gjepalajt. Pavarsisht se këto hapësira territoriale mund të konsiderohen si zona rurale, në to vihen re elementë të zonave urbane, si në zhvillimin e infrastrukturës por edhe në hapësirën që zë trualli i ndërtimit. Hapësirat rurale në të këto bashki, shtrihen si në territoret fushore, por edhe në zonat kodrinore. Si aktivitete kryesore që zhvillohen në zonat rurale janë bujqësia, blegtori, pemtaria etj.

Mundësi më e mirë, për zhvillimin e zonave rurale, është zhvillimi i fermave tradicionale. Zhvillimi i aktiviteteve që do të krijojnë mundësi punësimi, jashtë sektorit bujqësor, për të rinjtë e zonës rurale, janë krijimi i ndërmarrjeve familjare apo bizneseve të vogla, të cilat duhet të mbështeten kryesisht në avantazhet konkurrese që ka fshati. Ndër këto avantazhe mund të renditen pasuritë mjedisore e të traditës historike e kulturore, prodhimet artizanale e produktet ushqimore tradicionale, klima, relievi shumëllojshmëria dhe bukuritë e peizazhit, pyjet etj. Përdorimi efektiv i këtyre mundësive bëhet i mundur vetëm në rastet kur menaxhimi i të gjitha kapaciteteve të mësipërme realizohet si produkt i punës që duhet të bëjnë komunitetet profesionalisht të përgatitura, pjesa më vitale e të cilave janë të rinjtë dhe të trajnuarit. Zhvillimi i kapaciteteve për punësim të të rinjve në zonat rurale bëhet nëpërmjet nxitjes dhe mbështetjes së aktiviteteve ekonomike alternative, jashtë sektorit bujqësor, të tilla si fermat tradicionale.

Ferma tradicionale është njësi ekonomike prej nga marrin udhë prodhimet tradicionale, ushqimet “Made in Albania”, është njësi që krijon mundësi reale për demonstrimin e traditës dhe etno kulturës së zonës, është ferma ku mbahen kafshët e racës lokale (pasardhëse e kafshëve që kanë populluar në shekuj këtë rajon, është ferma që fton këdo ta prekë, të bëhet pjesë dhe të ndjehet si të ishte vetë ai që punon në kushtet dhe sipas rregullave të ndjekura në shekuj nga banorët vendas. Ferma tradicionale është subjekt me potenciale prodhuese të shumëllojshme. Ajo është njësi ekonomike që zotëron varietetet më të dallueshme për punësim; është njësi rreth të cilës dhe më të cilën mund të ndërtohen strukturat dhe zbatohen programe për zhvillimin e agroturizmit. Në të mund të sigurohet realizimi i vlerës së shtuar në prodhimin bujqësor e blegtoral, (bio), e cila është e konkurrese në tregjet kombëtare dhe globale³⁶¹.

Aktualisht qeveria subvencionon pjesë të investimeve që bëhen në bujqësi, pemtari, frutikulturë, blegtori dhe në industrinë e agropërpunimit. Nuk është trajtuar ende ideja e subvensionëve në aktivitetet jo-bujqësore. Jashtë vëmendjes ka mbetur edhe mbështetja e iniciativave që synojnë zhvillimin e fermave tradicionale, ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të biodiversitetit në bimët dhe kafshët bujqësore. Nuk ka programe subvensionimi falas dhe deri në mbështetjen financiare me *fond grand* për ngritjen e një ferme tradicionale, për të cilin mund të përdoret si iniciator të progresit, numri i fermave që vizitojnë fermën në vit.

V.5.5. Menaxhimi i pasurive klimatike

Hapësira territoriale e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut merr sasi të konsiderueshme rrezatimi diellor, e cila vjen në formën e energjisë diellore. Duke qenë se territoret e Durrësit dhe Shijakut marrin rreth 2 606 orë³⁶² me diell në vit, ajo konvertohet në 192.38 kkal/cm² në vit. I gjithë territori në studim merr rreth 96 768

³⁶¹ Kume, E (2011). *Mbështetja për zhvillimin e qëndrueshëm të fermave tradicionale-mundësi vetpunësimi për të rinjtë në zonat rurale*. Simpoziumi I VII^{te} Ndërkombëtar (Biodiversiteti, Ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm- faktor kyç për zhvillimin rural), Tiranë.

³⁶² Instituti Meteorologjik Shqiptar (1975). *Klima e Shqipërisë*. Tiranë

* 10^7 kËh gjatë një viti. Duke u mbështetur në ligjin e parë dhe të dytë të termodinamikës, nxehtësia diellore mund të shndërrohet në energji elektrike. Në kushtet e problemeve të mëdha globale, të pakësimit të burimeve energjitike (të parapërtëritshme) dhe rritjes së numrit të popullsisë, është e rëndësishme ndërmarrja e masave për kursimin e energjisë dhe investimi në përdorimin e burimeve të pashtershme. Territorët e të dyja bashkive të lartpërmendura gjenden nën presionin e madh të konsumit të përditshëm familjar, publik dhe ekonomik të energjisë, prandaj është i rëndësishëm përdorimi i energjisë diellore. Kthimi i energjisë diellore në nxehtësi dhe elektricitet mund të realizohet nëpërmjet pajisjeve fotovoltanike (PV-modulet diellore), paneleve diellore termike dhe paneleve diellore me përqëndrim. Lidhja e moduleve individuale me njëra-tjetrën mund të mund të furnizojnë me energji një shtëpi të terrë.

Energjia diellore mund të përdoret direkt në funksionimin e pajisjeve elektrike, për ndriçim, për ngrohjen e ujit të dusheve, ngrohjen e banesave dhe ftohjen gjatë muajve të nxehtë të verës. Duke qenë se shumica e ndërtimeve të banimit në bashkinë Durrës dhe të Shijakut nuk janë me termoizolim, por shtëpi private 2 deri në 3-kate, ngrohja e tyre ka kosto të lartë ekonomike për konsumatorin. Energjia elektrike e përdorur në të dyja bashkitë prodhohet nga hidrocentralët, të cilët gjatë verës, meqenëse se ka reshje më të pakta, prodhojnë më pak energji elektrike. Duke qenë se pjesa më e madhe e ndërtimeve në këto territore janë private dhe kanë sipërfaqe të mëdha të terracave dhe çative, krijojnë lehtësira teknike në instalimin e paneleve diellore.

Energjia diellore është një furnizues i mirë në degën e industrisë dhe sidomos industrisë së turizmit. Në territorin e Durrësit dhe të Shijakut zhvillohet turizmi dhe sidomos ai banlear (gjatë periudhës qershor-tetor) dhe për rrjedhojë rreth 80% e konsumit të energjisë i takon kësaj periudhe. Përdorimi i energjisë diellore përbën një ulje të koston energjitike për çdo biznes. Energjia diellore është e përdorshme edhe në bujqësi, në ngrohjen e serrave apo energjinë në ujitjen e tokave bujqësore.

Një sistem i thjeshtë fotovoltanik, i përbërë nga një panel fotovoltanik 50-100Ëatt, nga një paketë elektronike rregulluese 8A, bateri 50-70 Ah, 5-7 llamba LED dhe nga një siguresë 15 A (12 Volt) kushton 300-500 euro, në kosto fillestare³⁶³. Një pompë fotovoltanike me 500 Wat, e cila është zhytëse dhe mund të nxjerrë ujë deri në thellësinë 50 m, kushton rreth 2200 euro³⁶⁴. Energjia fotovoltanike mund të përdoret edhe në blegtori e më gjerë, si për ndriçim dhe sigurim të ujit të pijshëm për bagëtinë.

Potenciali fotovoltanik nuk është i njëjtë për planet e lëvizshme dhe ato të palëvizshme. Rrezatimi i përgjithshëm vjetor duke përfshirë edhe rrezatimin e shpërndarë, për një plan të palëvizshëm dhe në kushtet e një moti të kthjellët është rreth 3996 W/ m²³⁶⁵. Gjatë stinën së verës territorët e Durrësit dhe të Shijakut kanë vlerat më të larta të rrezatimit diellor, deri në 1300W/ m² pasi mbizotëron moti anticiklonik. Në stinën e pranverës dhe të vjeshtës rrezatimi mesatar diellor është rreth 100-150 W/ m². Vlerat më të larta të rrezatimit diellor i ka muaji gusht (452 W/ m²). Vlerat e rrezatimit diellor mesatar në plan të lëvizshëm me dy akse janë rreth 23% më të larta se ato mesatare në plan të palëvizshëm, e cila arrin rreth 5388 W/ m²

³⁶³ Beka, I. (2014). *Të nxisim dhe mbështesim përdorimin e energjisë diellore në Shqipëri*. GIZ Albania, Tiranë

³⁶⁴ Po aty.

³⁶⁵ Prifti, A. (2015). *Vlerësimi i burimeve fotovoltanike në Shqipëri në varësi të kushteve fiziko-gjeografike dhe social-ekonomike*. Studime Gjeografike Nr.18, faqe 197-210, Tiranë.

³⁶⁶.Shpërndarja stinore e këtij rrezatimi është i ndryshëm gjatë 4 (katër) stinëve, në verë 35%, në pranverë 27%, vjeshtë 24% dhe gjatë dimrit 14%. Muaji me sasi më të vogla të rezatimit është dhjetori (203 W/ m²). Sasinë më të madhe të rrezatimit të pasqyruar e ka muaji qershor me (190 W/ m²). Sipas vlerësimit të Priftit, A.: “nëpërmjet sistemit FV mund të përfitohet rreth 20-30% e energjisë që konsumohet në çdo familje të bashkisë Durrës dhe Shijak”.

Krahas pajisjeve fotovoltanike, në përthithjen e energjisë diellore përdoren edhe panelet diellore termike dhe me përqëndrim. Pavarësisht se territoret e Durrësit dhe Shijakut marrin sasi të konsiderueshme të energjisë diellore, gjatë vitit ndryshon këndi i rënies së rrezeve të diellit dhe për rrjedhojë duhet të ndryshojë e këndi i vendosjes optimale të paneleve diellore. Sipas të dhënave të Institutit Hidro-Meteorologjik Shqiptar, në territorin e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut, Këndi Optimal Vjetor është 38.33⁰. Gjatë periudhës së verës Këndi Optimal është 29.24⁰, ndërsa gjatë periudhës së dimrit 57.67⁰. Në tabelën e mëposhtme jepen këndet optimale vjetore dhe sipas periudhave të vitit.

Tabela 57.Këndet optimale të vendosjes së paneleve në bashkinë Durrës dhe Shijak

Këndi	Këndi Optimal Vjetor	Këndi Optimal Veror	Këndi Optimal Dimëror
Bashkia Durrës/Shijak	38.33	29.24	57.67

Burimi: Instituti Hidro-Meteorologjik Shqipëtar

Burimet e dritës konsiderohen si burime të qëndrueshme dhe të pashtershme, të cilat sjellin qëndrueshmëri ekologjike, ekonomike dhe zhvillim human. Pavarësisht koston fillesare të instalimit të tyre, gjatë prodhimit të energjisë diellore nuk gjenerohen ndotës mjedisorë dhe humanë. Për më tepër panelet diellore nuk kanë kosto (ekonomike dhe mjedisore) gjatë përdorimit të tyre dhe kanë siguri e lehtësi në përdorim.

V.5.6. Menaxhimi i pasurive ujore

Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve ujore kërkon eksplorimin, prodhimin, përpunimin, shkarkimin dhe trajtimin e qëndrueshëm i tyre. Në territorin e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut ka rëndësi të respektohet integriteti i detit Adriatik, i lumit Erzen dhe Ishëm, i liqeneve bregdetare dhe ujëmbledhësave, nëpërmjet përdorimit racional dhe kontrollit të shkarkimeve të ndotjeve. Menaxhimi i integruar i detit Adriatik përfshin parandalimin e ndotjeve detare prej anijeve që qarkullojnë nëUjërat territoriale të Durrësit, si dhe i ndotjeve prej kanaleve kullues që derdhen në vijën bregdetare.

Ujërat e lumit Erzen dhe Ishëm duhen mbrojtur nga mbetjet ngurta dhe të lëngëta që derdhen përgjatë shtratit të tij, që nga burimi e deri në afërsi të grykëderdhjes. Për ruajtjen e burimeve ujore në territoret e bashkisë së Durrësit dhe Shijakut duhet të rritet përdorimi i burimeve alternative të ujit si: ujërat e ricikluara, ujërat e shiut dhe ujëmbledhësat³⁶⁷. Në bashkinë e Durrësit duhet vënë në funksion

³⁶⁶ Prifti, A. (2015). *Vlerësimi i burimeve fotovoltanike në Shqipëri në varësi të kushteve fiziko-gjeografike dhe social-ekonomike*. Studime Gjeografike Nr.18, faqe 197-210, Tiranë.

³⁶⁷ STOA (2013). *Sustainable management of natural resources ëith focus on ëater and agriculture*. Final Report.

landfilli i Kënetës, i cili duhet të riciklojëujërat e ndotura të kanaleve kullues të të dyja bashkive. Nga 35 ujëmbledhësat që ekzistojnë, vetëm 13 prej tyre janë në funksion. Për të ndihmuar zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë në fushën e Durrësit ka rëndësi investimi në rikthimin e funksionit të tyre ujitës.

V.5.7. Menaxhimi i hapësirave agrokulturore

Toka dhe të mirat që vijnë prej saj janë marrë falas dhe janë nënvlerësuar nga qytetërimet, si në të shkuarën dhe në të tashmen. Toka konsiderohet një resurs i paripërtëritshëm për jetëgjatësinë e njeriut. Për të kuptuar nëse toka bujqësore është përdorur në mënyrë të qëndrueshme është e rëndësishme të merren parasysh treguesit ekologjik, teknik, social-ekonomik dhe kulturor. Te treguesit ekologjikë futen cilësia e tokës, cilësia e ujërave nëntokësore, niveli i biodiversitetit, shëndeti human. Treguesit teknikë janë aksesimi mbi tokën, disponueshmëria e mjeteve dhe mekanizmave të ndryshëm. Treguesit social-ekonomikë janë vlerat ekonomike që vijnë nga përdorimi i tokës. Treguesit kulturorë vlerësohen si treguesit e nivelit të edukimit human.

Koncepti i menaxhimit të tokës bujqësore nënkupton hartimin dhe implementimin e vendimeve rreth asaj sesi burimet tokësore do të shpërndahen dhe përdoren të bazuara në një sërë nevojash dhe objektivash të përkufizuara mirë. Menaxhimi i qëndrueshëm i tokës ndikon në reduktimin e nivelit të varfërisë, në zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, rritjen e standardeve të jetesës dhe në reduktimin e papunësisë³⁶⁸.

Rritja e shpejtë e popullsisë në territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut, po sjell degradim të tokës bujqësore. Me degradim të tokës do të kuptojmë reduktim të vlerës ekonomike nga të mirat dhe shërbimet ekologjike që ofron toka, si rezultat i veprimtarisë njerëzore dhe evolucionit bio-fizik natyror³⁶⁹. Për të përmirësuar dhe rikthyer vlerën maksimale ekonomike të tokave është i rëndësishëm aplikimi i menaxhimit të qëndrueshëm të tokës. Zbatimi i praktikave të menaxhimit të tokës, në funksion të rritjes së pjellorisë së saj, ndihmojnë në mbrojtjen nga degradimi. Punimi i tokës, plehrimi dhe ujitja sipas teknologjive të duhura përbën një investim shumë të vyer për njerëzimin³⁷⁰.

Të kujdesesh për tokën do të thotë ta ruash dhe përmirësosh resurset që përmban toka. Qëllimi kryesor është parandalimi i dëmtimit dhe rehabilitimi i tokave bujqësore. Tokat e kripura që gjenden në bashkinë e Durrësit kanë nevojë për kullim, nivelim dhe punim të tokës, shpërlarjen dhe mbjellja e bimëve bujqësore. Krahas kullimit, për përmirësimin e tokave të kripura mund të përdoret mënyra e shpërlarjes së tyre. Për të vlerësuar kërkesat për shpërlarje është e nevojshme të njihen kripëzimi i ujërave të ujitjes (Ecu) dhe toleranca e bimëve ndaj kripëzimit të tokës (ECe). Përmirësimi i tokave të kripura kërkon përfshirjen e procesit të bimët bujqësore më të përshtatshme për tu mbjellë në këto toka janë elbi, panxhari, festuka, melilotusi, loliumi, sorgumi dhe pambuku, pasi kanë qëndrueshmëri më të lartë ndaj kripëzimit. Kultivimi i tyre ndikon në pasurimin e tokës me lëndë organike, e cila ndikon në përmirësimin e cilësive fizike dhe kimike të tokës.

Tokat me cilësi të mira (tokat e thella me pjerrësi të butë, me teksturë të mesme, strukturë të mirë, të pasura me lëndë organike dhe ushqyese për bimët) reagojnë shumë më mirë ndaj menaxhimit të përshtatshëm, duke përfshirë punimin, plehrimin etj. Kujdesi ndaj tokës shprehet edhe në mënyrën e kultivimit të bimëve,

³⁶⁸ Kombet e Bashkuara (KB)

³⁶⁹ Co-PLAN, Revista Periodike Shkencore “Habitat” 1, faqe 22

shkallës së përdorimit të kimikateve bujqësore, llojit të ujitjes, përdorimit të qarkullimit bimor dhe masave të marra ndaj procesit të erozionit.

Kultivimi i bimëve mund të bëhet me rreshta ose në formë të shpërndarë. Një pjesë e kulturave të arrave si perimet, patatet, fasulet, disa lloje drithërash dhe drufrutorët kultivohen në rreshta. Mënyra e kultivimit në rreshta ndryshon nga njëra bimë në tjetrën, në varësi të dendësisë, thellësisë e mbjelljes dhe gjerësisë së rreshtave. Kultivimi i në rreshta nxit erozionin e tokës, përderisa një pjesë e sipërfaqes së tokës mbahet e pambuluar. Kjo pjesë e sipërfaqes së tokës, shumë e ndjeshme ndaj erozionit, qoftë edhe nga reshjet verore të rrëmbyera. Shumica e bimëve që kultivohen në rreshta nuk zhvillojnë një shtresë rrënjore të trashë dhe me shtrirje të gjerë, duke e lënë tokën subjekt të proceseve të erozionit. Duke qenë se rreth $\frac{1}{4}$ e tokave agrokulturore kultivohet në rreshta ka rëndësi mbjelja e kulturave bujqësore mbuluese midis tyre. Kultivimi i bimëve mbuluese të sipërfaqes së tokës si tërfili, lupini, elbi, batha etj, në sajë të zhvillimit intensiv të rrënjëve në shtresën sipërfaqësore të tokës prej disa centimetrash, i jep tokës një qëndrueshmëri të lartë ndaj erozionit. Këto bimë duke mbuluar sipërfaqen e tokës pakësojnë forcën goditëse të pikave të shiut, duke minimizuar efektin dispergues të tyre.

Përdorimi i kimikateve bujqësore është një praktikë që aplikohet gjerësisht dhe synon mbrojtjen e prodhimit nga sëmundjet, dëmtuesit dhe barërat e këqia. Përdorimi i herbicideve për kontrollimin e barërave të këqia, në kushtet e kultivimit të bimëve pa punimin e tokës paraqet disa avantazhe në krahasim me sistemet e tjera të bujqësisë. Avantazhi më i madh i këtij sistemi është mbrojtja e tokës nga erozioni, qoftë edhe në kushtet e kultivimit të tokave të pjerrëta, pasi eviton punimin e tokës, e cila mbahet e mbuluar nga një shtesë bimore. Avantazh tjetër është cilësia dhe kostoja e ulët e herbicideve.

Ujitja është një praktikë bujqësore e përdorur në periudhat e thata të vitit. Përdorimi i ujitjes mund të bëhet në disa mënyra. Ka rëndësi përshtatja e mënyrës së ujitjes me llojin e kulturës bujqësore. Më e zakonshme është ujitja me brazda, e aplikuar gjerësisht në bimët që mbillen në rreshta (prashitëse). Tokat bujqësore të territorit të bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut gjenden në fushën e Durrësit, ndërsa ujëmbledhësat gjenden në zonat kodrinore, çka mundëson vënien në praktikë ujitjen me brazda. Ujitja me përmytje, ndonëse jo e rekomanduar, mund të praktikohet në bimët mbuluese. Metoda me shihedhje mund të përdoret në kulturat bujqësore me lartësi të vogla, si perime dhe foragjere. Metoda me pika mund të përdoret në pemëtari dhe vreshtari, sidomos në rastet kur aplikohet sistemi bujqësor intensiv.

Qarkullimi i bimëve përcaktohet si alternimi sistematik i bimëve nga njëra fushë në tjetrën, qëdo të thotë që bimët pasardhëse duhet të jenë specie apo varietete të ndryshme nga bimët paraardhëse. Gjatë venies në praktikë të qarkullimit bujqësor ka rëndësi të merren parasysh struktura dhe renditja e kulturave, madhësia e fushës dhe rotacioni, duke synuar ruajtjen e tokës dhe përmirësimin ekonomik-bujqësor. Qarkullimi i bimëve është qarkullimi i më shumë se një bime në fermë dhe konsiston në përshtatjen e tyre ndaj natyrës fizike e kimike të tokës, si dhe klimës lokale. Në tokat e hirta kafe të bashkisës së Durrësit dhe të Shijakut, të cilat kanë horizont humusor të thellë rekomandohet qarkullimi i bimëve me tri-katër fusha. Në tokat azonale ose aluvionale është i rekomandueshëm qarkullimi me më shumë fusha dhe me shtrirje kohore më të gjatë. Qarkullimi favorizon diversifikimin dhe ndihmon në mbajtjen në nivel të lartë të produktivitetit të tokës, duke kontribuar në balancimin e ekonomisë bujqësore dhe shpërndarjen gjithëvjetoje të punës dhe të të ardhurave të fermës. Disa nga efektet më të rëndësishme të qarkullimit të bimëve janë: reduktimi i dëmtimit nga insektet dhe sëmundje, eliminimi i mbetjeve të herbicideve,

përmirësimi i pjellorisë së tokës, përmirësime në stabilitetin e agregateve dhe punimin e tokës, përdorimi i ujit tokësor, reduktimi i erozionit të tokës dhe reduktimi i efekteve alelopatike dhe fitotoksike.

Mbrojtja e tokës nga erozioni fizik, kimik dhe biologjik, kërkon aplikimin e disa praktikave si: punimi tërthor pjerrësisë, vendosja e rreshtave të bimëve tërthor pjerrësisë, punimi me konture, plehrimi i gjelbër, tarracimi, kanalet antierozive dhe pyllëzimi i shpateve të pjerrëta³⁷¹. Për të mbrojtur tokat e punueshme nga gryerja është e nevojshme që ato të punohen në drejtim pingul me drejtimin e pjerrësisë pasi në këtë mënyrë krijohet një pengesë në lëvizjen e ujërave nga lart poshtë. Në tokat bujqësore, që gjenden në terrenet kodrinore të Malit të Durrësit dhe shpateve perëndimore dhe veri-lindore të vargut kodrinor Rodon-Prezë, kërkohet hapja e vijave antierozive pingul me drejtimin e rrjedhjes së ujërave. Këto vija copëzojnë gjatësinë e shpatit të pjerrët në nënjësi dhe ndërpresin rrjedhjes sipërfaqësore. Pjerrësia e vijave antierozive, që janë edhe vija kulluese, duhet të jenë në kufij 1-3 %.

Në sistemet kodrinore ku është zbatuar praktika e brezarimit, ka rëndësi përmirësimi dhe mirëmbajtja e brezareve pasi redukton pjerrësinë natyrore të terrenit. Krahas tyre për mbrojtjen e tokës nga erozioni është i nevojshëm prania e vegjetacionit, i cili ndikon në reduktimin e efektit disperues të pikës së shiut dhe sasinë e shpejtësisë së rrjedhjes sipërfaqësore. Këto ndodhin pasi mbulesa bimore amortizon goditjen e pikave të shiut direkt mbi grimcat e tokës duke sjellë kështu dispergim minimal, rruajtje të strukturës dhe aftësive infiltruese të tokës, zvogëlim të sasisë dhe shpejtësisë së rrjedhjeve sipërfaqësore. Efektet më të forta mbrojtëse i kanë pyjet, livadhet natyrore dhe të kultivuara, bimët e kultivuara me densitet të madh të mbulesës dhe në fund bimët prashitëse.

V.5.8. Menaxhimi i pasurive të biodiversitetit

Territoret natyrore të bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut janë të pasura me lloje të ndryshme gjenetike me vlera ekonomike përdorimi dhe mospërdorimi, me vlera ekologjike, estetike dhe etike³⁷². Vlera ekonomike e tyre është vlera potenciale që pasuria gjenetike dhe llojore i ka ofruar banorëve të bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut. Njeriu varet nga gjallesat jovetëm për sigurimin e ushqimit por edhe nga fakti se ato janë burimet bazë e prodhimit të barnave mjekësore dhe produkteve të tjera industriale. Krahas vlerës ekonomike, biodiversiteti i këtyre territoreve ka vlera ekologjike, të ndërvarësisë llojore me njëra-tjerën, vlera estetike ose të peizazhit dhe vlera etike, që lidhet me të drejtën e llojeve për të jetuar dhe ekzistuar në tokë.

Vlerat e habitateve dhe të llojeve ruhen, kontrollohen, përmirësohen dhe rehabilitohen nëpërmjet praktikave të menaxhimit të qëndrueshëm të biodiversitetit. Menaxhimi i biodiversitetit kërkon ndërhyrjen e njeriut për mbrojtjen e gjendjes funksionale të larmisë biologjike³⁷³.

Tre parimet bazë për mbrojtjen e biodiversitetit janë: ruajtja e tij, studimi dhe përdorimi i qëndrueshëm i biodiversitetit. Njihet dy lloje ruajtjesh: In-situ dhe Ex-situ. Ruajtja In-situ është ruajtja e ekosistemeve, habitateve natyrore dhe kujdesi për ruajtjen e popullatave të bimëve në mjediset e tyre natyrore. Rëndësi të veçantë ka ruajtja e bimëve dhe kafshëve të kërcënuara për tu zhdukur. Biodiversiteti duhet ruajtur nga zjarret, kullotat e rënda, shpyllëzimet, ndotja dhe gjuetia. Krahas tyre ka edhe faktorë të tjerë. Këputja apo shkullja e luleve nga natyralistët apo koleksionistët e bimëve që kanë njohuri botanike për bimët e rralla apo speciet lokale mund të

³⁷¹ Gjoka, F. (2015). *Pedogjeografia*. Tiranë.

³⁷² Dollma, M. (2012). *Ekologji Humane*. Tiranë.

³⁷³ Klasifikimi Metodiko-Teknike për Mbrojtjen e Biodiversitetit

shkaktojë zhdukjen e asaj bime nga një areal i caktuar. Njëkohësisht përmirësimet bujqësore çojnë në pakësimin apo zhdukjen e disa habitateve natyrore për disa bimë të caktuara. Edhe futja e pesticideve qoftë qëllimisht apo aksidentalisht mund të çojë në pakësimin e konsiderueshëm të specieve të veçanta bimësh dhe kafshësh.

